



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 13 dhe 17 MAJ 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
13. i 17. MAJA 2010. GODINE**

**MAJ – MAJA
2010**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Ibrahim GASHI**, anëtar i Kryesisë së Kuvednit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatohet në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojmë kemi të paraqitur për fjalë. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!
Faleminderit shumë për mundësinë që t'i them vetëm dy fjali. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së t'i uroj profesor Sabri Hamitit Urdhrin Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, urdhër ky i ndarë nga presidenti Topi me rastin e 60 – vjetorit të lindjes së tij, që është respekt për punën e tij dhe respekt për Kosovën. Prandaj, urime profesor, i keni bërë nderë edhe Kuvendit edhe Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Edhe unë i shpreh urimet në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Vështirë se të dalin fjalë nderimi për Qeverinë, nëse analizojmë me vëmendje atë që po ndodhë në Kosovë. Nëse e analizojmë marshimin e minatorëve para 20 vjetëve për ta mbrojtur Kosovën dhe nëse analizojmë marshimin e minatorëve pas 20 vjetëve për të kërkuar kafshatën e gojës, e kemi vështirë të mendojmë se çka po bëjmë ne.

Në Republikën më të re të botës, në Republikën e Kosovës po ndodhin gjëra shumë të çuditshme dhe askush as nga Kuvendi, as nga Qeveria nuk jep përgjegjësi. Sikur të kishin ndodhur këto gjëra në një shtet demokratik, Qeveria do të lejonte rrugën për zgjedhje të reja, por kjo te ne nuk ndodhë, sepse vështirë që dikush të jep urdhër që ta çojë vetveten në burg. Prandaj, Kosovës i duhet një prokurori e fortë që ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Prandaj, Kosovës i duhet një gjyqësi e fortë që ta luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Është lehtë për të ardhur deri te përfundimi, nëse e analizojmë politikën, ta zëmë, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse gjysma e votave të Lidhjes Demokratike të Kosovës janë në Prishtinë dhe Prishtina kërkon diçka tjetër, ndërsa Kryesia bën diçka tjetër. Unë besoj që në një të ardhmen të shkurtër këto vota të Prishtinës nuk do t'i kenë më, nuk do t'i kenë për shkak se...

KRYETARI: Faleminderit!

Replikë, urdhëro! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: I nderuari kryetar,

Pa dëshiruar të replikoj, po nganjëherë me zor të detyron dikush. Unë do të doja t'ju lutem kolegëve, mos ta shfrytëzojnë Kuvendin për propagandë partiake, politike, aq më tepër mund të përdorin për vete dhe partinë e vet, por nuk u jepet kjo e drejtë t'i komentojnë zhvillimet dhe punën e partive të tjera në kuptimin e asaj, sepse ne e kemi subjektivitetin tonë, ne e bëjmë politikën tonë partiake. Se a do të ketë LDK-ja vota në Prishtinë apo jo, do të binden se do të ketë edhe tjetërkah më shumë se sa që ka tash.

KRYETARI: Faleminderit!

Një minutë, Gani Geci.

GANI GECI: Unë pyes kryetarin e Grupit Parlamentar – për çka është Kuvendi? Kurrëgjë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Nuk jam ngritur në cilësinë e deputetit që të flas për mos respektimin e Kushtetutës, që është bërë praktikë e përditshme apo për cenim të sovranitetit, apo për vizita të padëshiruara fyese dhe provokative të zyrtarëve të armatosur që defilojnë nëpër territorin e Republikës së Kosovës.

Sot jam ngritur për një çështje që për 50 vite të sistemit monist dhe 10 vite të okupimit klasik, shumë pjesë të territorit të Kosovës nuk e kanë njohur dorën e shtetit në kuptimin e ofrimit të sigurisë dhe të mundësive për jetë normale dhe, fatkeqësisht, pas dy viteve të pavarësisë së vendit, një realitet i tillë nuk ka ndryshuar.

Të nderuar deputetë,

Zona kufitare e Kosovës, e njohur me emrin Malësia e Gollakut, që përfshinë një të dhjetën e territorit të vendit, është shembull më eklatant i lënies në harresë dhe i përjashtuar nga planet zhvillimore e që duhet të tërheqë vëmendjen dhe të thërret ndërgjegjen e institucioneve të vendit. Kjo bëhet edhe më brengosëse duke pasqyruar faktin se kjo zonë është në brezin kufitar me Serbinë dhe që me politikat e shëndosha institucionale do duhej të kishte një tretman pak më të veçantë.

Gjendjen tejet e vështirë që paraqitet në këtë zonë e demonstroi fakti që afër 40 fshatra të kësaj treve janë të izoluara tërësisht nga mungesa e infrastrukturës rrugore. Unë po përmendi vetëm disa prej tyre, si fshati Rakinicë, Brainë, Metërgoc, Shahiq, Gjurihec, Velegllavë e shumë të tjera. Përkundër zotimit të këtij ekzekutivi dhe të ministrisë përkatëse, që një zotim i tillë është dhënë në seancën plenare në qershor të vitit 2008, se viti 2009 do të shënon përfundimisht përfundimin e arteries rrugore Prishtinë – Mutivodë dhe Dheu i Kuq – Glllogoc – Hajkobilë, si segmente me rëndësi jetike të kësaj treve, një gjë e tillë ende nuk ka përfunduar.

Të nderuar...

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 prill 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në procesverbal? Urdhëro? Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryetar!

Po e shfrytëzoj tek procesverbal, por me sa unë di, ky Kuvend e ka miratuar Rregulloren e Re të Punës, e cila thotë që hynë në fuqi menjëherë dhe, sipas kësaj rregulloreje, një orë në fillim të seancës është për tema të lira, të cilat donë t'i trajtojnë deputetët. Prandaj, unë kërkoj që të zbatohet Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARI: Ata që deshën, e shfrytëzuan fjalën. Ju lutem, kemi hyrë në rend të ditës. A keni vërejtje në procesverbal. Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar!

Qeveritarë, deputetë të nderuar,

Unë, parimisht e mbështes punën e sekretarit dhe Sekretarisë së Kuvendit, bëjnë punë tepër të rëndë, të ndërlikuar dhe serioze, po aty – këtu ndonjëherë po thuaj se janë të pashmangshme edhe lëshimet. Në këtë rast, është fjala për një llapsus – kallamus, domethënë një lëshim teknik, ama që ka domethënie përmbajtjesore. Konkretisht, thuhet: “Riza Smaka ngriti çështjen e pagave të ulëta të pensionistëve”. Nuk është përmbajtja ajo. Po, “pensionet e ashtuquajtura jashtëzakonisht nëpërkëmbëse, që të ngriten a të zbriten në mënyrë kuantitative pagat e trustistëve pensionistë”, kjo ishte substanca, edhe Ligji që e kam apeluar, të miratohet në procedurë urgjente. Do të kisha pasur dëshirë që të bëhet ky korrigjim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj nga administrata që ta ndryshojë këtë pjesë të procesverbalit, duhet të korrigjohet kjo pjesë. Pasi nuk ka vërejtje tjera, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 prill 2010.

Pika e dytë e rendit të ditës është:

2. Koha për pyetje parlamentare

Procedimi i pyetjeve bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve. Ju e dini se tani, sipas Rregullores së Re, koha për pyetje parlamentare është 60 minuta do, të thotë tash është shtuar për 10 minuta.

Fillojmë me deputeten Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pyetja ime është shtruar më 26 prill dhe lidhet me Ligjin e punës dhe sjelljen e tij në Kuvend. 4 ditë më vonë ky ligj është miratuar nga Qeveria e Kosovës, kuptohet ashtu si zakonisht, një ditë para lajmërimit për protesta nga ana e punëtorëve të Kosovës. Prandaj, pyetja e sotshme do të jetë, duke marrë parasysh që pyetja e 26 prillit nuk është relevante.

I nderuar kryeministër,

A ka qenë kjo vetëm për të blerë paqe momentale, ashtu siç bëni zakonisht me vendime ad-hoc kur keni kriza, apo seriozisht jeni të bindur kësaj radhe që kërkesat e punëtorëve dhe të qytetarëve të Kosovës të aprovohen dhe ky Ligj, më në fund, pas shumë vjetëve të

vijë në Kuvendin e Kosovës dhe punëtorët të fillojnë t'i gëzojnë të drejtat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara Donika Kadaj, deputete, faleminderit për pyetjen tuaj!

Dëshiroj të theksoj se të gjithat që i kam bërë unë dhe Qeveria që e udhëheq, është miratimi i Projektligjit të punës nga Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 30 prill 2010 dhe puna të cilën ne e kemi bërë është ajo që i ka munguar Kosovës në 10 vitet e fundit, do të thotë kemi pritur 10 vite për të ardhur deri te miratimi i këtij ligji dhe tash është proceduar në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim dhe miratim më datën 7 maj, kështu që nuk ka qenë çështje ditësh, por që 10 vite rrafsh Kosova ka pritur për këtë projektligj dhe Qeveria e ka miratuar në mbledhjen e saj, e ka proceduar në Kuvend dhe tash Kuvendi do ta diskutojë dhe kalojë.

Dëshiroj edhe të theksoj gjërat shtesë të cilat janë të nevojshme edhe për ju, edhe për Qeverinë, edhe për Kuvendin, edhe për të gjitha institucionet dhe, natyrisht, opinionin.

Është një projektligj i harmonizuar me gjithë faktorin relevant ndërkombëtarë, i këshilluar gjithashtu dhe i standardeve më të larta të Bashkimit Evropian, ku përfshihet dispozitat themelore, themelimi i marrëdhënies së punës, të drejtat për sistemimin e të punësuarit, orari i punës, pushimi dhe mungesat, mbrojtja dhe siguria në punë, pagat dhe benificionet e të punësuarve, ndërprerja e marrëdhënies së punës, procedura për realizimin e të drejtave nga puna, organizatat e të punësuarve dhe të punëdhënësve, dispozitat ndëshkimore, dispozitat kalimtare. Pra, qëllimi i këtij projektligji, i munguar në 10 vitet e kaluara në Kosovë, është të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, procedurat e realizimit të tyre të cilat procedohen me këtë ligj, kontratën kolektive dhe kontratën e punës në përputhje me konventat ndërkombëtare të punës dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Dëshiroj të shfrytëzoj rastin, të nderuar deputetë, që sot para jush dhe Kabinetit qeveritar t'ju informoj se edhe Ligji për pensionistë do të procedohet brenda periudhës njëmuajore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Fjala deputetes Donika Kadaj – Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Kryeministër, mbaje në mend, sot një muaj do të jemi prapë në Kuvend, sepse shumë herë datat e juaja s'kanë dal ashtu siç keni thënë publikisht. Po, mua po më intereson, nuk është ndonjë fshehtësi që problem për këtë ligj ka qenë kostoja financiare e tij. A janë mjetet dhe në cilën linjë buxhetore janë, a janë siguruar mjetet për zbatimin e këtij ligji, sepse që 10 vjet ky ligj, në fakt, nuk është sjellë dhe nuk është aprovuar për shkak të koston financiare. Prandaj, nuk është që ju historikisht keni bërë diçka, por po na intereson a janë mjetet e siguruar dhe ku janë ato mjete, konkretisht?

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,
Ne nuk po plasim për histori, por për realitetin aktual. Do të thotë, është një Projektligj që, realisht, i ka munguar pa të drejtë Kosovës dhe punëtorit kosovar në 10 vitet e fundit. E theksova, ai projektligj është miratuar nga Qeveria e Kosovës, është i harmonizuar plotësisht me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me këshillimet e autoriteteve tjera ndërkombëtare të nevojshme dhe të dobishme për Republikën e Kosovës dhe institucionet e Kosovës, është plotësisht në përputhshmëri me angazhimet tona financiare edhe të buxhetit të Republikës së Kosovës, pra ka edhe mbulimet financiare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi në rendin e ditës - Pyetje parlamentare.

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Ministri s'është këtu, a doni ta bëni pyetjen? Urdhëroni!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë!

Pyetja ime është parashtuar më 27 prill 2010. Çështja: Zotëri ministër, pak ditë më parë, shpresoj se e shikon televizionin dhe këtë seancë, pak ditë më parë zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Vlora Çitaku, në një konferencë për media lidhur me njohjen e Swazilandit tregoi se, citoj: "Këso lloj notash verbale Ministrisë tonë i vinë çdo ditë".

Zotëri ministër, personalisht nuk i besoj kësaj deklaratë, prandaj a mund të na tregoni se nga cilat shtete ju kanë ardhur nota verbale, sikur të shtetit të Swazilandit, si dhe brenda këtij viti Kosova mori tri njohje, me dje, domethënë, katër, dy nga të cilat ju madje i injoruat, që flet se nuk ishin kontribut i punës tuaj. A justifikon kjo punën e juaj, misionin që Ministria e Punëve të Jashtme ka në procesin e njohjeve? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Ministri s'është këtu. Vazhdojmë, deputeti Heset Cakolli, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën!

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Çështja: Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/2, të datës 19 janar 2006, konkretisht të Aneksit IV të saj, është ndaluar importi i automjeteve motorike më të vjetra më shumë se 8 vite, të cilat klasifikohen nën kodin e nomenklaturës së mallrave 87/03, ndërsa nga korriku i vitit 2009, në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 2008/08 për homologimin e automjeteve, kërkohet që çdo automjet i importuar në Republikën e Kosovës të bëhet verifikimi sipas homologimit.

Pyetja: zotëri ministër, a jeni në dijeni se këto dy dokumente që i ceka më lart, nuk janë në përputhshmëri njëra me tjetrën dhe si rezultat i tyre po pëson qytetari i Kosovës?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Cakolli,

Konsideroj që pyetja ishte drejtuar më shumë për Ministrin e Transportit sa i përket homologimit, ndërsa sa i përket pjesës së parë të tetë vjetëve vjetërsi, ne jemi duke

rishikuar mundësinë që të rirregullohet kjo çështje në mënyrën më të mirë edhe për qytetarin, edhe për vetë buxhetin e Kosovës dhe unë do të kisha pasur dëshirë që t'ju ftoja që bashkërisht, me ekipin tim dhe me ekipet tjera relevante, të bashkëpunojmë në mënyrë që në dy javët e ardhshme, sidomos tash pas, me të 20-tin presim edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, të ulemi dhe ta rirregullojmë këtë sferë, sidomos në vjetërsinë e importit të makinave.

Sa i përket homologimit, edhe një herë do të kisha konsideruar që është Ministria e Transportit më kompetente të përgjigjet në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

HESET ÇAKOLLI: Po, zoti kryetar,
Zoti ministër,

Unë e kam shumë të qartë çështjen e homologimit edhe është në fushën e Ministrisë së Transportit dhe të Post - Telekomunikacionit, është një çështje që duhet të punohet dhe duhet të zbatohet ajo për shkak se është kërkesë e kohës dhe është në përputhshmëri edhe me direktivat e Bashkimit Evropian. Mirëpo, Aneksi IV i Rregullores së UNMIK-ut e pengon, domethënë, dhe janë në kundërshtim njëra me tjetrën sepse, vetëm një shembull dua ta marrë me këtë rast. Për mendimin tim, është absurd nëse Mercedes C – klase dhe X – klase, i prodhuar në vitin 2000 dhe me normën euro3, nuk ka të drejtë të importohet. Ndërsa, me këtë rregullore është e mundshme të importohet automjeti, për shembull, i vitit 2005 dhe nuk e plotëson asnjë kusht, prandaj këto dy dokumente mendoj që në të ardhmen duhet të harmonizohen. Ftesës së juaj do t'i përgjigjem me kënaqësi, nëse mund të kontribuoj në këtë fushë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje? Nuk ke. Faleminderit!
Vazhdojmë, deputeti Heset Çakolli, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.
Me rregullore, ju e dini që keni të drejtë t'i bëni dy pyetje dhe të merrni përgjigje.

HESET ÇAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!
Pyetja e dytë ka të bëjë me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Çështja: Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 02/-70 për sigurinë e komunikacionit rrugor, sikur edhe në Udhëzimin administrativ nr. 14/2009, qytetarëve të Republikës së Kosovës me rastin e regjistrimit të automjeteve u garantohet pajisja me leje të komunikacionit, targa dhe librezë të qarkullimit. Ndërsa, ka më shumë se 4 muaj që qytetarët e Kosovës nuk po e gëzojnë këtë të drejtë meqë, përveç se ende nuk ka filluar pajisja me targa të reja, edhe pajisja me targa të vjetra KS është e pamundur pasi që ato mungojnë.

Zoti ministër, kur do të gëzojnë këtë të drejtë të garantuar qytetarët e Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: i nderuar kryetar i Parlamentit, zoti Krasniqi,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Çakolli,
Është një çështje që me të vërtetë ka ngritur shqetësime edhe te qytetarët në përgjithësi, mirëpo unë kam përgatitur përgjigjen edhe do t'ua komunikoj.
Ministria e Punëve të Brendshme ka riiniciuar procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative për fillimin e lëshimit të targave të reja të Republikës së Kosovës. Për

shkak të vështirësive të shfaqura gjatë procedurave të rregullta tenderuese, ne ende nuk kemi lidhur marrëdhënie kontraktuale me asnjë kompani për fillimin e lëshimit të targave të reja. Ndërkohë, vështirësi kemi pasur edhe në furnizimin me targa ekzistuese për arsye të përfundimit të kontratës me kompaninë e cila ka furnizuar Ministrinë e Punëve të Brendshme me targat ekzistuese. Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar procedurat e nevojshme për lidhjen e kontratës së re për furnizim me targa ekzistuese, furnizimi i të gjithë qytetarëve dhe qendrave të regjistrimit të automjeteve me targa ekzistuese do të fillojë në fillim të javës së ardhshme dhe do të mbulohen në tërësi kërkesat e qytetarëve. Po ashtu, Ministria e Punëve të Brendshme, si institucion përgjegjës, ka filluar me procedurat e ritenderimit, në bashkëpunim me një kompani konsulente të Komisionit Evropian, që ofron këshilla profesionale në përgatitjen e procedurave tenderuese, në mënyrë që të përfundojmë me sukses lidhjen e kontratës së domosdoshme për furnizim me targa të reja të Republikës së Kosovës. Ndërsa, sa i përket librezave të regjistrimit të automjeteve, gjendja është e normalizuar në raport me kërkesat e qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, ke pyetje shtesë?

HESET ÇAKOLLI: Jo, faleminderit! Nuk kam pyetje shtesë, por dëshiroj që këtë që e tha ministri, të përmbushet sa më parë dhe qytetarët të mos....

KRYETARI: Faleminderit. Vazhdojmë, deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Sadri Ferati.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Pyetje për ministrin. Zoti ministër, në komunën e Fushë Kosovës, përkatësisht Kuvendi i Komunës në njërën prej mbledhjeve janë konstituuar organet e Kuvendit të Komunës në pajtim me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale. Në mbledhjen e cekur nuk është bërë emërimi i zëvendëskryesuesit të Kuvendit Komunal për komunitete, që i takon anëtarit të Kuvendit nga radhët e IRDK-së, zotit Bedri Mustafa, i cili ka tubuar më shumë vota në krahasim me anëtarët tjerë të zgjedhur të cilët iu takojnë komuniteteve joshumicë, ashtu siç është përcaktuar me nenin 52 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale. Me këtë rast, strukturat komunale të Fushë Kosovës pa asnjë arsytim refuzojnë emërimin e një zëvendëskryesuesi dhe kështu po bëjnë shkelje të nenit të caktuar të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

I nderuar zoti ministër, të kam informuar për këtë dhe nuk kam marrë përgjigje. E kam informuar edhe zoti Feith dhe nuk kam marrë përgjigje. Prandaj, pres zbatimin e ligjit.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuar kryetar,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,
I nderuari deputet Neziraj,

Ashtu siç e thatë edhe ju në pretendimin e pyetjes së juaj, sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale, aty ku komuniteti joshumicë përbën së paku 10% apo më shumë, duhet të procedohet me zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të asamblesë komunale. Pas pyetjes suaj, ne jemi interesuar dhe nga komuna e Fushë Kosovës kemi marrë përgjigjen se në bazë të

Ligjit për kufijtë administrativ parashikohet që një pjesë e lokalitetit të komunës së Fushë Kosovës do t'i bashkëngjitet Graçanicës dhe pikërisht janë lokalitetet të koncentruara me qytetarët e komunitetit joshumicë dhe pretendimi i komunës ka qenë se ky numër tani do të bie nën 10%. Ne nuk jemi ndarë të kënaqur me këtë përgjigje të komunës së Fushë Kosovës ngase kemi konsideruar se kjo nuk bën një fakt ligjor dhe kemi realizuar kontakt direkt me komunën e Fushë Kosovës dhe unë besoj se do të përmbushet pjesa e paragrafit 54 pika 2 e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe presim shumë shpejtë se kjo çështje do të zgjidhet konform ligjit dhe dispozitave ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë?

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! Unë veç do ta plotësoj që edhe sipas Ligjit mbi financat lokale komuna e Fushë Kosovës ka mbi 10% të komuniteteve jo shumicë, do të thotë nuk po kërkoj mëshirë, por kërkoj që të zbatohet ligji dhe ajo i takon IRDK-së që të zgjidhet për arsye se janë dy dokumente që janë të lëshuara nga Qeveria e Kosovës, se Fushë Kosova ka mbi 10% dhe në disa komuna ka edhe më pak se 10% dhe janë zgjedhur zëvendëskryesuesit, bile në Kamenicë është zgjedhur përfaqësuesi i komunitetit serb edhe pa dalë në zgjedhje. Unë nuk po kërkoj atë të mos dilet në zgjedhje, po kam dalë në zgjedhje dhe i kam fituar votat, andaj kërkoj të zbatohet ligji dhe nuk është e arsyeshme që të zhargitet deri tani. Faleminderit!

KRYETARI: Sigurisht edhe komuna, edhe Ministria e Pushtetit Lokal e kanë parasysh që duhet ta zbatojnë ligjin.

Vazhdojmë, deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Bleran Stavileci.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Komuna e Istogut është një nga komunat që plotëson të gjitha kriteret për zhvillimin e turizmit malor dhe të blegtorisë. Në debatin që patëm me qytetarët dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Blegtorëve të Istogut, brenga e tyre është lënia anash e kësaj dege të rëndësishme të bujqësisë. Është gati projekti për ndërtimin e rrugës për në vendin e quajtur Livadhet e Istogut, rrugë malore që do të lidhte vendbanimet e Istogut me këto bjeshkë të pasura me kullosa dhe do të ndikonte shumë në zhvillimin e blegtorisë dhe të turizmit malor.

Zoti ministër, a ju ka arritur ndonjëherë ndonjë kërkesë nga Qeveria komunale e Istogut lidhur me ndërtimin e kësaj rruge shumë të rëndësishme për zhvillimin e turizmit dhe të blegtorisë së kësaj komune?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

I nderuar deputet Naser Rugova,

Po ju përgjigjem menjëherë që një kërkesë e tillë në adresë të Ministrisë së Bujqësisë nuk ka arritur. Pavarësisht nga kjo, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vazhdimësi ka mbështetur komunën e Istogut dhe komunat e tjera përmes projekteve të cilat ajo i realizon, në veçanti përmes skemës së subvencioneve dhe të grandeve. Në këtë

drejtim, edhe në komunën e Istogut ka pasur investime gjithëpërfshirëse dhe mjaft të shpërndara.

Ju informoj se në projektin e subvencionimit të kafshëve të imëta kanë qenë përfitues 67 fermerë, në projektin e subvencionimit të gjedheve, pra të lopëve qumështore, kanë qenë përfitues 57 fermerë, pastaj po ashtu në projektin e subvencionimit të mbjellave vjeshtore, kulturën e grurit, kanë qenë 185 dhe projekte të tjera. Gjithsej në këtë komunë ka pasur 412 ekonomi familjare të cilat kanë përfituar nga skema e subvencioneve. Megjithatë, dihet se zonat rurale në Kosovë ballafaqohen me sfida të veçanta për sa i takon zhvillimit ekonomik, gjenerimit të vendeve të reja të punës, po në të njëjtën kohë këto zona ofrojnë mundësi reale në kuptimin e potencialit për zhvillim, të krijimit të vendeve të punës dhe të zhvillimit të turizmit rural.

Në këtë drejtim, ne kemi edhe projekte të tjera me të cilat ato i mbështesim, janë në kuadër të masës së tetë të Planit për zhvillimin e bujqësisë 2007 – 2013, janë të ashtuquajturat grupe lokale të veprimit, janë themeluar 30 të tilla në të gjitha komunat, ka pasur 13 pilot projekte edhe kjo është një mundësi edhe për komunën e Istogut, por edhe për komunat e tjera që të kemi projekte të përbashkëta, në mënyrë që ta avancojmë edhe blegtorinë, edhe turizmin malor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputet, ke pyetje shtesë? E ke fjalën!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!
Një kërkesë për këtë rrugë është bërë në Ministrinë e Transportit dhe të Post - Telekomunikacionit, por është një kosto e madhe andaj, zoti ministër, ju inkurajoj që në bashkëpunim me Ministrin e Transportit, thjeshtë të filloni realizimin e këtij projekti, që është jetik për zhvillimin e komunës së Istogut. Gjithashtu, Istogu ka edhe pemëtarë më të spikatur në Kosovë. Ju kisha inkurajuar që të merrni hapa për sigurimin e një depo frigoriferi për pemëtarët e vyeshtë të komunës së Istogut, sepse vërtet kanë nevojë të madhe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!
Ligji për pronën është një ndër ligjet më të rëndësishme të një shteti, sepse rregullon një çështje shumë të rëndësishme dhe delikate. Problemet me pronat janë të mëdha, si në aspektin e kontesteve pronësore, të trajtimit, por edhe të statusit. Me qenë se në gjykata janë diku 40.000 lëndë të papërpunuara, Qeveria duhet të kujdeset që t'u sigurojë të drejtën e pronësisë qytetarëve të Kosovës. Mos rregullimi i kësaj çështje largon edhe investitorët e jashtë.

Zoti kryeministër, kur do të hartohet dhe procedohet në Kuvend ky ligj, me qenë se në agjendën legjislative të vitit 2010 të Qeverisë nuk është paraparë ky ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!
E nderuar deputete,

Konsideroj që në bazë të procedurave të Kuvendit, ka të drejtë të delegohet pyetje te ndonjë resor tjetër, andaj kam kënaqësinë t'ju njoftoj se procesi i hartimit të këtij ligji është në fazën përfundimtare dhe ju do ta keni, besoj, gjatë verës këtë ligj, ndërsa sot do ta kemi edhe shqyrtimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi pronën e paluajtshme në Kuvend, një nga pikat e rëndësishme që do t'i diskutojmë, konsideroj pika numër 5, por edhe pjesa tjetër e legjislacionit, të cilën ju e përmendët, do të procedohet brenda kësaj vere. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Ke pyetje shtesë deputete?

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, kryetar!
Zoti ministër,

Unë dëshiroj t'ju përkujtoj disa deklaramë të zyrtarëve të Kryeministrit. Njëri nga Zyra ligjore ka thënë se do të procedohet në tremujorin e parë të këtij viti, sekretari permanent ka thënë se ky ligj nuk ekziston, zëvendëskryeministri ka thënë se ky ligj është i nevojshëm. Tani, që thatë ju verës, a mund të na jepni së paku jo datën e saktë, po muajin kur do të jetë ligji në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Sipas legjislacionit në fuqi, ne e kemi për procedim brenda këtij viti. Në qoftë se Kuvendi insiston që ta biem sa më shpejt, edhe ne do t'i mobilizojmë grupet punuese që të procedohet në periudhën më të shkurtër të mundshme. Nuk mund të them sot në cilin muaj, por në një nga takimet ose nëse dëshiron me shkrim, do t'u orientohej juve personalisht që t'ju informoj saktë për afërsisht se Qeveria kur do ta ketë në agjendën e vet për ta dërguar këtu në parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Deputeti s'është këtu. Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Ministri s'është këtu, deputet e do fjalën? Fjala deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Unë do të pres, i nderuar, sepse është pyetja për tenderin, për pajisjen e shkollave me teknologji informative, që u dha 24 milionë më shtrenjtë. Unë e kam bërë këtë pyetje një herë, zoti ministër nuk më është përgjigjur, është pjesa e dytë e asaj pyetje, shpresoj se do të vjen së shpejti, do ta informoj opinionin publik se çka ndodhi me atë tender, ku u keqpërdorën 24 milionë euro. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk janë keqpërdorur 24 milionë euro, ti e di.
Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin Bleran Stavileci.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Çështja është: Në zonën nga vijë unë, ekziston sistemi i ujitjes "Radoniqi" dhe mendoj se nuk duhet ndonjë investim aq i madh për t'i futur nën sistem të ujitjes sipërfaqet e tokës bujqësore.

Pyetja është, ministër: Në një të ardhme të afërt apo sa më të shpejtë, kur do të jetë e mundur Qeveria të mendojë për ujitjen e rreth 600 hektarë tokë bujqësore në fshatin Piranë, Randobravë dhe Reti e Ulët, si dhe për ujëmbledhësin e Dragaqinës në komunën e

Therandës, nga mund të ujitën mijëra tokë të kësaj komune dhe të komunës së Mamushës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Luljeta Shehu,

Është e vërtetë se njëri nga problemet më të mëdhenj të sektorit të bujqësisë është, pra, edhe sistemi i ujitjes, i ujitjes së tokave bujqësore. Për këtë arsye, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e bujqësisë në planin e saj strategjik njërën nga pikat kryesore e ka riparimin, zgjerimin dhe formimin e një sistemi më të qëndrueshëm të ujitjes, i cili është në kuadër të masës së tretë të kësaj strategjie.

Duke i parë të arsyeshme investimet në këtë sektor, ne kemi vazhduar me investime në infrastrukturën ujore me ç'rast kanë përfutur shumë komuna, si Prizreni, Istogu, Juniku, Gjakova, Klina, Vushtrria, Kamenica, Vitia Rahoveci, Peja, Deçani dhe Drenasi. Përmes realizimit të projekteve të rehabilitimit të sistemit të ujitjes, zgjerimit të sistemit të ujitjes dhe krijimit të pendave, deri më tani është arritur që rreth 7025 hektarë të futen nën ujitje, shuma e investimeve të cilave ka arritur në rreth 2.5 milionë euro. Po ashtu, edhe gjatë këtij viti përmes projektit të investimeve kapitale, Ministria e Bujqësisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojnë të realizojnë projekte në këtë sektor. Komunat, ndërmarrjet e ujitjes dhe fermerët e organizuar me shoqatat e ujitjes kanë mundësinë që çdo vit, pra gjatë gjithë kohës të bëjnë kërkesa pranë Ministrisë së Bujqësisë për realizimin e projekteve të ujitjes në territoret e tyre. Ministria e Bujqësisë ka ngritur principet e realizimit të këtyre projekteve të bazuara në sistemin e kriterëve të pranueshmërisë dhe në procesin e përzgjedhjes së programimit, pra të rehabilitimit të zgjerimit dhe të krijimit të pendave të reja. Përsëri po e ritheksoj që Ministria gjatë gjithë kohës pranon kërkesa, projektpropozime për sektorin e ujitjes nga të gjitha komuna, ndërmarrjet e ujitjes dhe nga shoqatat e ujitjes dhe pastaj ato i përzgjedh në përputhje me procedurat në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputete, ke pyetje shtesë? Faleminderit, edhe prej jush!

Vazhdojmë, deputeti Adem Hajdari, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj dhe ministren Edita Tahiri. As njëri, as tjetri ministër nuk janë këtu, mund ta lexoni pyetjen.

ADEM HAJDARAJ: A mund të përgjigjet kryeministri?

KRYETARI: Jo, kryeministrit sot nuk përgjigjet, se s'e ka pyetjen. E lëmë për seancën e radhës, deputet.

ADEM HAJDARAJ: Mirë, faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë, deputeti Riza Smaka, pyetje për zëvendëskryeministrat, Kuçi apo Manaj.

RIZA SMAKA: Respekte zotëri kryetar!

Zotëri kryeministër,

Cilido nga zëvendëskryeministrat do të ishte adapt për mua. Pyetja është kjo: Me bindjen se shqetësimi im referuar numrit të konsideruar të akteve ligjore gjuhësisht, terminologjikisht dhe teknikisht të dobëta, njëkohësisht mund të jetë edhe i juaji, në këtë rast ju adresohem për një diskurs konciz dhe meditim serioz, duke u nisur nga vetëm një ekzemplar, nga shumë të tjerë indikativë i cilësimit të tillë, që mund të konsistojë edhe në Ligjin nr. 03/L-134 për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare. Dispozitat e këtij ligji janë aq të papërcaktuara sa që aplikuesit e tij, qoftë edhe jurisprudentit apo jurisprudencës të shquar, pa shmangshëm i shkakton paqartësi serioze të cilat nëse do të mund t'i zgjidhte vetëm nëpërmjet interpretimeve dhe komentimeve presuptive hipotetike, nëpërmjet analogjive të caktuara. Ndër të tjera, vetëm disa, po bie fjala, thotë: “Ministria nënkupton Ministrinë përkatëse”, “ministër nënkupton ministrin”, e tjera, e tjera. Ju lutem, për të qenë ironia edhe më e madhe, jo vetëm ky ligj, po në shumë akte ligjore aplikative e tjera, shembuj të tillë ka madje shumë. Ju lutem ...

KRYETARI: Faleminderit, deputet! I ke pasur vetëm 2 minuta për pyetje. Cili zëvendëskryeministër do të përgjigjet. Fjalën e ka zëvendëskryeministri Ramë Manaj.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar kryetar, kryeministër, të nderuar deputetë,
I nderuari zoti Smaka,
Shqetësimi për kualitetin e ligjeve është i të gjithë neve. Në kontekstin e pyetjes, ne kemi filluar dhe po përcjellim përmirësimet e mundshme edhe në ligjet e tjera. Sa i përket Ligjit për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare, kemi formuar grupin punues për amendamentim. Po ju përkujtoj se Qeveria është përgjegjëse për draftet e ligjeve, ndërsa draftet kalojnë në Kuvend dhe ligji merr formën përfundimtare në Kuvend. Mirëpo, ne po punojmë dhe kemi formuar edhe grupin punues për evidentimin dhe eliminimin e kolizionit të ligjeve. Ky komision ka evidentuar deri tani dhjetëra ligje, në të cilat ka kolizion ligjesh nga fusha të ndryshe dhe tashmë fillohet edhe me eliminimin e kolizionit në ligje. Pra, procesi i ngritjes së cilësisë së ligjeve është i gjithmonshëm dhe i vazhdueshëm dhe, natyrisht, të gjithë kemi obligim që të kontribuojmë në të. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Respekte për përgjigjen kompetente të zotëri Manajt, zëvendëskryeministër. Më vjen mirë që, më në fund, Qeveria me të vërtetë e ka marrë këtë çështje tepër seriozisht se, fundi i fundit, funksioni primar i Kuvendit, përkatësisht edhe i Qeverisë është bërja e ligjeve edhe aplikimi i ligjeve, këto të tjerat janë terciare. Ju lutem, kjo është primarja e primareve. Unë, bona fide do të kisha propozuar që Qeveria ta formojë një këshill legjislativ. Ka juristë të mirë, ka me të vërtetë me eksperiencë të mira, normative që t'i krehin këto dokumente dhe si të tilla me të vërtetë do të miratoheshin më shpejt, më mirë, e pastaj do të aplikoheshin. Ju falënderohem!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetja e radhës, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Haki Demolli.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri ministër,
Aktvendimi, aktgjykimi i formës së prerë është titullus ekzekutivus, e ka pozicionin e aktit ligjor që duhet medoemos, deshëm nuk deshëm, për t'u aplikuar. Është një situatë që këtë të dhënë e kam nga kontaktet me deputetët, por edhe kam marrë të dhëna edhe

nga administrata e komunës në Pejë. Po e zëmë, për katundet e Rugovës, për Rekën e Allasë, për Haxhajt, për Bogë, për Kuqishtë, për Shkrel e tjera, janë 13 katunde, janë 860 raste juridike administrative përfundimtare, janë aktvendimet përfundimtare që u referohen afër 1000 hektarëve tokë, pronë tradicionale. Pronarët e tyre për asnjë shkak të arsyeshem janë të privuar nga e drejta elementare private...

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, fjala është për ju.

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Smaka, lidhur me pyetjen tuaj, sipas të cilës keni kërkuar përgjigje mbi moszbatimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore të formës së prerë nga ana e kuvendeve komunale, siç janë përmendur Kuvendi Komunal i Pejës, Deçanit, Burimit dhe të tjerë, fillimisht ju informoj se kuvendet komunale në fushëveprimin e tyre janë të pavarura nga pushteti qendror dhe se të njëjtat funksionin dhe mandatin e tyre e ushtrojnë në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të akteve të tjera normative, ndërsa roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është i përcaktuar qartë me ligjin e lartë cekur.

Sa i përket Ministrisë së Drejtësisë, si degë e pushtetit ekzekutiv në nivel qendror, e njëjta në bazë të dispozitave ligjore në fuqi nuk disponon me mandatin e mbikëqyrjes së pushtetit lokal dhe as të atij gjyqësor. Rrjedhimisht, kompetent për mbikëqyrjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë janë gjykatat. Për sqarim të mëtejshëm, funksioni themelor i gjykatave është vendosja meritore në çështjet juridike dhe përkitazi me këtë, përmbarimi, qoftë edhe i dhunshëm, pas kalimit të afatit partitiv i vendimeve gjyqësore dhe i atyre në procedurë administrative të cilat i plotësojnë kushtet për përmbarim në bazë të nenit 23 dhe 24 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore.

Me gjithë këtë, në pajtim me mandatin ligjor, Ministria e Drejtësisë është kompetente për hartimin e ligjeve që i përkasin fushës së drejtësisë, përfshirë edhe Ligjin për procedurën përmbarimore, i cili ligj me strategjinë legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës parashihet të amendamentohet konform standardeve ndërkombëtare, gjë që shpresojmë se do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e gjendjes së krijuar. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputet, ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: ... i nderuar, mirëpo do të isha angazhuar që ministria, përkatësisht Qeveria jonë ka autoritet edhe funksional edhe politik. Pavarësisht nga këto kompetenca që mungojnë e tjera, këto janë pasojë e akteve ligjore tonat defekte, që të bëni një trysni, sepse autoriteti i Ministrisë së Drejtësisë është shumë i fuqishëm, ekspresiv në administratat komunale, se nuk ka kurrfarë pengese. Është fjala për aktvendime administrative, gjyqësore, përfundimtare, të formës së prerë. Është fjala për pronat private. Ju lutem, është çështje vitale për qytetarët që me dekada padrejtësisht u janë privuar të drejtat e shfrytëzimit të pronave private, që janë burim i ekzistencës elementare, është çështja shumë e ndjeshme. Prandaj, do të isha angazhuar që ndoshta edhe Qeveria të japë një..., se Qeveria e ka edhe funksionin mbikëqyrës, ju lutem,

kontrollues. Nuk është fjala veç, bie fjala autorizimi ligjor, që t'i japë këtë urdhëresë, apo jo, prandaj ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi.

TEUTA HADRI: Zoti ministër,
Një ditë para se ju ta bëni vizitën e paralajmëruar në Institutin e Onkologjisë, ka shpërthyer tubi i ujit dhe ka dëmtuar aparatura shumë të shtrenjta, Akceleratorin, CT-në dhe Rezonancën magnetike. A e keni vlerësuar sa është dëmi i shkaktuar dhe a ka dhënë dikush përgjegjësi për këtë dëm?

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Kolegë të nderuar dhe kolege deputete,
Kjo është një pyetje e juaja, në të cilën unë ende nuk e kam përgjigjen. Edhe unë personalisht kam qenë i prekur me një situatë, gjatë një vizite që e kam bërë në objektin e Onkologjisë. Për mos t'ju mërzitur, kjo historia e kësaj nuk mund të tregohet në këto dy minutat, pa lidhje që po i marrim për t'u përgjigjur në pyetje e përgjigje parlamentare, por është një problem për të cilin ne po presim epilogun, ne e kemi caktuar një komision, ai është duke e bërë punën e vet. Janë konstatuar këto defekte, ka shpërthyer uji një herë, dy herë, tri herë dhe objekti në të cilën qëndrojnë këto aparatura, për të cilat unë kam qenë i tmerruar atë ditë kur i kam parë që notojnë në ujë sikur të ishim në një shtet më të prapambetur të Afrikës apo diku tjetër, na ka detyruar që ta bëjmë një komision mikst, që urgjentisht të bëhet njëfarë vlerësimi aty. Objekti ende nuk është lëshuar në përdorim për shkak se nuk ka pasur pranim teknik, domethënë është një histori kështu tipike e këtij vendi, ku një ndërtues e ndërton një objekt pa kurrfarë normativash, pa kurrfarë standardesh. Këto janë aparatura të ndjeshme, as mbrojtje nga rrezatimi nuk është siguruar, të gjitha ato. Kjo është sikur ta blinte një fshatar një televizor dhe nuk ka shtëpi e qetë në livadh televizorin. Do me thënë, më së pari janë sjellë aparaturat, pastaj është bërë objekti me dy-tri defekte. Për mos ta zgjatur, ne jemi shumë të angazhuar që këtë punë ta kryejmë, natyrisht me këto procedura ligjore. Shyqyr Zotit që nuk jemi në Kinë, se unë tash, si ministër kisha qenë i arrestuar, edhe pse e kam marrë këtë punë që një muaj ditë, se janë të dëme, dëmet janë të shumëfishta, nuk është vetëm dëme materiale, është dëmi në esencën e imixhit, dëmi i të gjithë atyre eurove që po shpenzohen për pacientët tanë që dalin jashtë apo nëpër klinika private e tjera. Domethënë, është një..., do ta quaja një katrahurë e cila do të ketë zgjidhje. Unë nga ky vend, edhe një herë ju siguroj se pasi të përfundojnë këto investigime, hetime, konstatime, komisione e të gjitha, pa lejuar që të devalvohet kjo punë, do të dal, në çdo moment jam i gatshëm të jap një raport për këtë punë, edhe ato masat që... Natyrisht, përgjegjësi duhet të ketë, nuk është puna ime tani këtu të caktoj ato gradat e përgjegjësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Mirë, ju faleminderit! Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Nenad Rashi.

TEUTA HADRI: Zoti ministër, autoritetet gjermane kanë nënshkruar marrëveshjen për adresimin e 10.000 romëve të paraqitur si kosovarë. Ata do të kthehen pjesë, pjesë në Kosovë, jo të gjithë përnjëherë. Kthimi i tyre në Kosovë do ta rëndojë skemën e ndihmës sociale dhe buxhetin e Kosovës. Pyetja: A keni bërë ndonjë strategji për kthimin e tyre dhe në cilën kategori të ndihmës sociale do të hyjnë ata? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër Rashiq!

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Poštovani zamenici premijera, ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodo Teuta,

Strategija za taj, da ga nazovem tako specifičan povratak, je već usvojena i to je bilo još u 2007. godini, i sama ta strategija je predviđala da svako od ministarstava, odnosno partnera imaju svoj deo zadatka. U ovom slučaju, što se tiče Ministarstva za rad i socijalno staranje, naš zadatak jeste da od momenta kad ti ljudi dotaknu tlo, ili na samom Aerodromu da ih mi preuzmimo i narednih nedelju dana mi se staramo o njima od samog smeštaja do prevoza, zadnjeg dana do njihove destinacije koju oni budu odredili. Samo strategija je u procesu rebaloiranja ili u jednoj analizi dodataka tih koji mogu da budu interesantni. U ovom slučaju, posle naših nedelju dana, sama opština bi trebala da preuzme odgovornost za sve ljude koji će biti vraćeni. Do sada, možda te obaveze opština nije preuzimala onako kao što bi trebalo, ali mislim da će stanje biti poboljšano posle zakona koji je pre dve sednice Vlada usvojen baš za te ljude kojima se reguliše status od onog momenta kada oni nastave da žive na Kosovu, i posle završetka te strategije, ja mislim da će bolji, ne bolji uslovi nego jasnija će biti slika njihovog položaja. U svakom slučaju, bilo ko od njih da dođe, bilo koje nacionalnosti, ne utvrđuje se o tome dali je bilo koje nacionalnosti, recimo Romske, Aškalijske, Albanske, Srpske, nego na osnovu pravnih kriterijuma, znači svi kad se vrate, imaju svoj ... i pravni status.

Još jedna informacija u vezi ovoga, u dogledno vreme, već je u izradi jedan nacrt zakona koji će imati za obavezu da sve opštine imaju svoje lokalne kancelarije za prihvatanje ovih ljudi, tako da je taj, ja sam video nacrt zakona tog. Verovatno će trebati još možda eventualno 15, 20 ili mesec dana da bi se on tehnički završio, pa će verovatno doći u vaše ruke gde ćete moći da vidite stvarno koje su to mere koje će biti preduzete i kakav će status ti ljudi imati. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

Regjia, fjalën deputetes Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Zoti ministër, në mesin e romëve të paraqitur si kosovarë, ka pasur edhe Rom nga Shqipëria, nga Mali i Zi, nga Maqedonia dhe nga Serbia e Jugut, kështu që ju a e keni bërë listën se cilët janë romët që do të kthehen në Kosovë, se duhet të jetë një listë, se nëse kthehen edhe ata të Maqedonisë, të Jugut të Serbisë e të Malit të Zi, ata do ta ngarkojnë skemën e ndihmës sociale.

KRYETARI: Ministër!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Gospodo Teuta, ja stvarno listu nisam video. Mi u ovom momentu ne možemo da znamo koji su ti ljudi koji će biti vraćeni kod nas, ali naravno da u ovom slučaju kao što ste rekli vi, nemačke vlasti znaju odakle su ti ljudi došli tad kad su došli. Verujem da je njihova data baza verovatno detaljna, tako da oni, bar ja sam ubeđen u to, neće sigurno pogrešiti za sve te ljude koji nisu sa samog Kosova. Možda dodatne informacije znamo da će ovaj broj iz Nemačke, pogotovo povećati na mesečnom nivou za 220 ljudi koji će biti vraćeni. Ali, kao što sam rekao, kroz sve ove sisteme koje sam već obrazložio, verovatno će njihova slika, njihov status biti mnogo jasniji i možda

mere koje mi ubuduće možemo da preduzmemo, budućih, znači Zakon o povratku njihovom je već usvojen na Vladi, tako da ima dobrih koraka u tom pravcu. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Sadri Ferati.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

I shtyrë nga emisioni Pulsi në KTV dhe deklarinimet publike të drejtorit të QKUK-së, Ali Sadria, dhe pas pyetjes që ia kam drejtuar ministrit të Shëndetësisë, Bujar Bukoshit, tash po i drejtohem ministrit Sadri Ferati, pushtetit lokal që ta zbardhin gjendjen lidhur me keqmenaxhimin apo shfrytëzimin e paligjshëm të pronës së QKUK-së. Komuna e Prishtinës nënshkroi kontratë me Qendrën kardiake për shfrytëzimin e parcelës për spital privat në hapësirën ngjitur me Qendrën Klinike Universitare dhe leje për ndërtimet private brenda hapësirës së QKUK-së. Sipas Udhëzimit administrativ të Ministrisë së Shëndetësisë, 08-2007 për shërbimin spitalor në Kosovë, objektet private spitalore duhet të jenë në largësi së paku 1.5 kilometra nga spitalet publike.

Ministria që ju e drejtoni, zoti ministër, është autoritet mbikëqyrës për qeverisjen lokale nëpër komunat e Kosovës. Pyetja...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Ju faleminderit për pyetjen! Ministër, mund të përgjigjesh.

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit, kryetar,

I nderuar, deputet Rrustemi,

Pas marrjes së pyetjes suaj, ne edhe një herë iu jemi kthyer komplet kësaj çështjeje që daton, pra, që nga viti 2004, dhe, edhe me këtë rast mund t'ju informoj se Ministria, duke u bazuar në mandatin ligjor, pas shqyrtimit dhe analizimit të pyetjes në fjalë, duke u bazuar në nenin 14.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, numër 03L-040, ka konstatuar se komunat kanë të drejtë ta japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme pra, konform të këtij ligji, pra që është ligj bazik. Po ashtu, bazuar në nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, numër 03-L-040, pikat se komunat kanë kompetencë të plotë dhe ekskluzive për sa i përket shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit. Bazuar në atë që u tha më lartë, legjislacioni i jep të drejtë komunës që të lidhë marrëveshje për dhënie në shfrytëzim të tokës ndërtimore. Po ashtu, kjo çështje ka qenë edhe temë e diskutimit në Kabinetin qeveritar, të datës 31.10.2007 dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e ka shfrytëzuar obligimin, përgjegjësinë dhe të drejtën e vet dhe kuvendit komunal iu është drejtuar dhe me një shkresë të rishqyrtimit të vendimit të njëjtë. Ne tani do të vazhdojmë konsultimet me ministritë e linjave, posaçërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, për të parë se kjo e drejtë e komunës a është ushtruar konform ligjeve dhe legjislacionit të ministrive sektoriale? Pra, për një përgjigje akoma më të qartë dhe përfundimtare, do të duhej një kohë pas konsultimit me kolegët.

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

NAIM RRUSTEMI: Fjalinë e fundit nuk munda ta lexoj, por ishte arsyeja pse keni thënë se vendimi i komunës është i drejtë. Keni të drejtë të deklaroheni për komuna, po a ka mundësi të ma shpjegoni edhe mua edhe qytetarëve të Kosovës, si është e mundur që arsyetimi të jetë joligjor e vendimi të thuhet që është i drejtë. Arsyetimi për ndërtimin e Spitalit brenda hapësirës 1.5 kilometra, se kur merret me qira, ka kërkesë, ka arsyetim

për çka po jepet me qira toka. A ka mundësi të na tregoni qysh është arsyetimi të jetë jo ligjor, kurse vendimi të jetë ligjor?

MINISTRI SADRI FERATI: Realisht, nuk po e di për cilën deklaratë, po e përsëris shumë publikisht, komuna ka të drejtë, është kompetente të menaxhojë me pronën komunale dhe të njëjtën për ta përdorur konform ligjeve dhe ligjin e citova, nenin dhe pikën e citova, ka të drejtë të marrë vendime në dhënien me qira, dhënien në shfrytëzim dhe formave të tjera. Ndërsa, sa i përket licencave dhe, thashë ajo nuk bazohet në Ligjin për vetëqeverise lokale. Ju shikoni më mirë 1.5, nuk besoj se 1.5 kilometër e keni nxjerrë nga Ligji për vetëqeverisje lokale. Të kujt? Ligjit për... a të Shëndetësisë. Pikërisht atë ta them, do të konsultohemi.

(Reagime nga salla)

Me leje, i nderuar deputet! E citova Ligjin për vetëqeverisjen lokale që komunës i jap të drejtë për të menaxhuar me pronën. Do të konsultohem me ministrat e linjave për të parë se a janë zbatuar ligjet dhe udhëzimet e ministrive sektoriale? Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Adem Hajdaraj, mund ta bëni pyetjen tani pasi e kemi ministren këtu.

ADEM HAJDARAJ: Po, megjithatë, po e bëj.

Çështja të cilën e kam shtruar, ka të bëjë me një vendim, respektivisht qëndrim të Qeverisë të vitit 2008, përkitazi me vazhdimin e viteve të pensionimit të profesorëve universitarë. Është thënë disa herë edhe nga ministri, nga të tjerët se ajo do të bëhet shumë shpejt, por nuk është bërë, kështu që edhe pse më se një vit kanë punuar njerëzit, profesorët, tashti kur ka ardhur ministrja e re, menjëherë e ka shkruar vendimin dhe i ka hequr nga lista e pagave, në mënyrë shumë të padefinuar. Dhe është një qëndrim jo i drejtë, përkundër vendimeve të ministrit, premtimeve të ministrit këtu në Kuvend, bile ka kërkuar ministri që të ketë përkrahje kur të vijë kjo çështje.

Është nevojë e Universitetit, është nevojë e njerëzve, është nevojë e Kuvendit të Kosovës, prandaj pyetja është - Pse nuk u....

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministre, a ke përgjigje në këtë pyetje?

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Përshëndetje, të gjithëve!

Përshëndetje, kolegë!

Dola që t'ju respektoj për pyetjen, sepse kjo pyetje nuk është proceduar në Ministri, në mënyrë që të përgatitem të jap përgjigjen. Pyetja ka të bëjë jo vetëm me Ministrinë tonë, por edhe me Ministrinë e Arsimit, prandaj nëse kam mirëkuptim, ta kem pyetjen, natyrisht të përgatitem dhe t'ua jap përgjigjen. Siç e dini, jam një kohë të shkurtër në këtë detyrë dhe, mbase do të duhej ta dija menjëherë përgjigjen, por është një çështje që do proceduar. Prandaj, le të përsëritet pyetja, le të vijë në ministrinë tonë. Unë nuk e kam pasur dhe, sigurisht, edhe me kolegun e Ministrisë së Arsimit do të bashkëpunojmë për t'iu dhënë përgjigjen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Do të thotë, nuk kemi më pyetje parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në pajtim me vendimin e Kuvendit, të datës 29 prill 2010, ka rishqyrtuar amendamentet në Projektligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Kuvendit ia ka parashtruar raportin me rekomandime për miratim.

Para se te procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pra, me vendimin e seancës plenare të 29 prillit, vendim i cili rezultoi se është i nevojshëm një harmonizimi i disa amendamenteve të Projektligjit për shërbimin civil dhe kjo ishte si rekomandim i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, janë krijuar menjëherë dy grupe punuese të dy komisioneve gjegjëse dhe me datën 4 maj, është punuar në harmonizimin e këtyre amendamenteve.

Vlen të theksohet se, unë jam falënderues për angazhimin e të gjithë deputetëve të Komisionit dhe kolegëve nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në harmonizimin e këtyre amendamenteve. Sigurisht, që ky projektligj ka rëndësinë e vet të jashtëzakonshme për miratim në kuptimin e asaj, sepse përfundimisht do të rregullohet statusi i nëpunësve civilë, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal.

Më këtë rast, unë nuk do ta zgjasja, meqë puna e këtyre projektligjeve është debatuar aq gjatë, por thërras Kuvendin për miratim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në sallë kemi 72 deputetë. Vazhdojmë të votojmë për amendamentet veç e veç. Në radhë është amendamenti i parë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim

Amendamenti 1

Votojmë tash.

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash.

Me vota 65 “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Kemi dy propozime. I pari është i komisionit funksional

Votojmë tash.

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash.

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash.

Me 60 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash.

Me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Votojmë tash.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38

Votojmë tash.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40

Votojmë tash.

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41

Votojmë tash.

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45

Votojmë tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 45.

Amendamenti 46

Votojmë tash.

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47

Votojmë tash.

Me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49

Votojmë tash.

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50

Votojmë tash:

Me 70 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenim, miratohet amendamenti 50

Amendamenti 51

Votojmë tash.

Me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 51.

Amendamenti 52

Votojmë tash.

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 53.

Amendamenti 54

Votojmë tash.

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 55.

Amendamenti 56

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 56.

Amendamenti 57

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 57.

Amendamenti 58

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 58.

Amendamenti 59

Votojmë tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti

Amendamenti 60

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 60.

Amendamenti 61

Votojmë tash.

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 61.

Amendamenti 62

Votojmë tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 62.

Amendamenti 63

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 63.

Amendamenti 64

Votojmë tash.

Me 68 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 64.

Amendamenti 65

Votojmë tash.

Me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 65.

Amendamenti 66 dhe i parafundit

Votojmë tash.

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 66.

Amendamenti 67, amendamenti i fundit

Votojmë tash.

Me 78 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 67.

Tani e votojmë tekstin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Prezentë janë 86 deputetë.

Konstatoj se me 80 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

Pasi e kemi në sallë një numër të mirë të deputetëve dhe na duhen 80 vota për pikën e 7-të të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar

Do të thotë, kërkohen 80 vota, ju e dini këtë.

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, ka shqyrtuar Propozim-amendamentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim.

Propozim-amendamentet dhe raporti me rekomandime i Komisionit funksional u është shpërndarë deputetëve. Fjalën e ka deputeti ose kryetari i Komisionit, Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisionit për Buxhet dhe Financa i kanë ardhur propozimet nga Qeveria për plotësimin e Marrëveshjes të lidhur kohë më parë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe atë, për sa i përket tri amendamenteve, ne i kemi quajtur kështu amendamente, por këto janë rezoluta të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që duhet të përfshihen në marrëveshjen që e kemi ratifikuar kohë më parë, dhe prandaj Komisioni ka konsideruar se Marrëveshja bëhet e plotë vetëm me përfshirjen e këtyre tri propozimeve ose tri amendamenteve që kanë ardhur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Materialin, sigurisht i keni përpara, ndoshta nuk ka nevojë për shpjegimin e tyre dhe Komisioni ka konstatuar se Kuvendi duhet ta miratojë...

KRYETARI: Ju faleminderit! A ka nevojë të deklarohen shefat e grupeve parlamentare? Atëherë, shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Në sallë janë 86 deputetë.

Konstatoj se me 83 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Propozim – amendamentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

Kthehemi te pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat e nëpunësve civilë

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në pajtim me vendimin e Kuvendit, të datës 29 prill 2010, ka rishqyrtuar amendamentet në

Projektligjin për pagat e nëpunësve civil dhe Kuvendit ia ka parashtruar raportin me rekomandime për miratim.

Pasi të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, ka shqyrtuar Projektligjin për pagat dhe pas seancës së kaluar, së bashku me Komisionin për Legjislacion, ka shqyrtuar të gjitha çështjet që kanë qenë diskutabile, duke i harmonizuar ato. Gjithashtu, dua të theksoj se Komisioni ka pasur parasysh edhe vërejtjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, kontributin e deputetëve dhe dua të theksoj edhe një çështje se Komisioni ka pasur edhe një bashkëpunim në me sindikatat e shërbyesve civil në amendamentimin e këtij projektligji. Andaj thërras që të mbështeten këto amendamente që ta kemi një ligj që rregullon pagat e shërbyesve civil.

Drejtimin e seancën e merr anëtari i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti deputet! Gani Koci, e ka kërkuar fjalën, në emër të Komisionit.

GANI KOCI: Unë kisha dëshiruar vetëm një sqarim. Ne e kemi pasur amendamentet në seancën e kaluar lidhur me këtë ligj dhe kontesti i Komisionit për Buxhet dhe Financa ose kontestimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, ka qenë te amendamenti 46, respektivisht më herët ishte 47. Materialin që e kemi marrë ne këtu, nuk po e shoh atë si amendament të tillë dhe kemi vetëm 42 amendamente. Kryetari ose përfaqësuesi i Komisionit funksional e tha se janë të përfshira rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Unë nuk po i shohë këto rekomandime në këtë që na është ofruar, prandaj kisha dëshiruar një sqarim rreth kësaj, në mënyrë që të mos na krijohet një konfuzitet nesër në aplikimin e Ligjit për pagat e shërbyesve civil.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Edhe një herë fjalën raportuesit për këtë Projektligj, Hajredin Hyseni

HAJREDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk ka dhënë rekomandim, por ka thënë se ka implikime buxhetore. Megjithatë, Grupi punues së bashku me Komisionin Legjislativ, ka shqyrtuar atë propozim ose të Komisionit për Buxhet dhe atë, ka qenë për shujtë dhe për rrugë dhe ne e kemi hequr prapë. Komisioni ka vendosur që të hiqet si amendament i veçantë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën prapë e ka kërkuar kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

GANI KOCI: Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e vet të mbajtur më 23.4.2010, lidhur me amendamentin 47, që i referohet nenit 23, paragrafi 1.4 të Komisionit funksional dhe Kuvendit i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk përkrah amendamentin 46, që i referohet nenit 23, paragrafi 1.4 të komisionit funksional, sepse i njëjti përmban implikime buxhetore shitesë dhe i rekomandon Kuvendit të mos e miratojë.

Ky është rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne nuk kemi paraqitur amendament, amendamenti është të mos miratohet...

(Reagim nga salla)

GANI KOCI:... Është fshirë krejt. Okej. Atëherë, pajtohem.

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Jo, mendoj se e dha sqarimin që është fshirë ai nen dhe kryetari i Komisionit për Buxhet pajtohet.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës.

Në sallë janë prezentë 86 deputetë. Vazhdojmë me amendamentin e parë, me votimin e amendamentit të parë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Amendamenti 1

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Janë dy propozime, votojmë për propozimin e Komisionit Funksional, fillimisht.

Votojmë tash.

Konstatohet se miratohet amendamenti nr. 3, versioni i komisionit funksional

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7 i deputetit Riza Smaka, pa përkrahjen nga komisioni funksional

Votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 12 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash.

Konstatohet se me 40 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash.

Konstatohet se me 51 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash.

Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19/a i cili ka dy propozime, pra propozimin e Komisionit funksional për të cilin votojmë tash.

Votojmë tash.

Konstatoj se me miratohet amendamenti i 19 me 46 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime.

Amendamenti 20.

Votojmë tash.

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash.

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash.

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Votojmë tash.

Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 37.

Para se ta votojmë amendamentin 38, fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Ka të bëjë me një shtim të pikës, te nenit 23, pas pikës 2.4, shtohet pika 2.5 si vijon: është pagtyra. A është paga e tyre apo pagesa në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pa fajin e tyre dhe në rast të pensionimit. Unë mendoj se edhe ashtu është e tepërt, sepse dihet pagesa në rast të marrëdhënies, ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe në rast të pensionimit është 2.2 ku thotë: pagesën për shkak të pensionimit, domethënë është vetëm e përsëritur. Ndoshta, anëtarët e Komisionit mund ta japin shpjegimin. Ju faleminderit!

Për përgjigje, fjalën e ka kërkuar raportuesi i Komisionit, deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Fjala “pagtyr, ka kuptimin e tri pagave, në qoftë se shkon dikush në pension, që është praktikë edhe në vendet tjera, apo në qoftë se shuhet një vend pune që t’i jepen, prej 1 deri në 3 pagat. Këtë kuptim e ka fjala “pagtyr”.

KRYESUESI: Ju faleminderit,

Vazhdojmë me votimin e amendamentit 38, pas këtij sqarimi. Lus regjinë dhe deputetët që të vazhdojmë me votim.

Amendamenti 38

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39

Votojmë tash.

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41

Votojmë tash.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti i parafundit 41

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42

Votojmë tash.

Konstatohet se me 76 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 42.

Votojmë tani për tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë prezentë 78 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim të Projektligjit në tërësi dhe votojmë tash.

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 79 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, deputetët miratuan Projektligjin për pagat nëpunësve civilë.

Vazhdojmë me pikën e radhës, pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes ndryshim-plotësimin e ligjit 03-L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Kjo nismë ligjore e Ministrisë për Ekonomik dhe Financa, është pjesë e programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përmes këtij ndryshimi, Qeveria e Republikës së Kosovës, në frymën e përsheptimit të zhvillimit të sektorit të energjetikës, të infrastrukturës rrugore dhe në përgjegjësi të gjitha elementeve që kanë të bëjnë me procedurat e shpronësimit të pronës së paluajtshme, me qëllim të arritjes së objektivave të veta në ngritjen e zhvillimit ekonomik, ka propozuar disa ndryshime të cilat përkojnë me afatet për njoftimin, vendimet përfundimtare, parashtrimin e ankesave dhe kërkesave, procedurat gjyqësore që kanë të bëjnë me shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Kryesisht ka të bëjë, e pra me përsheptimin e procedurës së shpronësimit përmes shkurtimit të afateve ligjore- procedurale, të gjitha në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira të Unionit Evropian dhe të regjionit.

Neni i cili në fakt rregullon këtë çështje, është neni 35. Në këtë pikë kemi paraparë një procedurë më të shpejtë për zgjidhjen e ankesave nga gjykata, ka qenë 60 ditë, ne konsiderojmë që 30 ditë është e mjaftueshme, dhe e cila do të mundësojë që të ketë një procedim më të shpejtë të vendimeve gjyqësore, me qëllim të arrihen edhe objektivat e zhvillimit më të shpejtë të ekonomisë në sektorët e caktuar.

Subjekt përgjegjës për zbatimin e këtij ligji janë: Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, komunat apo ndonjë institucion tjetër shoqëroro-politik, i cili nis procedurën për shpronësimin e ndonjë prone të paluajtshme, me qëllim të zhvillimit të ndonjë projekti për interes publik. Aktualisht kjo fushë pra është mbuluar me Ligjin mbi shpronësimin 03-L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe ndryshimet dhe plotësimet që ne i propozojmë, ua mundësojnë Qeverisë së Republikës së Kosovës, komunave dhe institucioneve tjera relevante që kanë të drejtë për shpronësim në bazë Ligjit mbi shpronësimin, që të gjitha procedurat t'i kryejë në një afat më të shkurtër, por gjithnjë duke respektuar të drejtat e njeriut dhe konventat e rëndësishme ndërkombëtare në këtë fushë. Andaj, kërkoj nga ju të nderuar deputetë, që ta mbështesim këtë ligj i cili është shumë i rëndësishëm për objektivat që i kemi në zhvillimin e përsheptuar ekonomik të vendit. Me kaq po e përfundoj, duke kërkuar nga ju që t'i mbështesim pra edhe nenin 35 edhe nenet e tjera dhe ky ligj të aprovohet në afatin sa më të shkurtër, gjithnjë duke pasur parasysh nevojat e përsheptimit të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Ju faleminderit, shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional, nuk është paraqitur sot. Po shoh. Vazhdojmë me kryetarët e komisioneve tjera, nuk e kanë kërkuar fjalën dhe shkojmë te

diskutuesit, te përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, është paraqitur deputeti Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj, të cilin po e shqyrtojmë sot. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimet e pronës së paluajtshme, paraqet një ligj të rëndësishëm për sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, u janë përshtatur rrethanave të reja të krijuara aktualisht në Kosovë. Me anë të këtij ligji, janë propozuar ndryshime konkrete që kanë të bëjnë me rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës ose komuna përkatëse mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore dhe të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një subjekti konkret.

Projektligji i propozuar në mënyrë taksative cakton parimet dhe procedurat konkrete me qëllim të përmirësimit të funksionimit dhe të implementimit të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Me anë të këtij projektligji të propozuar më konkretisht plotësohen dhe ndryshohen afatet për njoftim dhe shpallje, vendimi përfundimtar, parashtrimi i ankesave dhe kërkesave, procedurat për shpronësimin dhe kompensimin e pronës së paluajtshme gjithnjë duke e kufizuar afatin e paraqitjes.

Projektligji i propozuar është në përputhje me standardet evropiane. Është me rëndësi që këto ndryshime të bëra duhet të jenë më komplete në aspektin e teknikës juridike të dispozitave juridike, konkretisht në nenin 9, 10 dhe 11 të Ligjit Numër 3/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, nene të cilat duhet të riformulohen më mirë me qëllim të zbatimit më të mirë në praktikë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e ndryshimeve të propozuara në lëmin e shpronësimit si dhe rëndësinë e veçantë që ka Ligji për shpronësimin për rrethanat aktuale në Kosovë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tonë profesional do ta paraqesim në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Ministër i Financave,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Numër 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Edhe ne i kemi shqyrtuar këto 10 nene të paraqitura për ndryshim dhe plotësim, të cilat kanë të bëjnë me ndryshimin e afateve për njoftim të shpalljeve, vendimet përfundimtare, parashtrimin e ankesave dhe kërkesave, procedurat gjyqësore në lidhje me shpronësimin dhe kompensimin e pronës së paluajtshme.

Prandaj, edhe ne mendojmë se me këto ndryshime bëhet përmirësimi i funksionimit dhe zbatimit të ligjit i cili është në fuqi, kështu që si Grup Parlamentar i LDK-së i japim përkrahje, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me këtë projektligj, siç u tha edhe nga parafolësit, ndryshohen disa afate në procedura të shpronësimit të pronës së paluajtshme, më konkretisht, shkurtohen afatet për ndjekjen e procedurave, qoftë të apelit, qoftë të vendimmarrjes përfundimtare.

Ne e kuptojmë se këto ndryshime mund të sjellin efikasitet në procesin e shpronësimit, por shkurtimi i dyfishtë, e për disa çështje të veçanta edhe trefish i afateve të apelimit dhe marrjes së vendimit mund të ketë për pasojë marrjen e ndonjë vendimi gabimisht. Si rezultat i presionit të afatit kohor. Pra, mund të sillen në një pozitë të palakmueshme cilado prej hallkave të involvuara në procesin e shpronësimit të pronës së paluajtshme, duke përfshirë këtu edhe ata që ankohen, edhe ata që marrin vendim. Pra, ekziston mundësia e ndonjë vendimi të gabueshëm ose të kalimit të afatit të ankesës ose apelit për shkak të afatit tepër të shkurtër.

Si do që të jetë, ne e kuptojmë se kjo mund dhe është insistuar që të bëhet me qëllim që të rritet efikasiteti në procedurat e shpronësimit. Ne do të shikojmë që në procedura të shqyrtimit nëpër komisione të shohim se cili do të jetë afati më i mirë, më i përshtatshëm në mënyrë që të eliminohen edhe këto mundësi të gabimeve të paqëllimshme, por që mund të rrjedhin si rezultat i kohës së shkurtuar.

Prandaj, do të japim kontributin tonë në shqyrtimin në komisione deri në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Të nderuar zotëri zëvendëskryeministra,

Ministër Shala, i nderuar, i respektuar,

Deputetë të nderuar,

Apriori e mbështesim këtë dokument si të nevojshëm, por disa vërejtje parimore që do të na kishin shërbyer për të medituuar pak më konkretisht, bie fjala, shpronësimi. Meqenëse ka institute juridike pronësore, që janë institute, domethënë të përpunuara, siç është eksproprijimi, në këtë rast shpronësimi, por ka deproprijim apo depropriacion, ka apropiacion, unë do të isha angazhuar që ta quajmë eksproprijim, sepse do të ishte konsistent me shprehjet tjera që i referohen pronësisë.

Te neni 9, ku thuhet – harmonizimi me standardet ndërkombëtare. Tash standardet, është fjala për aktet juridike, po këtu do të duhej të precizoheshin se Unioni Evropian miraton akte juridike të tipave të ndryshëm, të kategorive të ndryshme dhe të dimensioneve apo të efekteve juridike të ndryshme, e do të duhej që të precizoheshin, po e zëmë, diku të zënin vend, si të them, të precizoheshin, kur thuhet, për shembull, për shpronësimin e pronës së paluajtshme në Kosovë, jo në Kosovë, tanimë në Republikën e Kosovës, është i harmonizuar me direktivat... (cilat?)... dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Është

një term i gjerë, i pa definuar, se ka rregullore, ka rregulla, ka direktiva e tjera, e tjera. Këtu nuk është fjala për miratim, por është fjala për ratifikim, sepse kësisoj është terminologji dhe institut juridik ndërkombëtar që aplikohet, se kur është fjala për dokumente juridike aplikative në Unionin Evropian, ndërsa ato si të tilla në i ratifikojmë ose nuk i ratifikojmë, e në i ratifikojmë sepse është në interesin tonë.

Te neni 1, paragrafi 2. përdoren do terma të panjohura në onomo-teknikë, nënparagraf. Nuk praktikohet, ka nën, ka paragraf, ka aline, ka pikë, pika kjo... kjo..., prandaj subparagraf apo podstav nuk njihet as në anglisht, as në serbisht, as boshnjakisht, as në gjuhën shqipe.

Çështja e eksproprijimit është çështje juridike-administrative. Do të duhej të nisej e të përfundonte në procedurën administrative, përkatësisht në procedurën administrative gjyqësore në Gjykatën Supreme, në konflikte administrative, e mos të ngatërrohet edhe me çështjet me procedura gjyqësore, sepse komplikohet, ju lutem, stërgjaten procedurat dhe për aq bëhet si të them ngatërresë në disfavorin e palëve. Në gjykata ka vend dhe do të duhej vetëm çështja e kompensimit, në qoftë se do të kontestohet në procedurën juridike administrative. Unë këtë po e them, sepse kjo zgjidhje është standarde. Jam relativisht mirë i familjarizuar me tematikën e eksproprijimeve dhe flas gati me kompetencë, si të them kështu, sepse i kam të konsultuara edhe dokumentet juridike të shteteve të Unionit Evropian. Intenca është që të unifikohen, nuk janë unifikuar, por në parim nuk kanë kontradikta. Prandaj, kjo çështje është konceptore, që do të duhej të fillonte dhe të mbaronte me procedurën juridike administrative, eventualisht gjyqësore në Gjykatën Supreme sipas Ligjit për konfliktet administrative, a eventualisht nëse do të hapej konteksti përkitazi me kompensimin, atëherë gjykata do të ishte aty për aty.

Në tekst, në krejt tekstin nuk ka konsistencë në disa terma. Po e zëmë, “ankesë”, herë përdoret “ankesë”, herë “apel”, e kështu, e në të vërtetë edhe në anglisht, bile ajo është complaint - ankesa, e apeli e ka një diksion tjetër dhe një funksion tjetër, e do të duhej që një term të përdorej prej fillimi deri në fund e jo herë ashtu, herë ashtu se na dalin probleme të mëdha në aplikimin praktik, se ndryshe mund të trajtohet apeli, ndryshe ankesa.

Po asisoj te termi “refuzon”. Bie fjala, në anglisht është “reject”. Rigest është “flaket”, “hudhet”, a “flaket”, “hudhet” është atëherë kur fare nuk shqyrtohet, ose konstatohet se nuk ka të drejtë, pala nuk ka interes juridik, nuk ka kapacitet proceduror ose nuk është akti juridik apo mjeti i juridik i lejuar. Flaket, fare nuk shqyrtohet. Domethënë, hudhet, ndërsa këtu përdoret herë refuzohet, e në anglisht është kësisoj, e në serbisht herë “odbija” herë “odbacuje”, prandaj edhe këtu do të duhej të unifikohej termi adapt me përmbajtjen dhe në mënyrë konsistente të aplikohet deri në fund.

Po asisoj edhe te “aktgjykimi”. Ja bie fjala, në faqen 8, në shqip “aktgjykim”, në anglisht “judgement”, ndërsa në serbisht “rešenje”, a “rešenje” është “aktvendimi”. A është fjala për tri akte ligjore që duhet të jenë krejtësisht analoge. Dua të them, gabim, jo veç nocional e konceptual, por mund të jetë edhe përmbajtjesor.

Te 9-shi, “organi i shpronësimit nuk nxjerr vendim përfundimtar”. Asnjë organ, asnjë institucion, asnjëherë nuk miraton akt qoftë juridik, administrativ, qoftë gjyqësor përfundimtar. Mund të bëhet përfundimtar kur do të skadonte afati për ankesë, si mjet juridik i rregullt, ose kur do të refuzohej, bie fjala, mjeti juridik i rregullt, por jo që e

vendos përfundimisht. Domethënë, juridikisht nuk është në rregull, domethënë gabim juridik material.

Edhe “apeli kundër aktgjykimit” ose këtu thotë në serbisht “žalba protiv rešenja”. Ju lutem, “ankesa kundër aktvendimit”, në serbisht, ndërsa në shqip “apeli kundër aktgjykimit”. Aktgjykimin e miraton gjykata, pse, cila gjykatë, bile këtu nuk dihet fare nga ky tekst, po e zëmë, a këtu aktvendimin mundet gjykata edhe në rast se caktohet të miratojë aktvendim, por aty miraton në çështjet procedurore, por jo në çështjet juridike – materiale.

Ka edhe vërejtje tjera, në këtë rast nuk do të ndalem. Këto ishin disa nga vërejtjet parimore, që shpresoj se në punën e mëtejshme do të meditojmë, do të përpiqemi për të bërë një punë pak më serioze, për t’i bërë disa përmirësime, a në këtë rast do të isha lutur që zotëri ministri stafin atje me të vërtetë ta mobilizojë se këto vërejtje janë substanciale. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Konsiderojmë se ka qenë i nevojshëm shkurtimi, konkretizimi dhe harmonizimi i procedurave që kanë të bëjnë, do të thotë, me ndryshimet, rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria ose një komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave të tjera në pronën e paluajtshme të një personi.

Duke i ditur projektet e mëdha nacionale që e presin Kosovën, është e domosdoshme që këto procedura të shkurtohen, të konkretizohen, të saktësohen dhe të precizohen.

Zotëri ministër, unë mendoj që ky ligj do të duhej të mbështetej pastaj edhe me akte tjera normative, me udhëzime administrative që në njëfarë forme konkretizojnë edhe punën e institucioneve lokale, sepse dihet që një pjesë e madhe e këtyre projekteve kalojnë kah komuniteti, kah komunat dhe definitivisht duhet të harmonizohet edhe hierarkia e vendimmarrjes, por edhe procedura institucionale në mes të institucioneve qendrore dhe atyre lokale.

Lidhja Demokratike e Dardanisë mendon që është imediat që në këtë organ më të lartë legjislativ të vijë edhe Ligji për pronën, një ligj bazik i cili do të rregullonte këtë fushë në mënyrë gjenerale. Pastaj, edhe këto ligje të tjera, por edhe ministria, edhe komuna do të ishin më të fuqishme me akte tjera normative që vërtet ta bëjnë më të zbatueshëm edhe këtë ligj, por edhe ligjet tjera që lidhen me këtë fushë dhe jo vetëm me Ministrinë e Ekonomisë, të Financave, të Transportit, Postelekomunikacionit, Ministrinë e Energjetikës, por unë mendoj që këtu do të duhej edhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, të Zhvillimit rural ta ketë rolin dhe kompetencën e vet të paraparë.

Afatet për njoftim, shpallje, vendimet përfundimtare, parashtrimi i ankesave dhe kërkesave, procedurat e tjera gjyqësore, vërtet duhet të jemi të kujdesshëm, sepse kemi të bëjmë me çështje sensitive me pronën e personave, me pronën private, andaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë në parim e mbështet këtë projektligj,

duke aluduar që të precizohen më mirë neni 9, 10, 11 dhe kontributin tonë do ta japim gjatë procedimit të mëtejshëm të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhezair Murati.

ĐŽEZAIR MURATI: Hvala vam, gospodine predsjedavajući!

I mi smo dosta pažljivo proanalizirali ovaj nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o eksproprijaciji nepokretne imovine i smatramo da je došao u pravo vreme, ali takođe mislimo da je mogao još malo dublje, analitičnije da zadire u samu sadržinu problematike. Mislimo da ima mesta gde se dovoljno ne razdvaja konfiskacija i uzurpacija i da ne znam koliko to na drugim jezicima i kako zvuči, odnosno kakve ima zakonske obaveze, ali kod nas se to jako razlikuju ova dva izraza.

Drugo, u principu imamo primedbu, jer u memorandumu priloženom uz izmenu ovog zakona ne postoji na drugom službenom jeziku niti deklaracija o usklađenosti sa evropskim zakonodavstvom, niti ostale odredbe koje se tiču toga i mislim da nije prvi puta da izostaju ove manjkavosti na jednom od službenih jezika. Mislim da treba da se vodi računa o tome.

Možda je tehnička stvar da primetim da ima mnogo nepreciznih izraza, jezičkih grešaka u prepisivanju da li od hrvatskog nekog zakona kako to imamo običaja, ali mi ćemo sigurno za drugo čitanje pripremiti neke od amandmana. Dobra strana izmena i dopuna ovog zakona je ta što se pomeraju rokovi ka kraćim vremenskim razdobljima. Mislimo da to doprinosi njegovoj efikasnosti i mi ćemo konkretno dati neke predloge da ovi rokovi budu još uži vremenski, kažem, zbog njegove efikasnosti.

Takođe, kada su u pitanju neki članovi zakona, dodaćemo neke od odredbi kada je u pitanju, recimo, uzurpacija nekih trećih lica objekata ili njihovih pratećih objekata, recito, u nekim posebnim slučajevima kada su u pitanju porodice socijalno ugrožene, sa invalidima ili hendikepiranima i tako dalje. Dakle, mi smatramo da u njemu još ima mesta da se on brusi, dodaje i precizira. Ali, u svakom slučaju mi ćemo se priključiti u pripremanju njegovog drugog čitanja sa amandmanima koje ćemo predložiti funkcionalnoj komisiji tako da i mi ovaj Nacrt zakona o izmeni i dopuni ovog zakona u načelu prihvatamo, kažem, ali smo i dalje mišljenja da je mogao i u samoj ponudi ovog teksta da bude još malo precizniji i detaljniji. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS’së nuk është paraqitur askush për diskutim. Në emër të Grupit për Integritet, fjalën e ka kërkuar deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Danas imamo pred sobom Nacrt zakona o dopuni Zakona Broj 03-L/139 o eksproprijaciji nepokretne imovine koji se nadoveže na matični Zakon o eksproprijaciji imovine. Mi kao grupa smo pažljivo razmotrili ovaj zakon, u stvari dodatak na ovaj zakon i mišljenja smo da je i sam Zakon o eksproprijaciji došao kao dosta neobrađen, nedefinisan za naše područje, nije usklađen, samo je jednostavno prepisan i mogu da kažem jako loše, loše prepisan.

Ovde se praktično zakoni sada rade kopi-paste, nemaju nikakvu logiku kada ih pročitamo i onda nam treba dosta pažnje kada su u pitanju prevodi, ne znam na albanskom, na

engleskom, ali kada su u pitanju prevodi na srpskom, da se to dosta trudimo i vidimo da to nije ni hrvatski, ni slovenački, ni srpski, ni bosanski jezik i čudimo se kakav je to jezik. To je jedna od naših primedbi.

Druga primedba, kada je u pitanju Nacrt zakona... U ovom nacrtu zakona nisu definisani mnogi pojmovi. Kao prvo, Zakon razmatra eksproprijaciju na nivou centralne vlasti i na nivou opština, lokalnih vlasti kada je u pitanju oduzimanje imovine za nacionalne programe. Mi se slažemo sa tim da treba da ovaj zakon postoji, da funkcioniše, ali ne može da postoji pre zakona, nacrta zakona o imovini, znači gde se definiše da li je imovina državna, društvena, privatna. Mi nemamo zakon o imovini, matični zakon ili bazu zakona za eksproprijaciju. Jako važan zakon koji isto tako nemamo, Nacrt zakona o definisanju svojine i svojinskih odnosa i nosioca svojine, kada je u pitanju nepokretna imovina, normalno da imamo registar imovine na centralnom i opštinskom nivou sve do privatne svojine građana. Zašto ovo kažem? Mi znamo kakva je situacija na terenu, sa ovim zakonom mi ćemo samo da napravimo korak napred, ne korak nazad, naročito kada znamo da u ovom zakonu nisu definisani sudovi, koji su, gde, žalba, za koje namene, šta, znači ciljevi samo su opisani, nisu definisani, sami sudovi, naročito kada je u pitanju strana 8 zakona, član 8. koji ću ja da pročitam i da svi malo razmislimo kao poslanici i da vidimo koja se zloupotreba može vršiti danas ovde na Kosovu kada je u pitanju ovaj član 8. Znači, kaže član 8. – ukoliko sud ne izda rešenje u roku od 30 dana predviđenih podstavom 6.3., znači član 6.3. koji kaže, da se ne vraćam na član 6.3. gde kaže – izdaje presudu u slučaju u roku od 30 kalendarskih dana nakon prijema odgovora od organa za eksproprijaciju. Ukoliko, znači, sud ne izda rešenje u roku od 30 dana predviđenih podstavom 6.3. smatra se da je sud konačno izdao rešenje o odbijanju žalbe u potpunosti, odmah nakon isteka ovog roka od 30 dana. Šta znači ovo? Mi znamo da će naši sudovi jednostavno da prećute, da će da bude sukob interesa između vlade, centralnog nivoa, opštinskog nivoa, da ljudi neće u roku da dobijaju odgovor od suda i na ime svojih žalbi da će to prećutno biti odobravanje, gde se mogu kršiti svojinski i pravni odnosi građana. Molim da naročito funkcionalne komisije, kada budu radile na ovaj član, da obrate posebnu pažnju, jer se zadire u interese građana, u interese zajednica, u interese svojine, tako da namenski zakon nije definisao, kažem sudove, nije dao pravilno, ne može da kaže prećutno ako sud ne razmatra. Sud treba da bude definisan, koji sud, koji departman, koji sektor, gde građani treba da se žale, u kom roku, definisano da dobije, da bi ovaj zakon bio opravdan. Unapred se zahvaljujemo i mislimo da ćemo svoj doprinos da damo, potrebno je ovo i samoj funkcionalnoj komisiji radi boljeg sprovođenja ovog zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Vazhdojmë me diskutuesit e radhës. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Gani Koci, më fal!

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, kolegë!

Përsëendetje, kolegë deputetë, ministra!

Së pari duhet ta dimë se para veti kemi një ligj, i cili është ligj i jashtëzakonshëm, apo më mirë të themi, ligj i cili është në kundërshtim me një deklaratë të Kombeve të Bashkuara, por ajo deklaratë e Kombeve të Bashkuara pikërisht lejon që në raste të caktuara të shpronësohet prona e pronarit privat, sepse me nenin 17 të Deklaratës Universale për të

Drejtat e Njeriut thuhet se e drejta pronësore është e shenjtë, domethënë e gëzon çdokush, qoftë vetëm për veten, të drejtën pronësore.

Këtu kemi të bëjmë me të kundërtën. Meqë është interesi i përgjithshëm publik, interesi i shtetit, atëherë mund të privohet dikush nga e drejta pronësore. Mirëpo, ajo që po më pengon mua, është se pse brenda një afati kaq të shkurtër pa filluar akoma të zbatohet në jetë ky ligj, i cili është miratuar më 26.3.2009, ka hyrë në fuqi më 23.4.2009, është dekretuar, do të thotë, nga presidenti i Kosovës, kur është shpallur në “Gazetë zyrtare”, unë nuk di, por 15 ditë pas shpalljes në “Gazetën zyrtare” fillon të zbatohet, kur u paraqit nevoja që ky ligj për një periudhë kaq të shkurtër të ndryshohet kur akoma nuk është zbatuar në jetë. Kjo është, nën një.

Nën dy, në memorandumin shpjegues thuhet se ky ligj është në harmoni me standardet ndërkombëtare, por edhe ai tjetri ka qenë në harmoni me standardet ndërkombëtare, sepse edhe ai është miratuar më 2009 dhe gjithashtu ka qenë i pajisur me *acquis-communitaire*.

Nën tre, mua po më pengon, për shembull, kam koment lidhur me ndryshimet që janë propozuar në nenin 9, ku është shkurtuar afati prej 30 ditësh dhe është zëvendësuar me 10 ditë. Unë mendoj se ky afat nuk është afat i mjaftueshëm, do të ishte më mirë dhe më i përshtatshëm afati prej 15 ditësh.

Nën katër, paragrafi apo neni 10, propozohet të ndryshohet paragrafi 1.2 i këtij neni, ku thuhet – do të përfshijë në vendim preliminar një njoftim me të cilin informohet çdo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, e tjera, e tjera. Shpronësimi bëhet vetëm ndaj pronës, ndaj personit i cili është titullar i pronës. Nëse dikush ka ndonjë interes tjetër, le të urdhërojë le t’i paraqitet gjykatës së rregullt për t’i mbrojtur të drejtat e veta. Kështu si është paraparë, ka për t’u zvarritur, jo për t’u zvogëluar afati, por ka shumë për t’u zvarritur, sepse dikush del thotë – e kam të drejtën e servitutit, dikush thotë e kam të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm, dikush thotë – jo nuk e kam transferuar pronën, e kam kontratën, e kam aktgjykimin, por nuk e kam bërë ndryshimin në librat kadastrale, e tjera, e tjera. Vetëm ndaj titullarit të pronës mund të bëhet shpronësimi dhe vetëm ndaj tij mund të bëhet kompensimi. Nëse dikush ka ndonjë interes tjetër, atëherë ai mund ta padisë titullarin e jo shfrytëzuesin e tokës së shpronësuar, që kompensimin që e ka marrë pa bazë, t’ia kthejë këtij nëse e fiton kontestin. Disa afate janë shkurtuar, disa janë zvogëluar. Afati 12 mujor për mua është shumë afat i gjatë, duhet të shkurtohet. Nga ana tjetër, hyrja në posedim, thotë ka kundërthënie në këtë ndryshim, diku thotë mund të hyjë në posedim brenda afatit prej kaq ditësh, diku thotë mund të mos i merret nga posedimi. Po nëse i lihet atij në posedim, ai e shfrytëzon tokën, plus e merr kompensimin dhe çka ndodh? Ndodh që nëse objekti i caktuar duhet të ndërtohet, vonohet së ndërtuari për shkaqe të arsyeshme ose ku ta di unë për çka dhe ish pronari, sepse me shpronësim ai veç e merr atë statusin e ish pronarit, po begatohet pa bazë, po e shfrytëzon tokën, e cila me shpronësim po kalon në pronësi shtetërore, prandaj te posedimet, bile-bile në raste të caktuara duhet të hyhet në posedime dhe pa u bërë i plotfuqishëm vendimi për shpronësim ose vendimi tjetër, ose të caktohet ndonjë e drejtë e servitutit, në mënyrë që të arrihet qëllimi për ndërtimin e objekteve të rëndësishme.

Me disa përmirësime që duhet të bëhen rreth afateve, sidomos rreth afateve, sepse procedura për kompensimin e dëmit është e rregulluar me ligj, unë e mbështes, në parim, këtë projektligj, por duhet të jemi shumë të kujdesshëm se ka me të vërtetë kundërthënie midis afateve që janë përcaktuar me këtë projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të mëparshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuara deputete! Fjalën e ka deputeti Gani Koci, le të përgatitet deputeti Bahri Hyseni.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues! Shumica prej çështjeve që kisha ndërmend t'i them, i thanë parafolësit. Unë dua të përmend vetëm një fakt se gjatë shqyrtimit të parë të këtij projektligji dhe deri në miratimin kemi pasur një afat shumë të gjatë kohor dhe kemi pasur shumë diskutime, shumë analiza dhe duhet të them këtu se edhe atëherë ndoshta kam qenë një nga kundërshtarët për sa i përket afateve që atëherë kanë qenë të përcaktuara në Ligjin e shpronësimit dhe, vërtet, edhe atëherë është thënë standardet ndërkombëtare dhe tash thuhet standardet ndërkombëtare, po që të plotësohet një standard ndërkombëtar, duhet të plotësohet një standard tjetër paraprak dhe ne ndoshta nuk jemi akoma në standardin as ekonomik, as politik ndërkombëtar që vërtet me saktësi ose me ekzaktësi të përcaktojmë standardet gjatë hartimit dhe projektimit të ligjeve tona.

Unë mendoj që standardi ynë duhet të jetë brenda kushteve dhe rrethanave edhe ekonomike, edhe politike në të cilat ne jemi duke u zhvilluar dhe me ato standarde pastaj të mbërrijmë deri te standardet më të larta. Atëherë e kemi kontestuar këtë, se vërtet kur kemi të bëjmë me afatet, kur kemi të bëjmë me afatet, ne duhet të jemi në harmoni të plotë me afatet kur është fjala për afatet me procedurat, me kontekstet administrative, procedurat administrative që duhet të jenë të përputhshme me ligjet tjera që e rregullojnë këtë çështje, sepse janë të natyrës dhe nuk mundet me një procedurë administrative për një çështje të ketë një afat tjetër, për çështjen tjetër të ketë një afat tjetër. Dhe ky ligj, sikur edhe gjykatave, iu jep një..., si të them, i detyron ato që jashtë afateve të procedurave që i kanë, gjykatat të vendosin për çështje që kanë të bëjnë me shpronësimin, prandaj duhet të jenë në harmoni edhe këtu gjatë leximit të dytë dhe gjatë shqyrtimit në komisionin funksional sinqerisht duhet të ketë parasysh që të harmonizohen dhe të mos kemi afate të ndryshme për çështje të njëjta.

Një çështje, që për mua është shumë e rëndësishme, është se kur thuhet – apelon vendimin preliminar, thotë subjekti ose pronari duhet t'i dorëzojë zyrës së shpronësimit atje, organit shpronësues, 5 kopje të ankesës së vet dhe propozuesi do të ishte mirë të na shpjegojë pse 5 kopje, kur vetëm duhet të marrë një njoftim, sepse është apeluar në nivel gjykatë dhe jo 5 kopje. Kjo i bie sikur vetë titullari i pronës ose i shpronësuarit ose ai që pretendohet të shpronësohet duhet të përgatisë komplet lëndën për organin shpronësues dhe në këtë mënyrë t'i lehtësojë punën organit shpronësues.

Në anën tjetër, te paragrafi 4 që ka të bëjë me nenin 9 atje, thotë – nëse kërkesat e paragrafit 3, në qoftë se s'i ka plotësuar kërkesat e paragrafit 3, që ishte paragrafi 3 më lart, atëherë gjykata menjëherë do të shqyrtojë ankesën në fjalë dhe me vetë iniciativë do të nxjerrë vendim për refuzim të ankesës. Në qoftë se unë s'i kam dorëzuar 5 kopje në organin shqyrtues, gjykata ma refuzon ankesën. Mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet dhe nuk do të duhej të ishte kështu, sepse ky është një prejudikim i vendimit të gjykatës, në këtë rast, dhe ne nuk guxojmë të prejudikojmë, se gjykata duhet të vendos – të refuzojë ose të miratojë. Ajo duhet të gjykojë, ajo gjykon mbi bazë të provave dhe nuk prejudikohet vendimi që do ta marrë, qoftë për refuzim ose për miratim.

Një çështje që e tha shumë drejt ndoshta edhe parafolësja rreth vendimit të gjykatës në qoftë se nuk vendos për 30 ditë gjykata, atëherë ankesa merret si e refuzuar. Pse të mos

jetë e kundërta, ankesa të merret që është e pranuar, që kemi shumë raste, në qoftë se organi kompetent.... dhe gjykata në këtë rast duhet të vendosë mbi bazë të kësaj ankesë. Ajo është e detyruar të vendosë mbi bazë të ankesës dhe të nxjerrë një vendim për ankesën. Dhe në këtë rast nuk guxon, heshtja e gjykatës nuk mund të jetë dhe nuk mund të ketë vendin, se gjykata nuk guxon të heshtë, ajo duhet të marrë një vendim. Ky është problemi. Vetëm në procedurat administrative heshtja nënkupton miratim ose refuzim të diçkahit, në procedurat gjyqësore nuk ka heshtje, ka vendim, aktvendim dhe aktgjykim, prandaj këto çështje mendoj që duhet të mendohen drejt dhe duhet të shkruhen qartë, sepse nëse u tha ajo se prona është e shtrenjtë dhe është e shenjtë, vërtet duhet të kemi parasysh këtë që pronari të mos dëmtohet dhe të mos jenë procedurat që e dëmtojnë pronarin në të drejtën e vet që e ka.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, le të përgatitet deputeti i fundit i paraqitur për këtë pikë, deputeti Driton Tali.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra!

Të nderuar kolegë deputetë,

E mora fjalën me qëllim, sepse nuk do të jemi komision funksional dhe me qëllim që komisioni funksional t'i ketë parasysh disa çështje, t'i diskutojmë bashkë. Njëra prej çështjeve tash veç u diskutua paraprakisht, është bërë situata dhe po kemi situata të shumta me projektligje, ku po u përcaktojmë detyra dhe afate gjykatave. Gjykatat i kanë afatet e tyre. Ne vetëm mund t'i udhëzojmë palët dhe i qesim obligim palës që brenda një afati të caktuar ta paraqesë lëndën në gjykatë, kurrësi nuk mundemi me projektligje tjera t'i rregullojmë afatet gjyqësore, është çështja e parë dhe kjo duhet gjithsesi të eliminohet.

Mirëpo, konsideroj se janë disa çështje shumë më të rëndësishme. Ne jemi vetëm duke e plotësuar ligjin bazik që e kemi dhe nëse e shihni, janë vetëm disa modifikime të cilat janë bërë me qëllim që ta bëjmë të zbatueshëm. Bile, po më vjen keq që në preambulë e kanë shkruar – me qëllim të përmirësimit të funksionimit të ligjit. Jo, s'është, se ligji as nuk funksionon. Është me qëllim të zbatimit të ligjit dhe është mirë për ta plotësuar edhe këtë paragrafin e parë, nuk ka nevojë, sepse paragrafi i parë as nuk është amendament, po na tregon cilin ligj duhet plotësuar, vetvetiu po e nxjerrim projektligjin.

Mirëpo, në projektligj është përdorur termi – gjykata e apelit. Unë e kuptoj që Qeveria ka pasur të drejtë, sepse e kemi në procedim ligjin, Projektligjin për gjykatat. Mirëpo, ta kuptojmë drejt, Projektligji për gjykatat do të marrë kohë, themelimi dhe organizimi i gjykatave të apelit do të merr kohë. Ligji bazik nuk e njeh gjykatën e apelit. Shpronësimet kanë ndodhur dhe ka ankesa edhe para hyrjes në fuqi të këtij ligji, prandaj komisioni funksional duhet ta ketë parasysh. Absolut, të mos lë gjykata e apelit, por ta lë gjykata komentente, sepse nëse e lëmë decidivisht siç e keni shkruar, gjykata e apelit të nxjerrë vendim, do të jetë një bazë juridike me të cilën do të refuzohen shumë kërkesa apo do të kërkohet afat që qytetarët, kur të bëhet gjykata e apelit, t'i drejtohen gjykatës. Prandaj, do ta humbin edhe të drejtën e paraqitjes së ankesave. Kjo është çështje përmbajtjesore. Nuk po ndalem në çështje teknike të cilat u diskutuan, por është çështje përmbajtjesore. Duhet ta kemi parasysh që ta shkruajmë – gjykata komentente dhe në pamundësi ndoshta të organizohen gjykatat e apelit brenda një kohe të caktuar, të veprohet me atë që e kemi aktuale – Gjykata Supreme e Kosovës të vazhdojë procedurat dhe në momentin kur themelohen gjykatat e apelit,

atëherë natyrisht që lëndët do të drejtohen në gjykatën komentente, sepse vetë Gjykata Supreme e Kosovës do t'i orientojë atje.

Me këtë nuk ua humbim të drejtën qytetarëve të cilët kanë ankesa rreth shpronësimeve, nuk biem në ndeshje me ligjin bazik, sepse nuk e njeh gjykatën e apelit. Nëse e merrni, ligji bazik ka këtë orientim tjetër dhe këtë vetëm po e modifikojmë apo po e plotësojmë ligjin bazik në nene të përcaktuara dhe gjithsesi edhe një herë është mirë që të mos i detyrojmë, ne nuk mund t'i detyrojmë, por të mos shkruhen afatet e gjykatave në këtë ligj, sepse nuk mund t'i obligojmë. Është çështje e gjykatës. Ne vetëm e udhëzojmë qytetarin sa ka të drejtë të bëjë apelin apo ankesën, qysh e kanë bërë, nuk e di, edhe pse shumë e kanë përdorur apelin, por jo kurrësi ta obligojmë gjykatën që brenda 30 ditëve ajo të kthejë... Nuk është çështje administrative. Te çështjet administrative, nëse organi brenda një kohe të caktuar, sa e ka në rregullore apo në ligj, nuk i përgjigjet, qytetari nuk e fiton të drejtën automatikisht, se u interpretua keq, por e fiton një të drejtë që t'iu paraqitet organeve të drejtësisë apo organeve administrative të shkallës së dytë, tash varësisht prej lëndës, por nuk e fiton të drejtën, se heshtja e një organi administrativ nuk do të thotë pranim i ankesës, por e fiton një shkallë, e fiton një të drejtë që të lajmërohet në organin e shkallës së dytë administrative apo, në këtë rast, nëse është në shkallën e dytë, e fiton të drejtën që ta ndjekë këtë çështje administrative përmes organeve të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputeti i fundit i paraqitur për diskutim, Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: I nderuari zoti kryesues, unë po ju kursej, sepse me të vërtetë atë që desha ta them, parafolësi veç e çimentoj edhe një herë, kështu që s'më ka mbetur të shtoj diçka, për ta përsëritur atë që u tha deri më tani, nuk e kam ndërmend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në sallë kemi 65 deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën në fund, kështu që në vazhdim shkojmë në votim të Projektligjit, në parim. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Ndërkohë, në sallë janë 67 deputetë. Pra, lus regjinë që të përgatitet për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota "për", 1 "kundër" dhe 5 abstenime, miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë....

(Reagime në sallë)

Vazhdojmë dhe pastaj në 13:30, nëse nuk i përafrohemi fundit, e ndërpresim debatin për ta vazhduar në orën 15:00.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për eficiencën e energjisë

Në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtimin, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

E paraqes për miratim, në parim, Projektligjin për efikasencën e energjisë, projektligj i cili parashikohet nga strategjia e energjisë, si ajo për periudhën 2005-2015, ashtu edhe ajo e rishikuar, që u miratua nga ky Kuvend me datën 1 prill të vitit 2010.

Ky projektligj parashihet edhe nga neni 9 i Projektligjit për energjinë, të cilin ju e keni kaluar në shqyrtim të parë.

Në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë prej dhjetorit të vitit 2009, Kosova dhe vendet tjera anëtare të tij kërkohet të transfuzojnë dhe zbatojnë një numër direktivash të BE-së për efikasencën e energjisë, si:

1. Direktivën 2006/32, mbi efikasencën e konsumatorëve fundorë dhe shërbimet e energjisë;
2. Direktivën 2002/91 mbi performancën energjetike në ndërtesa, dhe
3. Direktivën 92/75 si dhe implementimin e direktivave mbi etiketimin dhe informimin standard të konsumit të energjisë dhe burimeve tjera nga produktet gjatë përdorimeve shtëpiake.

Në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë, Kosova detyrohet edhe që të rrisë efikasencën e përdorimit të energjisë me 9% për një periudhë 9 vjeçare, pra mesatarisht me 1% për çdo vit. Kjo përbën për vendin tonë një sfidë jo të vogël, tejkalimi i të cilës kërkon marrjen e një vargu masash ligjore institucionale dhe rregullatore, si dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që do të mundësojnë arritjen e këtij qëllimi ambicioz, por edhe të domosdoshëm njëkohësisht.

Qëllimi i Projektligjit për efikasencën e energjisë është të rregullojë infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe institucionale për efikasencën e energjisë në Kosovë.

Ky projektligj synon promovimin e efikasencës së energjisë, si dhe përgatitjen dhe aprovimin e planeve të efikasencës së energjisë, ndërmarrjen e masave për efikasencën e energjisë dhe obligimin e sektorit publik për t'u bërë shembull në përmirësimin e efikasencës.

Me këtë projektligj parashikohet të arrihet implementimi i masave të efikasencës së energjisë në mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet stimulimit të reduktimit të konsumit të energjisë në të gjitha komunat e Kosovës.

Projektligji për efikasencën e energjisë parashikon themelimin e Agjencisë për Efikasencën e Energjisë, e cila do të jetë në krye të zbatimit të programit nacional për efikasencën e energjisë, program ky që e kemi përgatitur në pajtim me Strategjinë e energjisë dhe kërkesat e Traktatit për Komunitetin e Energjisë.

Ky projektligj vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në përputhje me direktivat dhe praktikën e legjislacionit evropian *acquis communautaire*. Këtë e dëshmon edhe ekspertiza ligjore e Agjencionit për Zhvillime e Integrime Evropiane, që përkujdeset për harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së.

Gjithashtu, ky projektligj nuk ka kosto të lartë, siç edhe duket në deklaratën financiare të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Projektligji ka marrë pëlqimin edhe nga Sekretariati i Traktatit për Komunitetin e Energjisë.

Projektligji në fjalë përbëhet prej 5 krerësh dhe 16 neneve, duke filluar nga titujt konkretë, dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, dispozitat përcjellëse dhe ato kalimtare e përfundimtare.

I nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë,
Duke pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik, institucional dhe promovues për fushën e efikasitetit të energjisë, ju lus që këtë projektligj ta miratoni, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Në radhë janë diskutuesit sipas grupeve parlamentare, meqë nga komisioni s'kemi të paraqitur, nga komisionet funksionale. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër!

Përshëndetje kolegë deputetë dhe të gjithë ju të pranishëm!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për efikasitetin e energjisë dhe e mbështet, në parim.

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe institucionale për përcaktimin dhe përmbushjen e synimeve nacionale për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.

Ky projektligj vlen të ceket se nuk është në kolizion me asnjë dispozitë ligjore të legjislacionit në fuqi në Kosovë. Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji është i një rëndësie të veçantë ngase me legjislacionin e aplikueshëm nuk rregullohet në tërësi kjo materie. Nxjerrja e këtij ligji është e një rëndësie të veçantë edhe për arsyen se do t'i hapë rrugë zhvillimit të gjithëmbarshtëm ekonomik të vendit, duke krijuar bazë të mirëfilltë ligjore, duke përcaktuar mënyrën e përdorimit ekonomik të burimeve të energjisë, krijimin e kushteve më të qëndrueshme për furnizim të energjisë, si dhe minimizimin e ndikimit të dëmshëm në mjedis me qëllim të përafrimit me direktivat e BE-së në fushën e energjisë dhe implementimit në praktikë.

Me përfshirjen e këtij ligji, përkatësisht të Ligjit për efikasitetin e energjisë, në infrastrukturën ligjore të Kosovës do të arrihen qëllime të shumta, ndër më të rëndësishmet janë përmirësimi i kornizës ligjore, çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për efikasitet, ruajtjen e energjisë, përmirësimin e sigurimit të furnizimit me energji, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ky projektligj në përgjithësi ka 16 nene, përveç tjerash është një risi që vërtet i ka munguar ministrisë së Energjisë dhe Minierave, përkatësisht për zbatimin e këtij ligji parashihet me një nen të veçantë themelimi i Agjencisë për Eficiencë të Energjisë, implikime buxhetore nuk do të ketë, megjithëse Ministria përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe e Financave i parasheh disa rreziqe financiare të cilat janë vetëm prejudikuese, por praktikisht nuk paraqesin ndonjë rrezik financiar. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim, në parim. Kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional përkatës. Ju ftoj të gjithë juve, të nderuar deputetë, që ta mbështetni projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Përsëritje zëvendëskryeministër!

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka pasur debatin e tij lidhur me këtë Projektligj për eficiencën e energjisë dhe vlerëson se në parim duhet të përkrahet për shkak të rëndësisë dhe qëllimit të cilin e ka vu para veti ky ose që e kodifikon ky projektligj, në kuadër të paketës së ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë, që janë shumë të rëndësishëm që edhe kjo pjesë të ndërtohet, jo vetëm si pjesë integrale për implementimin e Strategjisë së energjisë që e kemi aprovuar, por edhe të asaj që u tha, pra, të eficiencës së energjisë, gjegjësisht detyrimeve që u dalin institucioneve tona në përmbushjen e atyre traktateve apo standardeve që kanë të bëjnë lidhur me energjinë që nga sektori i prodhimit, i shfrytëzimit e i kursimit, në harmoni me ato që kanë bërë edhe vendet më të përparuara, që kanë kaluar këto faza të tranzicionit, për të cilat ne jemi të detyruar t'i përmbushim. Prandaj, kjo është ajo përkrahja që i japim në parim, por vërejtjet tona parimore, po ashtu, kanë të bëjnë me dy-tre kapituj, të cilët vlerësojmë se përkundër përkushtimit që të punohet një projektligj që ka këtë rëndësi të madhe, mendojmë që ligji, ky draft i ofruar megjithatë është i mangët në përmbajtjen e tij, mendojmë që nuk i ka përmbushur të gjitha ato çka pretendohet dhe synohet të arrihet me këtë projektligj.

Në kreun e dytë, vërejtjet tona parimore kanë të bëjnë me qëllimin se më shumë i ka kushtuar rëndësi ndoshta ky projektligj themelimit të një agjencie, që ekziston veç departamenti, ose ndoshta ka teprime të ky kreu II, kur ka të bëjë me Komisionin për certifikim të auditorëve dhe menaxherëve të energjisë nga ana e Ministrisë, që mbetet për t'u vlerësuar nga komisioni funksional se a duhet të mbetet kjo, si dhe përderisa në pikën tjetër në vazhdim kemi që kur flet për raportin që duhet të japë ky angjencion, thuhet diku në çdo tre vite në progresin e zbatimit të tij. Mendojmë që është tepër vonë, duhet të korrigjohet dhe të shihet se çka duhet të ndryshohet në mënyrë që ky raport të jetë ose vjetor, ose ashtu qysh mendohet se është më së miri.

Po ashtu, kemi të bëjmë me hartimin e planit nacional. Në qoftë se ia vëmë karakterin një strategjie që e ka të karakterit edhe në eficiencën e energjisë, mendojmë që ajo nuk duhet të mbetet vetëm pjesë e Qeverisë, por duhet të kalojë në Parlament. Nëse veç themi që duhet të aprovohet një strategji e eficiencës nacionale dhe mbyllet debati ose vendimi merret në Qeveri, mendoj se nuk duhet ta përmbajë atë qëllim, prandaj duhet të mbetet ashtu sikur që është. Nëse kuvendi komunal është autoriteti i fundit juridik që e nxjerr për komunën një rregullore lidhur me këtë, me këto qëllime të eficiencës atëherë i takon edhe

Parlamentit që të jetë ai i fundit i cili duhet ta japë një vizë lidhur me këto synime nacionale në sferën e efijencës së energjisë.

Vërejtje e dytë parimore është te kreu III, që po ashtu ka të bëjë lidhur me këtë plan nacional të efijencës së energjisë që e përmenda dhe vërejtja e tretë dhe e fundit parimore vlerësojmë që është te kreu IV. Masat e efijencës së energjisë të cilat janë ndërtuar në kuadër të projektligjit janë të pakta, nuk e përmbushin objektivin që duhet ta ketë ky projektligj. Prandaj, këto mangësi ligjore, e kuptoj që do të ketë punë shumë komisioni funksional, por po i jap si vërejtje parimore se për objektivin që e ka shtruar, nuk e ka arritur atë qëllim ky projektligj dhe nuk i përcakton, pra, ato benefite apo nuk i përcakton as përkufizimet që kanë të bëjnë me një infrastrukturë konkrete që i duhet një projektligji të ketë sa i përket stimulimit dhe të investimeve që kanë të bëjnë me efijencën e energjisë, qoftë për detyrat dhe obligimet në kuadër të normativit që duhet të matet nesër se çka është efijencë e energjisë për prodhuesin e energjisë elektrike, për shfrytëzuesin, për ndërmarrjet publike, për biznesin, për ekonomitë familjare e të tjera. Pra, brenda kësaj ka një punë të madhe në qoftë se duam ta dimë se çka duhet të matet dhe realisht ta llogarisim nesër që është efijencë, pra është ajo që themi një kursim i energjisë elektrike, ose stimulimi që duhet të lejohet me ligj. Nëse kemi energji alternative, nëse duhet të përdoret energjia solare, nëse duhet të përdoret energjia e pompave termike, ku koeficienti i shfrytëzimit të energjisë është 1:4, atëherë cili është stimulimi për ekonominë familjare e cila investon ndoshta 10.000 euro në pajime për të përdorur pompat termike, qoftë gjeotermike, qoftë pompa të tjera në sisteme që kanë të bëjnë me ekonomizimin e energjisë, atëherë cili është stimulimi tjetër që duhet të jepet me anë të ligjit. Pra, janë disa pjesë të cilat i mungojnë këtij, për të cilat realisht unë mendoj se ka punë komisioni për të vendosur këto standarde, po them ligjore, për ta begatuar dhe për ta bërë një ligj që realisht është me interes që nesër të kemi kursimin e energjisë, po të kemi edhe stimulimin qoftë për biznesin, për ndërmarrje, për institucione publike ose në mënyrë të veçantë për ekonomitë familjare në sektorin e energjetikës. Prandaj, mbetet një punë e madhe, ne e përkrahim në parim, por i dhashë këto vërejtje parimore kështu që jam edhe i familjarizuar me këtë sektor të kësaj natyre të këtyre projektligjeve në parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ligjin që sot e keni sjellë, projektligjin në realitet, është një projektligj që nuk dallon nga ai projektligji që e patëm sjellë para 3 vitesh në parlament dhe kolegët tanë e patën refuzuar me pretekstin se po krijohet një agjenci e cila ka për qëllim vetëm punësimin e njerëzve.

Unë sot ndaj opinionin ndryshe dhe do ta mbështes këtë projektligj, sepse i nevojitet vendit, i nevojitet zhvillimit të sektorit të energjetikës, edhe pse ka mjaft vërejtje të cilat kolegu Rexhepi i përmendi, mangësi të cilat duhet të shtrohen në komisionin parlamentar për të plotësuar më mirë këtë projektligj. Më vjen keq që kanë kaluar 3 vite dhe duhet të presim që ky projektligj të vjen sot në debat dhe të kalojë për aprovim, në parim. Grupi ynë parlamentar e mbështet këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit zoti kryesues!

Përshëndetje për deputetët, se siç po shihet, Qeveria nuk është e interesuar t'i dëgjojë komentet lidhur me këtë projektligj.

Projektligji për eficiencën e energjisë mund të them se është projektligj i cili e plotëson kornizën apo, më mirë të them, infrastrukturën ligjore, mirëpo sa është punuar në këtë projektligj, tash do t'i jap komentet e mia dhe të grupit parlamentar.

Çdo vendi i duhet energji për të përkrahur aktivitetet e tyre ekonomike dhe zhvillimore. Në të ardhmen e afërt duhet të plotësohen kërkesat për energji, e cila është kërkesë në rritje, prandaj ne do të duhet të bëjmë një strategji për eficiencë të energjisë. Eficienca e energjisë mund të përkufizohet si një ndryshim të përdorimit të energjisë, që rezulton në një rritje të përfitimeve neto për njësi të energjisë. Unë do të përqendrohem në 3 mundësitë. Strategji për eficiencën e energjisë, domethënë burime alternative të energjisë. Sa kemi arritur këtu, nuk kemi arritur asgjë. Megjithatë, ky projektligj në vete ka kundërthënie të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato organizative e deri te implikimet buxhetore. Thuhet në vlerësimin e ndikimit buxhetor se nuk do të ketë implikime, kurse parashihet themelimi i Agjencionit për Eficiencë. Vallë, si do të funksionojë ky agjencion pa ndikime buxhetore? Po ashtu, si mund të funksionojë një agjencion me 6 zyrtarë dhe të kryejë obligimet e dhëna në bazë të këtij ligji? Më shumë se 2/3 e Projektligjit për eficiencë flasin për këtë farë angjencioni dhe për një komision, i cili fare lehtë mund të formohet dhe në mënyrë tjetër pa pasur implikime buxhetore. Tek masat për eficiencë të energjisë, në nenin 10, e tëra çka thuhet për këtë masë është se sektori publik duhet të përdorë në mënyrë eficiente energjinë. A thua me këtë rregullohet materiali? Është qesharake se asnjë detal mbi eficiencën, mënyra e rritjes së saj dhe implementimit e saj nuk jepet në këtë projektligj. Ndryshimi i klimës bën thirrje për zgjedhje të reja, ku është edhe standardi i BE-së për plotësim 20% të eficiencës për hyrjen e Kosovës në BE dhe pastaj duhet të punojmë në drejtim të arritjes së niveleve të reja arkitektonike për izolim të ndërtesave, me të cilat mundësojmë një rritje efieencie dhe ulje të kërkesave për energji. Kompetencat e reja të energjisë dhe të lëndëve të para për kursim të energjisë, izolim munden ndjeshëm të reduktojnë emisione të CO2. Eficienca e energjisë lidhet ngushtë me reduktimet e humbjeve të energjisë, ku ne në vitin 2009 dhe 2010 kemi humbje teknike diku 18.3%, humbje komerciale kemi 20.8%, ndërsa akoma funksionon plani ABC për qytetarët e Kosovës. Atëherë, sa do të mbërrihet eficienca e energjisë në rast se miratohet ky ligj për eficiencën e energjisë. Kosova duhet sa më parë të përgatisë plan konkret për veprim për eficiencë të energjisë dhe të fillojë zbatimin e këtij plani. Punohet vetëm sa për të thënë se kemi bërë diçka dhe unë absolutisht s'kam parë deri më tani asgjë. Për këtë plan të veprimit për eficiencën e energjisë duhet të përdoren masa të qarta që duhet ndërmarrë në vitet e ardhshme, mirëpo pasi të ketë Kosova energji dhe pa humbje teknike dhe komerciale, në këtë ligj që nuk ceket asgjë, përmirësimet në eficiencën e energjisë mund të zvogëlohen, nevojiten për investime në infrastrukturën energjetike, të ulen kostot e karburanteve, të rritin konkurrencën dhe të përmirësohet mirëqenia e konsumatorëve dhe, në fund, mund të them se në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së për arsye se plotëson konditat e BE-së ky ligj, atëherë mbetet që komisioni parlamentar të punojë pak më shumë që ky ligj të vjen në kondita çfarë duhet të jetë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Selmani! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që në fillim të them që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë jo rastësisht e pati kundërshtuar pakon ligjore që pati ardhur nga sponzorizuesi, nga Ministria e Energjisë dhe e Minierave, në kuptimin më pozitiv, se ato ligje ishin të paqarta, të pastudiuara mirë, jo konform edhe asaj Strategjie për energjinë 2009-2018, që nga ky Kuvend u miratua pa u debatua dhe analizuar si duhet dhe tani vijmë në konkludime që e tërë kjo pako ligjore që ka të bëjë me një fushë tejet të rëndësishme për qytetarët e Kosovës, për zhvillimin ekonomik, për thithjen e investitorëve, bie në kolizion me vetveten dhe këtu shihet që pakoja ligjore energjetike, e thanë edhe kolegët nga pozita, nuk është analizuar mirë, nuk ka plan të veprimit për zbatimin e këtyre ligjeve të cilat, nëse vetëm nevojiten ta kënaqin kalendarin legjislativ apo ambiciet e një ministri apo qeverie, unë këtë e shoh më larg, e shoh si interes nacional të vënies në kornizë ligjore dhe që shteti, thjeshtë, të prekë me dorë dhe të përkujdeset për këtë sistem. Që 10 vite në liri, që 2 vite e më tepër pavarësi, nuk jemi në gjendje ta hartojmë një kornizë ligjore konkrete, pragmatike, që në njëfarë forme do të stimulonte edhe kapitalin e huaj që të ndikojë në përmirësimin e kësaj efijence ligjore. Edhe një herë po e tërheq vëmendjen, është jo serioze që askush nga përfaqësuesit e Qeverisë nuk gjendet kur po diskutohet një projektligj, mbase i një fushe që Kosova dhe populli i Kosovës presin shumë prej tij.

Arsyetimi për projektligjin. Ju lutem dëgjoni me vëmendje sa abstrakt, sa i paqartë dhe sa i gjerë është arsyetimi. Ky ligj rregullon promovimin e efijencës së energjisë, si dhe përgatitjen dhe aprovimin e planeve të efijencës së energjisë, masat e efijencës së energjisë dhe obligimet e sektorit publik për ta përmirësuar efijencën e energjisë, themelimin e institucioneve përkatëse për implementimin e masave të efijencës së energjisë, e tjera, e tjera, vetëm sa s'kanë filluar të debatojnë edhe për fizikë nukleare apo edhe astrologji. Ju lutem, në krejt nenet dhe kapitujt e këtij ligji është një materie përshkruese, deskriptive, e thatë, jo konkrete dhe bëhet fjalë për një agjenci e cila do t'i ketë shefin e agjencisë edhe nja 5 punëtorë. Kur kësaj ia shtojmë rekomandimin e Departamentit të Buxhetit dhe të Financave, të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, po e lexoj – Rekomandim: Duke u bazuar në mundësitë buxhetore të buxhetit të Kosovës, që vlerësohen për periudhën 2011-2013, rekomandojmë që Ministria duhet të zotohet dhe të sigurojë se koston buxhetore, përfshirë edhe stafin për këtë agjenci të famshme, do ta përmbush nga buxheti aktual, në të kundërtën nëse do të ketë kërkesë për staf plotësues dhe mbi numrin maksimal të lejuar, rekomandojmë dhe sugjerojmë që ky projektligj, si i tillë, të mos aprovohet. Krijohet përshtypja që Departamenti i Buxhetit i ministrisë që e ka arkën e shtetit, është njëfarë qeverie atje të Afrikës Perëndimore apo të Saharasë dhe Ministria e Energjisë dhe e Minierave është pjesë e Qeverisë së Kosovës. Ju lutem, çfarë harmonizimi të qëndrimeve dhe kur merren vendimet në Qeveri për procedimin e ligjeve në Kuvend, vërtet duhet një bashkëpunim, një koordinim, sepse është një sektor jashtëzakonisht i rëndësishëm. Andaj, e thanë edhe kolegët e tjerë, për shkak se ne pretendojmë t'i respektojmë direktivat e Traktatit të Athinës për Energjinë, pretendojmë që ta krijojmë një ambient të volitshëm për investitorët e huaj dhe ta rrisim këtë efijencë, ky ligj, tani i bëj apel komisionit funksional të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrren ekspertë dhe të bëhet një ligj konkret pragmatik, që më vonë do të përcillet me një plan veprimi, me një dinamikë kohore të implementimit, me një plan kohor të zbatimit të këtij ligji dhe me një kosto financiare.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, me vërejtje të theksuara në substancën e materies së këtij ligji, do ta përkrah në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedavajući!

Pozdrav svima!

Ovim Nacrtom zakona uređuje se podsticanje energetske efikasnosti, mere i obaveze javnog sektora za poboljšanje energetske efikasnosti, kao i zaštita sredine kroz podsticanje smanjenja potrošnje energije. Ono što bi smo mi mogli istaći kao manjkavost ovog zakona, jeste to da je za sprovođenje mnogih odredbi i stavova iz ovog nacrt zakona neophodno donošenje mnogih podzakonskih akata. Inače, u načelu Parlamentarna grupa “7+” podržava ovaj nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, ponovo, na datu reč!

Ispred sebe imamo Zakon o efikasnosti mera za poboljšanje štednje energije. Jako važan zakon, jako potreban zakonskoj strukturi Kosova. Jedna od zakona koji nedostaje, koji je trebalo ranije da bude primenljiv i mislim da ovaj zakon treba pažljivo da razmatramo kada su u pitanju mere saglasnosti.

Ovaj zakon ima isto tako velike nedostatke. Nama je Evropska unija u odnosu na nas kada smo u pitanju, kada je u pitanju Evropska zajednica – Energetska evropska zajednica, svaka zemlja koja ulazi u ovu zajednicu ima obavezu za 20% štednje. Mi smo dobili procenat od 9%, znači polovina od efikasnosti, što smatram da moramo da ostvarimo.

Ovaj zakon je deo Ministarstva za energetiku i rudarstvo, u nadležnosti je tog ministarstva i to ministarstvo praktično trebalo bi putem ovog zakona da obezbeđuje i finansiranje u okviru budžeta Republike Kosova i finansiranje u okviru budžeta Evropske zajednice za energetiku.

Ovo dajem do znanja da ovo finansiranje, prvo iz budžeta, imaće implikacije, nisu definisane implikacije i mislim da dam do znanja da kada je u pitanju energija, naplaćivanje električne energije nije samo vid sa kojom se ovo zarađuje na ime električne energije, jedan od vidova je i davanje elektroenergetskih saglasnosti koju plaća svaki potrošač, a taj deo se trenutno ne definiše i ne troši racionalno i namenski na Kosovu. Zašto ovo kažem? Jedna od štednji je i to da postoji poseban fond za elektroenergetsku saglasnost, gde se izdvaja 25% sredstava, gde se namenski mogu koristiti na ime izgradnje, rekonstrukcije mreže gde je najveća ušteda u potrošnji.

Pored toga, ušteda u potrošnji gde se stimulišemo od strane Evropske zajednice, jeste i alternativna energija. Sa ovim zakonom mi moramo da kažemo da smo ispod svakog procenta, gde dajemo značaj alternativnoj energiji i ovaj zakon bi malo trebalo da bude više prilagođen kosovskim potrebama i da se Vlada institucionalno više angažuje na ime investicija u ovom sektoru. Isto tako, kada je u pitanju cena, nije se ovo definisalo tačno kada su u pitanju tarifni stavovi, kada je u pitanju privlačenje stranog kapitala. Ja ću da dam jedan primer, kada je u pitanju investicija stranog kapitala, gde imaju

energetsku saglasnost kada je u pitanju cena, kao što je država Bugarska, gde daje upola jeftiniju cenu električne energije stranom investitoru. Ovde nisu prepoznate prave stvari, nije dosta razrađeno, nije dosta data analiza i sledeća, da kažem, strategija za efikasnost energije. Zašto ovo kažem? Zato što se malo bavi gubicima, zato što se malo bavi tarifom, kao što sam prekla, gde moram da naznačim da je na Kosovu, da smo mi u regiji sa najskupljom energijom po kilovat času, tako da ovaj zakon malo više bi trebalo radna grupa koja je radila da prilagodi kosovskim uslovima.

Ovde imamo jako pojavu formiranja Agencije za efikasnost energije. Ja ću morati da kažem, mi kao Grupa i ja pojedinačno sama, mi smo protiv formiranja ove agencije. Mi smo praktično ovde postali inkubator agencija. Zašto ovo kažem? Zato što postoji Ministarstvo za energetiku, zato što postoje javna preduzeća koje prate ostvarivanje, koje rade i koje treba samo da dostavljaju i da vode statistiku o razvoju, proizvodnji, potrošnji, naplati električne energije, koju može, kao što se vidi, da postoji odsek pri ministarstvu, postoji odsek, odeljenje za energetiku, znači odeljenje za energetiku u okviru Vlade i to odeljenje bi bilo racionalno i dovoljno da izradi strategiju i plan i program razvoja efikasnosti energije radi uključivanja Kosovske energetske privrede u Evropskoj zajednici. Ovo je reonsko povezivanje, mi ćemo morati, znači da se uskladimo sa ovim zakonom i kada je u pitanju štednja i proizvodnja, i potrošnja i normalno što mora da se radi dosta kada je u pitanju svest potrošača, gde moramo da imamo posebne planove i programe obaveštavanja, informisanja potrošača o štednji električne energije, moram da kažem i o nenamenskom korišćenju, o krađi električne energije. Ja mogu slobodno danas da kažem da mi proizvodimo praktično neosnovanu potrošnju na tržištu, gde nismo dovoljno definisali nelegalizovane potrošače, kao što su da ne kažem veliki potrošači, pumpe, hoteli i moteli i gde možemo da smanjimo gubitke za od 60%, koliko su danas tehnički, pola komercijalni pola tehnički, na 30%. Zašto ovo kažem? Zato što su dozvoljeni gubici u Evropi od 5 do 12%, a mi danas sa 60% gubitaka treba da razmislimo i da sprovodimo ovaj zakon kako da nas primi Evropska zajednica za energetiku. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Meqë kemi vetëm 3 deputetë të paraqitur për diskutim, propozoj që të vazhdojmë dhe për të votuar, nëse nuk e kemi kuorumin, votojmë në ora 15:00, kur rikthehemi në sallë. Atëherë, fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Naim Rustemi.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues! Unë do të jem i shkurtër, sepse të them të drejtën, ky ligj s'ka edhe çka të flasim, jo që është i shkurtër në 16 nene, në realitet 13 nene i ka, se 3 të fundit merren me dispozitat kalimtare, por është ashtu siç u tha këtu, ligj përshkrues, që nuk shpjegon asgjë konkrete, pos hiqe, po them, nenin 5, ku merret me krijimin e Agjencisë Kosovare për Eficiencë të Energjisë, e që e mira së mirës do të ishte që ky ligj edhe ashtu të quhej – Ligji për krijimin e Agjencisë Kosovare për Eficiencë të Energjisë.

Çështja tjetër që desha ta them, e që nuk mund ta lë pa e t hënë në njëfarë mënyre, është gjuha e të shkruarit këtu. Me të drejtë, kolegu Rugova e ceku se nenet ligjit janë të shkruar ashtu që në gjuhën shqipe nuk merret vesh, në realitet këtu shihet se memorandumit shpjegues është shkruar së pari në gjuhën shqipe dhe pastaj nga gjuha shqipe është përkthyer tekstualisht në anglishte, sepse nuk kuptohet në anglishte dhe, e kundërta, ligji është bërë copy-paste dhe është përkthyer tekstualisht nga gjuha angleze, por që goxha problem është për ta kuptuar në gjuhën shqipe.

Shpresoj se në leximin e dytë do t'i kenë parasysh autorët dhe komisionet përgjegjëse dhe do t'i përmirësojnë këto gabime të cilat, sinqerisht, bien në sy. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet deputeti i fundit i paraqitur për këtë pikë, Bujar Dugolli.

NAIM RRUSTEMI: Edhe unë ngjashëm mendoj se ky ligj është shumë i shkurtër dhe nuk ofron mundësi, realisht nuk na ofron neve kurrfarë mundësie që të diskutojmë për këtë ligj. Hiq dy-tre nene që determinojnë dhe na e përcaktojnë rrugën që e ka marrë Qeveria, politikat qeveritare për themelimin e agjencisë apo për krijimin e trupit punues për auditimin e energjisë, me propozim të ministrisë a të qeverisë, ligji nuk ka çka të diskutojë më shumë, veç e ka hapur rrugën për promovimin e eficiencës së energjisë dhe përgatitjen e aprovimit apo përgatitjen e planeve në të ardhmen se do të bëjmë diçka për promovimin e eficiencës së energjisë. Realisht të them, s'di as për çka po diskutojmë. Krejt çka kemi për të votuar, ne kemi për të votuar një vendim që e kemi bërë ligj, që ka pasur mundësi edhe të jetë vendim për të themeluar një agjencion, për të themeluar një trup koordinues për auditor dhe menaxhues të energjisë, asgjë më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Unë iu bashkëngjitem atyre vërejtjeve parimore që i dhanë edhe kolegët tjerë. Konsideroj se ky ligj që është paraqitur në këtë formë, ka mund të jetë në formë të 2 a 3 amendamenteve në kuadër të Ligjit për energji, por pasi që ka ardhur kështu si i tillë, i cili pasqyron faktikisht vetëm krijimin e një mekanizmi, siç është Agjencioni për Eficiencën e Energjisë, që për mendimin tim është më shumë një ngarkesë për buxhetin, se sa një trupë që mund të jetë efikase për ta zgjidhur këtë problematikë që është shumë e madhe në Kosovë.

Konsideroj që në kuadër të Ministrisë ka mund të rregullohet kjo me një departament të veçantë, i cili në kuadër të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, me të gjithë faktorët relevantë do të hartonte një plan kombëtar për eficiencën e energjisë, sepse nuk ka qenë kjo problematikë si pasojë e mungesës së trupave, të mekanizmave, por si pasojë e mospasjes së një plani konkret se si t'i qaset Kosova që ka mungesë të energjisë elektrike dhe shfrytëzim të kësaj energjie të paktë që e ka në mënyrë shumë të pa vend, të padrejtë. Por, pasi që ka ardhur kështu, unë dëshiroj t'i jap disa vërejtje, sepse nga diskutimet që u thanë, u panë se shumë grupe, në shumicë e mbështesin, në parim, dhe faktikisht ky ligj do të kalojë, por dua t'i jap disa vërejtje sa u përket neneve konkrete. Për shembull, tek neni 5, kur flitet për Agjencinë Kosovare për Eficiencën e Energjisë, që thuhet është trup ekzekutiv i pavarur, mandej vazhdon në kuadër të Ministrisë. Unë mendoj që këto çështje duhet të rregullohen, në rast se janë agjencione të pavarura, atëherë janë të pavarura dhe t'i hiqen këto pjesë në kuadër të ministrisë. Është e kuptueshme që secila ministri e mbikëqyr veprimtarinë e një agjencioni përkatës, por të mos ketë këso lidhshmërie, se kjo ose është e pavarur, ose s'është e pavarur. Dhe kjo pjesa në kuadër të ministrisë të hiqet, të mbetet e pavarur.

Tek neni 6, tek detyrat e Agjencisë, ndër shumë detyra tjera, thuhet tek neni, pika 2.2, thuhet mbështet pjesëmarrjen e komuniteteve në zhvillimin e iniciativave për eficiencën e energjisë. Ju lutem, ky është pak një absurd, domethënë këtu kemi të bëjmë me konsumatorët publikë e privatë dhe konsumatorët nuk duhet të ndahen në

baza të komuniteteve dhe kjo konsideroj se është një çështje e pa vend pse ekziston ky nen këtu. Nuk duhet tash në çdo ligj qasja ndaj komuniteteve shumicë a pakicë të ekzistojë në ligje të tilla, siç është eficienta e energjisë, se s'ka lidhje me këtë çështje dhe konsideroj që konsumatorët duhet të jenë të njëjtë të gjithë, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike.

Te kreu IV, masat e eficientës së energjisë, respektivisht neni 10, flet për sektorin publik, por mendimi im është që duhet të futet 10.2, që duhet të flasë për sektorin privat, respektivisht konsumatorët e amvisërisë, të cilët përdorin energjinë elektrike në mënyrë eficiente, do të stimulohen. Si do të stimulohen, është pyetja, domethënë, në atë plan kombëtar, që mund të hartohet nga një agjenci e ardhshme, siç po parashihet në bazë të këtij ligji, ata duhet të paraqesin masat tek çmimet e konsumatorëve të amvisërisë, të cilët energjinë e shfrytëzojnë në mënyrë eficiente dhe ta stimulojnë, sepse në rast se nuk do të ketë një program stimulues për konsumatorë që do të jenë të ndërgjegjshëm dhe do ta përdorin në mënyrë efikase këtë energji, atëherë edhe ekzistimi i këtij ligji do të jetë shumë simbolik, për të mos thënë i parëndësishëm.

Me këto vërejtje, normalisht, edhe unë votën time do ta jepja “pro” në rast se në komision këto do të kalonin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! E konsiderojmë të shterur debatin lidhur me këtë projektligj. Shkojmë në pauzë deri në ora 15:00, për t'u kthyer dhe votuar Projektligjin.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauze

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, nga pika e parë ka mbetur votimi lidhur me Shqyrtimin e Projektligjit për ofiçientcën e energjisë.

Kjo pikë është kryer, por tash duhet të votojmë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sallë kemi 63 deputetë. Votojmë tash:

Sekretaria, numëroni sa deputetë janë në sallë!

Mirë, në sallë tani janë 72 deputetë.

Konstatoj se me 68 vota “për”, 2 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për eficientcën e energjisë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Kurse, për ligjin paraprak, do të thotë është fjala për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, pas votimit nuk është thënë:

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Debat për gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore, sipas mocionit të deputetit Driton Tali, të mbështetur edhe nga 11 deputetë të tjerë

Deputeti Driton Tali, i mbështetur edhe nga 11 deputetë të tjerë, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit debat parlamentar për gjendjen e ndërmarrjeve publike qendrore.

Kërkesa e deputetit Tali u është shpërndarë deputetëve.

Propozuesi i mocionit për debat, përfaqësuesi i grupit të deputetëve, deputeti Driton Tali e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

Procedura është në rregull! Jo, jo – procedura është në rregull krejt. Driton Tali e ka fjalën.

Driton, vetëm pak, një moment. Jo, jo, mos shko në vend. I kam vetëm dy fjalë.

Shikoni, ne sipas kërkesës tuaj, kemi kërkuar nga Qeveria të sjellë material. Qeveria nuk e ka sjellë materialin. Kryesia e ka shqyrtuar dhe mbi bazën e Rregullores së Punës e ka caktuar debatin për sot. Do të thotë, kjo është mbi bazën e Rregullores së Punës. Tash e ke fjalën, deputet Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit! Unë desha ta them atë që e tha deputeti i nderuar, zoti Emrush Xhemajli, dhe e thashë por përgjigjen nga Qeveria e kam se kjo Qeveri nuk është etatiste, andaj edhe nuk ka kërkuar diçka nga ndërmarrjet publike.

Sidoqoftë, të nderuar të pranishëm dhe ju qytetarë të Kosovës, të cilët na përcillni përmes televizionit, unë këtë pikë të kësaj seance do ta filloja duke ju rikujtuar 11 shkurtin e vitit 2008, atëherë kjo qeveri posa e mori mandatin, ende pa e bërë një muaj, shpalli PTK-në, KEK-un dhe Aeroportin e Prishtinës kampione të korrupsionit. Por, shtrohet pyetja se çfarë bëri kjo qeveri si aksionare, pra pronare e këtyre ndërmarrjeve,

për ta ndryshuar atë gjendje në këto ndërmarrje publike – kampione të korrupsionit dhe tash cila është situata, pra pas më se 2 vjet çfarë bëri Qeveria për të përmirësuar qeverisjen atje?

Unë do të filloja me Aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës. Siç e dimë, OIOS -ja apo Office of Internal Oversight Services, që në shqipe është Zyra e Shërbimeve për Mbikëqyrje të Brendshme të OKB-së, pati raportuar për korrupsion dhe keqpërdorim sistematik në Aeroportin e Prishtinës. Ai raport pati gjetur një mal shkëlqesh në ligj, si bie fjala – dhënie të mitos për vende të punës, manipulime të ardhurave nga hapësirat komerciale të Aeroportit, si për shembull restaurantet, shërbimet dhe hapësirat që i shfrytëzojnë kompanitë ajrore e tjera, pastaj vjedhje dhe mashtrime gjatë menaxhimit e tjera, e tjera. Mirëpo, sipas shumë informatave, del se një menaxhim i tillë edhe më tutje vazhdon, pra me të njëjtin avaz, duke u nisur edhe nga fakti se nuk ka transparencë në menaxhimin e Aeroportit. Edhe sot, sikurse atëherë, institucioni i konkursit nuk respektohet, punësohen pa kurrfarë kriteri dhe nevojë punëtorë të rinj dhe jo vetëm me të ashtuquajturën kontratë mbi vepër. Ata të gjithë janë ose familjarë ose aktivistë partiakë. Numri i të punësuarve apo më mirë të thuhet të mbipunësuarve tashti ka arritur në rreth 850 punëtorë.

Sa për ta ilustruar këtë gjendje, të thuhet se Aeroporti “Nikola Tesla” i Beogradit ka 409 punëtorë, i shërben 2.659.000 pasagjerë gjatë vitit, derisa Aeroporti i Prishtinës 1.200.000 pasagjerë i shërben me rreth 850 punëtorë. Pra, një i punësuar në Aeroportin “Nikola Tesla” brenda vitit i shërben rreth 6.480 pasagjerë, kurse një i punësuar në Aeroportin e Prishtinës i shërben rreth 1.412 pasagjerë në vit, pra raporti është 1 me 4.6 apo përafërsisht 1 me 5.

Apo ta marrim shembull Aeroportin e Shkupit, i cili bën qarkullim vjetor 14.000.000 euro, pra rreth 2 herë më shumë se Aeroporti i Prishtinës, por me rreth 100 punëtorë më pak se sa që i punëson Aeroporti i Prishtinës.

I përmenda këto të dhëna për të treguar se sa me efikasitet menaxhohet sot Aeroporti, sepse çdokush që do të investojë, qoftë edhe me koncesion, në një projekt afarist gjënë e parë të cilën do ta bëjë, e llogarit raportin e efikasitetit afarist, të ashtuquajtur efficiency ratio apo business ratio, që rrjedhimisht do ta llogarisë edhe raportin e efikasitetit të punëtorëve të ashtuquajtur Employee Efficiency Ratio. Raporti i cili në mënyrë direkte ndihmon në vlerën e ndërmarrjes, domethënë ia rrit apo ia ulë vlerën, varësisht, ndërmarrjes. E, siç dihet, konsensioneri nuk do t’i punësojë më shumë se 550 punëtorë, bile edhe ky numër është i madh për kapacitetin që e ka Aeroporti i Prishtinës, andaj shtrohet pyetja se çka do të bëhet me 300 punëtorë, si do të kompensohen ata, a do të kompensohen prej buxhetit të Kosovës. Nëse po, çfarë kompensimi do të jepet atje, sepse ne e dimë që pagat në aeroport janë më të lartat në Kosovë.

Pastaj, çfarë mund të thuhet për KEK-un, ku përshtypja jepet se në këtë korporatë bëhet garë se kush po e menaxhon më keq. Vetë fakti se rreth 30.000.000 euro janë dhënë në tender njëburimor, nga ku më të suksesshmit ishin “AC/DC Kosova”, e cila për vetëm pas pak muajve pasi që u regjistrua si ndërmarrje, e fiton tenderin për 10.354.510 euro dhe pak kohë më pas e fiton edhe një tender me vlerë 184.000 euro, në realitet rreth ose mbi 184.000. Domethënë, mbi 10.538.000 euro për pak muaj pasi që të krijohet si kompani. Apo ndërmarrja e dytë, më fatlumja, ishte “Ecotrade” me tenderin që e fitoi për 5.346.974 euro. Të thuhet se “Ecotrade” me “AC/DC Kos”, sipas

informatave që i kemi, i takojnë të njëjtës familje. Pra, janë familjarë të njëjtë. Edhe disa ndërmarrje tjera kjo familje i posedon.

Sidoqoftë, “Ecotrade”, t’ua rikujtoj qytetarëve të Kosovës, se është ajo ndërmarrje, e cila, në partneritet me ndërmarrjen shoqërore apo shtetërore të Serbisë “IMK 14 oktober”, fitoi kontratën e re 50 milionë eurosh për riparimin e shiritave transportues të KEK-ut, punë të cilën gjithmonë e bënte “Kosova-monti” gjegjësisht “Remont-montimi”, që ishte pjesë e KEK-ut. Dhënia e tenderit kompanisë “Ecotrade” dhe “14 oktoberit” për njerëzit e rrethanat ishte e pakuptimtë, kur dihet se “Remont-montimi” të gjitha këto shirita i ka montuar vetë, i ka mirëmbajtur dhe ka bërë riparimin e tyre përherë deri para luftës. Po të kryhej kjo punë nga këta punëtorë, do të kushtonte një shumë simbolike krahasuar me 50 milionë euro.

Për të mos u ndalur tash në secilin rast dhe detaje, si bie fjala vjedhjet që ndodhën, si për shembull vidhen pa u thyer dryni 4.000 kilogramë unaza bronzi, thjeshtë futet kamioni dhe ngarkohet si në bahçe të babës së vet, pra i merr 4 tonë unaza të bronzta, apo mbushja e ekskavatorit T2 me dhe qëllimisht që të nxirret jashtë përdorimit, ose vjedhja e bërthamave të 37 transformatorëve energjetikë, apo rishpallja e tenderit për ushqim, sepse ishin shkelur nenet 64 dhe 30 të Ligjit të prokurimit publik, apo përsëri i jepet tender “Al Ston Power”, kompanisë franceze, e cila i ka borxh 7 milion euro Kosovës për mospaguarjen e tatimit, sepse kjo kompani “Al Ston Power” çdo vit kishte marrë tender të majmë nga KEK-u. Dikush këtyre po u jep tender dhe kush mund të më bind mua se këto janë të rastësishme këta tenderë, se nuk ka hile në këto maskarallëqe. Pastaj, si është e mundur që Kosova të blejë rrymë gjithmonë më të shtrenjtë se vendet fqinje. Disa herë u bë pyetja dhe asnjëherë nuk u dha përgjigja e qartë. U tentua të arsyetohet me fajin kujdestar – Serbinë, se ajo po na e rritë çmimin. Tash, beso, nëse je aq i marrë, se Serbia e cila po e konsideruaka Kosovën si treg të brendshëm, kur kompanitë serbe si “Rudnap” apo “EFT-ja”, pra njerëzit me influencë të madhe me shoqërinë serbe si Miroslav Mishković, Vojo Llazareviq, Vuk Hamović apo edhe Svetislav Bullatović, i tatimon dyfish se po shesin rrymë në Kosovë. Prandaj, rryma e importuar në Kosovë është deri në 2.4 herë më e shtrenjtë se sa që e importojnë fqinjët tanë.

Qëllimisht i përmenda këto ndërmarrjet serbe, sepse KEK-u merr rrymë vetëm se prej tyre e neve na shet pallavra këtu, thotë se EFT-ja është ndërmarrje zvicerane, a nuk tregon se është pronar Vuk Hamović dhe Svetislav Bullatović.

Dhe, siç e dini, vetëm vitin 2009 rreth 46.000.000 euro janë dhënë në import të rrymës. Bëjeni ju, llogariteni ju se sa është keqmenaxhuar me para të buxhetit.

Tash, pse i japin punë vetvetes drejtorët, kjo më nuk është lajm, sepse kjo është bërë një paradigmë, si për shembull drejtori i KOSTT-it që i jep punë edhe më tutje Komtelit, kompanisë që ka qenë bashkëthemelues, partner, e që sipas informatave edhe më tutje është aksionar në atë kompani, apo mbipunësimi, edhe kjo çështje më nuk është lajm në KEK, krahasuar me Aeroportin, ku drejtorët i punësojnë nipat e tyre atje. Në KEK drejtori i punëson kushërinjtë, djemtë e axhës, dhëndurët dhe vëllezërit. Po, mos qofsh për veti, si thonë, s’je për askënd hiq.

Dhe menaxhmenti i KEK-ut për krejt këtë punë, po them “të mirë”, e shpërblen veten me banesa të mira, me qira simbolike e madje edhe pa paguar hiq....

(Ndërprerje nga ana e regjisë)

KRYETARI: Edhe sa kohë po do, Driton? Edhe dy minuta!

DRITON TALI: ...pra edhe rroga e bonuse të majme, që kapin shifrat e disa dhjetëra mijëra eurove për muaj. Dhe, me gjithë këto probleme menaxhuese, kjo Qeveri e cila erdhi në pushtet duke premtuar se do ta luftojë keqqeverisjen, sidomos në ato ndërmarrje që janë kampione të korrupsionit, e kanë gjetur një formulë shumë të mirë, e ajo është privatizimi, që me vokabularin e qeverisë është falja e aseteve të Kosovës. Pra, këto probleme do t'i zgjidh në atë mënyrën e nyjës së Gordonit. Veç e kanë vendosur që distribuimi dhe furnizimin ta privatizojnë, duke menduar se e vetmja zgjidhje është privatizimi, e injorojnë eksperiencën e Maqedonisë, pastaj të Shqipërisë, ku operatori privat i ka ngritur çmimet. Një dreq e di se pse nuk i marrin eksperiencat e vendeve tjera ish-socialiste, të cilat kanë gjetur formula konform kohës, por vazhdojnë me disa slogane bajate të viteve '80 dhe fillim viteve '90 me atë se privatizimi apo ekonomia e tregut të lirë, që jemi kundër komunizmit e tjera, e tjera.

Hiç më mirë nuk është as në PTK, e cila para dy viteve vlerësohej rreth 1 miliardë euro, e tash vlera i është zhvlerësuar dukshëm. Vazhdohet të zhvlerësohet, sepse menaxhohet pa kurrfarë përgjegjësie, qoftë profesionale, qoftë sociale apo edhe asaj morale. Jepen tenderë për të ashtuquajtur operatorë virtualë të telefonisë mobile, në realitet krijohet një operator i tretë mobil, i cili nuk investon në krijimin e infrastrukturës, sepse do ta përdorë infrastrukturën e PTK-së, por duke marrë 70%. Pra, në stilin hajde bëhemi partnerë unë e ti, të gjithë unë i investoj, ti s'ke çka të investosh dhe profitin e ndajmë 70% për ty e 30 e ndali për veti. Kush nuk do të bëhej partner i imi me këto kushte.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është e Qeverisë. Fjala është për ministrin Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti deputet Tali, faleminderit për ekspozenë!

Unë dëshiroj që në pika shumë të shkurtra të paraqes disa nga të dhënat sa i përket gjendjes në ndërmarrjet publike dhe përgjegjësitë që ka Grupi ndërmarrës për ndërmarrjet publike dhe unë si kryesues i Grupit ndërmarrës për ndërmarrjet publike, pra në cilësinë e kryesuesit të Grupit ndërmarrës për ndërmarrjet publike dua të paraqes disa informata të rëndësishme. Nuk kemi paraqitur raport, sepse sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike, një raport në Kuvend, ndërmarrjet publike, përkatësisht Grupi ndërmarrës dhe Njësia për monitorim dhe politika të ndërmarrjeve publike është e obliguar ta sjell në Parlament vetëm pasi të kryhen auditimet e ndërmarrjeve publike dhe meqenëse auditimet janë në fazën përfundimtare, pasi që të përmbledhet një raport, neve do ta sjellim për vitin 2009. Pra auditimi për ndërmarrjet publike për vitin 2009, janë duke u përfunduar dhe duhet të vijë raporti këtu në Parlament sipas ligjit.

Unë vetëm desha të jap disa informacione që Grupi ndërmarrës për ndërmarrjet publike, pra, i cili përbëhet nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ministri i Energjisë, ministri i Ambientit dhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, dua që të sjell këtu informacione të mjaftueshme për juve për të

treguar gjendjen dhe veprimet që i kemi bërë si Grup ministror konform ligjit për menaxhimin e ndërmarrjeve publike.

Kemi dallime konceptuale në këtë. Është një ligj që është aprovuar nga ky parlament dhe unë asgjë më shumë nuk mund të shtojë nga kufizimet e mia ligjore që kalohen si ministër, përkatësisht si grup ndërministror ndaj ndërmarrjeve publike.

Andaj, më lejoni që të jap disa nene të cilat përcaktojnë këto elemente, të cilat për ju, besoj, janë të mirë ditura.

Neni 7.6 i Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas këtij neni definohet pavarësia e punës së bordit. Neni 7.6. – Detyrimi për mbikëqyrje, i themeluar me këtë nen, nuk do të ushtrohet në një mënyrë që të ndërhyjë ose ka qëllim që të ndërhyjë në veprimtarinë ose pavarësinë e bordit të drejtorëve apo të Komisionit të auditimit të ndërmarrjeve. Andaj, do t’ju kisha lutur që t’iu referohemi aspekteve ligjore të cilat ky parlament i ka aprovuar.

Grupi ndërministror ka aprovuar, po ashtu, komisionet e auditimit të cilat do të vërtetojnë nëse....

(Ndërhyrje nga salla)

...po, zoti kryetar, tash, në qoftë se më lejohet, atëherë... nuk do të shtyhem kush po flet më shumë me zë këtu, por nëse më lejohet, e kisha shpjeguar.

KRYETARI: Deputetë, ju lutem, ne ju dëgjuam, e tash ju duhet të dëgjoni.

MINISTRI AHMET SHALA: Sipas nenit 26.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike parashehet që Komisioni i auditimit do të vërtetojë nëse veprimtaria dhe punët e ndërmarrjeve publike janë duke u ushtruar në mënyrë të ligjshme, të përgjegjshme dhe ekskluzivisht në interes të aksionarit. Këtu përfundon ndikimi i një ministri në relacion me ndërmarrjet publike.

Po ashtu, neni 37 i Ligjit mbi ndërmarrjet publike themelon Njësinë për politikën dhe monitorim të ndërmarrjeve publike me qëllim që kjo njësi t’i japë mbështetje Grupit ndërministror për të udhëzuar, udhëhequr dhe përgatitur statutet, kodet e mirësjelljes dhe të gjitha këto janë bërë.

Dua të them edhe një çështje që është, konsideroj, mjaft e rëndësishme. Neni 8.1 i Ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe i cili përcakton se raportimi mund të përfundojë, pra kur është fjala për raportimin që u kërkua këtu në Parlament, mund të përfundojë së audituari të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, proces ky i cili do të përfundojë në kohën kur do të paraqitet në Kuvend, pas përfundimit të auditimit të këtyre ndërmarrjeve publike, në përputhje me nenin 28.3 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, po ashtu edhe të nenit 28.1.

Prandaj, do t’ju kisha lutur, zoti Tali, do t’ju kisha lutur të gjithëve, neve do ta sjellim raportin... Deputet Tali, kërkoj falje! Natyrisht, do ta sjellim raportin e plotësuar me të gjitha të dhënat pas përfundimit të auditimit dhe do t’ju kisha kërkuar, po ashtu, të gjithë deputetëve, të kuptohet se kufiri i ndikimit të Grupit ndërministror në ndërmarrjet publike përfundon në pikën ku Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes

një konkursi të shpallur nga sekretari i kryeministrit, në mënyrë transparente zgjedh anëtarët e bordit. Anëtarët e bordit të çdo ndërmarrjeje publike janë të udhëhequr me kodin e sjelljes, me statutin dhe me të gjitha procedurat e ligjit, janë përgjegjës para ligji drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e bordit për politikën, për statusin, për vendimet e biznesit. Nuk mund të ndërhyhet nga Qeveria më shumë, të kërkohej më shumë se sa që e lejon ligji. Kushdo, ju kisha lutur, kushdo në ndonjë ndërmarrje publike, qoftë drejtor, qoftë anëtar i bordit, qoftë punëtor, në qoftë se ka elemente të tilla, çfarë zoti Tali paraqiti, janë adresat e sakta ku duhet të paraqiten. Neve besojmë në auditimet, besojmë në auditorin e jashtëm, besojmë në auditimet që do të na paraqiten dhe në momentin kur do të përfundojnë, do t'i sjellim këtu. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në kontekst pozitiv, po ia përmend emrin!
Replikë, Driton Tali!

DRITON TALI: Për shkak se s'kam kohë shumë, veç desha... Disa herë e keqinterpretoi ligjin zoti ministër, unë iu drejtova Qeverisë, jo ministrit. Sidoqoftë, pika 7.6 thotë, mirë që e lexove: në një mënyrë, domethënë që ndërhyjë, nuk lejon, por ne nuk po kërkojmë të ndërhyjë, të tregojë se çka po bëjnë. Krejt çka është kërkuar në raport, raporti është një përmbledhje e asaj çka është bërë, e jo çka duhet të bëjnë. Domethënë, nëse ju mendoni se ndërhyrje është për të kërkuar përgjegjësi ndaj personave të cilët nuk menaxhojnë konform ligjeve, më falni, po nuk po di çka është ndërhyrja atëherë. Andaj, mos e keqinterpretoni ligjin. Ju lutem, shumë mirë ia kam bërë pyetjen Qeverisë, mocionin, konform Ligjit për ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYETARI: Ke të drejtë ministër, një minutë kundërreplikë!

MINISTRI AHMET SHALA: Unë, veç desha të përsëris, pra që të mos përmendim emra, se pastaj mund të ndodhë edhe ndonjë kundërreplikë. Pas përfundimit të auditivit, i cili është në përfundim e sipër, do të vjen raporti i plotë, konform raportit të auditivit, nga Njësia për monitorim për Parlamentin, sipas procedurave ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë, pati reagime pse ministri e mori fjalën. Neni 40 i Rregullores së re, Rregulla 22 e Rregullores së vjetër, paragrafi 1, pika e) e Rregullores së re, thotë: "Në rastin kur propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor nuk është Qeveria, Kuvendi mund ta kërkojë edhe deklarin e Qeverisë". Prandaj, mbi bazën e këtij neni dhe të kësaj rregullore ne ia dhamë fjalën ministrit.

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare. Sipas radhës, fjalën i pari e merr kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Fjalën e ka në emër të grupit, deputeti Arsim Bajrami. Fjala i jepet përmes kartelës së Vlora Çitakut.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep përkrahje parimore debatit për këtë temë. Vlerësojmë se iniciativa i ka plotësuar kushtet për të debatuar, mirëpo vlerësojmë se debati do të jetë i hendikepuar në mungesë të një raporti nga Qeveria, i cili edhe u paralajmërua nga ministri dhe ne mendojmë se debati do të ishte kuptimplotë, do të thotë mund të rezultonte me rekomandime adekuate vetëm pasi ta kishim këtë raport, të cilin edhe e paralajmëroi ministri.

Ne mendojmë se raportimi apo informata e Qeverisë duhet të jetë në dy segmente. E para, duhet të përfshijë raportet e auditimit dhe menaxhimit, po ne dëshirojmë që Qeveria të njoftojë Kuvendin edhe për ecurinë e transformimit të këtyre ndërmarrjeve publike, të mbajë procesin transparent dhe të njoftojë se në cilën fazë ka ardhur procesi i transformimit duke e ditur se ndërmarrjet kryesore publike janë në proces të transformimit dhe është interes legjitim i Kuvendit që të jetë i informuar për procesin, tempin, shkallën, problemet dhe modalitetet e transformimit të ndërmarrjeve kryesore publike. Andaj, ne do ta përkrahim debatin, por mendoj se nga ky debat nuk mund të rezultojnë konkluzione dhe mendoj se konkluzionet duhet të shtyhen pas ardhjes së raporteve të auditimit për menaxhimin e ndërmarrjeve kryesore publike. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkesa është për debat, ju njoftoj, të nderuar deputetë! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Berim Ramosaj e ka fjalën.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, ministër,

Në emër të Grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim i japim mbështetje debatit, duke marrë parasysh gjendjen e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror në Kosovë. Vetë funksionimi i tyre, respektivisht vetë fakti i ekzistimit të pronës si pronë publike të ndërmarrjeve publike në Kosovë të nivelit qendror, kërkojnë plotësimin e dy kriterëve elementare, të cilat janë vë në pyetje nga ndërmarrjet publike. Është fjala për efikasitetin ekonomik të tyre dhe përgjegjësinë sociale të tyre. Këto janë dy kriterë, të cilat, të gjitha ndërmarrjet publike që nuk janë privatizuar, qoftë në regjion, qoftë në Evropë në përgjithësi, duhet t'i plotësojnë këto dy kriterë. Kriterin e efikasitetit ekonomik e plotësojnë duke marrë parasysh raportin midis shpenzimeve dhe fitimit që e realizojnë, gjë që mungon në shumicën e ndërmarrjeve publike në Kosovë. Kurse, sa i përket kriterit të përgjegjësisë sociale të tyre, vërtet ato nuk po mund të luajnë ende atë rolin e respektimit, qoftë të komunitetit, qoftë të drejtave, qoftë të raporteve të mjedisit social në përgjithësi. Menaxhimi i tyre është i nivelit relativisht të ulët, duke shikuar edhe efikasitetin e tyre edhe efektivitetin e tyre. Efikasiteti i tyre është vë në pyetje duke marrë parasysh strukturat menaxheriale të këtyre ndërmarrjeve publike, të cilat nuk po munden ende t'i menaxhojnë ashtu që të realizojnë fitime maksimale, ndërsa sa i përket efektivitetit, respektivisht realizimit të objektivave për të cilën edhe ato ndërmarrje funksionojnë si ndërmarrje publike, po ashtu janë shumë pikëpyetje në lidhje me to.

Pas debatit i cili, në fakt, i sheh shumë të meta të tyre, por sheh edhe suksese, pa dyshim, do të dalë ndonjë prej deputeteve, ne kemi menduar që në fund të debatit të nxirren rekomandime në lidhje me këto ndërmarrje. Rekomandimi i parë kishte për të qenë rishikimi i organizimit të tyre në aspektin menaxherial, që nënkupton ndërtimin e kapaciteteve menaxheriale të drejtorëve në nivel të top menaxhmentit, në nivel të menaxhmentit të mesëm dhe në nivel të ulët, që ende kanë mbetur nga strukturat e kaluara. Këto ndërmarrje, edhe pse janë organizuar si kompani, shumica e tyre prapë kanë mbetur si struktura të vjetra në aspektin menaxherial, mu për atë edhe suksesi i tyre sot mungon.

Rishikim i bordeve mbikëqyrëse, si rekomandim i dytë. Duke marrë parasysh se shumica e bordeve mbikëqyrëse të këtyre kompanive janë borde që janë shumë të infilttruar nga aspekti politik, pa dyshim ne rekomandojmë që bordet e këtyre ndërmarrjeve, në qoftë se dëshirojmë të luajnë rolin e mbikëqyrësit, në aspektin e menaxhimit të jenë edhe të nivelit të ekspertizës, edhe të nivelit të përfaqësimit në

aspektin edhe të grupacioneve politike, por edhe të komunitetit në tërësi, gjë që mungon në shumicën e ndërmarrjeve publike.

Dhe, në fund, ne mendojmë se privatizimi i operatorëve, i pjesëve të këtyre ndërmarrjeve ose privatizimi i tërësishëm i këtyre ndërmarrjeve sigurisht do të jetë terapia kryesore për ta nxjerrë të sëmurin nga kjo gjendje. Meqenëse ndërmarrjet publike në Kosovë po vërehen për shkallë të ulët të menaxhimit, për nepotizëm dhe për shkallë të lartë të korrupsionit, ne mendojmë se privatizimi është ai që mund të tejkalojë këtë fenomen. Apriori, ky privatizim të jetë normalisht në bazë të konditave, shumë transparent, të respektohet prona publike e në të njëjtën kohë t'u jepet operatorëve, respektivisht privatëve të cilët janë në gjendje edhe t'i menaxhojnë më mirë, por edhe të sigurojnë shkallë të lartë të fitimit, gjë që Republika e Kosovës përfiton qoftë nga taksat, qoftë nga format tjera, qoftë koncensionare që jepen, apo nga shitja e tyre.

Duke marrë parasysh këtë, ne e kemi një strategji të privatizimit në përgjithësi. Kjo ka arritur deri në një shkallë në ndërmarrjet shoqërore, por në ndërmarrje publike ende nuk jemi, përveç fazës fillestare në koncensionim, respektivisht të dhënies së disa operatorëve. Ne mendoj më se privatizimi, në fund, privatizimi dhe prapë privatizimi do të jetë faktori vendimtar që ne do të na lirojë nga ky kancer i madh, që faktikisht burim i kancerit të korrupsionit, të hajnisë, të nepotizmit dhe të shumë formave negative në Kosovë. Ky, si proces duhet të sulmohet, e jo të personalizohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, kush e do fjalën? Deputeti Ardian Gjini! Keni parasysh, lexoni rregullat, në dashi rregulloren e re, në dashi të vjetrën, kërkesa është për debat.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës,

E këqyra orën për të parë sa minuta po i lënë, se kanë nisur t'i shkurtojnë

Sidoqoftë, në hyrje kisha thënë, e kisha cituar dike që një herë, në gjuhë të huaj ka thënë: "krejt qa nevojitet që e keqja të triumfojë në botë, është që njerëzit e mirë të mos bëjnë kurrjë". Le të jetë kjo thirrje për ata që e konsiderojnë vetën njerëz të mirë të shohin pak rreth e rreth vetës dhe të vendosin se çka donë të bëjnë më tutje. Sidoqoftë, po filloj prapë jashtë konceptit që e kam ndërtuar me disa fjalë që i tha ministri më përpara. E lexoi ligjin shumë mirë. Para pak minutave në lajme kanë lajmëruar që Televizioni publik, që Qeveria e Kosovës, ka kërkuar nga PTK-ja, ta ndalë punësimin.

Ministri na tha këtu që Qeveria nuk guxon të ndërhyjë në punën e menaxhmentit, përpos përmes bordit. Realisht, kjo është edhe thyerje e planit të Ahtisarit, e Propozimit Gjithëpërfshirës edhe i Kushtetutës së Kosovës, por edhe e ligjit, kjo ndërhyrje e sotme. Kryetari i Kuvendit ka qenë me mua, ne e kemi pranuar modelin evropian të menaxhimit të ndërmarrjeve publike, që është përfshirë në atë pakt, do të thotë, sot Qeveria ka ndërhyrë në ndërmarrjen publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, drejtpërdrejt ka kërkuar të ndalët punësimi. Tani shtrohet pyetja: pse ka ndërhyrë Qeveria? Ai far menaxheri që e ka zgjedhur Bordi, që këta e kanë zgjedhur, nuk ka biznes plan, ai nuk e din sa duhet t'i punësojë, ai nuk e din kur duhet për t'u ndalur, ose s' guxon të mos punësojë se i thonë këta realisht. Domethënë, diçka është krejt e mbrrapshtë, këtu diçka është krejt jo në rregull edhe kanë filluar të harrojnë edhe vetë

çka po bëjnë. Edhe ministri, në vend se të na i lexoj ligjet neve, është dashur t'ia lexojë Kryeministrit, në mbledhje të Qeverisë.

T'ia thotë, mos kryeministër se është shkelje e ligjit. Nuk guxon Qeveria të ndërhyjë kështu drejtpërdrejt në punën e ndërmarrjes publike, përpos në mënyra tjera. Edhe e ka gjetur më kollaj të na e lexoj neve se nuk ka guxuar ta lexojë atje këtë ligj, t'ia tregojë kryeministrit se çka duhet të bëjë. Tani lirisht qeshni, ju neve, keni për të na falënderuar se po ua çelim sytë dhe po jua ruajmë rreshtin e fundit, mos, keni kujdes. Domethënë, edhe ju gëzojuni suksesit të Kosovës, vazhdoni për t'ju gëzuar suksesit të Kosovës.

Tash po kaloj në këtë pjesën konceptuale edhe po ndalem vetëm pak te KEK-u, për shembull. Kosova, pa e përsëritur kolegun tim përpara, Kosova blen rrymën më të shtrenjtën, përmbi dy herë më shtrenjtë se vendet tjera. Gjithmonë ka arsye, arsyet janë të ndryshme, dikush na thotë diçka tjetër, dikush diçka tjetër, por nuk është çudi, nuk keni çka të çuditëni se e bëra një hulumtim dhe edhe del që arkat fiskale, që po i imponon ky ministri, në Kosovë kushtojnë mbi 650 euro, ndërsa në Serbi, 150 deri në 350, më e lira deri të më e shtrenjta, të njëjta, prej një ndërmarrje të huaj, atje një fabrike që i prodhon të njëjta, krejt të njëjta. Por, nuk është me rëndësi prapë kjo punë se qysh kemi për t'u çuditur ne, pse rryma blihet dy herë më shtrenjtë kur e kemi blerë dy herë më shtrenjtë, kur e kemi blerë 15 euro një abetare, hajt se ta ruaj rendin e fundit unë ty.

Ti e blen 15 euro një abetare dhe po vazhdojmë më tepër, është interesant një fjalë, e kam dëgjuar, është fenomenologji. Kjo far fenomenologjia po u marrka me fenomenet, që ndodhi që janë gati të pashpjegueshme. Për shembull, ndërmarrjeve publike u zhduket prona, zhduket toka, sot është, nesër nuk është, hiq s'është, lype sa të duash, nuk e gjen. Po prapë këto farë fenomenet nuk janë për t'u çuditur, nuk keni çka të çuditëni se në Kosovë uji rrinë në asfalt në përpjetëze, dilni rrugëve, kurrkund në botë nuk bën vaki, përpjetëze është edhe uji rrinë në asfalt. Duhet t'ia thërrasim ekspertët ndërkombëtarë të vijnë të na shpjegojnë çka është ky farë asfalti antigravitacional a çka është ky, domethënë, nuk është çudi kjo punë?

Po kthehem edhe pak te PTK-ja edhe te "Vala" edhe po ju them fenomeni tjetër është që në botë ka raste në të cilat Qeveria i diskriminon ndërmarrjet private edhe i favorizon ndërmarrjet publike. Edhe ajo është shkelje e ligjit në ato vende, për shkak se nuk guxon ashtu, duhet të ketë rregulla të barabarta për të gjithë. Çka ndodhë në Kosovë, është fenomeni tjetër? Qeveria e Kosovës i favorizon ndërmarrjet private e i shkel ndërmarrjet publike edhe po ju kallëzoj qysh, qe sa kollaj, pa u keqkuptuar, domethënë, me respektin më të madh për kompaninë IPKO, po ju tregoj cili është raporti në mes VALËS dhe IPKO-s, shembull ta marrim. Kompania publike IPKO i ka dy frekuenca, 900 dhe 1800 megaherc. Kompania publike Vala, e ka kërkuar frekuencën e dytë, sikur operatori privat, e ka kërkuar disa herë dhe nuk i jepet, domethënë ART-ja, që kur bisedon me ata vetë,

Qeveria çka të na thotë, nuk ia japin operatorit publik kushtet e njëjta me operatorin privat, fenomen është ky.

Çështja tjetër është se ekzistojnë rregullat për përgjim të licencuar në operatorin publik Vala, e nuk ekzistojnë në operatorin privat IPKO, që domethënë, prapë Qeveria ka kujdes që të ketë përparësi pakëz ndërmarrja private, ose kompania private, në krahasim me kompaninë publike, që duhet të jetë mbrojtëse e saj. Çështja tjetër është, lypin operim për shembull për Internet, Trixhi, prapë nuk ia jep, thotë duhet hapur tender, se a di me ju s' mund të merremi, me publikun nuk mundemi e me të tjerët

mund të merremi edhe punësimi, po kthehem edhe një herë. Nuk e di pse nuk janë këtu, gjysma e ministrave bre, i kanë familjarët e vet aty, po çka po na thonë këtu neve, duke filluar prej atij Stavilecit që ulet në skaj, mund t'jua përmend edhe emrat nëse doni, i kanë punësuar krejt njerëzit brenda dhe tash po thonë ne po e ndalim punësimin.

Me këtë punësim që ka ndodhur, ia kanë ulur vlerën ndërmarrjes publike para se ta shesin edhe tash thotë ndaleni punësimin, t'ia rrisim vlerën. Po edhe kjo nuk është kurrfarë çudie, kur dihet, të gjithë ne e dimë që i kemi dhënë 15 milionë euro për ta ndërtuar "Rilindjen", për t'jua hequr prej qirasë ministritë, e tash paguajmë qira për "Rilindjen." Çka kemi të çuditemi për ndërmarrjet publike? Edhe në fund po ju them, pasi po qeshni, a po ju duket që është patriotizëm kështu, Gani? A po të duket edhe po të lus, gëzoju edhe ti suksesit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Gani Koci e ka fjalën. Mos përmendi emra.

GANI KOCI: Unë sukseseve edhe rezultateve të Kosovës iu kam gëzuar moti, por është vërtet e pamundshme që për dy vjet t'i ndërtojmë edhe t'i rregullojmë të gjitha ato që i ke prishur ti, Ardian Gjini, bashkë me shokët tuaj, në Qeverinë e kaluar.

KRYETARI: Një minutë kundërreplikë, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Realisht, nuk e di për çka po flet zoti Gani Koci, vetë është pjesë e rrënimit të institucioneve edhe ndërmarrjeve publike, bile ky nuk ka të drejtë. Mirëpo, po ju them diçka, nëse i shihni parametrat e para dy vjetëve dhe sot e shihni kush ka rrënuar edhe ai UNMIK-u i keq që e shajti ti ka qenë pak më i kujdesshëm me ndërmarrjet publike, iu ka dhimbte pak vendi i vet më shumë se sa po të dhemb ty, qysh ia bëjnë njerëzit vendit të vet kështu?

KRYETARI: Pa fjalë! Në emër të AKR-së, kush e donë fjalën? Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot ky Kuvend po debaton për një çështje shumë të rëndësishme, për një çështje për të cilën një debat i tillë është dashur të bëhet shumë më herët, sepse kam frikë se tashmë është i vonuar. Them i vonuar, sepse në vazhdimësi gjendja në ndërmarrjet publike qendrore po shkon drejt keqësimit për shkak të ndërhyrjes të vazhdueshme të politikës dhe keqmenaxhimit të skajshëm.

Në mungesë të raporteve zyrtare të Auditorit Gjeneral, diskutimi im do të mbështet në raportet e institucioneve tjera relevante, ndërkombëtare dhe vendore.

Kolegë të nderuar,

Sot ndërmarrjet publike, janë kthyer në një arenë përplasjesh të interesave të partive politike në pushtet. Bordet dhe strukturat menaxhuese të ndërmarrjeve publike janë politizuar skajshmërisht dhe po vazhdojnë edhe më tutje të politizohen. Derisa Qeveria e Republikës së Kosovës, ka marrë kompetenca në raport me ndërmarrjet publike, kjo nuk është përcjell njëkohësisht me krijimin e mekanizmave efektiv mbikëqyrës për këto ndërmarrje, dhe si rezultat i kësaj sot ato kanë mbetur me qëllim pasuri e gjithkujt dhe pasuri e askujt. Bordet dhe menaxhmenti i këtyre ndërmarrjeve janë vënë në shërbim të grupeve të interesit dhe individëve të partive në pushtet ose të familjarëve të tyre. Nuk

është e vështirë për ta vërtetuar këtë fakt, vetëm duhet pyetur se kush ku mund të punësojë dike. Zgjidhja fatkeqësisht është, ndërmarrjet publike.

Që nga kosovarizimi i ndërmarrjeve publike, me ligjin e ri, nëpër këto ndërmarrje janë punësuar me mijëra punëtorë, pa kurrfarë kriteri dhe bazë ligjore apo të ndonjë dokumenti afarist. Për shembull, në kompaninë më profitabile në Kosovë, në Postën dhe Telekomin e Kosovës, janë punësuar mbi 2000 persona, që nga ardhja e drejtorit të ri. Nuk e di se cila është baza ligjore e marrjes së personave në punë, pa shpallur konkurs, por vetëm me një kontratë, e ashtuquajtur kontratë mbi veprën, e që pas tre muajve, këtyre punëtorëve u lëshohet kontrata afatgjate, praktikë antiligjore dhe për më tepër në kundërshtim me çdo dokument afarist.

Si mund të punësohen mbi 2000 persona në një ndërmarrje për dy vjet, ku gjatë këtyre dy vjetëve, kjo ndërmarrje ka rënie të aseteve, si për shkak të konkurrencës, ashtu edhe për shkak të keqmenaxhimit, por këta të punësuar janë: gra, motra, vëllezër, tezakë, kushërinj, baxhanakë e tjerë, e tjerë, të personave me ndikim në politikën kosovare? Dhe tashmë është bërë rregull e pashkruar që për punësimin eventual në një ndërmarrje publike në Kosovë, duhet plotësuar njërën nga këto dy kushte: të kesh lidhje me persona me ndikim, ose të japësh mito në një vlerë bajagi të madhe.

Kjo problematikë e punësimit, pa bazë ligjore dhe me një nepotizëm të skajshëm, është prezent pothuaj se në të gjitha ndërmarrjet publike, por që më e theksuara është në ndërmarrjet më të mëdha, që realizojnë profite të mëdha, për shembull në PTK, Aeroport, por edhe në KEK.

Zotëri ministër,

Ju më herët thatë se Qeveria nuk mund të përzihet në punën dhe buxhetin e ndërmarrjeve publike. Si mund ta arsyetoni faktin se shumë herë Qeveria përzihet në buxhetin e juaj, më mirë të them në mjete, duke ndërtuar shtëpi, mirë është që ndërtohen shtëpi edhe unë jam për t'u ndërtuar shtëpitë, mirëpo këto ndodhin me mjetet e juaja dhe pikërisht para fushatave zgjedhore?

Të nderuar kolegë,

Fatkeqësisht, punësimi nuk është e vetmja shkelje ligjore që bëhet në këto ndërmarrje, por janë edhe prokurimet korruptive dhe të ashtuquajtura sponzorizime me karakter politik apo përfitues. Sot jemi dëshmitarë se si këto ndërmarrje bëjnë prokurime dhe sa të përfolura janë këto, duke krijuar mundësinë e vjedhjeve me qindra miliona euro, duke lidhur kontrata me operatorë fiktivë ose operatorë të papërgjegjshëm, por që në këtë rast, unë nuk do të diskutoj më tutje për këtë segment, sepse ka aq shumë fakte, sa që është e pamundur për ta përmbledhur në diskutimin tim.

Segment tjetër korruptiv janë bërë edhe të ashtuquajturat sponzorizime. Është për t'u habitur se si Njësia për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, nuk ka kërkuar ose së paku rekomanduar që këto ndërmarrje të kenë një rregullore në bazë të së cilës mund të bëjnë sponzorizime. Sinqerisht ju them se unë po ndihem e fyer kur po i shoh logot e këtyre ndërmarrjeve nëpër çfarëdo pseudo ngjarje ose kur po e mendoj se çfarë profiti mund t'i sjellë ky sponzorizim. Për fund, më lejoni t'i theksoj edhe disa probleme në formë rekomandimesh lidhur me këto ndërmarrje publike, e që vlerësoj se janë shumë me rëndësi që të dalin nga ky debat.

E para, Kuvendi duhet ta detyrojë Qeverinë, si pronare e këtyre ndërmarrjeve, që të kujdeset në bazë të ligjit, lidhur me rritjen e aksioneve të këtyre ndërmarrjeve.

Së dyti, dy herë në vit t'i raportojë Kuvendit, lidhur me performancën e këtyre ndërmarrjeve.

Së treti, mos t'i hyjë privatizimit apo ndonjë forme tjetër të këtyre ndërmarrjeve që janë asetet kryesore të vendit, të cilat edhe për një kohë, përkundër shumë keqpërdorimeve dhe keq menaxhimit, janë profitabile dhe në një mënyrë e mbajnë monopolin.

Kolegë deputetë,

Uroj që ky debat të mos mbetet vetëm në sferën e një debati, i cili e konsumon një çështje kaq të rëndësishme, por si rezultat i tij, mendoj se është e domosdoshme që ky Kuvend të formojë një komision hetimor parlamentar për hetimin e shkeljeve të shumta që janë bërë deri me tani në ndërmarrjet publike. Dhe krejt në fund të këtij diskutimi, unë e ftoj Prokurorinë Speciale që t'i fillojë hetimet në këto ndërmarrje, sepse konsideroj se e ka shumë lehtë t'i gjejë rrugët e financimit të paligjshëm apo edhe lidhjes politike me këto ndërmarrje. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Zotëri ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më në fund, Kuvendi i Republikës së Kosovës, nganjëherë edhe me iniciativa të vetë deputetëve, me kërkesën e 12 deputetëve, ka kërkuar një debat mbase shumë të rëndësishëm dhe substancial për ndërmarrjet publike, sepse këto dy vjet e pak muaj të pavarësisë, ky Kuvend, pothuajse fare nuk është marr me ndërmarrjet publike që kanë një vlerë dhe një rëndësi të jashtëzakonshme si asetet nacionale.

Sipas nenit 8.1 të Ligjit për ndërmarrjet publike, me të cilin Qeveria i përgjigjet Kuvendit për mënyrën në të cilën ajo, ministria apo edhe grupi ndërmintor, njësia për politikën dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike, i ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Qeveria duhet t'i raportojë Kuvendit në bazë vjetore lidhur me performancën e këtyre autorizimeve dhe përgjegjësisë, si dhe për arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar qartë me nenin 6.1 të këtij ligji.

Sipas nenit 8.1 të këtij Ligji për ndërmarrjet publike, me të cilin Qeveria obligohet t'ia sigurojë të dhënat kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit, për mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjeve publike, që nga 15 qershori i vitit 2008, kur ky ligj ka hyrë në fuqi, por kjo nuk ka ndodhur. Tani jemi në fund të majit të vitit 2010. Vërtet është e pashpjegueshme, me kërkesën e 12 deputetëve të gjitha grupeve politike, kur organi legjislativ vendos që të vejë në rend dite një temë kaq të ndjeshme, zoti ministër ka qenë dashur që të vihet me një shkresë, qoftë edhe sot në mëngjes t'i leni në setet e deputetëve, që ende nuk është kryer ky proces i famshëm i auditimit, dhe në këtë mënyrë të mos luhet dhe të mos të lajthitet Kuvendi dhe deputetët. Ne jemi të zgjedhurit e qytetarëve, ne përfaqësojmë vullnetin e qytetarëve në organin më të lartë legjislativ të vendit. Që disa herë po apeloj që Qeveria është zgjedhur nga Kuvendi dhe i jep llogari Kuvendit.

Duke e parë këtë trend mospërfillës, për njerëz të zgjedhur në organin më të lartë legjislativ të vendit, atëherë po bini vetë në insinuata të palakmueshme, qoftë edhe

vendime ad-hoc, të cilat deshët apo nuk deshët, duhet të vijnë këtu dhe ta marrin bekimin e këtij institucioni. Mbase, ne nuk jemi njerëzit më të mirë dhe më të denjë, por populli i Kosovës, përmes vullnetit të tij politik, ka vendosur që ne të debatojmë për asetet nacionale. Këto ndërmarrje publike janë pasuri kombëtare e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Zotëri ministër,

Ju thatë që anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike, përmes një konkursi transparent dhe publik, të shpallur nga sekretari i përhershëm i Qeverisë, janë zgjedhur. Nuk dua t'ju demantoj tani dhe nuk dua të flas me emra, por kemi në Bordin e PTK-së, anëtarë të Kryesisë të Kuvendit dhe deputetë, kemi në bordin e Agjencionit të Privatizimit të Kosovës, deputetë. Kemi familjarë të politikanëve nga hierarkia më e lartë e shtetit. Në qoftë se doni, ua përmend me emër ku punojnë dhe pse i kanë nga dy apo tri poste dhe pse kanë përfitime nga këto ndërmarrje publike, nga 4000 e 5000 euro. Dhe për këtë duhet drejtësia, pasi që ky shtet dhe këto institucione s'po kanë fuqi as politike as juridike as morale për të ushtruar pushtetin e vet dhe për ta zbatuar ligjin, atëherë po duhet të hyjë drejtësia dhe të kryejë punën e vet. Nuk është shenjë e mirë dhe nuk është terapi e mirë kjo për shtetin e ri të Kosovës, sepse kështu po na ikin investitorët dhe që dy vjet e disa muaj, ministër, me pavarësi, asnjë cent investime të huaja direkt nuk kanë ardhur në Kosovë. Asnjë vend i ri i punës nuk është hapur nga IHADE, dhe realisht, ministri i Ekonomisë së Financave, e di mirë këtë çështje.

Është përfolur shumë në media edhe këto dy-tri ditët e fundit për korrupsionin, aferat korruptive, skandalet, vjedhjet dhe shkeljet enorme dhe abuzimet me buxhetin e këtyre ndërmarrjeve publike. Është e pashmangshme qysh në PTK, për një projekt fizibiliteti që e kap shifrën maksimale 10 milionë, ndahen 20 milionë. Të kujt janë këto mjete? Kush guxon të menaxhojë kështu? Thjesht, kush guxon t'i vjedhë ato para të popullit të Kosovës dhe kujt i duhet t' i japin përgjegjësi tani këta njerëz? A ka shtet, a ka institucione, kur nuk po e bëjmë ne punën tonë, e miqtë tanë ndërkombëtarë po thonë, kryeni punën, atëherë po na hyjnë, po na terrorizojnë me maska, po na bastisin, po dalim në emisionet e mediave më të fuqishme si hajna, ose ambasadorë të vendeve jo mike të Kosovës po thonë: "shtet banditësh". Faji është te ne, faji është edhe i këtij Parlamenti. Duhet për ta ushtruar detyrën tonë, ta respektojmë ligjin, Kushtetutën, dhe legjislacionin në fuqi.

Zoti ministër, keni përgjegjësi, keni përgjegjësi edhe si ministër i Ekonomisë së Financave, por edhe si grup ndërministror, pa dashur juve personalisht t'ju apostrofoj. Por është përgjegjësi mbi institucionet e shtetit të Kosovës, ose jemi shtet dhe t'i kryejmë obligimet tona shtetërore, ose jemi njëfarë sui generis dhe ashtu po na vijnë të gjitha punët dhe ato më të zakonshmet që mund t' i kryejmë vetë, sui generis. Mbi 1000 njerëz punësohen në PTK, prej se ka ardhur kjo Qeveri, Qeveria më e mirë në botë, më e suksesshme në planet, historike e tjera e tjera. Por, raportet e auditimit që i keni sot-pjesë të caktuara edhe në media, flasin të kundërtën, që jemi si institucione në listë të zezë në krahasim me vendet e rajonit dhe jeni Qeveria më e korruptuar në regjion, bindshëm, jeni rekord dhe në kuptimin më pozitiv çka keni për t' ju thënë deputetëve dhe qytetarëve? Mos i leni hapësirë tjetërkujt të vijë të merret me ju, por ta ndërtojmë një korrelacion të komunikimit institucional, ekzekutiv, llogaridhënie dhe transparencë legjislativitet dhe t'i njoftojmë qytetarët për asetet e tyre nacionale, asgjë më shumë as më pak. Dhe, këto nuk po i them unë, por po i thonë mekanizmat relevant, vendorë dhe ndërkombëtarë dhe po i thonë edhe mediat, të cilat edhe ashtu disa media, se të tjerat dihet çka po ndodhë me to.

Është e vërtetë që duhet të privatizohen, por duhet një performancë, një evoluim, një vlerësim real i këtyre ndërmarrjeve dhe çka fiton Kosova dhe qytetari i Kosovës, vetëm shitjen apo vetëm taksat që do t'i paguajnë ata operatorë të ardhshëm të privatizimit? Jo, duhet të vlerësohet mirë, të hartohen politikat dhe strategjitë me interes nacional. Pse shitet PTK-ja? Në Gjermani është debatuar dy vjet e diçka.

Zoti ministër,

Janë disa sektorë në PTK, që janë të rëndësishëm për Agjencionin Kosovar të Inteligjencës, për Ministrinë e Punëve të Brendshme, për Forcën e Sigurisë, për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, për Zyrën e presidentit, kryeparlamentarit, kryeministrit, janë disa linja telekomunikative që nuk bën t'i dijë ai që vjen edhe ta blen PTK-n. Janë të shtetit të Kosovës, jemi institucione, sepse në këso pozita indiferente kur të gjithë na i dinë punët dhe ne nuk i dimë punët tona, nuk ka këndohet këngë e mirë. Atëherë, zotëri ministër, të përshpejtohet ky proces dhe të vihet me një raport konkret që ky Kuvend, të debatojë dhe të dalë me konkluzatë të qarta si të shkohet më tutje, sepse kështu qysh po vazhdohet, vërtet këto ndërmarrje publike që janë asete nacionale dhe populli i Kosovës pret diçka të mirë prej tyre, po devalvohen dhe unë frikohem që kjo Qeveri, me këtë trend që e ka nisur, do t'i shesë për pesë pare. Ju faleminderit! Dhashë Zoti që të jem gabim.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “7+”...

Urdhëro, ministër! Jo, mundeni tash, sa për mua. A ke çka thua? Urdhëro!

(Reagime nga salla)

MINISTRI AHMET SHALA: Jo në fund po harroni çka po flisni. Unë veç dy-tri gjëra desha për hir edhe të audiencës, edhe të korrektësisë që kemi, prapë do të përpiqem që të mos përmend emra, që të shkaktoj më replikë.

Në Kosovë, në vitin 2008, janë investuar 350 milionë euro, sipas shënimeve të Bankës Qendrore. Në Kosovë, në vitin 2009, janë investuar 250 milionë euro dhe të shënuara si investime të drejtpërdrejta të jashtme. Andaj, do t'ju kisha lutur, unë e di që kjo përdoret shpeshherë edhe për fushatë edhe për imixh edhe për diçka tjetër, por kur të flasim me shifra, është mirë të flitet saktë me shifra. Shikoni raportet e Bankës Qendrore dhe tregojnë saktë sa janë shifrat e investimeve të jashtme direkte. Nuk janë të kënaqshme, natyrisht, por megjithatë nuk është e vërtetë fjala që u tha këtu e paraflësit se nuk ka asnjë investim të jashtëm, do t'ju kish lutur.

Aspektin tjetër desha të sqaroj disa elemente, sa i përket monitorimit dhe mbikëqyrjes, ju kisha lutur shumë merreni nën 7.1, po i kemi lexuar, por këtu po i deformoni dhe thotë në mënyrë shumë decisive, se në qoftë se performanca e bordeve të ndërmarrjeve publike, vetëm po citoj:” 7.1 ..., sido që të jetë, nëse një ndërmarrje publike dështon në arritjen e caceve të saja të performancës për dy vite financiare radhazi, personi përgjegjës për ushtrimin e detyrave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e bordit të drejtorëve”. Ende nuk kanë kaluar dy vjet, unë nuk dua ta shkelë ligjin, nëse dikush do. Dakord. Ne jemi me shumë vëmendje duke i përcjellë disa ndërmarrje shoqërore. Nuk jemi të kënaqur 100%, por nuk mund të zbatoj përtej ligji këto gjëra dhe, edhe nëse dikush insiston për çdo ditë, unë nuk do të jem ai i cili do të iniciojë një procedurë kundërligjore.

Të gjitha auditivet të cilat janë, do të sillen këtu, do të jenë në portofolin e secilës ndërmarrje dhe vetëm atëherë dikush mund të ngre ndonjë procedurë të caktuar. Ju faleminderit!

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Neni 48 i Rregullores së Kuvendit, thotë: “Ministri që e ka mbajtur fjalën, ka të drejtë t’u përgjigjet shkurtimisht komenteve ose pyetjeve që mund t’i parashtrohen”, do të thotë ministri ka pasur të drejtë.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, nuk donë. Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk donë. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo se javljam povodom pokrenute debate od strane grupe poslanika, na čelu sa gospodinom Dritonom Talijem, o situaciji u javnim preduzećima ovde na Kosovu.

Danas imamo jako važnu temu pred sobom i pozdravljam grupu poslanika koji su pokrenuli ovu inicijativu za razmatranje situacije u javnim preduzećima. Situacija u javnim preduzećima, moramo da znamo na Kosovu da je alarmantna. Alarmantna je naročito u javnom preduzeću, a i ne vidimo danas na kosovskoj sceni malo, da kažem malo potencijala političke moći i političke volje od strane Vlade Kosova da nešto promeni ili reguliše u sferi javnih preduzeća.

Prvo, kao prvo, mi danas imamo debatu kakva je situacija na terenu, kakva je situacija u javnim preduzećima, šta ne dostaje, šta ne valja. Prvo, moramo da znamo da su to javna preduzeća kao što je Aerodrom, kao što je Elektroprivreda KEK, kao što je PTK, Pošta i drumski saobraćaj i ostala javna preduzeća. Međutim, nešto što jako zabrinjava, kao što su i komunalne usluge, normalno javna preduzeća. Prvo, moramo da znamo šta se tamo u javnim preduzećima dešava. Dali oni imaju socijalni i ekonomski program. Možemo da kažemo slobodno ne, zato što tada javna preduzeća, koja treba da zarađuju mimo Aerodroma, su sva javna preduzeća i pošte koja mi vršimo dekapitulizaciju javnih preduzeća, dajemo iz budžeta javnim preduzećima, godinama dajemo, da ne kažemo milijardu ipo smo uložili u KEK, i šta smo od KEK-a napravili. Ovo je jako važno pitanje, koliko javna preduzeća postoje da bi punili budžet Kosova, a ne da bi praznili budžet Kosova.

Kao drugo, krši se Zakon o zapošljavanju, Zakon o radu, Zakon o penzijskom i invalidskom osiguranju u ovim preduzećima. Ne možemo da kažemo danas ne postoje zakoni, da kažem sa klauzolom – Kosovo Republika, ali te zakone smo imali sa UNMIK-ovom Uredbom. Situacija je na terenu bila da se oko zapošljavanja, da nemaju, ova javna preduzeća nemaju zakon i nemaju red o zapošljavanju. Nemaju sistematizaciju, nemaju nivelizaciju radnih mesta, nema zapošljavanja po ključu za zajednice. Sva menadžerska mesta su uzurpirana od strane političkih subjekata. To nije novina, to možemo slobodno da kažemo. Možemo da pođemo na teren da identifikujemo ljude sa imenom i prezimenom.

Ova Vlada mora da definiše status javnih preduzeća. Status javnih preduzeća još nije definisan. Dali su ona akcionarska društva. Ako su akcionarska društva, postoji Centralna

banka. Šta su od papira, šta su od novca, šta su kao ulog stavili, koju garanciju da budu javna preduzeća. Gde su ti fondovi, gde su pare, gde su pare? Ko je kupio akcije?

Drugo, dali su deoničarska preduzeća, što znači u deoničarskim preduzećima pola su društvena radnička, pola državna. Dali su društvena, državna preduzeća? Koji je kapital, koji odnos 50, 51, 30 sa radnicima 49. Ona su danas samo dekapitulizovana preduzeća, gde se vrši jaka i velika zloupotreba u svim sferama, u svim ovim preduzećima u kojima sam dala do znanja.

Mi moramo danas da damo jako važne poruke, obavezna je decentralizacija javnih preduzeća. Jako je žalosno da su na Kosovu danas centralizovana javna preduzeća, mi znamo zašto, da bi se vodio račun, da bi to bila jedna blagajna, centralizovana, koju mogu da koriste pojedinci i zloupotrebljavaju normalno isti ti pojedinci. Obavezna decentralizacija u vođenju politike poslovanja u nabavci, u javnoj nabavci, gde se vrši zloupotreba Zakona o javnoj nabavci, gde se na centralnom nivou nabavlja za sva, da kažem, preduzeća elektroprivreda na Kosovu, gde su prepoznatljivi po tenderu isti, oni koji dobijaju posao i oni koji poručuju posao. Znači, da bi sprečili pranje novca, mi moramo da izvršimo decentralizaciju javnih preduzeća, a od toga će budžet Kosova i kosovska politička situacija samo da dobije a da izgubi ništa neće.

Jako je manjkavost javnih preduzeća zakonsko, kažem nezakonito menadžiranje. Nema menadžiranja sa stručnim kadrovima koji imaju višegodišnje iskustvo radi poboljšanja normalne ekonomske i socijalne situacije u javnim preduzećima na Kosovu. Moram da kažem da postoje menadžeri koji imaju samo osnovnu školu, škollën fillore. Mi nismo napravili analizu ko je zaposlen sve u javnom preduzeću. To što je zaposlen nezakonito bez konkursa, sa nekim internim ugovorima i šta se sve tamo dešava, mi moramo da napravimo jednu stručnu ekipu koja će više da stavi na skener javna preduzeća.

Znači, Vlada i mi kao Skupština, Vlada je ta koja daje konkurs ministarstva i biramo normalno bordove, ja neću da ponavljam članove i stavove, koje je ministar ponovio i sa kojima je žustro gledao da se odbrani, mora Vlada da preispita bordove. Mi Skupština glasamo bordove i sredstva koja smo izdvajali za ova javna preduzeća, postajali su od 2008. 2009. a šta je postignuto, koji je bord preispitan, šta je bilo na terenu? Ništa. Moramo da ugasimo nepotizam, moramo da uradimo analizu sadašnje situacije kada je u pitanju Aerodrom, kada je u pitanju KEK, kada je u pitanju PTK, kada je u pitanju svako javno preduzeće ovde na Kosovu.

Dato nam je do znanja da je međuministarska grupa za javna preduzeća nadležna za davanje izveštaja o situacijama u javnim preduzećima. To je obaveza na osnovu Zakona o javnim preduzećima. Mi moramo da kažemo da imamo stvarno, kada se radi teorijski, jako dobru platformu zakona, međutim kada je praksa u pitanju, mi moramo da priznamo da smo prozvani od strane Evropske komisije. Evo, ja ću samo nekoliko naslova na koje sam naišla i za koje mi je jako žao kada kažu da je na Kosovu kriminal snažniji od vlasti, ili da EU poziva na bolju praksu nabavke na Kosovu. Dali mi možemo da demantujemo ove izveštaje koje daje BBC-i, koje daje Evropska komisija. Mi možemo da demantujemo ovde jednu Veziru Emruš. Mi ne smemo više da snosimo kolektivnu odgovornost. Moramo da prepoznamo, ja sam više puta dala do znanja, ljude na terenu u javnim preduzećima, u institucijama ko je, šta je, gde je, šta izvršava, koje rezultate ima, ovo je jako bitno.

Ja moram da kažem, kada je u pitanju zapošljavanje, kada je u pitanju perspektiva, kada je u pitanju razvoj javnih preduzeća, svojina javnih preduzeća, oko svih ovih pitanja, da se pozabavimo i da formiramo jednu specijalnu grupu od nas grupe poslanika, koji bi bil više nacionalno prisutni i da odemo, a ne da revizija, dao nam je do znanja gospodin ministar za reviziju. Ja moram da vam kažem, ja radim u KEK-u u Prizrenu, da u reviziju dolaze generalni direktor, da su revizija auditori svih ljudi koji trenutno gledaju šta je ostalo, ako je pita pojedena, dali je tepsija tamo. Gledaju da sklone i tepsiju. Dali je ovo u redu? Šta ćemo, kako ćemo dalje? Dali imamo precizne rezultate od neke revizije ili nečega. To što nas prezivaju, dali želimo neke pokazatelje da smo smanjili gubitke, da smo povećali naplatu, da smo povećali sredstva u budžetu Kosova, da budžet Kosova nije hiljadu, milijardu i 450 miliona, nego smo povećali budžet za 450 miliona. Mi moramo da prepoznamo aktere to što u javnim preduzećima ne ide, ne funkcioniše. Sa menadžmentom moram da dam do znanja da se mora voditi računa sa menadžmentom. Tamo su direktori, menadžeri ljudi koji nemaju po dve-tri godine radnog iskustva.

Moramo da znamo, sa dobrim stručnjacima Kosova ima potencijal i za javna preduzeća, i za dekapitulizaciju i za zapošljavanje. Kakvo je tamo zapošljavanje bilo, ja ću jedan primer da vam dam. 5000 hiljada je radnika, 7000 hiljada je radnika bilo 99 godine.

KRYETARI: Ju faleminderit! Veç edhe deputetët që janë të punësuar në shumë ndërmarrje publike, nuk është bash e mirë në një vend ku ka papunësi shumë. Mendoj, duhet t'i keni parasysh edhe këto, se nuk janë bash, bash krejt mirë. Urdhëro, zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'i përgëzoj iniciuesit e këtij debati të nevojshëm mendoj për institucionet, por edhe për opinionin në Kosovë.

Dëshiroj të theksoj se ky debat është ndihmues në kuptimin e avancimit të proceseve dhe të implementimit të prioritetëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të Republikës. Natyrisht se ne jetojmë në demokraci dhe është krejt e natyrshme dhe është vlerë që kemi dallime konceptuale sa i përket edhe prioritetëve, por në të njëjtën kohë edhe planeve të punës dhe vizioneve, pra ka dallime në filozofinë qeverisëse, por edhe në të menduarit, por gjithashtu edhe sa i përket të ardhmes se të qeverisurit në vendin tonë, por të ardhmes tonë si perspektivë.

Prandaj, këto dallime duhet shikuar si një vlerë Qeverisë edhe demokratike dhe assesit të qiten në planin keqqeverisës. Nëse dikush mendon ndryshe dhe ka plan tjetër nga ndonjë parti apo grup i caktuar politik, nuk është keqqeverisje, por është një vlerë qeverisëse, demokratike që ndodh në çdo vend demokratik. Por, duhet kuptuar se tani jetojmë në botën e konkurrencës së lirë dhe respektojmë atë. Nuk jetojmë me mentalitetin e vetëqeverisjes socialiste e as të planeve pesëvjeçare të së kaluarës, por jetojmë në botën e lirë të parimeve dhe vlerave demokratike, të konkurrencës së lirë dhe, natyrisht në proceset integruese euro-atlantike.

Ndoshta edhe mund të them, nuk është edhe krejt faji ynë pse jemi vonuar në këto procese, pasi që edhe vend ynë është pavarësuar, i fundit në rajon, por po qe se e bëjmë edhe një paralele në mes të vendeve të rajonit sa i përket procesit të privatizimit, Kosova vazhdon të mbetet e fundit, madje dhe pas Bosnje e Hercegovinës, Serbisë, apo e

Rumanisë, Turqisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Kroacisë, sa i përket disa aspekteve, të cilat u theksuan edhe këtu.

Unë dua të potencoj se vendimet të cilat janë marrë për projektet e rëndësishme zhvillimore të Republikës së Kosovës, janë vendime jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin dhe të gjithë qytetarët dhe perspektivën zhvillimore, por edhe integruese dhe rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Natyrisht se duke filluar nga projekti madhor i autostradës, që nuk mund të jetë ndoshta edhe temë e bisedës, por pasi që ishin ngritur edhe më herët dilema, dua t'ju informoj veç kanë filluar punimet në kuptimin e plotë të fjalës, por dua t'ju siguroj të gjithë juve dhe gjithë qytetarët e Kosovës, se pikërisht edhe nga kursimet e mëdha që janë bërë, janë siguruar edhe mjetet e nevojshme për punë në kuptimin me kapacitet të plotë përgjatë tërë këtij viti.

Pastaj, do të vazhdoja po ashtu me projektet dhe agjendën e Qeverisë së Kosovës, e cila ka kaluar përmes Parlamentit dhe është votuar, po nga ky Parlament. Dëshiroj të theksoj se këto vendime që po i merr Qeveria e Kosovës, janë vendime të vonuara, por edhe si kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe si koleg i juaji, kam të drejtë legjitime të pyes se pse u vonua me këto vendime? Shtrohet dilema apo pyetja sot, se pse po merren këto vendime tash, apo pse po merren këto vendime nga ju që jeni në Qeveri?

Dëshiroj të theksoj se sa i përket Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, nesër shpallet fituesi i konkensionimit. Të gjithë jeni të ftuar në atë proces, të gjithë jeni të ftuar dhe do të jetë transparent maksimalisht, bile do të jetë model për rajonin, sepse do të jenë kamerat drejtpërdrejt për ata që dëshirojnë ta përcjellin dhe ky proces do të shkojë sipas standardeve të Bashkimit Evropian, sipas standardeve perëndimore dhe jo modeleve që u përmendën këtu në fillim, modelit të Beogradit. Pra edhe këtu e kemi dallimin në të menduarit dhe të vepruarit dhe planin e punës që dikush e merr shembull, ta zëmë Serbinë, krejt pa nevojë dhe modeli që ne punojmë, modeli i Brukselit dhe modeli perëndimor.

Pastaj, procesi i privatizimit e distribuimit është në një plan të mbarë, është duke shkuar sipas agjendës dhe do të përmbyllet me sukses. Gjithashtu, strategjia, ne e kemi filluar me kohën e duhur pas 10 vjetësh vonesë, të cilat ne jemi përballur me ardhjen në Qeveri.

Sa i përket energjetikës, dëshiroj të theksoj se strategjia për energji është votuar nga Parlamenti i Kosovës dhe unë vetëm e implementoj strategjinë e votuar dhe të mbështetur nga ju të gjithë pa dallime dhe ju falënderoj për këtë mbështetje. Dikush edhe mund të pyet edhe për projektin e Kosovës së Re, se pse po fillon sivjet? Po fillon, sepse të tjerët nuk kanë ditur për ta realizuar këtë projekt, nuk kanë qenë të vendosur të marrin vendime dhe ky proces është duke shkuar shumë mirë. Kemi një interesim të jashtëzakonshëm të investitorëve ndërkombëtarë dhe kjo do të ndodhë. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të theksoj se e gjithë agjenda për privatizimin e PTK-së, është me një agjendë të planifikuar e të respektuar në përpikëri, në kuptimin edhe të prioritetëve, por edhe të periudhave kohore. E di që ka pasur edhe të tillë që kanë ngritur edhe çështjen e "Trepçës", natyrisht ka filluar studimi i këtij procesi, është diskutuar edhe për Veriun, në kuptimin e plotë që t'i shesim njëri-tjetrit patriotizëm, zoti iniciues i këtij debati, por unë dëshiroj t'ju theksoj se, unë si kryeministër i Qeverisë së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës, çdo vendim që e merr Parlamenti i Kosovës, është i gatshëm në të gjitha aspektet ta implementojë edhe në Veri. Vetëm merreni ju vendimin, që ju mendoni, por jo në kuptimin politik dhe t'i shesim njëri-tjetrit patriotizëm.

Në anën tjetër edhe procesi i privatizimit të Brezovicës, është duke shkuar mirë, në bashkëpunim me komunitetin lokal dhe unë besoj se do të krijohen kushte dhe mundësi të mira që të përmbillet shpejt, do të thotë, të gjitha këto të cilat jemi duke i realizuar, janë projekte të cilat të tjerët nuk kanë pasur guxim të marrin vendime dhe dije për t'i realizuar, në anën tjetër, mos prit, zotëri iniciues i debatit, pse unë të mendoj si ti në vitet 70-ta, ose 75-ta apo të viteve të 80-ta, të realizmit socialist, apo të ekonomisë socialiste.

Faleminderit shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Behgjet Pacolli.

(Reagime nga salla)

Por, unë e bëj rendin e diskutuesve.

Regjia, replikë Driton Talit.

DRITON TALI: Zoti kryeministër, nuk të ofendova. Ti më the patriot, më fal, mos më ofendo se patriot është keq t'i thuash në ditën e sodit një qytetari të ndershëm të Kosovës, i cili s'ka vjedhur kurrë hiq, sepse patrioti është sinonim i atyre që po vjedhin apo që kanë bashkëpunuar në të kaluarën me Udbën. Unë nuk kam vjedhur kurrë, e as s'kam bashkëpunuar kurrë me Udbën, as unë, as babai im, as babagjyshi im. Andaj, nuk i plotësoj kushtet e patriotit dhe, po ashtu, shkollën nuk e kam kryer pas luftës me të njohshëm, por goxha moti e kam kryer. Kjo është një, sa i përket patriotit.

E dyta, mua më vjen mirë që më në fund ke filluar të largohesh nga marksizëm-leninizmi i juaj, nga enverizmi i juaj e t'i përqafoni konceptet perëndimore, unë ato i di, atje jam krijuar. Domethënë, në këto koncepte janë krijuar, por gjithmonë duke besuar në transparencë dhe në fjalën e dhënë publike, të mos i ndërroj fjalët dhe gjithmonë duke pasur ndjeshmëri ndaj pronës publike, apo ndaj pronës të cilën e bën. Andaj, këto që i thashë, nuk kam shitur patriotizëm. Nëse ju mendoni se KEK-u blen rrymë nga ndërmarrjet e Beogradit edhe unë s' duhet t' i them ato, se KEK-u më thotë se një ndërmarrje ku janë pronarët serbë, më thotë se është ndërmarrje e Zvicrës, unë nuk po paragjykoj kurrë hiq, veç po i jap disa informata të cilat i kam, apo nëse çohet ministri dhe e keqpërdor Ligjin për ndërmarrjet publike dhe ai tregoi se dy vjetët financiare kanë përfunduar, se viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor, këtë shumë mirë e di zoti ministër, e tjera, e tjera, këtu unë patriotizëm nuk jam duke shitur, mundësia është profesionalizëm, por jo patriotizëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, kryeministri.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Jo, nuk është replikë dhe nuk dëshiroj të replikoj se thashë edhe në fillim të fjalës sime, unë punoj me vlera dhe standardet perëndimore, ky është vizioni im dhe i Qeverisë që e udhëheq, por edhe i koalicionit qeverisës me orientim djathtist. Orientimi ultramajtist, me elemente të vetëqeverisjes socialiste të shokut Tito dhe të Enver Hoxhës, le të mbetet në botën tuaj. Ju faleminderit, shumë.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, të lajmëruar janë edhe 18 deputetë për diskutim. Para se të fillojmë me deputetët, unë jam dakord, nëse edhe ju jeni dakord, që diskutimet të

zgjasin 5 minuta. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash. Regjia, përgatituni për votim, për 5 minuta.

Votojmë tash. Kemi 72 deputetë. Kuvendi ka vendosur ndryshe, nuk ka ndarje të debatit, Kuvendi ka të drejtë të votojë.

Me 44 vota “ për”, 22 “kundër” 4 abstenime, domethënë diskutimet zgjasin 5 minuta. Vazhdojmë radhën e diskutuesve. Fjalën e ka deputeti Behgjet Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Është debat me vend, debatohet për ndërmarrjet publike, ajo është edhe pikë e dhimbshme e shoqërisë sonë, ndërmarrjet publike të ndërtuara prej baballarëve tanë, prej djersës së tyre dhe ne duhet të kemi respekt për trajtimin e tyre.

Folëm për punësimin në këto ndërmarrje, punësimin e tepruar, nuk është nom i madh, siç ka thanë përpara i ndjeri Presidenti historik i Kosovës, Ibrahim Rugova, mbetet te ne, mes neve edhe aty përfitojnë dikush prej nesh, prej familjeve ndoshta që kanë nevojë, nuk është nom i madh, por duhet të japë një drejtim tjetër këtij debati dhe të ndalem te ligjshmëria e trajtimit të këtyre ndërmarrjeve, gjegjësisht trajtimi ekonomik profitabil me këto ndërmarrje.

Unë ju them edhe sot dhe ju lutem nënvizoni këtë, ne nuk kem ligj për privatizimin, gjegjësisht trajtimin e ndërmarrjeve publike. Dhe propozoj që të formohet një komision, të bëjmë përzgjedhjen e njerëzve të cilët do të hartojnë Ligjin për trajtimin e ndërmarrjeve publike. Unë ju them sot se në mungesë të këtij ligji secili që ka ardhur, secili që ka dalë te foltorja i ka trajtuar këto ndërmarrje si ka dashur, nuk kemi të drejtë t’i trajtojmë ashtu. Prandaj, ky ka qenë edhe shkaku më kryesor që sot nuk kemi atmosferë të investimeve, më vjen keq ta kundërshtoj ministrin Shala, i cili thotë se ne kemi pasur aq qindra miliona investime të huaja në Kosovë e aq nga miliona investime të huaja. Jo, zoti ministër, nuk kemi pasur investime të huaja, kemi pasur ndoshta donacione, kemi pasur para që na i kanë falur, ndihma, po jo investime të huaja se investimet e huaja është dashur të jenë evidente dhe të mbliidhen taksat prej tyre, të shihet profiti i tyre, të shihet sa punëtorë ka punësuar dhe kush ka përfituar prej tyre. Nuk kemi aso ndërmarrje në Kosovë, jam i gatshëm të debatoj me ju. Nuk kemi atmosferë të favorshme për investorët e huaj në Kosovë, nuk kemi infrastrukturë bazë që t’i thirrni të huajt këtu për arsye se nuk kemi as ligje, nuk respektojmë ligjin, por edhe infrastruktura logjistike mungon.

Prandaj, në këtë kontekst kryeministri tha se nesër do të hapet oferta për fituesin e Aeroportit, gjegjësisht partnerit të ardhshëm të Aeroportit dhe unë t’ju them se nesër hapet para telekamerave, por fituesi dihet, po ju them këtu dihet, ka qenë sot edhe në shtyp. Unë kam lexuar se ekziston fituesi edhe ekziston emri dhe mbiemri. Prandaj, nuk është transparente si punohet me ndërmarrjet publike ku me të vërtetë s’kemi të drejtë t’i trajtojmë në atë mënyrë.

Prandaj, unë kisha edhe disa pyetje këtu për ministrin nëse kam të drejtë të kem përgjigje ndonjëherë, do të isha falënderues.

Çfarë kritere ekonomike përdoret që shpallët tenderin për zgjedhjen e formës të partneritetit për Aeroportin? Si caktuat mënyrën, gjegjësisht formën e partneritetit a do të jetë ajo një koncesion apo do të jetë një shitje klasike, apo do të jetë një bioti si e quajmë, do të thotë ndërto, opero dhe transferoma ose ndonjë mënyrë tjetër e bashkëpunimit? Për sa vjet zgjat ky bashkëpunim dhe çka do t'i sjellë Kosovës ky bashkëpunim me një partner të ardhshëm që nuk e dimë në çfarë forme e kemi zgjedhur dhe në cilën formë do të operojë ai? Çka do të përfitojë buxheti i Kosovës prej saj? Unë kam dëgjuar ndoshta gaboj, kam dëgjuar se 20 vjet ...

KRYETARI: Regjia një minutë, meqë ka filluar me vonesë.

BEHGJET PACOLLI: ...dhe kam dëgjuar se është folur edhe bile prej qarqeve qeveritare se nga Aeroporti, nga bashkëpunimi në këtë mënyrë me Aeroportin, Qeveria e Kosovës do të përfitojë 20 vjet, 400 milionë. Unë po ju them këtë se as 40 milionë jo, nuk është e mundur, prandaj bëni një kalkulim dhe tregoni qytetarëve, të bijve të atyre që e ndërtuan atë, në çfarë mënyre e thoni këtë dhe t'i gëzohemi kësaj informate edhe ne nëse janë 400 milionë me të vërtetë, por po ju them këtu me çfarëdo garancioni që as 40 milionë dhe do të jeni ju ata që do t'i shihni se as 10 milionë, s'do t'i fitoni, për arsye se kemi thënë po ashtu do ta fitojë këtë tender ai që ka ofertën më të lartë. Ju nuk e keni shitur atë aeroport për të marrë para, po ju ja jepni dikujt dhe të investojë sa më tepër, dikush ofron për Aeroportin 20 milionë për 15 mijë metra katrorë, por dikush ndoshta ofron për të njëjtat metra katrorë edhe 200 milionë, do të thotë duhet ta marrë ai edhe ne presim 20 apo 40 vjet derisa t'i kthejë ai 200 milionët e saj, s'ka lidhje ekonomike ky vështtrim. Prandaj, të jeni më transparent, tregohuni qytetarëve dhe po të isha unë në vendin e juaj, zoti ministër ...

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka ministri Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Vetëm desha, sepse është ngritur disa herë çështja e bazës ligjore për privatizimin apo koncesionimin e ndërmarrjeve publike. Më vjen keq që duhet t'i përsëris këtu nenet e ligjeve, të cilat ju vetë i keni aprovuar, por dua të lexoj nenin 9 të Ligjit mbi ndërmarrjet publike, i cili thotë shitja e aksioneve. Ju kisha lutur ta dëgjojmë me vëmendje, sepse u shtrua edhe si kontest i bazës ligjore të saj. "Aksionet e një ndërmarrje publike qendrore mund të shiten lirisht nga Qeveria, nëse Qeveria miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një komision qeveritar për privatizim për të vazhduar me tenderim dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pas miratimit të këtij vendimi nga Qeveria e Kuvendi, Komisioni qeveritar për privatizim është i autorizuar të kryejë një tender dhe t'i shesë aksionet në fjalë". Unë nuk po vazhdoj t' i lexoj edhe tri nën nene që janë 9.2, 9.3 dhe 9.4, të cilat në mënyrë tepër të elaboruar japin bazën ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike. Kështu që çdo vendim i përmbyllur për privatizimin e një ndërmarrje publike, do ta ketë përfundimin e saj vetëm në qoftë se ky Kuvend e miraton. Andaj, ju kisha lutur shumë edhe në procesin e Postë- Telekomunikacionit të Kosovës, ne ende nuk e kemi shpallur tenderin për privatizimin e Postë -Telekomunikacionit të Kosovës dhe vendimi përfundimtar për të përmbyllur atë proces do të mbahet nga ju. Prandaj, mos të shpallim spekulime, ka bazë, baza juridike ekziston në këtë ligj. Ka

praktika që bëjnë për çdo sektor ligje, ne kemi zgjedhur këtë dhe kjo është e rregulluar me ligj.

Sa i përket ligjit të koncesionimit të Aeroportit, e kemi bërë në bazë të Ligjit mbi partneritetin publiko - privat. Ju kisha lutur, shikoni atë ligj, i cili është zbatuar këtu në bazë të konceptit të koncesionimit për 20 vjet dhe përzgjedhja e modelit është

KRYESUESI: Ministër, rregullorja ju lejon komente të shkurtra. Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

S'ia ke përmendur emrin, por mos më pengo se po shkon minutazha ose duhet të filloj aty ku e la deputeti Tali, sepse mocioni ynë ka të bëjë me menaxhimin e ndërmarrjeve publike qendrore.

Të nderuar deputetë,

Diskutimi i iniciuesit të tij u ndal atje ku kishte të bëjë me të ashtuquajturin operatorin virtual të telefonisë mobile, që e ka emrin Zmobile, që tenderin e ka fituar një kompani që nuk ka konkurruar, me fjalë të tjera e ka fituar, oferta i është dhënë kompanisë Dardafon.net. Duhet të bëjmë dallimin mes Dardafonit dhe Dardafon.net, konkurrimi ka qenë në Dardafon. Nëse ka diku në botë që jepet tenderi pa konkurruar, le ta thotë ministri, sepse për këtë çështje kanë qenë të informuara edhe strukturat e tjera se unë jam në njohuri dhe e di, edhe e di në mënyrë zyrtare se këtu po bëhen hetime të thella lidhur me operimin e Dardafon.netit. Këtu kem të bëjmë me një problem shumë, shumë të madh, këtu nuk kem të bëjmë me djathtizëm, majtizëm kem të bëjmë me xhepizëm, për t'i shtirë parat në xhep, as djathtas as majtas. Këtu ke të bëjmë me krijim të pasurive shumë, shumë të mëdha. Nëse ministri i Ekonomisë dhe Financave mund ta arsyetojë si është futur Postë- Telekomit i Kosovës në operatorin virtual mobil, pse iu ka dhënë licenca atij pa konkurruar, atëherë qe ku është foltorja le të thotë, nuk ka konkurruar, e ka marrë. Kanë bërë në mënyrë retroaktive ndryshim të dokumentacionit. Me fjalë të tjera ju jeni të sigurt qysh e keni emrin se nëse bëhet në mënyrë retroaktive ndryshimi i dokumentacionit, atëherë çka mbetet, nuk mbetet funksionim i institucioneve? Me këtë rast i nderuar ministër, ti e dinë shumë mirë që në mënyrë retroaktive është ndryshuar dokumentacioni.

Dhe gjatë procesit të privatizimit e dinë ministri që e ka marrë raportin prej këshilltarëve të transaksionit se vetëm ky operacion i kushton Kosovës 200 milionë euro. Zhvlerësimi i Postë Telekomit është bërë vetëm pse janë futur në operatorin virtual Zemobile, 200 milionë euro përafrim, përafrim është zhvlerësuar vlera e "Valës". Nëse dikush është patriot edhe e zhvlerëson pasurinë e vet 200 milionë, unë nuk e di cili është tradhtari.

Gjithashtu, kemi diskutuar përmes pyetjeve parlamentare që i kemi drejtuar ministrit të Ekonomisë dhe Financave për në Shqipëri. Ministri i Financave e ka marrë gjithashtu raportin që po thotë se 40 milionë euro është vlerësuar Postë Telekomit i Kosovës, për shkak të futjes së operimit apo të tendencës së futjes për operatorin e katërt në Shqipëri. U fut në tender në Shqipëri me kompani që shet distribuimin e lëngjeve pa asnjë Know-how, ashtu siç e thoshte në atë kohë ministri i Financave.

Po duke mos i ranguar tjerat se i mbetem borxh të vazhdoj t'ia lexuar fjalimin Dritonit që e ka pasur, do të them se hapat e fundit që i ka marrë Ministria kur e ka parë e fundit më, e fundit që i kanë dalë disa tenderë, ka qenë hap që është për t'u përshëndetur.

Unë e përshëndes ndërprerjen e kontratës me përpillim me Andox Cipres, sepse as ky s'ka konkurruar kanë dashur t'ia japin kontratën, s'ka konkurrua në fillim Andox Cipres, ka konkurrua Andoxi i tjetrit shtet, edhe ne të presim që Komisioni Evropian të na jap neve sugjerime për t'i ndërprerë investimet, edhe pse investitorët që kanë ardhur në konferencën e investitorëve kanë thanë se nuk keni nevojë për të shpenzuar para, s'keni nevojë, s'keni arsye, pse të shpenzoni diçka që unë vij me to? Nëse unë e blej "Valën", atëherë unë vij me platformën e Billigut apo platformën e faturimit, mos shpenzo po ka qenë diçka si për ngut, pse ngutet dikush për të shpenzuar mjete? Unë tregoj pse ngutet, sepse mban shpresë që i del diçka, mbanë shpresë që ka përfitime të majme prej kësaj ushtrimore.

E mos të flasim për shembull për këto që janë më të vogla, kem pasur tenderë që kanë qenë shumë të përfolur edhe nuk e di arsyen qysh kanë tentua për t'i fshehur. Pse? Të nderuar, nuk është tendenca për t'i fshehur sendet, është demokratike, është vlerë perëndimore transparenca, t'i hapim gjërat. Në rast se një tregim po e them, një polic më tha tash detyrë jona nuk është t'i zëmë, është t'i fshehim ..

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

Motivi kryesor pse kam menduar se duhet të diskutohet për ndërmarrje publike se jam edhe nënshkruese e këtij mocioni është se ka filluar procesi i privatizimit nga Qeveria dhe unë mendoj se fillimi si ka bërë Qeveria, dyshojnë në transparencën e mjaftueshme. Prandaj, si rezultat i fillimit janë shumë, shumë shqetësime dhe në opinion janë ngritur disa pyetje. A është koha e duhur për privatizimin, a janë zgjedhur modelet më të mira në këtë proces, a ekzistojnë procedurat e duhura që sigurojnë transparencën dhe llogaridhënie, a ekziston infrastruktura e duhur ligjore që të sigurojë privatizimin fer dhe transparentë dhe si do të përdoren fondet e grumbulluara nga privatizimi? Unë nuk e kam këtë pjesën e keqpërdorimit dhe veprime korruptive se nuk kam njohuri, sikur ta kisha me siguri kisha për ta cekur edhe atë.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit, zotëri Ministër. Qeveria, gjithashtu, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës është ajo e cila i administron ndërmarrjet publike dhe është përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Deri më tani Qeveria është e vërtetë ka treguar vendosmërinë për t'i privatizuar në mënyrë sa më të shpejtë këto tri ndërmarrje, por unë e bëj pyetje a është krijuar koncesuesi i nevojshëm në Kuvendin e Kosovës dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë? Unë mendoj se jo. Prandaj mendoj se duhet të shikojmë edhe kornizën e tanishme ligjore e cila afron vetëm zgjidhje bazike për ta filluar procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, procedurat dhe politikat mendoj se nuk janë të qarta a duhet të jenë. Gjithashtu, duhet edhe Komisioni qeveritar për privatizimin dhe Komisioni drejtues ndërmnistror për partneritet publiko-privat të kenë kompetenca shumë më të gjëra dhe nga ana tjetër mbikëqyrja ndaj tyre dhe raportimi i tyre ndaj Kuvendit të Kosovës nuk ka qenë i siguar. Zoti Ministër ka thënë që po pritët auditimi, por me Ligjin për ndërmarrje publike ka qenë obligim çdo vit të raportohet për menaxhimin e këtyre ndërmarrjeve.

Qeveria, gjithashtu nuk ka politika të qarta lidhur me ristrukturimin pronësor të ndërmarrjeve publike dhe sa do t'i shesë aksionet te investitorët privat, a do t'i mbajë do aksione në pronë të sajë, domethënë të shtetit? Unë mendoj se duhet të shiten ato aksione që në masën e duhur dhe nuk do t'i dekurajojnë investitorët, por sa më shumë aksione

duhet të mbeten në pronësi publike. Ndoshta është ky koncept ndryshe që unë e shikoj, aty po pajtohem me Kryeministrin se mendoj se shteti ynë duhet të ketë aksione, a sa për paraqitjen e tij, mendoj se ai duhet t'i shesë krejt. Unë nuk pajtohem, prandaj, në koncept nuk pajtohem me këtë.

Si është menaxhimi i ndërmarrjeve publike, a është në funksion të rritjes së vlerës së tyre apo në favor të zhvlerësimit e këtui është problemi? Në PTK rritet numri i punësimit, kurse kemi edhe vlerësimin e rrjetit shpërndarës të rrymës në KEK, ku është humbja 40%, s'po flas për ato teknike, po komerciale, prandaj edhe këtu menaxhimi është në pyetje. Prandaj, unë propozoj Qeveria duhet sa më shpejt t'ia procedojë Parlamentit për ta siguruar privatizimin efikas, transparent dhe llogaridhënës, amendamentimin e ligjeve ekzistuese mbi ndërmarrje publike dhe Ligjit për partneritetin publiko- privat dhe koncesionet apo në qoftë se merremi veshë të nxjerrë ligje të veçanta për privatizimin e secilës nga këto ndërmarrje publike të KEK-ut, PTK-së, Aeroportit, si duket është vonë se është puna e koncesionit. Duhet ta pranojmë edhe ne që Kuvendi jonë nuk ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive që të fuqizojë pozicionin në këtë proces. Autorizimet e Komisionit qeveritar të privatizimit dhe Komisionit ndërministror të partneritetit publiko-privat, duhet të peshohen dhe të rishqyrtohen edhe të qartësohet edhe pozicioni i tyre, se unë mendoj se e kanë kompetenca shumë të larta a transparencë aspak.

Qeveria dhe Kuvendi përmes debatit duhet të ndërtojnë politikat që sigurojnë se një pjesë të mjeteve, të cilat vijnë nga privatizimi ...

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Se kemi qeveri të papërgjegjshme... është dëshmia më e mirë. Është interesant që Qeveria s'ua sjell raportin me kërkesë deputetëve, që në fund të fundit e ka obligim, po është ironike që vjen kryeministri dhe ministri Shala dhe na mbajnë fjalime koti, shpesh edhe të pavërteta.

Zoti kryesues, të nderuar deputetë, i nderuar ministër, shpresoj që s'je në telefon dhe po më dëgjon, dëshiroj të shpreh mbështetjen për mocionin e deputetit Tali dhe 11 deputetët e tjerë për të debatuar për një çështje kaq të rëndësishme, siç është gjendja në ndërmarrjet publike qendrore në Kosovë. Është e domosdoshme që të debatohet për këto, duke marrë parasysh se ndërmarrjet janë shtyllat kryesore të ekonomisë kosovare dhe bartëse të zhvillimit ekonomik.

Megjithatë, diskutimi i sotëm është joserioz, sepse nuk bazohet në asnjë informatë zyrtare, të gjitha informatat që i kemi, i kemi kryesisht nga mediat. Më mirë do të ishte ministri Shala të shkonte të punonte raport dhe ta sillte para Kuvendit, se sa të mbajë fjalime dhe debat me secilin deputet. Prandaj, për të zhvilluar diskutimin, që në fillim propozoj që Qeveria të përgatisë raportin me kohë për gjendjen faktike të ndërmarrjeve apo të kompanive dhe strategjitë e koncesionimit apo të privatizimit të tyre, pastaj të hapet debati në Kuvend. Çdo ditë në sondazhet kombëtare dhe ndërkombëtare gjejmë se oazat e korrupsionit, pos Qeverisë, janë edhe këto kompani, për të cilat ne si përfaqësues të popullit informohemi nga shtypi.

Duke marrë parasysh se nga buxheti i Kosovës për KEK-un mesatarisht ndahen 50 deri 60 milionë euro, kurse ne s'kemi informata kthyesë se çka ndodh në korporatë, atëherë

propozoj që për proceset e tenderimit në KEK dhe po ashtu në PTK, t'i raportohet Kuvendit. Është zhgënjyes trendi në PTK, sepse ka humbur nga vlera PTK-ja për shkak të keqmenaxhimit. Politika e punësimit, po ashtu, është zhgënjyese, sepse mund të punësohen ata që e kanë librezën e PDK-së. Prandaj, të na raportohet për numrin e punëtorëve që nga viti 2007 e 2009 dhe në bazë të cilit plan të punësimit është bërë rritja e numrit të punëtorëve. Po ashtu, t'i raportohen Kuvendit raportet e auditimeve të pavarura, jo vetëm për vitin 2009, por edhe për vitin 2008.

Strategjia e privatizimit të PTK-së duhet të diskutohet para se PTK-ja të privatizohet, sepse është aset nacional, prandaj privatizimi nuk duhet të zhvillohet i izoluar, por duhet të jetë pjesë e reformave të përgjithshme ekonomike dhe juridike. Po ashtu, paraprakisht duhet të dihet se ku do të investohen këto mjete, në cilat investime kapitale ose projekte kapitale.

Duhet pasur parasysh mënyrën e vlerësimit të vlerës reale të tregut dhe të përcaktohet limiti maksimal nën të cilën nuk mund të shitet ky aset i rëndësishëm. Kjo ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përzgjedhjen e kohës, sepse nuk është kohë e përshtatshme të shitet PTK-ja atëherë kur ekziston krizë financiare globale në botë.

Së pari, duhet të përgatiten ligjet për funksionimin e tregut të kapitalit: Ligji për privatizimin e ndërmarrjeve, Ligji mbi Bankën Qendrore dhe Ligji për bursën, pra të krijohet ambienti ligjor i përshtatshëm për privatizimin e PTK-së dhe të ndërmarrjeve tjera, kështu që të jepet mundësia e shitjes së aksioneve në burse, ku kanë të drejtë të marrin pjesë qytetarët e Kosovës dhe të tjerët. Të gjithë këtë e mbështes në faktin se në tenderin për koncesionimin e Aeroportit, në të cilin kanë marrë pjesë tre ofertues, prapë sipas informatës së medieve, që tregon “interesim të madh që ekziston sot në Kosovë për investime”. Në situatë normale, do të kishte shumë konkurrues, sepse profiti është i madh, e mos të flas për interesimin e investitorëve për Termocentralin “Kosova e Re”, ku investitorët serioz ikën.

Të nderuar deputetë,

Asetet është lehtë për t'i shitur, por është vështirë për ta rritur vlerën dhe të shiten atëherë kur mund të arrihet vlera më e madhe e shitjes së tyre. Nëse Qeveria heq dorë nga të gjitha asetet që i ka Kosova, a mendon Qeveria se buxheti duhet të mbulohet vetëm nga taksat?

Nga praktikat e reja, pos taksave, një pjesë dermuese e të hyrave të buxhetit sigurohen nga asetet e shtetit. Për shembull, Sllovenia mund të merret si model që mbush arkën e shtetit prej dividendave të kompanive publike, kurse qytetarët ngarkohen shumë më pakë me taksa.

I nderuar kryesues,

Ftoj Kryesinë, por edhe juve që me kohë ta siguron raportin nga Qeveria, kurse ngelet dyshim se Qeveria do ta sjellë raportin me kohë. Faleminderit, për durimin, sidomos deputetëve të Partisë Demokratike!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputetja Synavere Rysha.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Ja vlen që Kuvendi i Republikës së Kosovës të zhvillojë diskurs serioz për ndërmarrjet publike, të cilat aktualisht janë polise sikur poliset që ishin ... shtete të pavarura apo independente jashtë kontrollit politik të Kuvendit apo jo që është një absurd i patolerueshëm.

Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shtetërore, si të them edhe sa i përket definicionit nuk kanë dallime apo shumë vështirë do të mund të përcaktoheshin diferenca të caktuara, ia vlen që statusi juridik i tyre të rishikohet me një analizë kritike. Aktualisht, ndërmarrjet publike nuk kanë organograme, nuk kanë akte për sistematizime, nuk kanë kriteret të objektivizuara për paga. Pagat janë kryesisht në bazë të arbitrarizmit të menaxhmentit, favorizohet kush ia vlen në qoftë se është partizan politik militant, po e zëmë, favorizohet e tjera e tjera, që nuk është në rregull apo jo. Në parim unë e kam këtë bindje se tani për tani po e zëmë, është një formacion politik që ka pozitë dominante sa i përket punësimit, por edhe ndonjë formacion politik tjetër po të ishte, ma merr mendja që do të kishte vepruar ngjashëm, ama unë brengosem që nuk ka rregulla, por punësohen si të them në mënyrë stihike, nuk ka kriterijume, nuk ka sistematizim për punë, nuk ka rregull të punësimit. Nuk përfillet kontrata e punës, instituti, kontratë e punës nuk përfillet, konkursi po thuaj se nuk ekziston, që nuk është fare mirë. Nuk është mirë që ndërmarrjet publike të bëjnë sponzorime edhe në atë mënyrë të favorizojnë këtë entitet apo atë entitet, se është fjala për paranë publike. Nuk mundet ndërmarrja publike ta disponojë paranë publike pa kurrfarë përgjegjësie, pa kurrfarë kontrolli.

Sot quhen ndërmarrje publike, shoqëri aksionare, lidhje nuk ka shoqëria aksionare me organizimin e tanishëm, me konceptin juridik të tanishëm. Po ta marrim po e zëmë Ligjin për organizatat biznesore, që është në fuqi në aplikim dhe t'i shikojmë atje ç' është shoqëria aksionare, lidhje nuk ka. Nuk ka shembull të këtillë se çfarë është tani për tani struktura edhe koncepti i organizimit të këtyre ndërmarrjeve publike. Këto nuk janë shoqëri aksionare, këto quhen, ama nuk kanë lidhje me shoqëritë aksionare.

Kur është fjala për korrentin që importojmë me çmimin e disfavorshëm, ekziston juridik civil i mirënjohur së paku që 2000 vjet i cili quhet rebus sigstanti bus, këtë po e potencoj. Qeveria do të duhej që ta inicionte procedimin e rishikimit të kontratës, sepse është në disfavorin e vendit tonë edhe ekziston bazamenti juridik për t'u modifikuar në konformitet me ekuivalencën e pestacioneve.

Unë konsideroj që do të duhej juridikisht të bëjë një rishikim analitik edhe të përcaktohej statusi juridik i ndërmarrjeve publike, posaçërisht ekstraprofiti në shtetet e përparuara, ekstra profiti trajtohet kështu. Të hyrat të cilat janë enorme jo si rezultat i punës, i organizimit, i disiplinës, e i teknologjisë së përparuar, e i traditës në punë, mirëpo i pozitës monopoliste në treg, e ato para, zotëri kryesues, merren direkt edhe qiten, disa thonë derdhen, nuk derdhen se kur derdh i hedh, depozitohen në buxhet e nga buxheti ne i kem me qindra e qindra pozicione shumë delikate, shumë të nevojshme për paranë publike.

Do të duhej që administrata publike të njëjtësojë në administratën shtetërore. Ta marrim po e zëmë një jurist, që do të punonte po e zëmë që punon në administratën shtetërore në Kuvendin e Kosovës, ta marrim një jurist që punon në Postë ose në cilëndo

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndoshta nuk është praktikë e mirë kjo kur deputetëve po iu merret radha dhe po bëhet renditja në bazë të dëshirave apo vullnetit të kryesuesit, edhe pse e ka bazën ligjore. Unë do ta kundërshtoj edhe do të jem ajo që do ta ndryshoja këtë procedurë, sepse nuk është në rregull ne përgatitem dhe e kërkojmë fjalën këtu nga ata që donë të flasin të parët e kërkojnë të parët fjalën, prandaj nuk është në rregull kjo, megjithatë është bërë një praktikë e keqe. Unë do të filloj me temën.

Kur flasim për ndërmarrjet publike në Kosovë mendohet gjithëherë për PTK-në, Aeroportin Ndërkombëtarë të Prishtinës, KEK-un, si ato më të mëdha, mandej kompanitë për menaxhimin e ujërave, mbeturinave, ngrohje qendrore, hekurudhat e kështu me radhë. Do të kishte qenë mirë dhe e udhës që këtij debati t'i paraprinte një raport i përmbledhur nga Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, për gjendjen aktuale dhe afarizmin e këtyre ndërmarrjeve si një objekt trajtimi për deputetët. Megjithëse kjo u tha me një farë mënyrë u dha një koment nga ministri për Ekonomi dhe Financa, ishte i paqëndrueshëm dhe vërtet nuk kishte bazë për ta debatuar, sepse ne si deputetë nuk kërkojmë raport për vitin 2009, po kemi kërkuar, të paktën të kemi një raport për periudhën e pasluftës se si kanë afaruar këto ndërmarrje dhe të kapen pikat më kyçe, sepse në këtë mënyrë debati do të shkojë shumë i shkapërderdhur dhe secili nga këndvështrimi i vet. E thashë, në mungesë të kësaj detyrohemi t'i qasemi kësaj çështje secili nga këndvështrimi jonë si deputet.

Sidoqoftë janë PTK-ja dhe Aeroporti dy kompani më profitabile në Kosovë që gjenerojnë më së shumti të hyra nga afarizmi i tyre, kjo falë monopolit që kanë në treg. Aeroporti si kompani e vetme dhe pa konkurrencë në tregun kosovar dhe PTK-ja e cila për një periudhë të gjatë ka punuar në këtë klimë derisa janë futur në tregun kosovar edhe operatorë tjerë. Por, çka në fakt po ndodhë me këto kompani? Edhe pse këto kompani po afarojnë mirë dhe konsiderohen si resurse nacionale, Qeveria ka vendosur t'i fusë në procesin e privatizimit edhe aty me hapa të përshpejtuar. Shqetësimi më i madh është mos transparenca e këtij procesi, përqindja e aksioneve që do të mbajë Qeveria nga shitja e aseteve, si dhe mënyra si do të përdoren paratë nga shitja apo nga privatizimi i këtyre kompanive. Tashmë jemi dëshmitarë që nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore kanë rezultuar mbi 500 milionë euro, kemi krijuar të hyra, mirëpo nuk dihet fati i tyre edhe për një periudhë të gjatë nuk do të dihet se çka do të ndodhë me ato 500 milionë euro.

Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me resurse nacionale që u takojnë edhe gjeneratave të ardhshme, ky proces duhet të analizohet mirë dhe të vlerësohet a është pikërisht tani koha e përshtatshme të fillohet me privatizimin e Aeroportit dhe PTK-së? Mandej, askush nuk e ka të qartë se çka do të fitojë Kosova nga ky proces.

Mungesa e Ligjit për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe aseteve të tyre ku do të përcaktoheshin kushtet dhe procedurat e qarta për privatizimin apo dhënien me koncesion të aseteve publike, do ta vështirësonte edhe më tej këtë proces.

Procesi i privatizimit duhet të rishikuar, sepse një numër shumë i madh i ndërmarrjeve të privatizuar janë treguar të pasuksesshme, numri i punëtorëve nga ky proces ka shënuar rënie, ka shumë mos përmbushje të premtimeve nga ana e blerësve, vonesa të mëdha të shpërndarjes së 20% të punëtorëve e shumë probleme të tjera. Thënë shkurt privatizimi në Kosovë ka rezultuar si i dështuar.

Duke marrë për bazë atë që u tha më lartë i rekomandojmë Qeverisë të ndërpresë procedurat për privatizimin, sidomos të këtyre kompanive publike qendrore në situatën aktuale dhe të presë një klimë më të favorshme dhe të përshtatshme, sepse në instancën e fundit, arsyeshmëria ekonomike e Kosovës në këtë moment është të vazhdojë të afrojnë edhe për një kohë duke u bazuar në statusin aktual të tyre, derisa të krijohen kushtet e favorshme për privatizim apo koncesionin, që nënkuptojmë vlerën e rritjes së tyre apo kthimin e vlerës aktuale që e kanë pasur më herët dhe bazën ligjore e cila edhe më tej mungon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Dua veç t'ua përkujtoj se unë nuk bëra asnjë ndryshim nga renditja e të paraqitur e diskutuesve edhe pse e kam këtë të drejtë dhe këtë mund ta konfirmoni në çdo kohë në regji.

Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër, ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen keq që u lodh deputeti Shala edhe shkoi, edhe Kryeministri, megjithatë, unë po i them disa fjalë lidhur me temën e sotme.

Jam njëri nga ata që kam mbështetur këtë debat për gjendjen e ndërmarrjeve publike qendrore. Unë them se i mbështet kërkesat e paraqitura në fillim të debatit edhe kërkesat tjera me radhë që u shtruan. Në radhë të parë jam që të silllet për miratim në Kuvendin e Kosovës Ligji për privatizimin e ndërmarrjeve publike. Duhet nxjerr këtë ligj në mënyrë që të dihet se cilat ndërmarrje duhet të privatizohen dhe cilat jo, në çfarë kushte duhet të ndodhë ky privatizim i mëtutjeshëm i ndërmarrjeve publike. Unë po e them këtë, sepse ne jemi dëshmitarë si Kuvend që në formë të ndryshme Qeveria ka hequr dorë për mundësisë të menaxhimit të ndërmarrjeve me vetë faktin se të gjitha ka dhënë shenja se dëshiron t'i privatizojë dhe asnjë mos ta lë si kompani publike qendrore, domethënë kjo është për atë dhe e keni vërejtur që nuk flitet për menaxhim. Tash ligji është i nevojshëm, sepse privatizimi në fakt është shndërruar me një lloj jo logjike ekonomike edhe për të fituar buxheti, po me një lloj manie. Merre me mend përmendet jo një herë si kriter guximi për të vendosur për t'i privatizuar, jo kriter leverdia ekonomike që të fitojë diçka Kosova prej tyre, por për ne kriter është trimëria, ne guxojmë për t'i privatizuar kjo është një diçka që po përsëritet shpeshherë që s'ka kurrfarë nevojë të punohet kështu.

Një diçka që bie në sy është anashkalimi i ligjit ekzistues për ndërmarrjet publike gjatë privatizimit. Megjithëse fare mirë thuhet në ligj se për çdo ndërmarrje që privatizohet merret vendim i veçantë në Kuvendin e Kosovës, nuk merret vendim kolektiv për të gjitha ndërmarrjet. Në praktikë ka ndodhur ndryshe, Kuvendi ka marrë deri më tash vetëm dy vendime me sa unë e di për privatizim në fushën e energjetikës, ndërsa intezivisht është punuar për privatizim në të gjitha ndërmarrjet publike. Këtu është shfrytëzuar zbrazëtira ligjore dhe jemi dakord e cila do të duhej të precizonte se për cilat ndërmarrje mund të fillojnë procedurat e privatizimit. Këtu kemi edhe aso raste në fushën e energjetikës është thanë se po bëhet privatizimi edhe në privatizim, me gjithë se është tërhequr, ju e dini që ka marrë pjesë edhe CZ i Çekosllovakisë, që e dimë që nuk është fare ndërmarrje private, po është ndërmarrje shoqërore- shtetërore hesapi, edhe tash këtu ajo prezantohet si ne po privatizojmë tek ata që në fakt nuk janë fare ndërmarrje

private. Më shkurt shteti me një farë forme po ia kalon në menaxhim publik tjetrit shtet, kurrëgjë tjetër, në rastin konkret po flasim.

Tash këtu shumë u ideologjizua edhe po ideologjizohet kjo punë, kështu me sa e dimë në Kuvendin e Kosovës dhe të gjitha partitë politike që janë pjesëmarrëse janë shprehur për ekonomi kapitaliste, ekonomi tregut, dallojmë në atë a po dëshirojmë t'lemë punonjësve diçka prej drejtave edhe mundësive që të zhvillohen ata apo jo, edhe nuk diskutohet për diçka tjetër. Me akuza nuk mund të ndërtohet një ekonomi e qëndrueshme në Kosovë, me akuza të natyrës jashtë ekonomike, krejt ideologjike sepse

KRYESUESI: Edhe një minutë.

EMRUSH XHEMAJLI: Jo, jo e di që s'ka për atë është thjesht, por po diskutojmë mes deputetëve. Fare lehtë mund të thuhet që jemi për ndërtim një shoqërie kapitaliste pasi që u ideologjizua kjo të natyrës skandinave të vendeve të zhvilluara thuaj Amerikane e krejt po jo latino-amerikane edhe kështu mund të thuhet, a po kuptohemi?

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e deputeti Xhevdet Neziraj, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.
Regjia fjalën deputetit Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Dhe kolegë deputetë,

Unë do të ndalem vetëm në aspektin e punësimit në këto ndërmarrje, ndërsa më gjerësisht do të bisedojmë kur të bëhet auditimi i ndërmarrjeve publike.

Politika e punësimit në ndërmarrjet publike, raporti që në na ka ardhur nga Zyra e Kryeministrit tregon se ka shkelje shumë të rënda, sidomos në punësimin në radhët e komuniteteve. Ta marrim shembull gjatë auditimit nga Komisioni për Komunitete në KEK nga 7600 punëtorë, nuk është asnjë pjesëtarë i komunitetit egjiptas i punësuar, ka 2 – 3 serbë. Ndërsa, sa i përket Postës edhe pse zoti Sllobodan nuk qenka këtu, që është anëtar i Bordit të PTK-së, vetëm në fshatin Gorazhdec, që është afër Pejës, që ka 500 banorë, i ka të punësuar 5 persona, për arsye se janë të Partisë së SLS-së dhe një kandidate në Gjakovë e subjektit tim politik që ka konkurruar thotë ti mund të punësohesh vetëm nëse bëhesh anëtarë e SLS-it, kjo është politika të cilën janë duke e drejtuar në Qeveri. Këtë, zoti Ministër, po ta them si koleg që t'ju thuash anëtarëve të Bordit që mos të dalin kështu publikisht se njerëzit tregojnë.

Në komunën e Pejës jetojnë 5000 qytetarë të komunitetit egjiptas dhe s'është asnjë i punësuar në PTK. Ndërsa, me Ligjin për promovimin e komuniteteve ekziston një normë e caktuar ligj, që është dalë nga pakoja e Ahtisarit dhe duhet të jenë njerëz të punësuar, nuk po kërkoj shumë. por po kërkoj që në Dukagjin nga një pjastër të jetë i punësuar dhe atë do t'ia udhëzoja njerëz me fakultet. Tani ia kam dërguar një letër drejtorit të Postës, Shyqyri Haxha, po më dhimben këto 80 cent që ja kam qar, ku ka konkurruar një djalë, inxhinier i informatikës, drejtimi i telekomunikacionit dhe nuk thirret as në intervistë, ndërsa të jesh i bindur që në qytetin tim të Pejës, ka njerëz që s'dinë as me shkrua paragon bllok. I kam ble kartelet, janë bërë 5 persona edhe mesi ma kanë shkrua një paragon, do të thotë aq ekspertë janë të punësuar. Dhe, përfundimisht dua të ju them kolegëve të mi të Aleancës, ministrave, i kanë humbur zgjedhjet për arsye se s'kanë ditur për t' i punësuar sikur ju që keni ditur t' i punësoni vetëm në ndërmarrje publike,

thjesht keni vepruar shumë mirë, edhe hallall ju qoftë kështu duhet të punoni, nuk është mirë të fshiheni, unë të isha Kryeministër do të kisha thënë dua t'i punësoj njerëzit e mi se i kam fituar zgjedhjet, është e vërtetë nuk kanë mbajtur ligjërata për punësim vija partiake. Ata s'mund ta mohoj, unë besoja që këto ndërmarrje publike nuk duhet të jenë në funksion të një partie, po duhet të jenë në funksion të qytetarëve të Kosovës dhe nuk është punësimi vetëm i një komuniteti, komunitetin serb në këtë rast. Unë nuk di komuniteti serb s'është duke iu dashur, ne jem nënshkrues edhe të pavarësisë, përkrahëm edhe pavarësinë e Kosovës, ndërsa këta s'po ju donë ju po doni t'i doni me zor, po s'janë duke iu dashur se i kanë planet e veta dhe kështu që janë duke vepruar.

Dhe, PTK-ja gjithë që kanë "Valën 63" ua ka dhënë edhe 2500 kartelet, nga 5 euro falas që bëjnë me mijëra euro dhe prapë është dashur t'ia riktheni "Valën 63" të serbëve se ata e kanë shtetin e vet, botërisht janë duke iu treguar dhe jeni duke i diskriminuar njerëz që iu kanë ndihmuar në çdo proces. Komuniteti egjiptas ju ka ndihmuar edhe para luftës, edhe gjatë luftës, edhe masë luftës, atëherë miqve duhet t'ia ktheni edhe tani me shkallë të punësimit, me integritet të tyre, nuk po kërkoj atë që çka s'më takon, por po e kërkoj atë që më takon me ligj.

Dhe, përfundimisht, me gjerësisht për këto ndërmarrje do të flas kur bëhet auditimi, do të flas me shifra dhe me argumente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, dhe përgatitem unë.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat,

Dhe kolegët deputetë,

Unë kisha dilemën se çfarë do të jetë kontributi real edhe i imi si parlamentarë në këtë debat, përkundër vlerësimit parimor se duhet të iniciohen edhe nga kjo mënyrë e formës nga deputetë kolegë të tjerë të debatet të cilat mendoj që i takojnë këtij Parlamentit. Por mendoj që ashtu qysh po fillon ashtu edhe përfundon sikur edhe ai fjalimi im, pra do të jetë pa kurrfarë efekti, ndoshta por po e konsumojmë këtë kohë.

Se është kështu, mendoj që i ka takua edhe propozuesit që dalë me temën me formën dhe selektimin e debatit për ndërmarrje të veçanta e jo për të gjitha ndërmarrjet publike. Asgjë s'kanë të përbashkëta, Posta, hekurudhat, KEK-u, Aeroporti, diçka tjetër pra s'ka mundësi brenda një kohe, kjo pra tregon se do të jetë pa efekt, më shumë e kemi për defilim, cilado qoftë ajo marketing dhe të tjera se sa për një efekt realë që e meriton një debat në Parlament për këto ndërmarrje publike. Prandaj, më së miri këtë e tha edhe deputeti Pacolli, pak më herët që me përvojën, pak foli por shumë tha, po nuk arriti të kalojë jashtë temës së Aeroportit edhe ajo filloi e mbaroi, pra pa atë çka e kemi si synim, si objektiv edhe brenda një debati. Pra, ky e arsyeton atë konstatimin tim që edhe propozuesi është dashur ta mendojë temën të cilën e shtron në Parlament.

Po çka është një anë e mirë nga ana e propozuesit, është kjo se koalicionin qeveritar PDK, LDK dhe të tjerët që jemi në koalicion dhe që kemi përgjegjësi kushtetuese, na ka përkujtuar, pra pak na ka përkujtuar se megjithatë ne duhet të vendosim në Parlament debatin, transparencën, për punën e të gjitha ndërmarrjeve publike, por jo në këtë mënyrë, qoftë përmes raporteve atë që e përgatit Qeveria, Ministria, dhe të tjera dhe realisht të japim pra ato përgjigje të cilat kërkojnë, sepse mendoj që është pjesë e politikës dhe e strategjisë të koalicionit tonë që të jemi transparentë, jo ta keqpërdorim këtu foltoren, jo

Parlamentin, po të japim përgjigje për atë që e kemi marrë të qeverisim vendin. Prandaj këtu e arsyetoj, sepse pas pavarësimit të vendit, realisht këtu është foltorja ku duhet ne të flasim për reforma zhvillimore, për forcimin në ndërtimin e pavarësisë ekonomike, atë që e tha pak më herët kryeministri, po kjo nuk po ndodhë. Prandaj, vërejtja është me vend, pra të jemi ne këtu, të kemi, të flasim për projektet nacionale, për procesin e privatizimit, për marrëveshje tregtare, për ecurinë, analizën ekonomike si po ecën, dhe ambientin ekonomik të investimeve dhe të tjera. Pra, kjo është ajo për të cilën e përkrah edhe e mbështes në parim këtë iniciativë, por me bindjen pra si deputet edhe grupet parlamentare, edhe LDK-ja që është pjesë e koalicionit, duhet të punojmë më shumë në grupin e vet parlamentar dhe këto çështje t'i shtrojmë mbarë edhe mirë që realisht pra ne të kemi atë mbikëqyrje parlamentare se si po punohet me këto asete, me këtë pasuri publike, me këto ndërmarrje publike me qëllimin më të mirë, pra që të qeverisim, të menaxhojmë, t'i transformojmë, t'i ristrukturojmë, por mos t'i lëmë, domethënë pas dore dhe kështu bëjmë vetëm sfilata sa për të bërë Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi, le të përgatitet deputetja Besa Gaxheri.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përsëritës nismën e propozuesve që të debatohet një temë kaq me interes përball opinionit jo të mirë që krijohet për funksionimin aktual të kompanive publike në Kosovë. Kjo është qysh të them e fshehtë publike që e dëgjon gjithë andej dhe ne është mirë që të debatohet në vendin ku duhet të debatohen çështje të tilla që preokupojnë qytetarët. Edhe nepotizmi, edhe funksionimi jo i mirë, edhe diskriminimi pozitiv i atyre që punojnë në disa nga këto organizata me paga shumë të larta që kalojnë disa herë mesataren e vendit, domethënë janë çështje që duhet të diskutohen këtu. Po, ndoshta edhe një aspekt tjetër që është dashur edhe propozuesit edhe ne secili të mendojmë se këtë çështje a po e shtrojmë në kohën e duhur, sigurisht që jo, këtu doli edhe një kërkesë për nevojën urgjente të amendamentimit të ligjeve ekzistuese ose të draftimit të një ligji të ri për privatizimin e kompanive publike. Unë nuk besoj që do të vijmë te kjo, sepse tashmë në horizont janë paralajmëruar se do të privatizohen të gjitha ndërmarrjet kryesore publike dhe jemi shumë vonë në kohë për të thënë diçka për këtë temë kaq të nevojshme. Unë veç dua të rikujtoj aspektin politik, domethënë peshën politike që ka, dimensionin politik që ka kjo çështje. Dua t'ju rikujtoj që Kosova si vend që ka dalë nga lufta, si vend i ri që është krijuar si shtet i ri, duhet politikat ekonomike t'i mendojë në dy dimensione. Një në dimensione të transformimit rrënjësor sistemorë, pra t'i shkëpusë nga praktikatat e logjikëve ekonomike centraliste dhe t'i qojë kah logjika e ekonomisë së tregut. Dhe dy të provojë që ta ruaj në këtë tranzicion komponentin e shtetit të mirëqenies sociale.

Të gjitha vendet që kanë ecë sikur ne nëpër këto trajektore e kanë pasur parasysh shumë këtë, madje edhe vendet kapitaliste pas Luftës së Dytë Botërore kanë shkuar duke i dhënë shumë rëndësi elementit të krijimit të shtetit të mirëqenies sociale. Shteti ka ruajtur mbi 20% të aseteve në kompanitë e mëdha publike qysh janë kompanitë e metaleve, kompanitë e thëngjillit, kompanitë e telekomunikimit, pra telefoninë, transportin publik, kanë ruajtur më shumë se 20% dhe nuk kanë shkuar drejtpërdrejt në privatizimin e tyre qysh po ngutemi ne. Unë kam frikën se jemi duke u ngutur jo racionalist, sepse ne kemi

dhënë prova edhe përpara miqve tanë ndërkombëtarë se po e transformojmë vendin se efekti politik i privatizimit për ta quar ekonominë e Kosovës drejt ekonomisë së tregut është arritur me shkallën e privatizimit të shpejtë deri në këtë masë. Prandaj, nuk shoh arsye që të ngutemi pa e hartuar së pakut një ligj mbi privatizimin e këtyre kompanive publike që kanë mbetur, në mënyrë nëpërmes atij ligjit të ruajmë interesat vitale të qytetarëve të Kosovës. Mirëpo, kjo është vetëm një thirrje dhe sponzoruesit e debatit të sonte është dashur të na dëgjojnë deri në fund, t'i evidentojnë këto dhe ndoshta në fund të dalin me konkluzione, me rekomandime që ky debat të ketë së paku një efekt që u tha këtu që nuk po e dimë cili do të jetë efekti real i këtij debati. Dhe në këtë kuadër mendoj se së pakut është dashur të nënvizohen poentat kryesore që u thanë, qofshin edhe nga Qeveria ato që vërtet qëndrojnë që janë rationale nismat e Qeverisë, por edhe korrigjimet që i bëmë ne si deputetë, pavarësisht prej cilit tabor, pozitë apo opozitë, sepse është një projekt crucial, është një projekt i interesit nacional, çështja e privatizimit të vetmeve asete që i kemi të rëndësishme nacionale, sepse bashkë me ato pajisje, stabilimente, ne po privatizojmë në të shumtën e rasteve po privatizojmë edhe asetet nacionale që i ka krijuar një herë natyre pra Zoti dhe nuk i përsërit më, qysh janë rezervat e mineraleve në Kosovë dhe ndoshta pikërisht për këto është dashur të kemi një ligj mbi bazën e të cilin nesër pasardhësve tanë u themi mbi bazën e këtij ligji që ka hartuar Parlamenti i Kosovës e ka miratuar e kemi bërë këtë privatizim dhe jo mbi bazën e interesave që mund të interpretohen që janë interesa parciais të grupeve kur shohim se si menaxhohen aktualisht kompanitë publike. Faleminderit! Kjo ishte veç një nënvizim i vogël.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj deputeten Besa Gaxherri ta marrë fjalën, të përgatitet deputetja, Qamile Morina.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është shumë e vërtetë që sot po debatojmë për një temë të ndjeshme, për pasurinë, pra, kombëtare, për ndërmarrjet publike qendrore, por realisht nuk e di sa kem qenë seriozë në këtë debat dhe nuk e di se si do të përmbyllet ky debat dhe çfarë efekti do të mbërri ky debat?

Unë nuk do të lëshohem në keq menaxhimet, keqpërdorimet që janë bërë në ndërmarrjet publike në Kosovë, sepse këto tash më i dimë të gjithë qytetarët jo ne që kemi obligim për t'i ditë dhe për t'i evidentua, por konkretisht isha drejtuar me pyetjen pse janë në këtë gjendje këto ndërmarrje publike, kush është përgjegjës për këtë gjendje në këto ndërmarrje publike dhe çfarë duhet të ndërmarrë institucionet e Kosovës që kjo gjendje të mos jetë e tillë apo t'i shpëtojmë nga gjendja aktuale.

Duke u nisur nga legjislacioni që ka Republika e Kosovës për menaxhimin e kompanive publike, ne e dimë se tashmë këto kompani publike kanë bordet e drejtorëve që faktikisht bëjnë politikën e këtyre kompanive publike dhe natyrisht kemi drejtorë që ekzekutojnë ato politika.

Pak më parë ministri i Ekonomisë dhe Financave na e citoi një nen atje të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe na tregoi decidivisht se ku pushton ndërhyrja e Qeverisë në këto kompani publike, deri me zgjedhjen, pra shpalljen e konkursit dhe zgjedhjen e drejtorëve të bordeve të këtyre kompanive. Po a është e vërtetë kjo që vërtet, qoftë edhe zgjedhja e këtyre bordeve që janë njerëz tërësisht politikë, pra të partive politike dhe janë shumë

pakë ekspertë të fushave të caktuara të ndërmarrjeve publike, a është e vërtetë që edhe ashtu kjo Qeveria nuk ndërhyn në këto kompani publike duke edhe shpesh anashkaluar edhe vetë këto borde që i kanë zgjedhur.

Zoti Ministër, për një gjë të tillë, sepse koha është shumë e shkurtër, e kam sjell një vendim të cilën e keni aprovuar ju Qeveria, nuk e di, nuk e kam të sigurt a e keni dorëzua në PTK ende apo pretendoni ta qoni? Dhe, në këtë vendim të nderuar kolegë dua t'ua lexoj vetëm disa pika çka kërkon Qeveria nga PTK-ja?

Thotë: Të kërkojë nga PTK-ja dhe Bordi i saj i drejtorëve (është data 5 maj 2010) që të ndalojë efektin e menjëhershme të të gjithë projekteve të shpenzimeve kapitale, të cilat janë ose nuk janë të zotuar duke përfshirë, por jo kufizuar ndërtimin e shtyllave shtesë, shërbimet telefonisë, platformën e re të faturimit, projektimin për zgjerimin e rrjetave optike të Republikës së Kosovës, sidomos zgjerimin e rrjetit optik të telefonisë fikse të Kosovës. Të kërkojë nga PTK-ja dhe bordi i saj i drejtorëve që menjëherë të deklarojë dhe të paguaj një dividendë për vitin 2010, për aksionarin me shumë prej 80 milionë euro, ndërsa në shifra, në numra e ka shkruar 85. Shkojmë tutje, dhe të mos punësojë staf të ri ose kontraktues dhe të mos vazhdojë ndonjë kontratë ekzistuese të punësimit. Në vend që të thotë: mos të punësojë staf jashtë procedurave ligjore, pa konkurs publik. Qeveria ndërhyn dhe këtë staf, këtë punësim që ka ndodhur në kompani publike ka ndërhyrë Qeveria dhe është bërë natyrisht jashtë mundësive ligjore, nuk e kanë bërë vetë, nuk kanë guxuar ta bëjnë drejtorët ose shefat ekzekutivë.

Qeveria ka udhëzuar, dëgjoni me vëmendje, ka udhëzuar Njësinë për politika me monitorimin e ndërmarrjeve publike të aplikojë mbikëqyrje të vazhdueshme për të siguruar pajtueshmëri me politikat qeveritare, në praktikë kjo do të thotë që bordi duhet të sigurohet që Qeveria është e ftuar ta dërgojë dikën nga stafi i saj për të marrë pjesë në takimet e bordit ose komitetit të Bordit në kapacitet zyrtar, e gatshme dhe ka qasje të plotë për gjithë stafin dhe informatat në PTK. Nuk po vazhdoj më tutje, të nderuar kolegë. Kjo është ndërhyrje direkt në kompanitë publike. Nuk i mjafton baza ligjore që Bordi i bën politikat dhe auditori sjell raportet për menaxhimin e kompanisë, por Qeveria ndërhyn drejtpërdrejt dhe qon staf ekstra të grupeve të interesit të caktuar, qoftë të kryeministrit apo ministrave, që janë këtu e nuk janë, sepse përmes tyre, një grupi të interesit të ngushtë shkatërrohen kompanitë publike dhe donë t'i privatizojnë, natyrisht aksionarë do të jenë vetë, ata të cilët i kanë shkatërruar dhe i shkatërroj sot këto kompani publike. Qysh duhet t'i shpëtojmë? A duhet t'i privatizojnë këto kompani, ndoshta edhe duhet, por kur duhet, si duhet a duhet të jetë transparent, kush duhet të vendosë t'i privatizojnë këto kompani, si e.....

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet deputeti Gani Buqinca.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar!

Është për tu përsëndetur nisma e deputetëve për këtë debat, ngase privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovës, sidomos të atyre të sektorit strategjik është duke ndodhur në një kohë pa kohë në vendin tonë.

Konsideroj se është vështirë që të nxirret një argument i përgjithshëm për të gjitha ndërmarrjet publike që parashihen të privatizohen, kështu, për shembull, në rastin e Aeroportit mund të argumentohet në favor të koncesionimit të tij. Arsyeja është se në

Aeroport ka potencial, por edhe domosdoshmëri për zgjerimin e kapaciteteve, modernizimit të tyre dhe avancim të shërbimeve. Kjo nuk është mundur në situatën e tanishme, qoftë për shkak të pamundësive financiare të Qeverisë për ta mbështetur këtë, pamundësisë dhe paaftësisë së menaxhmentit aktual të Aeroportit për të siguruar mjete financiare në tregun privat të kapitaleve, por edhe për shkak të ndërhyrjes së shpeshtë politike në menaxhimin e aeroportit dhe punësimin e stafit të ri.

Situata në punësim është shumë brengosëse. Në bazë të shumë informatave aty janë futur si shefe dhe gra që më parë kanë qenë amvise dhe as nuk dinë si t'i përdorin ato pajisjet e komunikimit në Aeroport. Për momentin, vëllimi i transportit të udhëtarëve në Aeroport është më pak se 1.5 milionë udhëtarë në vit, me modernizim të tillë dhe rritje të linjave të fluturimit si dhe rritje të konkurrencës në linjat ekzistuese, ky kapacitet, pa problem mund të shtohet deri në 3 milionë, ndoshta.

Natyrisht, situata ndryshon krejtësisht në rastin e PTK-së. I gjithë problemi për momentin i PTK-së është më mirë të them, që nga paslufta është keq menaxhimi dhe vjedhja e buxhetit të Postës. Ky problem është krijuar për arsye të ndërhyrjeve politike ose të dominimit të politikës brenda PTK-së. Për shembull, për momentin dy figura me ndikim në PTK, por që nuk janë profesionistë në këtë lami të telekomunikacionit, janë familjarët e strukturave të larta shtetërore.

Në të njëjtën kohë, PTK mban mjete financiare të mëdha të cilat nuk i shfrytëzon për modernizimin të kapaciteteve, ata ende punojnë me sisteme shumë të vjetra të faturimit.

Duke punësuar njerëz me favore, Posta për momentin nuk ka ide të duhur për të konkurruar me kompani të tjera, ata ende nuk kanë ditur të sjellin as edhe një risi të vetmen në treg e cila, për shembull, në sferën e telefonisë mobile do t'i vinte në avantazh ndaj konkurrencës.

Situata është edhe më e keqe në telefoninë fikse, në fakt gjithçka këto do të flisnin në favor të një privatizimi të pjesshëm. Arsyeja pse unë jam kundër privatizimit të PTK-së është e shumëfishtë. Qeveria asnjëherë nuk ka arritur të arsyetojë tek qytetarët pse dëshiron ta privatizoj Postën. Ata nuk mund të thonë se e bëjnë këtë për të rritur efikasitetin, ose për t'i penguar keqpërdorimet, sepse janë vetë ata që e kanë shkaktuar këtë problem.

Nëse kjo Qeveri e ka sjell Postën në këtë situatë, duke keqpërdorur pozitën e vetë dhe duke vjedhur pasurinë e Postës, atëherë si mundemi ne të njëjtës Qeveri t'ia besojmë privatizimin? Në një situatë të tillë, ata do të privatizojnë me çmim të lirë, por atij ofertuesi që u ofron atyre më shumë mungesë. Tjetër është mungesa e infrastrukturës ligjore për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, si dhe ajo që është e rëndësishmja në një situatë të tillë është se mirëqenia e qytetarëve do të dëmtojë disa herë. Qeverinë do të shiste postën me çmime më të lirë për të nxjerrë përfitime personale dhe në të ardhmen Qeverisë do t'i mungonin për vite ... të hyrat nga fitimi i postës.

Pastaj është naiviteti për të lejuar privatizimin e ndërmarrjeve publike në një situatë kur ministria që e menaxhon PTK-n dhe Aeroportin, hetohet për vjedhje dhe keqpërdorim të detyrës. Nuk është shqyrtuar asnjëherë në ndonjë debat publik ose nga ekspertë vendorë edhe mundësia që çështja e menaxhimit apo keqmenaxhimit të ndërmarrjeve publike të zgjidhet me alternativa tjera.

Duke pasur parasysh që ndërmarrjet publike janë të kualifikuara me rëndësi strategjike si të tilla nuk mund të lejohet që ato kaq lehtë të privatizohen.

Për fund, jo transparenca dhe bisedimet, me dyer të mbyllura, që po i karakterizojnë shumë projekte të mëdha si Kosova e Re, ndërtimi i autostradës Vërmicë – Merdar, tani i devijuar, privatizimi i PTK-së, KEK-ut, censura në RTK, dhe lidhjet e shumë gazetave me krimin e organizuar të pushtetit.....

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputetja Myzejene Selmani.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet ishte shumë interesat debati sot, unë dëgjova me vëmendje propozuesit i falënderoj për iniciativën me përpjekjen e tyre që të shtrohet në Parlament për debat një temë mjaft serioze e cila preokupon jo vetëm stabilizimin e deputetëve, por edhe tërë qytetarët e Kosovës. Ajo çka më brengosi gjatë këtij debati deri në këto qaste, ishte niveli i ulët i debatit të filluar vetë nga propozuesi, niveli i ulët në pikëpamjen e seriozitetit dhe sidomos niveli i ulët në pikëpamje profesionale, etike dhe në pikëpamje morale. Ajo që brengos në të gjitha debatet që organizohen nga një grup zhurmagjnjësh këtu në Parlamentin e Kosovës, të cilët nuk e përcjellin vetë debatin të cilin e kanë propozuar dhe dalin shëtisin, por eksponohen para mediave për marketing politik, për fyerje publike, për një diskurs dhe një kulturë të ulët politike ndaj kundërshtarëve politikë, duke thënë, duke i quajtur gënjeshtarë, të papërgjegjshëm, të paditur e ku ta dijë unë, gjë që është shumë prekëse dhe është shumë denigruese për shumë kënd që është këtu ulur në këtë Kuvend.

Unë po i kthehem tash temës të cilën po e diskutojmë. Në shtetet në tranzicion, gjithmonë debatet për transformimin e pronës, kanë qenë me tensione të mëdha, kanë qenë dy tendenca, tendenca e ish- komunistëve, e ish – “rezhimlive” të kuq, që t’i shtijë në dorë ato asete të shtetit të cilat i kishin menaxhuar 50 vjet në të gjitha shtetet e Lindjes, dhe tendencat e grupeve të interesit, nëpërmes partive politike, që të vijnë deri te këto asete dhe këto burime dhe të mira materiale.

Ju, të nderuar kolegë deputetë, këtu në rast se nuk e keni ditur, thelbi i demokracisë qëndron në faktin që, mos të mbetet pushteti gjithmonë te një shtresë e shoqërisë, por ta kenë të gjitha shtresat e shoqërisë mundësinë të luftojnë me mjete demokratike për pushtet dhe të vijnë edhe ato e t’i shijojnë të mirat që vijnë nga pushteti. Në këtë drejtim, ju jeni shumë të shqetësuar që në Kosovë, tashmë dita - ditës po forcohet një shtresë e cila ka qenë e diskriminuar për 60 vjet, 100 vjet në Jugosllavi dhe ajo shtresë vazhdimisht është duke e shtrirë ndikimin e vet nëpërmes disa forcave politike këtu në Kosovë, dhe ju keni të drejtë të jeni shumë të brengosur.

Sa i përket koncepteve të privatizimit dhe termit që ne kemi guxim të marrim vendimin për privatizim, unë po ju them se të gjitha shtetet e Lindjes, të cilat kanë nga lidhshkrimet e veta dhe partitë politike, kanë pasur guximin të marrin vendime strategjike, të dhimbshme për privatizimin e ndërmarrjeve publike, sot i kanë punët shumë më mirë se ato shtete të cilat janë munduar për ta ruajtur njëfarë bashkëpronësie, njëfarë mentaliteti edhe të ekonomisë të centralizuar edhe ekonomisë së tregut. Unë mund t’iu them se ky koalicion qeverisës PDK-LDK, bashkë me minoritetet, ka një politikë të

djathtë në këtë proces, një politikë të privatizimit, dhe për këtë e ka marrë mandatin e qytetarëve të Kosovës kur ka dalë në zgjedhje. Për të gjitha këto projekte, kanë folur në një mënyrë të tërthortë dy partnerët e koalicionit më të madh të, edhe është bërë një ujdë për qeverisjen e këtij vendi dhe mua më vjen keq, që ju nuk mund ta ndryshoni strategjinë e partnerit të koalicionit qeverisës. Ju nuk folët a po shkelet ligji gjatë procesit të privatizimit, ligjet janë aprovuar këtu, baza ligjore ekziston dhe pikërisht për këtë arsye, unë ju kisha lutur që gjatë këtyre debateve të jeni më racional dhe...

(reagime nga salla)

... dhe unë t'ju them të drejtën, nuk jam ekspert i kësaj fushe, mirëpo nuk gjeta asnjë argument të prekshëm që ju e dokumentuat, përveç se në mënyrë paushall dy ditë akuza edhe gjykuat tërë Qeverinë. Unë po ju them, sikur të kishte ligje në Kosovë...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet deputeti Zef Morina.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues! Kisha dashur që Dritoni të mos më pengoj, sepse e kemi minutazhin jashtëzakonisht të vogël edhe kisha dashur të flas për ndërmarrjet publike, gjendjen që e kemi sot në to.

Po më vjen shumë keq që ky debat, me rëndësi të veçantë po trajtohet jo seriozisht nga disa deputetë të Parlamentit të Kosovës. Duke u nisur nga ndërmarrjet e mëdha, siç e dimë ne, ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike, mua më habit fakti se kryeministri më herët nuk dinte t'i dallonte ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike, sepse në Projektligjin për ndërmarrjet publike, deri sot "Trepça" ka qenë ndërmarrje shoqërore dhe nuk ka qenë ndërmarrje publike. Ndërsa, kryeministri tha se Trepça është ndërmarrje publike, veç nëse është bërë me ndonjë vendim të kryeministrit tani.

Nëse futemi te PTK-ja, atëherë do të shohim se hiq ma mirë nuk i ka punët as PTK-ja, duke e parë edhe gjendjen në KEK edhe në ndërmarrjet tjera, siç është Aeroporti dhe hekurudhat, e cila para dy vjetëve vlerësohej rreth 1 miliardë euro, kurse në mënyrën e si u menaxhua kohën e fundit, ajo u zhvlerësuar goxha dhe vazhdohet të zhvlerësohet. Vazhdohet të zhvlerësohet, sepse menaxhohet pa kurrfarë përgjegjësie, qoftë profesionale, qoftë përgjegjësisë sociale apo qoftë edhe asaj morale.

Jepet tender për të ashtuquajturin operator virtual, të cilin e përmenden edhe disa kolegë të mi, të telefonisë mobile, e në realitet krijohet një operator i tretë mobil, i cili nuk investon në krijimin e infrastrukturës, sepse do ta përdorë infrastrukturën e PTK-së, edhe do ta marrë profitin 70%.

Pastaj, si është e mundur që vetëm disa muaj para privatizimit menaxhmenti të japë tender 20 milionë euro për platformën e faturimit, shikoni pra se PTK-ja donë ta bëjë platformën e faturimit, ndërsa i japin 20 milionë euro një kompanie të Qipros, gjithashtu u përmend më herët. Çka tregon kjo? Menaxhmenti kurrë nuk kanë punuar në kompani serioze, sepse po të kishin punuar, ata do të dinin se kompanitë e kanë platformën e vet të faturimit, ndonëse kjo nuk është edhe arsyeja, sepse këtë ua ka thënë kompanitë e interesuara për privatizimin e PTK-së. Ata u thanë: mos shpenzoni para në atë platformë, sepse e kemi tonën. Kjo mbase tregon edhe çfarë Qeverie kemi, sa herë që janë ngritur

çështjet në këtë Kuvend, qoftë për dhënien e 45.000 eurove për garat private me kuaj, e mbani në mend shumë mirë, të nderuar deputetë.

Më vjen keq që shumë lukse tjera të cilat bëhen nga kjo kompani private, e cila arrin shifrën me mijëra euro e kësaj Qeverie, kjo Qeveri po harron se këto para janë të taksave të qytetarëve të Kosovës dhe duhet të ketë kujdes se si t'i menaxhojë dhe si t'i shpenzojë. Andaj, unë mendoj që në këto projekte, në asnjë moment nuk ka qenë transparente para qytetarëve të Kosovës dhe ky fakt është shqetësues dhe jo si disa deputetë që e marrin fjalën për të biseduar për një çështje jashtëzakonisht serioze dhe të kalojë në humor. Unë besoj që kjo është pasuri e paraardhësve tanë. Duhet ta dimë në ditë që fëmijët tanë do të pyesin se ku mbeti kjo pasuri dhe ne duhet të japim përgjigje? Andaj, ne të gjithë duhet të kemi kujdes, sepse ndërgjegjja bie në të gjithë ne, sepse sot e kemi fjalën për dhënë për këto ndërmarrje publike. Dhe ja tash Qeveria na befason papritmas dhe i anulon dy tenderë dhe platformën faturuese edhe zgjerimin e rrjeteve me fije optike, të cilat së bashku kapin shifrën rreth 30 milionë euro. Është shumë vështirë të kuptohet kjo, kisha dashur ta di edhe nga ministri i cili është prezent pse u anuluan këto dy kompani, kurse paraprakisht ishin dakord që këto kompani të jenë ashtu siç keni premtuar në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Zef Morina dhe përgatitet deputetja Sala Berisha- Shala, e fundit.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Debat i që sot po e zhvillojmë në Parlament, është shumë me rëndësi, natyrisht atëherë kur vërtet nga ky debat mund të nxirren konkluzione apo nxirren ide të ndryshme se si Qeveria dhe shteti i Kosovës do t'i trajtojë kompanitë publike, të cilat janë natyrisht pasuri e vendit.

Në qoftë se kthehemi dhjetë vjet më pas, dhe i shikojmë pikërisht këto kompani në çfarë gjendje kanë qenë, Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës i cili ishte totalisht i shkatërruar, PTK-ja, e cila nuk kishte as lidhe telefonike, hekurudha ka qenë në një gjendje ndoshta më të mirë që është sot, ndërsa KEK-u ishte pothuaj në gjendjen mund të themi pak më mirë se tani.

Dhe, pikërisht nëse ne do të fokusoheshim drejt, pa shikuar anën politike pozitive-opozitive, ose Qeveri dhe ata që janë jashtë Qeverie, do të ishte mirë të diskutoni pak më ndryshe. Pse po e them këtë? Është shumë e vërtetë që të tria këto kompani, Aeroporti ka ecur me hapa shumë të shpejtë dhe mund të them që është ndër kompanitë e vetme në rajon që ka ecur me zhvillimin më të shpejtë se kompanitë tjera. Ajo që më shqetëson mua si deputet, është se tash nuk ka qenë dashur të bëhet koncesionimi, ose në njëfarë mënyre privatizimi i përkohshëm, për shkak se kjo kompani është më e profitabile ndoshta që ne e kemi analizuar dhe jemi duke analizuar si duhet.

Kosova e ka vetëm një aeroport dhe duhet ta ketë edhe një aeroport tjetër alternativ, i cili është pothuaj me infrastrukturë të gatshme, por këtu Qeveria, jo kjo, por edhe e kaluara, nuk kanë treguar interesi, me përjashtim të Qeverisë Rexhepi, me të cilin vërtet kemi punuar që ta kemi edhe një aeroport tjetër për shkak se i nevojitet në mënyrë imediate edhe një aeroport Kosovës. Nëse, Aeroporti Ndërkombëtar, nesër, kam dëgjuar që do të

nënshkruhet marrëveshja, do të koncesionohet, jam shumë i sigurt se kriter do të jetë për 20 vjet , të mos të ketë konkurrencë, nëse është e kundërta jam shumë i lumtur.

Nga ana tjetër, nëse e shikojmë dhe dëgjova kritika të ndryshme pse kanë punësuar shumë njerëz, nëse kompania është profitabile nuk është shumë problematike, nëse kanë hyrë një numër i konsiderueshëm ose një numër më i madh i të punësuarave, sepse në Kosovë vërtetë kemi nevojë për të punësuar njerëz.

Gjithashtu është me PTK-në. PTK-ja, me përjashtim në telefoninë fikse që mendoj se nuk ka bërë investime aq sa duhet, në telefoninë celulare, është zhvilluar me tepër se që është, ka qenë e paraparë me program. Kështu që edhe këtu nuk qëndrojnë vërejtjet e kolegëve deputetë, se aty është kaos, aty nuk është mirë, aty ka, domethënë, keq menaxhim, nuk pajtohem.

Ajo që kërkoj nga Qeveria, është që, nëse eventualisht do të privatizohej PTK-ja, të ketë kujdes dhe pjesa e cila është vendimtare është domethënëse t'i takojë prapë shtetit ose Qeverisë, ndërsa një pjesë tjetër të jepet, domethënë në privatizim, ose të privatizohet, në mënyrë që të ketë një menaxhim më të sigurt edhe të jetë, thjesht të mos ketë ndikime politike.

Situata në Hekurudhat e Kosovës, është vërtet shumë e keqe. Po ju them sinqerisht nga viti në vit, gjendja është duke u dobësuar, janë duke u shkatërruar e që, nëse e shikojmë si pasuri shtetërore, janë jashtëzakonisht të rëndësishme, mos të them janë të rëndësishme sa edhe rrugët e Kosovës. Nuk e di këtu Qeveria çka ka bërë, por shpresoj që me politikat të cilat janë, qoftë afatmesme, qoftë edhe afatshkurta, të fokusohet më tepër, në mënyrë që situata në Hekurudhat e Kosovës të ndryshojë.

KEK-u, është një kompani e cila është dashur të jetë në një situatë shumë më të mirë. Nuk është...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha Shala, deputetja e fundit e paraqitur për këtë pikë. r

SALA BERISHA- SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Përsëritje për të gjithë.

Unë nuk e pata në plan ta marrë fjalën hiq, mirëpo nuk munda t'i përballoj provokimeve të disa "diskutuesve". Kjo pikë e rendit të ditës është me shumë rëndësi, domethënë, lënda është kërkesë për debat rreth gjendjes në ndërmarrjet publike qendrore. Gjendjen, disa prej deputetëve e kuptuan në mënyra të ndryshme, patën perceptime të ndryshme, gjendjen e punësimit, menaxhimit, financimit e kështu me radhë, të korrupsionit e ku ta dijë unë, mos t'i numëroj dhe propozuesit e kësaj pike të rendit diku në fjalinë e fundit të paragrafit 2, thotë propozojmë që t'ia ofrojmë një pasqyrë të qartë qytetarëve të Kosovës si aksionarë të këtyre ndërmarrjeve për gjendjen reale në të cilën gjenden.

Kërkesa është e parashtruar shumë në rregull, mirëpo diskutimet marrin kahe të ndryshme disa prej lisa disa për fshesa, kështu që mendoj se debati nuk e arriti qëllimin e duhur për të cilin kemi qenë të gjithë të interesuar dhe kureshtarë se çka do të dalë. Ajo që më provokoi më së shumti ishte se disa prej deputetëve ishin tepër të shqetësuar për punësim të jashtëzakonshëm të njerëzve në këto ndërmarrje publike, në Postë, në Aeroport, në KEK e kështu me radhë dhe i quajtën të afërm me udhëheqësit qeveritarë. Dhe unë ua bëj me dije këtyre deputetëve se është shumë mirë nëse janë ata të afërmit e

qeveritarëve, janë ata të cilët ua ka dhënë besimin të udhëheqin këta njerëz me Qeverinë, mendoj se janë njerëz më të merituar të shoqërisë sonë, janë kategoritë më të merituar për të cilën ditë ne jemi këtu edhe pse demokracia është e tillë që disa prej deputetëve nuk e meritojnë as këtë ditë as të ulen këtu në Parlamentin e Kosovës dhe të shqetësohen shumë për punësimin e tyre dhe për mua është kjo ia vlen thënia se ata që shohin vetëm zi njeriu çka të lyp edhe gjën. Nëse i hap sytë në terr, terr do të shohësh, por me këtë qasje se si e kanë disa prej deputetëve nuk do të jenë më këtu në ulëse të Parlamentit fare, s'po flas se me qenë opozitë janë shumë të kënaqur.

Tjetra që është për mua shumë me rëndësi nuk e kuptoj pse disa kanë moral të flasin për këtë temë edhe për performancën edhe për gjendjen si është nëpër ndërmarrje publike, ndërsa vetë mbajnë poste të larta në ato ndërmarrje publike dhe nuk i vret aspak ndërgjegjja ta lirojnë së paku atë vend të punës e t'i marrë dikush tjetër një mijë euro apo dy mijë euro, ta lirojë atë vend dhe ta marrë pagën vetëm këtu si deputet dhe kjo është demokracia, kjo le të jetë në ndërgjegjen e secilit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete! Fjalën e ka ministri... Më fal ministër, në ndërkohë u paraqit deputeti dhe anëtari i Kryesisë Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë kam vetëm një pyetje për ministrin, nëse ka mundësi të më përgjigjet. Ka të bëjë me koncesionimin e Aeroportit të Prishtinës, meqë edhe ashtu tema ka qenë për ndërmarrjet publike, të cilat janë në udhë që të bëhen private.

Zotëri ministër, pyetja ime është konkrete: Koncesionimi i Aeroportit. Ju i përmendët 20 vjet. Ju lutem shumë, nëse mund të përgjigjeni sot, a merr obligime që të bëhet monopolizues dhe të mos lejojë aeroport tjetër?

Nëse e bën këtë, është gabim i madh dhe ju e dini që Shqipëria e ka bërë këtë gabim dhe e vuan këtë gabim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka ministri për të kaluar pastaj te propozuesi i këtij mocioni.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryesues!

Desha sinqerisht të falënderoj secilin prej deputetëve! Nuk besoj që ka pasur qëllim të keq, pa marrë parasysh toneve dhe nervozeve sa i përket gjendjes së ndërmarrjeve publike. Tërë e dimë se nuk është e mirë. Dallojmë në metodat si t'i zgjidhim ato probleme, mbase është shumë e natyrshme. Ne konsiderojmë se çfarëdo sistemi të ndërtojmë ka pasur sistem edhe shumë më të ashpër për kontrollime, monitorime, me forma qofshin ligjore, qofshin administrative dhe të gjitha ato kanë dështuar fatkeqësisht. Ka edhe sisteme që ende kanë ndërmarrje publike, shtete të Evropës, shtete që kanë qenë edhe pjesë e bllokut komunist e që ka ndërmarrje publike që funksionojnë shumë mirë.

A do të jemi ne në gjendje si shoqëri kosovare të zgjedhim me ato metoda një, që thotë korpored governments, një qeverisje kooperative të mirë në bazë të gjitha rezultateve të deritashme edhe gjatë sundimit të UNMIK-ut, edhe gjatë sundimit që dy vjet që i kemi, ende s'janë bërë dy vjet prej se janë zgjedhur bordet, desha të reflektoj në disa nga vështirësitë, nuk besoj që do t'ia arrijmë. Andaj, kemi zgjedhur, u tha nga disa deputetë, mënyra shumë profesionale konsideroj, kemi zgjedhur mënyrën që sektori privat të jetë ai i cili do ta përzgjedhë këtë mënyrë.

Baza ligjore ekziston. Mund të ketë edhe 100 baza ligjore tjera të sofistikuar apo të stërsifikuar. Konsideroj që koha do të vërtetojë se çdo përpjekje për të perfeksionuar ndonjë sistem përmes ndonjë procesi, ndonjë ligji tjetër, do të jetë më e dëmshme koha e humbur se sa ecja përpara. Dhe, ne kemi përzgjedhur të ecim përpara duke konsideruar që ka bazë të mjaftueshme ligjore, duke siguruar mënyrën më transparente të mundshme përmes edhe vendimit tuaj.

Përqindja e privatizimeve të ndërmarrjeve publike do të jetë një temë e veçantë këtu, sidomos për Postë-Telekomunikacionin e Kosovës, kur të vijmë me propozime konkrete, ende janë duke u studiuar, do të përcaktohet edhe nga ky Kuvend.

Sa i përket pyetjes konkrete të profesorit dhe deputetit të nderuar, Sabri Hamiti, sipas të gjitha informacioneve, unë që kam dhe një ndër kërkesat e mia kanë qenë në fakt që mos t'i jepet monopol askujt për Aeroportin, është bërë gabimi në Shqipëri dhe po e vuajmë, që të kemi një liri të vendimmarrjes sa i përket zhvillimit të aseteve të tjera, duke përfshirë edhe Aeroportin Gjakovës dhe unë kërkoj që të iniciohet ajo procedurë.

Ligji mbi partneritetin publik lejon që sektori privat të ketë iniciativë më të madhe se sa sektori shtetëror. Mos të pritet veç Qeveria, komuna apo dikush tjetër... Jepeni iniciativën.

Dhe, desha të them që pa marrë parasysh se ky debat do të ishte shumë më i suksesshëm pas raportit që ne do të dërgonim pas auditiveve që do të bëheshin, konsideroj që e ka arritur qëllimin. Janë shoshitur plot gjëra të cilat janë në kokat tona, në përpjekjet tona për të përmirësuar gjendjen nëpër ndërmarrjet publike.

Dikush po shkon në ekstreme për denoncime nëpër foltore. Ekzistojnë institucionet që janë duke i përcjell. Kushdo që ka argumente, le t'i paraqesë. Secili e ka përgjegjësinë në bazë të ligjit dhe në këtë mënyrë konsideroj, si Grup ndërmnistror po i bëjmë të gjitha përpjekjet për të eliminuar të këqijat që po ndodhin atje.

Edhe vendimi i sotëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i mbështetur në ligj, i mbështetur në nen, nuk tejkalon përmasat e ndërhyrjes, por është fazë parapërgatitore, para transferimit të saj në sektorin privat. Kështu që, në të gjitha mbështetjet që i keni dhënë, unë desha t'i falënderoj në emër të Grupit ndërmnistror, të gjithë ata që kanë qëllim të mirë, të gjithë ata që kanë dhënë kontribut profesional. Me shumicën prej jush, kisha pasur dëshirë të ulemi, të bashkëbisedojmë se si të ecim përpara, në mënyrë që bashkëqeverisjen në ndërmarrjet publike ta bëjmë sa më profesionale dhe transformimin ta bëjmë sa më të lehtë, sa më të padhembshëm dhe sa më përfitues për shtetin e Kosovës. Ju falënderoj shumë dhe në emër të tjerë ministrave që, për shkak të agjendës së tyre, nuk kanë qenë... Unë, në emër të tyre po ashtu ju falënderoj dhe do të kemi raste tjera të takohemi pas dorëzimit të raportit të auditimit për secilën ndërmarrje publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka, i fundit për ta përmbyllur debatin, iniciuesi i tij, deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar kolegë,

Edhe unë mendoj se ky debat, ndonëse ishte pak i nxehtë, në disa momente, por megjithatë u thanë shumë gjëra, që pa marrë parasysh grupacionin tonë partiak kisha për të thënë, jo politik, na brengosin si qytetarë të Kosovës.

Ajo që kemi tentuar – iniciuesit e këtij mocioni, është që këto ethet e privatizimit t'i shikojmë nga një kënd tjetër, për shkak se privatizimi si koncept bëhet për hir të kompanisë, që kompania të zhvillohet, ndërmarrja të zhvillohet e jo të qartësohet prona. Domethënë, konform kësaj ne e kemi iniciuar këtë çështje dhe kemi disa rekomandime të cilat mund t'i votojmë, nëse doni, por megjithatë duhet t'i kemi, për t'i parë kështu, t'i kemi parasysh.

Një është, që të mos biem viktimë e etheve të privatizimit për hir të procesit të privatizimit se dikush po na thotë nuk bën të ketë pronë publike. Shikoni! ÇZ-in! ÇZ-i i cili është ardhur me privatizua KEK-un është pronë shtetërore, nuk është publike. 70% është Qeveria e Çekisë pronare. Që doni, po ua tregoj edhe strukturën aksionare të tyre, se e kam.

Pastaj, TLA-ja, që është gjiganti më i madh prodhues i energjisë në SHBA, në shpirtin e kapitalizmit, është pronë federale. Që nga 1938 kur EFDR – Roosevelt e ka krijuar me një ligj të posaçëm dhe i shërben mbi 20 milionë konsumatorë në SHBA. Është pronë federale, pronë shtetërore. E kemi rastin e EDF – Electricite de France që një herë filluan ta privatizojnë pastaj e ndalën, pikërisht duke pasur parasysh interesin e ndërmarrjes për shkak të rëndësisë strategjike që e ka dhe tash ka ngelur... qëllimi ka qenë 25% tash ka ngelë edhe më pak përqindja e privatizuar. E kemi rastin e Britich-Telekomit, 12 vjet ka zgjatur privatizimi, gjithmonë duke u parë për së pari interesi i ndërmarrjes që nënkuptohet edhe interesi publik dhe pastaj filozofit apo konceptet politike, qofshin të majta apo qofshin të djathta. Jemi kah flasim për një pasuri të Kosovës, të cilën këtë e kemi, nuk kemi tjetër. Ne mund t'i shesim pallavra vetvetes, dhe nuk bën ta humbim optimizmin, por këtë e kemi. Dhe, i jepet monopoli natyror, një që s'ka kurrfarë lidhjeje me Kosovën, kurrfarë ndjenja s'ka. E tash paramendonë sa do të jemi ne imponues ndaj tyre. Domethënë, këtu është koncepti i asaj. Unë po dëgjoj këto ekonomia e tregut. Ekonomia e tregut sallamadi nuk domethënë. I ka ligjet e veta, andaj është Qeveria për çka është, përndryshe, pse të kemi Qeveri, hajde t'i privatizojmë të gjitha, po e lëmë iniciativë private.... Domethënë ky është ai koncepti i asaj. Unë nuk jam kundër privatizimit, aty ku privatizimi e jep, e ulë burokracinë, e rrit efikasitetin. Ne këtu folëm, mbipunësimi e dëmton efikasitetin e biznesit – business efficiency, është raport i cili punën e parë e bën investuesi kur të investojë diçka dhe e sheh se ku mungojnë... Këto janë çështje shumë profesionale.

Domethënë kjo ishte ajo që mos të ngutemi të privatizojmë pse dikush, një këshilltar i transaksionit na thotë, që kur t'ia këqyrësh CV-në, ai kurrë s'ka punuar në vend të vetin e vjen e shet pallavra këtu. Pra, veç mos të biem viktimë e kësaj. Nëse privatizimi është në interes të ndërmarrjes, po more, pse jo. Kaq.

Andaj, po them që Ligji për privatizimin është domosdoshmëri duke pasur parasysh mënyrën se si na shkuan ndërmarrjet tjera. I kemi dy ndërmarrje, tashti cilat kanë mbetur, t'i shpëtojmë këto, ta ulim zararën sa të mundemi. Nuk mund të merremi ne me Feronikelin. Të paktën të mos të na humb edhe....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë!

DRITON TALI: ... Na kanë humbur të tjerat, të mos na humb edhe KEK-u apo Posta. Krejt kjo është, andaj ta sjellim ligjin, të futet në debat të mirëfilltë shoqëror, se sa kemi hise në këto ndërmarrje, kanë hise edhe qytetarët, që kurrë s'i kemi dëgjuar se çka kanë menduar dhe çka të thonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

(Ndërhyrje)

DRITON TALI: Jo! Rekomandimet u thanë, pra të sillet Ligji për privatizimin e ndërmarrjeve... Për shkak të këtyre dy ndërmarrjeve, e dëshirueshme është të jenë veç e veç, por edhe një ligj universal për privatizimin e ndërmarrjeve qendrore që janë të strategjisë së veçantë. Dhe për këtë proces i privatizimit le të ulet tempoja, të shikojmë se a ka mënyra tjera më të mira? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Meqë propozuesit nuk kanë ofruar mocion të shkruar me rekomandime, e konsiderojnë si të absorbuar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje...)

Nuk ka me shkrim! E kemi këtu para vetës, vetëm kanë kërkuar debat, që të debatohet për gjendjen në ndërmarrjet publike qendrore, asgjë më shumë. Vazhdojmë të hënën në orën 10, me pikat e mbetura, për shkak se nesër ka agjenda tjera në Parlament – dëgjime publike, tri dëgjime publike.

E hënë, më 17.5.2010, ora 10:00

Vazhdimi i seancës plenare të datës 13 maj 2010.

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 13 maj 2010, për pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Para se t'ia nisim me punë, fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Mirëmëngjesi të gjithëve!

Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministër dhe ministra,

Më datën 29 prill 2010, siç e dimë, bashkë e kemi aprovuar Rregulloren e Punës dhe dua të besoj që kemi bërë do lëshime teknike dhe tani administrata ka probleme për ta harmonizuar tekstin e Rregullores. Unë propozoj që sot ta fusim në rend të ditës këtë

rregullim të këtij gabimi teknik, mbase që neni 44 i Rregullores të fshihet fare, sepse përsëriten të gjitha ato që duhet thënë dhe thuhet në nenin 47. Nuk kemi nevojë të kemi nenin 44 fare, është propozim i imi dhe i grupit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Po, zoti kryetar, edhe ne e përkrahim si Grup Parlamentar i LDK-së propozimin e shefit të Grupit të PDK-së, Ramë Buja, dhe propozojmë që kjo të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Po, kryetar, pajtohem sepse është bërë lëshim më shumë teknik se sa që ka të bëjë diçka me përmbajtjen e neneve të caktuara.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të AKR-së, Suzan Novobrdali.

SUZAN NOVOBRDALIU: Meqë kemi të bëjmë me lëshim teknik, edhe ne pajtohem me të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit!
Ne e përkrahim.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit “7+”, Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: I mi, predsedniče, podržavamo inicijativu da se ovaj član iz tehničke razloga briše.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, deputeti Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Podržavamo predlog.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Numan Baliq e ka fjalën.

NUMAN BALIĆ: I mi kao Parlamentarna grupa za Integraciju takođe podržavamo prijedlog gospodina Buje.

KRYETARI: Faleminderit!
Pra, këtë çështje po e fusim si pikë e fundit të rendit të ditës për sot. Jeni dakord? Kush është “për”? Faleminderit! S’e di a i kemi numrat për ta përfunduar përnjëherë. Ju e dini që na duhen 80 deputetë, si kemi 80.

Vazhdojmë me rendin e punës. Në rend të ditës është:

- Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomandua, për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar, për miratim.

Ftoj kryetaren e komisionit funksional Myzejene Selmani, apo raportuesin e Komisionit për arsyetimin e raportit me rekomandime. Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2010, shqyrtoi Raportin vjetor 2009 të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe rekomandimin që të shqyrtohet në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës për arsye se i plotëson konditat ky raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk e donë fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Safete Haderxhonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin, për ministrat e Kabinetit qeveritar!

Përshëndetje për kolegët deputetë!

Grupi Parlamentar i partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ka konstatuar se raporti është sjellë me kohë dhe i plotëson të gjitha të dhënat të cilat i parasheh ligji që t'i paraqet përmes raportit.

Në raport paraqitet gjendja në sektorin e energjisë, duke përfshirë prodhimin e rrymës, ngrohjen qendrore, si dhe rregullimin e sektorit të energjisë alternative dhe të gazit.

Sa i përket sektorit të energjisë, nga raporti vërehet se është punuar mirë në hartimin e legjislacionit, është bërë rishikimi i strategjisë, si dhe janë hartuar ligjet kryesore të sektorit të energjisë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian, është miratuar Ligji për gazin, si dhe janë bërë hapa të rëndësishëm në plotësimin e Kornizës rregullative për shfrytëzimin e energjisë së ripërtritshme, kurse nga raporti vërejmë se Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka bërë punë në drejtim të kompletimit të legjislacionit dytësor.

Në faqen 7 të raportit, thuhet se detyra kryesore e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është të krijojë kushte për furnizimin e sigurt të konsumatorëve me energji, të krijojë kushte për ruajtjen e mjedisit të pastër, të ndërtojë një treg konkurrues të energjisë në Kosovë që do të bazohet mbi parimet e objektivitetit, të transparencës dhe të mos diskriminimit. Nëse e analizojmë me kujdes raportin, vërejmë se Zyra e Rregullatorit të

Energjisë është larg në realizimin e detyrës së saj kryesore, qoftë në krijimin e kushteve për furnizim të konsumatorëve me energji, qoftë në ruajtjen e mjedisit të pastër, qoftë në krijimin e tregut konkurrues të energjisë.

Nga raporti vërejmë se në 10 vitet e fundit janë shpenzuar 285 milionë euro për import të rrymës, kurse nga rryma e shitur janë arkëtuar rreth 18 milionë euro. Edhe më tutje vazhdon furnizimi me energji përmes importit. Në vitin 2009 është rritë sasia e energjisë së importuar për 33.35%, kurse është shënuar ulje e çmimeve për 32,67%.

Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e Kosovës, sipas këtij raporti, ende janë të larta dhe paraqesin një shqetësim për sektorin e energjisë elektrike dhe në përgjegjësi për ekonominë e vendit tonë.

Mesatarja e humbjeve në shpërndarjen në të kaluarën ka qenë 45.14%. Nga raporti shohim se vazhdojnë humbjet e përgjithshme në shpërndarje edhe në vitin 2009, ku këto humbje kanë qenë 42.80% të energjisë së futur në shpërndarje. Humbje teknike në vitin 2009 kanë qenë 18.05%, kurse ato komerciale 24.76%, kurse energjia e faturuar sillet rreth 57%. Energjia elektrike e faturuar dhe e arkëtuar ka shënuar rritje në vitin 2009 për 7.83% në krahasim me vitin e kaluar.

Sipas Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Kosova mbetet ndër vendet me tarifatat më të ulëta në rajon. Sa i përket sistemit të ngrohjes qendrore, edhe këtu argëtimi ka qenë i ulët, diku 53.31%.

Në vitin 2009, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ka marrë shumë ankesa nga konsumatorët për vendimet që ua ka lëshuar atyre Korporata Energjetike e Kosovës për shfrytëzimin e paautorizuar të rrymës. Nga 318 ankesa të konsumatorëve, ky departament i ka zgjidhur vetëm 142 ankesa. Mbetet që ky departament të bëjë më shumë në zgjidhjen e ankesave dhe të ketë një qasje më objektive ndaj konsumatorëve.

Nga praktika e deritashme mund të them se Kuvendi ka bërë shumë në krijimin e kushteve që agjencionet e pavarura të kryejnë rolin e tyre dhe të ruajnë pavarësinë e tyre. Mirëpo, shumë pak është zbardhur në vlerësimin e performancës së këtyre agjencioneve të pavarura, të cilat kanë shfrytëzuar buxhetin, por kanë gëzuar edhe donacione nga donatorët e ndryshëm.

Ne kemi shumë pak informata rreth të hyrave të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Nga raporti shohim se ka realizuar të hyra në vitin 2009 në shumën 467.223 euro. Mirëpo, nuk kemi asnjë të dhënë se si janë realizuar këto të hyra dhe sa janë reale shënimet të cilat janë paraqitur në raport.

Në vitin 2009 janë bartur edhe 549.249 euro nga viti 2008, që do të thotë shuma totale të hyrave të realizuara dhe të bartura për vitin 2009 ka qenë 1.016.472 euro. Nga këto mjete, me Ligjin për buxhetin Kuvendi i ka lejuar Zyrës së Rregullatorit shumën prej 985.988 euro për kryerjen e aktivitetit.

Në vitin 2009, kjo Zyrë ka shpenzuar vetëm 58,22% të buxhetit të planifikuar. Për paga dhe mëditje ka shpenzuar 249.000 euro apo 80.67%, për mallra dhe shpenzime nga 450.000 euro të planifikuara ka shpenzuar vetëm 191.000 euro apo 42,60% të mjeteve të ndara për këtë kategori dhe atë për udhëtime zyrtare ka shpenzuar 26.291 euro, për

shpenzime të telefonit dhe telefona 15.312 euro, për reklama dhe konkurse 13.743 euro, kurse për shpenzime kapitale janë shpenzuar vetëm 50.84% të mjeteve të planifikuara.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka nevojë të përmirësojë kapacitetet planifikuese të buxhetit, sepse çdo vit bën presion të madh në momentin kur bëhet ndarja e buxhetit, kurse kur është çështja të realizimi i buxhetit, ka ngecje të mëdha.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është përkrahur nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian më 985.600 euro, nga Banka Botërore më 176.000 euro, thuhet në raport se është përkrahur edhe nga USAID-i, por nuk kemi ndonjë vlerë të shënuar. Është mirë të bëhet performanca e shfrytëzimit të këtyre fondeve, se këto fonde a po kontribuojnë në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në punë në këtë zyrë, si po reflektojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale për përmbushjen e detyrave të tyre, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion për ta miratuar këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Zef Morina, e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin në fjalë, i cili raport për vitin 2009 përmban një pasqyrë të ngjarjeve më të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu, në raport janë të prezantuara të dhënat teknike dhe komerciale të rregulluara në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës.

Raporti është përgatitur në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, neni 10, ku janë të prezantuara të dhënat financiare. Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka vazhduar të komplotojë legjislacion dytësor, gjegjësisht harmonizimin e rregulloreve të reja, si dhe plotësimin dhe harmonizimin e tyre ekzistuese. Andaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku, në emër të Shkumbin Demalisë.

ETHEM ÇEKU: I nderuari, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raportin e Zyrës së Rregullatorit ne e kemi analizuar edhe në dy institucione, edhe në Komision, edhe si Grup Parlamentar. Parimisht, e kemi mbështetur si një informatë të mirë, e cila i servohet Parlamentit dhe deputetëve për të parë se ku është sektori i energjetikës në Kosovë.

Fatkeqësisht, përpos shifrave shumë të mira që janë sjellë në këtë raport dhe informacionet e mira që i sjell raporti të sistemuara, në aspektin e politikave zhvillimore të sektorit të energjisë nuk kemi fare ndryshime, bile në disa sektorë të caktuar sipas raportit kemi ngecje apo kemi stagnim tërësisht të sektorit të energjetikës. Humbjet

teknike mbesin përafërsisht të njëjta, bile me tendencë edhe të ngritjes, po ashtu edhe humbjet komerciale nga statistika që jepet në raport janë mjaftë të mëdha. Importet e energjisë elektrike në 3 vitet e fundit, po t'i shihni me vëmendje, e shohim se sa janë të shtrenjta importet dhe sa i kushton buxhetit të Kosovës blerja e energjisë elektrike, kurse shitja e energjisë elektrike prapë është në një pozitë mjaftë të palakueshme për sektorin tonë.

Problem tjetër paraqitet infrastruktura ligjore. Na vjen keq që s'kemi askënd nga institucionet përkatëse të Ministrisë apo të dikujt tjetër për të dëgjuar vërejtjet e kolegëve tanë deputetë, që e përmendën edhe më herët parafolësit sa iu përket importeve tepër të shtrenjta të energjisë elektrike.

Infrastruktura ligjore, ne e dimë që ka filluar të ridraftohet, të rishkruhet tërësisht ajo e cila ishte e mëparshme dhe kemi tërësisht hartimin e një infrastrukture të re ligjore, e cila deri diku nuk është në harmoni me projekte zhvillimore të cilët zhvillohen në sektorin e energjetikës në Kosovë.

Në parim, Grupi ynë parlamentar e mbështet raportin, por shpreh brenga të mëdha sa i përket zhvillimit në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se Raporti i Zyrës së Rregullatorit është sjellë me kohë dhe është shqyrtuar brenda Grupit Parlamentar të AKR-së, në fillim mund të them se ky raport paraqet gjendjen faktike të sektorit të energjisë në Kosovë, ku të gjithë sot përballemi me këtë gjendje çfarë e kemi. Në këtë raport, pikë së pari jepet mundësia e shikimit real të gjendjes faktike të prodhimit, të shpërndarjes dhe konsumatori sa është i kënaqur me sektorin e energjisë. Pikë së pari, mund të them se në raport janë dhënë mundësitë që ky raport të punohet në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe është thënë shumë saktësisht në këtë raport se sa prodhon Kosova. Nuk dua të përsëris parafolësen, e cila i dha shifrat totale të raportit, mirëpo mund të them se gjendja me konsum të energjisë prapë se prapë edhe në vitin 2009 ka qenë një gjendje jo e kënaqshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht asaj që thuhet se në KEK është përmirësuar gjendja e prodhimit dhe e furnizimit dhe njëkohësisht humbjet janë zvogëluar, mirëpo realiteti në këtë raport paraqitet krejt ndryshe dhe njëkohësisht në këtë raportet parashihen edhe të hollat të cilat i ndanë buxheti i Kosovës për Kompaninë Elektroenergjetike të Kosovës, e cila edhe në vitin 2009 prapë se prapë nuk ka mund të arrijë faturimin dhe arkëtimin aty ku është dashur, si një kompani publike, dhe prapë se prapë paratë e qytetarëve tanë dihet kah shkojnë – për import të energjisë elektrike.

Tregu i energjisë elektrike, po është kah blihet energjia elektrike dhe cilat kompani kanë licenca për energji elektrike për import dhe eksport të energjisë elektrike. Mund të them se është paraqitur edhe shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike, gjë që është në rregull në bazë të ligjit të cilin e ka Zyra e Rregullatorit.

Mirëpo, te sistemi i ngrohjes, në bazë të kornizave ligjore për sektorin e ngrohjes, edhe këtu është një pasqyrë shumë esenciale e paraqitur, por njëkohësisht prej kësaj seance bëjë apel te përfaqësuesit e “Termokosit” që të ndërrohet lënda e parë për prodhimin e ngrohjes për arsye se këtu shihen shifra marramendëse, të cilat janë të papaguara nga

konsumatorët dhe njëkohësisht shifra të cilat i ndahen prapë se prapë prej buxhetit të Kosovës kësaj kompanie. Është paraqitur edhe mbrojtja e konsumatorëve, mirëpo duke marrë parasysh gjendjen me furnizim dhe planin A,B,C dhe humbjet teknike dhe komerciale me të cilat ballafaqohet KEK-u dhe ballafaqohen qytetarët e Kosovës, atëherë nuk mund të ketë mbrojtje të konsumatorëve dhe në bazë të ligjit, kështu në total mund të them se raporti është raport i cili i përket Zyrës së Rregullatorit në bazë të infrastrukturës ligjore çfarë e ka, dhe uroj që Zyra e Rregullatorit të jetë një rregullator i pavarur nga Qeveria, me të cilën duhet të atakohen të gjithë investitorët e rinj të cilët vijnë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, deputetja Qamile Morina e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministra, deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë Raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji e konsideron mjaftë voluminoz, duke pasur parasysh që në te përfshihet Raporti për vitin 2009, si dhe gjithashtu raporti 10 vjeçar i rrjedhave të energjisë në vendin tonë. Përkundër synimit për raportim më të detajuar të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, duke përfshirë edhe periudhën 10 vjeçare, në këtë raport kemi vërejtur edhe mjaftë mangësi, si: raportit po i mungon pasqyra e disa shënimeve që ndikojnë në miratimin e caktimit të tarifave me pakicë, gjë që është faktor mjaftë i rëndësishëm për jetën e qytetarëve. Ajo që është me rëndësi, gjithashtu, është raporti i humbjeve komerciale sipas distrikteve për vitin 2009, si dhe pasqyra e humbjeve totale komerciale për periudhën 2000 – 2010 për Kosovë, gjë që mungon në këtë raport, si dhe raporti i humbjeve teknike sipas distrikteve për vitin 2009 dhe pasqyra e humbjeve totale teknike për periudhën 2000 – 2010 për vendin tonë. Ajo që do ta pasqyronte më mirë situatën tonë në këtë sektor, do të ishte kur raporti do të paraqiste humbjet totale në Kosovë, krahasuar me regjionin për periudhën 2000 – 2010, gjë që gjithashtu mungon në këtë raport. Pasqyrë shkalla e ndikimit të investimeve në zvogëlimin e humbjeve teknike në operatorin shpërndarës dhe operatorin e transmissiionit, gjithashtu mungon. Në këtë raport mungon zbërthimi i përafërt i importit për shkak të Pik-ut dhe për shkak të remontit të blloqeve të prodhimit, kur dihet se importi është një prej faktorëve vendimtarë në përcaktimin e çmimit të tarifave të tregut të rregullt.

Në raport shihet se vetëm në vitin e kaluar Kosova ka importuar energji elektrike në vlerën mbi 46 milionë dhe kjo krijon paqartësi duke pasur parasysh se ende është aktual plani A, B C dhe afër 60% të konsumuesve janë kategori – amvisëri. Dhe, ajo që bie në sy në aktivitetet ndërkombëtare të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si anëtare rajonale e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, ajo ende figuron si Zyra e Rregullatorit UNMIK. Kjo është e paarsyeshme dhe nuk do koment.

Dhe, së fundi, ajo që është me rëndësi, në raport mungon edhe paraqitja e ideve apo kërkesa e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë tek operatori shpërndarës, me qenë se humbjet janë të mëdha, kërkit të mënyrave si të veprohet në mënyrë që çmimi i tarifave me pakicë mos të ketë ngritje gjithmonë, duke pasur parasysh nivelin e theksuar të varfërisë në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti Enis Kervan, e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryetar!

Günümüzde ister elektrik kalitesine yönelik teknik hususların ordadan kaldırılmasında zorluklar mevcut olmakla birlikte, tüketicilerin gereksinimleri de karşılanmamıştır. Ancak Kosova Cumhuriyeti Enerji Sektörü yeni bir oluşum sürecinde bulunmaktadır. Dolayısıyla bu sürecin daha emin adımlarla ve daha kolay uygulanabilmesi için enerji stratejisi üzerinde çalışmalar yürütülmüştür. Enerji Sektörüne ait en önemli taslaklar hazırlanmıştır. Bu taslaklarda ve daha doğrusu hazırlanan raporda bazı eksikliklerin mevcut olduğu 7+ Parlamento Grubu tarafından da saptanmıştır. Ancak Taslağın Avrupa Birliği standartları ve yasasıyla uyum içinde oluşumu da göz önünde bulundurarak, 7+ Parlamenter Grubu Raporu kabul etmektedir. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk ka të paraqitur.

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrime, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pred nama je danas Izveštaj Regulatora za električnu energiju i napajanje gasom za Kosovo.

Mogu ka kažem u ime grupe da smo pažljivo razmotrili ovaj izveštaj i mi kao grupa dajemo danas jedan svoj doprinos.

U samom izveštaju moramo da kažemo da se sama kancelarija bavila dosta sa sobom, da se nije bavila sa tržištem, da se nije bavila sa mogućnostima, da nije vršila pravilne analize, da nije posmatrala regione oko sebe i da nije uporedila nijedan parametar sa regionom. Moramo da kažemo, iz samog iz izveštaja se vidi da se elektro - energetska i gasovodna situacija na Kosovu nalazi isto tako kao i pre 10. godina. Zašto kažem ovo? Zato što je iz izveštaja dato doznajanje da nisu još ispunjeni osnovni kriteriji, standardi kvaliteta napajanja i usluga. To je kontinuitet napajanja. U zadnje vreme smo prisutni kada je isključenje na delu na terenu. Drugi standard je kvalitet napajanja i komercijalni kvalitet. Znači, i kada je kvalitet napajanja i cena, svuda smo u odnosu na regiju, uskraćena je ova mogućnost za građane.

Kada sama kancelarija obavlja, pošto nemamo puno vremena, ja hoću da dam segment kada je u pitanju analiza gubitaka. Analiza gubitaka, vidimo da je iz izveštaja obavljena je analiza prenosa, proizvodnje, gubitaka, distribucije, ali kada su u pitanju gubici, moramo da kažemo da ovde se ne bavi dosta sa analizom gubitaka. Zašto kažem da se ne bavi dosta sa analizom gubitaka? Zato što su gubici dati za 2009. godinu, gde vidimo da su gubici veliki u odnosu na regiju, da se gubi i dalje energija, da su komercijalni, finansijski gubici, što moram da kažem da se pola energije i dalje fakturiše, pola energije se i dalje gubi. Dali smo mi toliko bogati da možemo da dozvolimo da nam se pola proizvedene energije gubi. Zašto ovo kažem, pogledajte stranicu 32, videćete da je proizvodnja 4 miliona 428 a da je fakturisano samo 2. miliona 532, znači pola energije se gubi, pravi gubici su od 50 do 60%.

Kada se radi o pitanju kupovine struje u regiji, isto moramo da kažemo da Kosovo kupuje po ceni od 109,50 eura, i ide nekad gornja cena do 143,55 eura za megavat čas. To je znači 62% skuplje od svih koji kupuju u regiji. Ovo je jako dobar parametar da se uporedi da li smo opet mi toliko bogati da kupujemo najskuplju energiju. Energija se kupuje u toku dana, jedan dan pre toga i kupuje se ugovorom, sezonskim ugovorom za stabilnost.

Šta je u politici nabavke, šta je, da li se čeka dan da kupimo skuplje, moramo ovo da analiziramo. Ovim se analizama malo bavi Kancelarija za regulatore. Kancelarija mora da donose pravilnik koliko nedostaje energije i koliko energije treba da kupimo i kada i u koje vreme i po kojoj ceni.

Drugo što hoću da dam doznanja, kada prodaje to je cena od 33,35, znači po sniženoj ceni, sve me zbrije, kada kupujemo, sve je skupo. Drugo što hoću ponovo da dam segment za energiju, jeste kada je u pitanju naplata. Moramo da kažemo, ovde se kaže da je 75% naplata, što nije tačno, zato što je ovde samo posmatrana 2009. godina, fakturisana iz 2009, naplaćeno iz 2009, a mi znamo za 10. godina prenesenu naplaćenu realizaciju nema, što znači da od 33% nema više naplate na Kosovu. I mi taj procenat još nismo poboljšali za punih 10. godina, nismo napravili platformu za plaćanje energije i kontinuitet kod naših građana.

Drugo što je jako važno, daju se do znanja zakonski okviri ove kancelarije i imamo jedan od zakonskih okvira, gde je zaštita potrošača. Kada je u pitanju zaštita potrošača, moram da kažem ovo, da me pažljivo slušaju kolege poslanici. Ova kancelarija je imala 318 žalbi, rešila je samo 142 žalbe, što je žalosno, 176 žalbi ostalo na čekanju. Ova se praksa kod nas preslikava u sudstvu, u energetici, svuda gde su žalbe, svuda gde građani hoće svoje pravo, tako da vidimo stvarno da ovo pravo koliko se rešava iz žalbi. Ja moram da kažem da su žalbe identifikovane na ime neovlašćene potrošnje, što krađa energije, na ime ne tačne registracije električne energije, kazne za isključenje, netačno očitavanje, prenos duga i pretplata za RTK. Ovo su sve formaliteti kada su u pitanju žalbe, za koje treba najviše nedelju dana, da ne kažem 5 minuta.

Drugo što hoću da kažem kada je u pitanju pretplata za RTK, ja moram da kažem da moramo da se pozabavimo sa svim našim regijama, ne tamo gde je pretplata data za više brojala u domaćinstvo gde nema uvek televizora, to treba Vlada da uđe i da napravi jednu sintezu sa ovom Kancelarijom za regulatore, i za regije kao što su Gora, Opoja, jedan deo Prizrena, Župa gde nisu imali praktično ovaj prijem, a gde su morali da plaćaju. Znači, da se oslobode i da se zbog naplate ovi potrošači ne svrstavaju u kategoriju u kojoj im vrednost od 270 i nešto eura otežava naplatu i verujte mi bivaju ove kategorije isključene zbog TV pretplate.

Ja sam razmatrala i deo gde je gasovod, moramo da kažemo da je jako malo, da se jako malo vodi računa da Kosovo bude snabdevano gasovodom, vidimo opisane su mreže i imam jedan predlog, mi moramo da napravimo plan i program, ova Kancelarija specifično, za elektrifikaciju i gasifikaciju kosovskih gradova, gde ćemo imati efikasnu mrežu, gde da prepozna kriterije koji su potrebni i da, normalno, u subvenciji koju dobija iz budžeta, namenski prati da li su to mreže, da li je to investicija kapitalna, da li je to kupovina, da li je prodaja, da li je politika preduzeća i, normalno, ova kancelarija je žalosno što se ne bavi malo sa ljudskim faktorom, jer ljudski faktor je faktor broj jedan ako hoćemo da pospešimo jednu granu. Ljudski faktor znamo kakav je, znamo kakav je menadžment i ne znam zašto je tabu tema za ovu kancelariju kada je u pitanju stručnost i ljudski faktor po ovim preduzećima, za koje moram da kažem da su monopol. Mi moramo neku situaciju da utvrdimo, da analiziramo, da vidimo i da damo segmente kako možemo do energije da dođemo kontinuirano, jer znamo da je energija sastavni deo svih proizvoda i, normalno, privlačenje investitora da napravimo politiku za električnu energiju, gde ćemo da privučemo investitore, da imaju kontinuirano napajanje i napajanje po povoljnoj ceni. Nije tačno da je Kosovo najjeftinije, jeftinija je u regiji Srbija, jeftinija je Makedonija, Crna Gora i svi ostali, znamo da prosečna cena nije dobro izračunata. 015

euro centi je na Kosovu struja, podelite sve kategorije, to je matematika čista, videćete ovde je zamka kada su u pitanju, rekla sam, gubici, kada je u pitanju tarifni stav i ovo ne bi trebalo da se dešava da nam se servira od strane jedne stručne kancelarije. Toliko. Hvala!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Ibrahim Gashi

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete, hvala!

Kalojmë tash sipas radhës së deputetëve. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, le të përgatitet deputeti afër tij, Driton Tali.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Unë, së pari e kisha paraqitur një farë indinjate në një formë, ndoshta edhe kritikë, po kritikë për të mirë për përfaqësuesit e grupeve parlamentare që gjatë diskutimeve të tyre, të jenë pak më profesional, mos të na lexojnë tabela apo të na tregojnë se ZRE duhet të raportojë, ligji kaq e kaq përbëhet prej kaq faqeve, le të futen në temë. Hiq diskutimin e fundit të Grupit Parlamentar, asnjë prej diskutimeve tjera s'ka pasur as nevojë të bëhet, sepse ata që merren realisht edhe aktivisht me punën e deputetit të Kuvendit, ata e lexojnë vetë tabelën, ata e dinë ligjin, mos të na lodhin kot së koti të humbim kohë.

Tash po i drejtohem Raportit të ZRE-së dhe do të shkoj drejtpërdrejt në faqen 18, ku tregohet për ndërmarrjet e licencuara në vitin 2009.

Të nderuar, unë në një kohë ia pata bërë një pyetje ministres së Energjisë dhe Minierave për importimin e rrymës së energjisë elektrike, nënshkrimin e kontratës prej kompanisë jo të licencuar Geni, Geni nga Beogradi dhe pati reagua në mënyrë shumë agresive pse po më pyetni mua për KEK. Dhe, çka po ndodh? Edhe raportet e organizatave ndërkombëtare, që aq shumë po thirremi në ta, tregojnë se ka pasur ndërhyrje të Ministrisë së Energjisë kur kemi të bëjmë me kontrata. Dhe, çka në të vërtetë ka ndodhë këtu? Këtu ka ndodhë që Geni, jo i Beogradit, s'ka qenë kurrë i licencuar, po Geni me seli në Tiranë qenka i licencuar më 29.12.2009, kurse kontratën e ka pasur të nënshkruar Geni në shtator të vitit 2009. Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me nënshkrim të kontratës me kompani që s'ka qenë e licencuar dhe përgjegjësi direkte e ZRE-së është që të harmonizojë dhe të mos lejojë veprime që janë në kundërshtim me ligjin. Sipas deklarimeve publike të zyrtarëve të Ministrisë së Energjisë, deklarimeve publike, deklarimeve publike edhe të personave tjerë publikë, të përfaqësuesve të KEK-ut kanë thanë se ne e kemi nënshkruar kontratën, më pastaj do të licencohet. Kjo krejt na tregon një gjë se me të vërtetë në sektorin e tregut të energjisë ... është zonë që ZRE-ja e mbron, e rregullon, e rregullon prej paqartësive, e rregullon prej manipulimeve, është detyrë primare e ZRE-së, nuk e ka luajtur rolin e vet. Mos luajtja e rolit të tillë prej ZRE-së, sipas mendimit tim personal, ky është një kualifikim ndoshta i ndryshëm nga të tjerët, mendoj që nuk kanë qenë në gjendje, në krejt raportin nuk e kemi bilancin energjetik për vitin 2010. Në rast se nuk ka profesionalizëm për të bërë bilancin elektroenergjetik, atëherë me standarde normale të Bashkimit Evropian kemi një mospërputhje mes bilancit dhe gjendjes reale. Në rast se ka mospërputhje, në rast se nuk jemi në gjendje të bëjmë bilanc, atëherë hapim rrugën për manipulime në tregtinë me energji, e hapim rrugën se është fakt, është prej raportit të ZRE-së, thotë Geni është licencuar më 29.12, ne kemi blerë prej Genit të Beogradit shtator të vitit 2009. Me fjalë të tjera, blejmë edhe në kohën Pik. Mandej, një ditë përpara blejmë rrymë, kur s'ka nevojë, pse? Pse se kemi bilancin elektroenergjetik mirë të treguar. Kjo ishte sa i përket faqes 18, të bëhet shumë publike, që është shumë e vërtetë që Geni sipas ZRE nuk paska qenë i licencuar atëherë kur është

blerë rryma edhe dikush te duhet ta ndjeje dhimbjen, nuk mjafton këtu, më tha dhe kaq, apo unë për një fjalë goje po i humbi milionat. Jo, drejtësia duhet të vendoset në vend. Këtu kemi të bëjmë me shumë para, me shumë para dhe nuk ka nevojë të nervozohet ministria e Energjisë, të thotë pse po më pyetni mua. Këtu ka të bëjë me para publike.

Do të kthehem në faqen 38, ku ka të bëjë krahasimi i çmimeve të importit në vendet e rajonit. Kjo tabelë, të nderuar, është hiq kurrgjë. Pika e parë, shtylla e dytë, unë e kam kontrolluar tabelën me Thomson Routers, burimi është Thomson Routers, që e përcjellin tregtinë me energji. Tabela e parë nuk është kjo, është për të treguar që ne e kemi blerë rrymën ngjashëm si të tjerët. S'është e vërtetë. Apo, për shembull, në fjali e ka thënë se këto shënime janë të ndryshme, varësisht nga palët, DESMIE i Greqisë, që është sistem i transmetimit, që e ka edhe përgjegjësinë për t'i mbikëqyrë burimet e energjisë, tregun e energjisë apo IPEX-i i Italisë ka sasinë dhe çmimin për tërë energjinë e transmetuar. Në fund e kemi shtyllën e KEK-ut, për import. KEK-u importon veç energji elektrike të prodhuar jo nga burimet të ndryshme, nuk i intereson burimet apo te jete energji alternative. Por çmimet që i kanë krahasuar, janë çmime mesatare, mesatarja e energjisë që prodhohet edhe nga burimet alternative.

Në rast se kemi të bëjmë me këtë punë, atëherë normalisht që energjia e prodhuar prej burimeve alternative, erës, ujit, bioenergja, këto normalisht që i ngrisin çmimet. Me fjalë të tjera, kjo është tipike komuniste, ata që kanë qejf të bëjnë manipulim me të dhëna, me statistika, t'i transmetojnë dëshirat e veta përmes statistikave, statistika me të cilat unë jam shumë i sigurt, kushdo prej deputetëve, 120 sa janë në sallë, le të jenë, çka thotë për ta kjo tabelë, kurrgjë, dhe plus nuk është e saktë. I ke të dyjat, këtë për ata që e vejnë në dyshim diskutimin tim, unë po e tregoj burimin kah janë nxjerrë të dhëna, European Energy Exchange (EEX) që e përcjell, që është një konzorcium gjerman, e përcjell tregtinë me energji, le të shkojnë në WEB faqen Thomson Routers e shohin që s'është ashtu. Qëllimi është të krahasohet energjia që e kemi importuar ne. Do me thënë, me fjalë të tjera të sillet një lloj imoraliteti, kur të duash të thuash diçka, të ngritësh çështje, por më së miri të dalë dikush dhe të thotë, më falni se unë jam grua, më falni se e kam nënën të sëmurë. Kur e shpenzon paranë publike, ke përgjegjësi. Ky është diskutimi im. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet për kontributin!
Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Abdyl Ymeri.

DRITON TALI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar të pranishëm dhe ju qytetarë që na përcillni përmes televizionit, unë e kam lexuar me interes të veçantë këtë raport për shumë arsye, ndër to edhe për të parë se çka ka ndryshuar për të mirë nga raporti i vitit të kaluar, ndonëse tashmë u thanë shumë gjëra nga parafolësi dhe ma lehtësoi pak të koncentrohem në gjëra tjera, por shpresoj se këtë raport këshilltarët e transaksioneve e kanë lexuar mirë dhe, po ashtu, kjo moda e re, konsulentët strategjikë, pra që janë urë lidhëse mes Qeverisë dhe këshilltarëve të transaksionit. Nëse hapim raportin në faqen 22, do të shohim se kërkesa maksimale për rrymë ka qenë të dielën, më 13 dhjetor të vitit 2009, dhe shifra ka qenë 1051 megavat. Në realitet, kjo shifër me vite sillet nga 1050 deri më 1100, që do me thënë Kosova më së shumti rrymë shpenzon gjatë kësaj kohe, pra, duke marrë parasysh edhe krejt këtë anarki që është në realitet në treg.

Kurse në faqe 23, thotë se humbjet teknike i kemi 18%, që do të thotë që nëse 18%, që janë rreth 190 megavat, ia heqim kësaj shifre, atëherë kërkesa maksimale do të ulet. Po

ashtu, thuhet në faqe 31, humbjet komerciale për vitin 2009 ishin 20.8, nëse është për t'ju besuar këtyre raporteve, që domethënë po të sanoheshin këto humbje, atëherë me siguri që edhe kërkesa do të ulej për të paktën 20%, mbase edhe më shumë. Pra, konsumi i Kosovës, maksimumi nuk është më shumë se 850 megavat orë në Pik dhe më pak në kohë tjera.

Dhe, nga ana tjetër, nëse e shihni tabelën 4.6, faqe 26, Kosova në vitin 2009 ka gjeneruar, ka prodhuar, thotë, 970 megavat orë rrymë, që domethënë se problemi të cilin gjithnjë e potencojnë në qeverisje, se ne nuk prodhojmë rrymë apo nuk gjenerojmë rrymë për nevoja tona, këto shifra e demantojnë. Pra, problemi nuk është i gjenreimit apo prodhimit, por problemi është i menaxhimit, domethënë kemi të bëjmë me probleme operacionale në KEK e jo me probleme gjeneruese.

Po e zëmë se “Kosovën A”, ashtu siç ka planifikuar Qeveria ta mbylli, atëherë po ashtu “Kosova B” dhe Ujmani së bashku me Lumbardhin do të jenë në gjendje t'i prodhojnë 600 megavat orë, andaj shtrohet pyetja se çka, domethënë pse diskutuam për 2000 megavat apo 2100 megavat kapacitete të reja, gjithnjë po flas për këta këshilltarë të transaksioneve, të cilët vinë e na shesin mjegull këtu.

Prandaj, unë po them, shtrohet edhe nënpyetja - a kemi nevojë, urgjencë të ndërtojmë kapacitete të mëdha, a kemi nevojë të investojmë në infrastrukturë, sepse dihet se rrjeti i Kosovës nuk mund të durojë më shumë se 800 megavat orë. Sipas disa të dhënave, del se problemi zgjidhet me rreth 300 milionë euro, nëse investohen në rrjet.

Po ashtu, nga kjo rrjedh edhe një çështje tjetër. “Kosova B” në prag ka prodhuar 520 megavat, nëse nuk jam gabim, domethënë me investimet adicionale- shtesë mund të rriten kapacitet deri në 600 megavat të “Kosovës B”. Tash shtrohet ajo pyetja tjetër strategjike, të cilën disa herë tentova ta bëjë këtu atëherë kur u diskutua për strategjinë e energjisë elektrike. Nëse “Kosova B” është në gjendje t'i prodhojë komod 550 megavat orë, pra pa i dhënë zor hiq, dhe nëse kapacitetet e reja do të jenë 500 megavat, fillimisht, atëherë pse Kosova apo pse Qeveria ende nuk e dinë sa përqindje të aksioneve do t'i ketë, 20% apo më pak. Kosova deponon 600 megavat, domethënë më shumë se 50% në projektin e ri dhe merr, nuk është e sigurt a do t'i marrë 20 apo më pak përqind të aksioneve. Kjo përsëri lidhet me atë që disa herë po e potencoj këtu, nëse në djepin e kapitalizmit, siç është SHBA-ja, TVA-ja, pra Tennessee Valley Authority mund të jetë pronë shtetërore, gjiganti më i madh prodhues, pse në Kosovë nuk mund të ketë shteti i Kosovës aksione më shumë në gjenerimin e rrymës elektrike. Apo nëse në Francë EDF-ja është mbi 85% pronë shtetërore, pse në Kosovë nuk mund Qeveria e Kosovës t'i ketë më shumë se 25, të themi 60% të aksioneve, pse nëse QEZ-i i famshëm i cili ishte krenari për Qeverinë në Kosovë se do të investojë në “Kosovën C”, Kosovën 2000 megavatësh, mund të jetë 70% pronë e shtetit të Çekisë, e Kosova nuk mund t'i ketë më shumë se, të themi 50% të aksioneve në projektin e ri, ku i deponon 600 megavat gati, e mos të flasim për qymyrin, se atë ia jep bakshish falë ndërtuesit të ri.

Pastaj, ajo irituesja që është, për tentimin e të menduarit ndryshe njerëzit kualifikohen si komunist, si ultramajtist dhe nga kush, nga vetë enveristat.

Pastaj, të shkojmë te faqja 37 të tabelës 4.20, shohim se importi i rrymës elektrike, ndonëse është rritur, por çmimi është ulur, shohim se në vitin 2009 janë shpenzuar 46.300.000 euro dhe pa tjetër këtu duhet të përmendi udhëheqësit e KEK-ut, zotin Gjokaj, por edhe të tjerët, të cilët na shpjegojnë se arsye pse Kosova gjithmonë blen

rrymë më shtrenjtë për 20 - 25% se sa çmimi në treg sipas tyre, se realiteti është më ndryshe, është sepse Serbia tregun e Kosovës e trajton si treg të vetin. Pra, Serbia Kosovën e trajton si Vojvodinën, andaj ia shet Kosovës deri 25% rrymën elektrike më shtrenjtë. Po them, Serbia, se gjithmonë Kosova merr rrymë prej ndërmarrjeve serbe, si Geni, që u përmend këtu, si Rudnapi, si EFT dhe shtrohet pyetja se këta zotërinj kujt po donë t'ia shesin këto pallavra, a me të vërtetë dikush ju beson atyre, se Tadiqi, Diana dragutinoviq ministrja e financave, po qoftë edhe tjetër kush në Qeveri, ka fuqi që Mirosllav Mishkoviqit, Vojin Lazareviqit, Vuk Hamoviqit, Svetislav Bullatoviqit, të cilët janë nga tatim paguesit më të mëdhenj në shoqërinë serbe, që atyre t'ua rrisin çmimin për shitje në Kosovë. Kjo është një pallavër, e cila s'gëlltitet fare. Problemi është se dikush është kah pasurohet.

Tash, po shkojmë përsëri...

KRYESUESI: Zoti deputet, te raporti...

DRITON TALI: Krejt në raport jam duke folur. Rryma, që blejmë rrymë, që s'ju pëlqen këtyre zotërinjve, s'kam çka ju bëj, unë jam kah e lexoj këtë. Pastaj, përsëri marrim dhe shikojmë te shitja e rrymës aty. Siç e përmendi Naimi, nëse e marrim bursën e rrymës elektrike EEX. – European Energy Exchange do ta shohim se çmimi mesatar atje në vitin 2009 ka qenë 43 euro, gjersa Kosova ka blerë rrymë elektrike me çmim mesatar prej 75.77 euro, domethënë Kosova gjithmonë ka importuar rrymë me çmim dyfish më të madh se sa rajoni dhe këtu na shpjegojnë se arsyeja është sepse gjithmonë Serbia e trajton Kosovën si treg të vetin, andaj edhe ia rritë çmimin të cilin e blejnë kosovarët.

Çështje tjetër, të cilën këtu na tregon është se ndonëse shumë pak jep informata, është çështja e Ferronikelit. Të keni parasysh, flasim për 46 milionë, nëse veç me 25% e merr dikush rrymën më shtrenjtë, siç thonë ata, se është shumë më shumë, domethënë del deri.....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sektori i energjisë elektrike, i cili konsiderohet si sektor më i rëndësishëm që do të ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të vendit, akoma vazhdon të mbetet në gjendje jo të mirë, duke pasur parasysh moszhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese, mirëmbajtjen joadekuate të termocentraleve ekzistuese, përmirësimin e rrjetit shpërndarës elektrik.

Ky sektor aktualisht nuk është në gjendje të plotësojë kërkesat e Kosovës për energji, kur dihet se kërkesa për energji është rritur dhe për këtë kemi import të energjisë me çmime bukur të larta dhe shpenzime të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Edhe reduktimet ditore të energjisë elektrike në bazë të planit A, B, C dhe shkyçjeve kolektive nuk kanë treguar shumë besueshmëri te konsumatorët për të qenë pagues të rregullt të energjisë së shpenzuar. Prandaj, hapat e ndërmarrë të Ministrisë së Energjisë dhe të Qeverisë në përgjithësi për reformimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë

shpresëdhënës për të ardhmen, ku së pari kemi krijuar një bazë të mirë ligjore për këtë fushë, investimet e bëra nga donatorët dhe Qeveria që nga paslufta kanë bërë që në vitet e fundit të kemi një furnizim më të mirë me energji elektrike, ndërsa në vitet në vijim të kemi ngritjen e kapaciteteve të reja prodhuese me një teknologji më të avancuar, “Kosovën e Re”, investime të mëtejshme, ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve në rrjetin shpërndarës elektrik, projekti Ferizaj II, lidhja ndërlihdhëse 400 kilovoltëshi Kosovë – Shqipëri, privatizimin e distribucionit dhe të furnizimit, të gjitha këto do të siguronin një zhvillim të këtij sektori dhe një furnizim të qëndrueshëm dhe të volitshëm me energji elektrike, që është parakusht i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Kosovë.

Në kuadër të kësaj, roli i Zyrës së Rregullatorit për Energji, si organ i pavarur, është që të rregullojë të gjitha aktivitetet që i përkasin sektorit të energjisë në Kosovë, siguron një funksionim transparent dhe jo diskriminues të tregut të energjisë duke u bazuar në parimet e tregut të lirë.

Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Energji është mirë i ndërtuar dhe ka po thuaj se të gjitha informatat e nevojshme rreth aktiviteteve të zhvilluara në sektorin e energjisë.

Në raport financiar shihet se Zyra e Rregullatorit të Energjisë krijon të hyra edhe ka bartje të mjeteve prej viti në vit dhe po që se i krahasojmë me buxhetin e ndarë, nga buxheti i Republikës së Kosovës shihet se është më i lartë.

Konsideroj se Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji nuk është dashur të marrë vendim për lirimin e të licencuarve nga obligimi i pagesës së taksës fillestare dhe vjetore, sepse mjetet me vlerë prej 819.909 euro kanë mund të përdoren dhe të investohen diku tjetër.

Zyra e Rregullatorit për Energji është e kujdesshme në shpenzimin e buxhetit të saj dhe nga raporti shihet se nga buxheti i planifikuar për vitin 2009 është realizuar vetëm 58.22% e buxhetit. Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa duhet të ketë parasysh gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2011 që të bëhet një krahasim, harmonizim dhe planifikim më i mirë i buxhetit për këtë zyrë.

Në faqen 25, në pikën 4.3.2, te cilësia e tensionit kemi një përshkrim për standardet e cilësisë së tensionit, se si duhet të jetë. Mirëpo, nuk kemi të paktën edhe një shembull të vetëm në ndonjë zonë të caktuar se vërtet si është cilësia e tensionit në rrjetin shpërndarës. Ndërsa, unë e di shumë lagje nëpër fshatra të komunës së Skenderajt që kanë shumë probleme edhe me furnizimin dhe tensionin, që nuk është në parametrat e paraparë, do të thotë kemi tension jo normal të energjisë elektrike edhe në mesin e ditës, kur nuk ka shpenzim të madh të energjisë, e mos të flasim për në mbrëmje kur nëpër shtëpitë e banorëve të këtyre lagjeve nuk punojnë as televizorët. Sigurisht që kjo është pasojë e rrjetit elektrik shumë të dobët dhe e kapacitetit jo të mjaftueshëm të trafave që kanë në dispozicion.

Në tabelën 32 shihet se kemi 18.05% humbje teknike, 24.76% humbje komerciale, që do të thotë se në total në shpërndarje kemi humbje 42.80%, që do të thotë se kemi humbje shumë të mëdha. Prandaj, është mirë që të forcohet mekanizmi i kontrollit të të gjitha organeve përgjegjëse me qëllim të zvogëlimit në nivelin më të ulët të humbjeve në rrjetin shpërndarës.

Po ashtu, në tabelën 33 Raporti në mes të ngarkimit të faturave dhe arketimit nuk janë as të përafërta dhe kemi një dallim të madh në mes tyre. Për mua është e paqartë se nga 318 ankesa të paraqitura nga konsumatorët, janë zgjidhur 142, kurse 176 ankesa janë të pazgjidhura. Çka, nëse do të kishim gjatë një viti më shumë ankesa? Dihet se do momenti i pranimit të një ankesa, është një afat i caktuar për t'ju kthyer përgjigje qoftë pozitive, qoftë negative palës. Me këtë neglizhencë të Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorit sigurisht që nuk do të kemi besueshmëri te ky departament nga ana e konsumatorëve.

Në raport nuk kam hasur borxhin e përgjithshëm që kanë konsumatorët ndaj KEK-ut, që është një borxh shumë i lartë. E përmendi këtë për një fakt se në një periudhë të caktuar një pjesë e konsumatorëve janë ngarkuar me paushall, e dihet se në zonat si në Drenicë e Dukagjin shkalla e shkatërrimit nga lufta ka qenë e lartë. Në komunën e Skenderajt shkalla e shkatërrimit ka qenë 90% në objektet e banimit, do të thotë njerëzit kanë pasur edhe probleme me strehim, kurse të njëjtën kohë nga KEK-u janë ngarkuar me fatura të energjisë elektrike me paushall edhe atë në ato raste kur njerëzit nuk kanë banuar fare në ato shtëpi të cilat kanë qenë të djegura. Për këtë është dashur të ketë një prerje të borxhit dhe të kemi një zgjidhje për këtë, sepse këta konsumatorë janë ngarkuar me këtë borxh në mënyrë jo të drejtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

RIZA SMAKA: i nderuar zotëri kryesues!

Të nderuar qeveritarë, deputetë të respektuar,

Nga Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dalin disa çështje të cilat janë edhe aktuale, janë edhe akute. Ndër të tjera, e marr temën – Kompletimi i kornizës ligjore dhe rregullative. U mor vesh, e kemi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ndërsa shihet më tej se kjo Zyra e Rregullatorit ka miratuar një nga rregulloret, e cila quhet – për procedurën e zgjidhjes së kontesteve. Kudo në shtetet moderne, çështjet që trajtohen në procedurë, rregullohen me akte ligjore edhe atë sistemore. Kemi ligj, po e zëmë, për procedurën administrative, civile, penale, kundërvajtëse e tjera e tjera, domethënë se kjo është çështje tepër me rëndësi, nuk mundet një institucion, një entitet, po e zëmë, në këtë rast Zyra, t'i caktojë rregullat e procedurës, edhe në qoftë se do t'i përfillte, ato apriori do të ishin të diskutueshme dhe si të tilla, natyrisht, nuk do t'i rezistonin as atakut më të lehtë në Gjykatën Kushtetuese po që se ndokush do ta bënte. Kjo reflektohet më pastaj te mbrojtja e konsumatorit, që shihet se mbrojtja e konsumatorit, po e zëmë, ja faqja këtu 58, po e zëmë, që nuk është siguruar. Ndër të tjera, po e zëmë, numër i madh i ankesave, numri më i madh, më tepër se gjysma nuk janë vendosur fare, e mos të hyjmë tash në ato që janë vendosur, se si janë vendosur e sa janë vendosur, se sa janë ato, nëse janë aktvendime në formën e caktuar me ligj, që duhet ta ketë një hyrje, një dispozitiv, një arsyetim, një udhëzim juridik, që zakonisht nuk e kanë. Më pastaj, udhëzimi juridik që do të duhej dihej se kujt t'i adresohet. Fundi i fundit, në qoftë se Zyra i cakton rregullat e procedurës, dihet fare mirë se kujt mund t'i adresohet dhe ankesa fare nuk shqyrtohet, po e zëmë, me muaj, jo me muaj, ndoshta edhe me vite.

Dalja e disa çështje tjera, po e zëmë, burimet alternative do të duhej të bëheshin investime tepër serioze që në burimet alternative të gjenim ne zgjidhje së paku suplementare për ta redukuar, për aq sa mund të redukohet, po e zëmë, dyoksidi i karbonit, monoksidi i karbonit, që aq tepër e ndot, e bën ... këtë klimë tonën në të cilën ne jetojmë.

Më pastaj, importimi i energjisë është shumë i shtrenjtë dhe në qoftë se ndokush do të thirrej në kontratën ekzistente, se ajo qenka më parë e përcaktuar, e fiksuar, e specifikuar, ekziston një institut juridik, i cili quhet Rebus sikstant ibus, që mund, jep bazën juridike për ta rishikuar kontratën dhe për ta ndryshuar, për ta modifikuar në përshtatje me rrethanat aktuale ekzistente.

Inkasomi del se nuk është në nivelin e duhur dhe më pastaj se nga aty rezultojnë edhe probleme serioze. Përderisa në disa rajone aplikohen dënime kolektive, që nuk lejohet absolutisht, apo jo, në qoftë se vetëm një konsumator është korrekt, po e marrim supozimin 99 të tjerë në atë lokalitet jo, nuk bën të dënohet konsumatori korrekt edhe lojal, po duhet të gjenden metoda të tjera. Ndërsa, kemi situata kur, po e zëmë, kolektivisht favorizohen disa komunitete, që është në kundërshtim me kushtetutën dhe me moralin. Energjia është mall, malli trajtohet në biznes, biznesi nuk njeh korniza të karakterit politik e tjera e tjera. Duhet të veprohet në konformitet me ligjin që e dikton ekonomia e tregut.

Faturimet e dobëta, jo të sakta, regjistrimi i pasaktë, prandaj edhe faturimet jo të sakta, leximi po asisoj paushall, nuk mund të tolerohet leximi paushall, ju lutem, shkon në disfavorin e shfrytëzuesit. Numri i madh i ankesave, do të thotë këto janë probleme, që supozoj se do të duhej të ishin tema topike të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe t'i trajtonte me seriozitet dhe t'i zgjidhte. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti i fundit deri tash i paraqitur, Shkumbin Demaliaj.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, të nderuar kolegë,

Fillimisht, desha të protestoj ndaj drejtuesit të seancës për mos përfilljen e Rregullores së Kuvendit, për indiferencën e qëllimshme edhe pas disa vërejtjeve nga këtu, që t'ua tërheq vërejtjen disa deputetëve që të jenë në rend të ditës, mos të nxisin debate, mos të prishin atmosferën e diskutimit dhe të kontribuojnë për të mirë për informimin e drejtë të qytetarëve, ai megjithatë vazhdon me indiferencë dhe i lejon deputetit që të flas për Shkup e për Shkodër pa kurrfarë lidhjeje me rendin e ditës, vetëm e vetëm se nga pozita e opozitarit, që është ulur aty sipas Rregullores së Kuvendit, i leverdisë që dikush të diskreditojë, të shantazhojë Qeverinë dhe të dezinformojë opinionin e gjerë....

KRYESUESI: Mbaju temës, zoti deputet!

... dhe kur ka kësi lloj diskutimesh dhe kësi lloj indifference nga drejtuesit e seancës, atëherë nuk ke si mos t'i kualifikosh...,

(Reagim nga salla)

... a po e nxjerr jashtë, a po e thirr ta nxjerrësh jashtë....

KRYESUESI: Përmbaju temës, zoti diskutues!

... temës, duhet mos të lejohen njerëzit të dalin prej teme...

KRYESUESI: Qetësi, ju lutem!

... për arsye se pastaj mbesin gjërat e pasqaruara në këtë Kuvend, zoti kryesues, dhe për këtë arsye jeni aty për të mos nxitur debate të ndryshme dhe të jemi brenda rendit të ditës...

KRYESUESI: Vazhdo me pikën e rendit të ditës ndërkaq, koleg i nderuar, bëhu më parlamentar!

..dëgjo, edhe kjo aq më keq, kjo nuk është hera e parë që kur e drejton zoti Ibrahim Gashi Kuvendin, ndodhin këso gjërash. Unë e kam tërhequr vërejtjen edhe më herët.

KRYESUESI: Ju lutem, unë do t'ju replikoj tash meqë ma përmendët emrin.

... meqë unë e thashë atë çka mendova dhe besoj që në të ardhmen nuk do të përsëriten këto gjëra për arsye se ngjallin emocione negative të deputetëve tjerë, unë do të kthehem te rendi i ditës.

Unë do të përkrah Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike për arsye se konsideroj se ka një përparim në punën e saj, mirëpo nuk mund të mos japë edhe disa vërejtje, sidomos në lidhje me faturimin e faturave në komunën e Drenasit, siç u tha këtu nga një kolegë, në komunën e Skenderajt.

Në këto dy komuna është bërë një faturim paushall që pas luftës në ndërtesa që nuk kanë ekzistuar, kanë ekzistuar vetëm rrënojat. Për një kohë shumë të gjatë aty nuk ka pasur rrjet elektrik, praktikisht nuk ka funksionuar rrjeti elektrik dhe janë grumbulluar shumë borxhe. Domethënë, ky është një problem të cilin e ka bërë KEK-u dhe ankesat të cilat janë drejtuar në Zyrën e Rregullatorit, nuk janë trajtuar me seriozitet të madh. Unë konsideroj se konsumatori sot në Kosovë i energjisë elektrike është tërësisht i pambrojtur dhe Zyra e Rregullatorit nuk është në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe të konsumatorëve në Kosovës në përgjithësi, është një problem në përgjithësi. Mjaftë ka individë të cilët ankohen për shkak të arbitraritetit të Korporatës Energjetike, qoftë në faturim, qoftë në gjëja vjedhjen e energjisë elektrike nëpër mes njehsorëve, njehsorëve të cilët janë qe 40 vjet të pa balancuar ose të pa ndërruar dhe Zyra e Rregullatorit duhet t'i bëjë presion shumë më të madh Korporatës Energjetike që t'i ndërrojë njehsorët, të bien njehsorët që janë të standardeve dhe të cilësisë për saktësinë dhe matjen e shpenzimeve të rrymës elektrike, njëkohësisht të investojë edhe në rrjetin elektrikë i cili, në dy komuna të cilat i përmenda, po thuaj se nuk plotëson asnjë standard elementar, kështu që cilësia e rrymës është tepër e dobët dhe furnizimi i qytetarëve është jashtëzakonisht jocilësor me energjinë elektrike. Nuk është më mirë edhe në regjione tjera, sidomos në ato rurale në Kosovë.

Duke shpresuar që edhe Korporata Energjetike në këtë fazë, në këtë mezo kohë deri, sa të bëhet privatizimi i saj, do të përmirësojë menaxhimin në përgjithësi dhe duke shpresuar se edhe Zyra e Rregullatorit Energjetik do të ngrisë përgjegjësinë e vet në punë dhe do të bëjë përmirësime të ndjeshme, ju ftoj që ta votojmë këtë raport të punës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Dua të them vetëm dy fjalë, meqë ma përmendët emrin aq dendur, që unë ndërhyra konform rregullores dy herë ndaj diskutimit të deputetit Tali që të përmbahet rendit të ditës dhe në momentin kur ndërhyra për herë të dytë, ai u rikthye plotësisht në rendin e

ditës dhe e përfundoi diskutimin e tij në rendin e ditës. Kjo është e evidentua edhe nga regjia, ndërhyrja ime, dhe kaq mund të bëj konform rregullores. Faleminderit!

Vazhdojmë me diskutuesin Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ma merr mendja se periudha e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse dhe Kornizës Kushtetuese është tejkaluar në Kuvendin e Kosovës edhe ne nuk kemi të drejtë t'i drejtohem Kryesisë së Kuvendit se si ata duhet ta drejtojnë edhe në formë si kërcënuese se çka bëjnë deputetët tjerë, secili kemi të drejtën tanë për të biseduar edhe kur jemi jashtë rendit të ditës mua ndërpritet fjala. Më së shumti, ai që dha vërejtje, më së shumti foli jashtë rendit të ditës...

KRYESUESI: Zoti deputet, të lutem, përmbaju rendit të ditës!

... Lidhur me raportin u fol shumë dhe po ju drejtohem deputetëve se po flasin në mënyrë jo profesionale. Më vjen shumë keq prej zotërinjve Rrustemi e Tali kur drejtohen në emër të deputetëve lidhur me raportin edhe në këtë rast, e them kushtimisht, se ata në mënyrë profesionale edhe shumë kanë qenë në rend të ditës, po kanë harruar një diçka lidhur me gjithë ato çka thanë. Kompanitë e palicencuara apo të licencuara më vonë serbe, që i shesin rrymë Kosovës, kanë harruar se në një pjesë të territorit të Kosovës faturat elektrike, edhe pse Kosova blen prej atyre kompanive, ato fatura Elektroekonomia e Serbisë i shpërndan faturat e konsumit, ata qytetarë i paguajnë edhe një herë Serbisë faturat. Kjo është një e vërtetë e madhe që ndodh brenda territorit të Kosovës. Vetëm desha t'ua përforcoj profesionalizmin zotërive Tali dhe Rrustemi, se po harrojnë edhe ata shumë shpesh diçka më interesante.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Replikë, Driton Tali.

DRITON TALI: Të nderuar,

Vjet në vitin 2009 i kemi shpenzuar 46.300.000 euro në importin e rrymës, nëse e marrim këtë se 20%, zyrtarisht 20 – 25% është blerë më shtrenjtë, atëherë del se 11.575.000 euro i keni humbur, kurse në vitin 2008 nga 51.510.000 euro i kemi humbur 12.870.000 euro. Këtu dikush po pasurohet. Nëse kjo nuk është në rend të ditës, unë nuk di çka është në rend të ditës. Pastaj, unë nuk munda ta përmend Ferroniklin, sepse shihni faqen 29, aty thuhet se Ferronikeli 18% i ka rritur përdorimin e rrymës elektrike. Ne vjet e kemi...

KRYESUESI: Lidhur me replikën.

... në rend të ditës. Ne vjet e kemi subvencionuar 40 milionë Ferronikelin, sivjet edhe 18% më shumë, ndonëse ka zbritur pak çmimi i rrymës elektrike. Nëse këto për zotërinjtë e Qeverisë apo të koalicionit qeveritarë të partisë më të madhe nuk janë në rend të ditës, unë këtu s'jam ardhur t'ju tregoj njerëzve përralla. Lexoni faqen 7, faqen 8, të lexohet edhe për së dyti raportine ZRE-së, se e kam lexua në shtëpi 7 herë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Lus regjinë që t'i ftojë deputetët, meqë jemi në fund të debatit lidhur me këtë pikë, që të votohet, sepse nuk kemi numër të mjaftueshëm në sallë. Ndërkaq, diskutuesi i fundit, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është me interes që së paku ta përfillim komisionin parlamentar që drejtohet nga opozita dhe ka rekomanduar që Raporti të aprovohet. Është me interes si deputetë të merremi me çështje përmbajtësore dhe të mos ofendojmë, sepse edhe ne të tjerët kemi diçka për të thënë dhe nuk është Kuvendi i dy - tre personave këtu. Po më vjen shumë keq që faturimi nuk ka ndodhur vetëm këtë vit kur por flasim, por faturimi është nga viti 2000, faturimi i energjisë elektrike ka ndodhur nga viti 2000. Kategoritë të cilat janë lënë anash dhe të cilat me patriotizëm po i mbrojmë sot këtu, janë lënë anash edhe në vitin 2001, edhe në vitin 2002, bile të mos them që është marrë vendim edhe të falen një 30% të borxhit, të cilin e kanë pasur, pavarësisht cilit komunitet i takojnë.

Unë do të doja vetëm t'i specifikoj 2 – 3 çështje.

Çështja e parë, është shumë e vërtetë që nuk kemi faturim real. Janë faturuar edhe objektet, të cila faktikisht kanë qenë jashtë sistemit ku ka qenë dashur të ketë rrymë elektrike.

E dyta, ne paguajmë më shumë se çdo kush energjinë elektrike, edhe kjo çështje është shumë reale. Një ekonomi familjare, e cila në kuadër të një normaliteti paguan mbi 100 euro, është e jashtëzakonshme dhe është e papërballueshme.

E treta, ne edhe sot kur po bisedojmë, ne nuk jemi si qytetarë të barabartë as në çështjen e pagesës, as në çështjen e asaj që duhet të kemi drita në mënyrë të barabartë, por as në çështjen më jonjerëzore që u bëhet, edhe pse dikush e paguan dhe mbetet jashtë sistemit që të ketë rrymë për shkak të 50%, ku rryma elektrike në ndonjë fshat apo në ndonjë lagje nuk paguhet. Kemi shkyçje kolektive edhe sot, prandaj ndoshta krejt esenca e kësaj ka qenë të përqendrohemi në debatin - a duhet që sot ata të cilët paguajnë edhe 100 euro për muaj rrymë elektrike, e paguajnë me rregull dhe të mos kenë rrymë elektrike për shkak të asaj që dikush nuk paguan rrymën elektrike, dikush shfrytëzon dhe nxehet me rrymë elektrike dhe s'pagan fare. Të gjitha këto e kanë një konkludim, nuk kemi menaxhim të mirë as në faturim, as në procedim të çështjeve që janë para organeve të drejtësisë, sepse vonohen atje me vite të tëra. Prandaj, duke pasur parasysh këtë situatë, unë konsideroj që raporti me një farë mënyre i ka përshkruar të gjitha të dhënat dhe askush nuk po tenton që në raport të fsheh realitetin që ekziston. Mu për këtë çështje, Qeveria e Kosovës ka marrë hapa shumë të rëndësishëm për ta privatizuar, sepse i kemi kaluar 10 vite, 10 vite me këto vështirësi, mirëpo varet nga ajo si po duam ta lexojmë raportin dhe si po duam të dalim para opinionit publik. Këto janë çështje të cilat nuk po i fshehim edhe ne, edhe ne kemi probleme me rrymën, edhe ne e paguajmë këtë tarifë, por realiteti mu për shkak të kësaj situate që e kemi, janë marrë hapa për ta privatizuar, për ta bërë një menaxhment i cili do ta mbikëqyrë situatën dhe këtë nuk e dinë vetëm një deputet, por e dinë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Prandaj, edhe njëherë unë e mbështes Rekomandimin e komisionit funksional që të aprovohet raporti me këto rekomandime që i dhanë edhe deputetët dhe në shumicën e rasteve disa prej tyre kishin të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Meqë debati lidhur me Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009 është shteruar, shkojmë në votim të raportit.

Në sallë kemi 63 deputetë. Lus të gjithë deputetë prezentë dhe regjinë që të përgatiten për votim të raportit dhe votojmë tash:

A ka pa kartelë që votojnë “për”? Tre deputetë.

Konstatohet se me 45 vota “për”, 11 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi aprovoi Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2009. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës:

10. Shqyrtim i Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar të njëjtën, për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim, me propozim për amendamentimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Atëherë, ftoj përfaqësuesit e komisionit funksional apo raportuesin e komisionit për arsyetim të raportit me rekomandime. Fjalën e ka në emër të komisionit, kryetarja e komisionit, Myzejene Selamani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në pajtim me Rregullën 41 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në mbledhjen e mbajtur më 27 prill 2010 shqyrtoi Raportin vjetor 2009 të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, të datës 26 mars 2010, dhe vendosi Kuvendit t’ia paraqes rekomandimin që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta mbështesë dhe ta miratojë Raportin vjetor të punës për vitin 2009 të Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk e ka kërkuar fjalën askush. Atëherë, kalojmë te përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputetja Sala Berisha - Shala.

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ,ministër!

Përshëndetje kolegë deputetë dhe gjithë ju të pranishëm!

Shqyrtimi i Raportit të AKP-së për vitin 2009 është analizuar hollësisht me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Raporti është në harmoni të plotë me Ligjin e AKP-së, është hera e dytë që i raporton Kuvendit ky agjencion. dhe dallimin mes dy raportimeve të këtij institucioni ka lëvizje të dukshme pozitive.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë raport dhe vlerëson të suksesshëm Raportin vjetor të AKP-së për vitin 2009, duke pas parasysh situatën dhe çështjet e trashëguara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e cila në përgjithësi për momentin paraqet një barrë të jashtëzakonshme për dinamikën e punës të AKP-së, siç thuhet në këtë raport.

Mandej, duke pasur parasysh ndikimin e krizës financiare, globale dhe vështirësitë që kanë hasur në relacionet me Odën e veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në faqen 6 përshkruhen aktivitetet e bordit gjatë vitit 2009, flitet edhe për nënshkrimin e

memorandumeve të mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Tregtisë, Industrisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit në lidhje me ndryshimet statusore të ndërmarrjeve të shitura përmes spinoffit special, në mënyrë që të zyrtarizohen si ndërmarrje të reja. Mandej, memorandumimi në mes të AKP-së, Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me verifikimin, kontrollin e historikut që ka të bëjë me ofertuesin fitues, fitues të përkohshëm në procesin e privatizimit. Mandej, faqe 11, tek aktiviteti i njësisë për përgatitjen e tenderëve, në kuadër të aktiviteteve të saj përmendet bashkëpunimi me institucione tjera, si ajo me Gjykatën Ekonomike, ku janë proceduar 62 kërkesa për gjetjen e provave historike të dokumentuara, që ndërmarrjet shoqërore në fakt janë pronë shoqërore dhe mendojmë që kjo është një punë e mirë që duhet të vazhdojë ta bëjë Agjencioni Kosovar i Privatizimit, ngase kemi raste ku është tjetërsuar prona shoqërore ashtu “pa u vërejtur”.

Tek njësia e marketingut dhe marrëdhënie me investitorë, përveç tjerash, me organizimin e ekipeve përforcohet mbledhja e informacioneve për ndërmarrje shoqërore të ndryshme për karakteristikat e çështjeve të ndryshme me interes të veçantë e tjera aktivitete të përshkruara në atë kapitull.

Një nga sfidat kryesore të AKP-së mbi procesin e privatizimit në Kosovë ishte edhe përsheptimi i shpërndarjes së 20% tek punëtorët. Në raport thuhet se ka hasur edhe në pengesa politike në lidhje me publikimin e listës së punëtorëve, që këtë listë e kemi në faqen 17.

Mandej, në faqe 21, veç se përforcohen këto pengesa, ku thuhet se duhet të përmendet që AKP-ja nuk ka vazhduar të publikojë lista tjera të punëtorëve pasi që do t'i grumbullonte dokumente për komision për shqyrtim dhe Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme.

Faqe 32, tek Njësia e administrimit direkt është paraqitur një listë e ndërmarrjeve që janë nën administrim direkt të AKP-së dhe arsytet e këtij administrimi, po e përmend vetëm një shembull shumë të përfolur, siç është ai i Llamkosit në Vushtrri, ku paraqitet arsyeja - mospërmbushja e obligimeve me spinoff special nga blerësi.

Dhe, në faqe 49, e kemi po të kjo tabelë, ku thuhet se për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të spinoffit special nga ana e blerësit, Bordi i AKP-së ka marrë vendim t'i kthejë aksionet. Njëra ndër arsytet e kthimit të aksioneve është edhe borxhet e mëdha të ndërmarrjes së re, mandej pagat e papaguara ndaj punëtorëve për 16 muaj. Ndërmarrja do të përgatitet për ritenderim, duhet të ndiqen procedurat gjyqësore për këtë ndërmarrje.

Të nderuar deputetë,

Nisja e një auditimi të jashtëm të pavarur për 22 ndërmarrje të privatizuara përmes metodës së spinoffit special është një sinjal i mirë. Ne e dimë mirë se 2007 UNMIK-u nuk pati lejuar publikimin e Raportit të Auditimit të AKP-së atëherë. Prandaj, me të drejtë thuhet në këtë raport, në faqe 25, Njësia për monitorim nuk ka trashëguar një pasqyrë të qartë dhe të saktë mbi përmbushjet dhe kushtet e kontratave për komercializim nga AKP-ja.

Të gjitha të dhënat elektronike, siç thuhet, janë fshirë nga AKM-ja, nuk kanë mbajtur bazën e të dhënave për monitorim të këtyre ndërmarrjeve. Përveç kësaj, raportet nuk janë azhurnuar dhe po thuaj të gjitha ndërmarrjet e raportuara vetëm deri në vitin 2007.

Faqe 27, kemi raportin lidhur me Njësinë e Trepçës dhe kjo vetëm për pjesën jugore. Këtu përshkruhen, përveç tjerash, edhe qasja pozitive e menaxhmentit të Trepçës në identifikimin e problemeve të shumta, fillimin e riorganizimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjes me qëllim të rritjes së produktivitetit të punës në Trepçë, duke zbatuar metoda moderne të menaxhimit përmes planifikimit, organizimit, udhëheqjes dhe kontrollit, duke përqendruar kështu përpjekjet e saj në rritjen e stabilitetit financiarë të ndërmarrjes dhe rritjen e të hyrave duke zvogëluar humbjet, gjë e cila edhe është arritur, që shihet tek tabela krahasuese vijuese, faqe 29 dhe 30, ku shihen përqindjet e rritjes në vitin 2009 karshi vitit 2008.

Përveç kësaj, AKM ka hasur edhe në pengesa të tjera, siç është Fondi i ngrirë i privatizimit, mandej pengesat ligjore, mungesa e projektligjeve financiare, si ajo e letrave me vlerë e tjera.

Mandej, mosmarrëveshjet me Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, që shpesh ju kanë sjellë telashe, nuk është funksionale e as në shërbim të agjencisë, as në proces të privatizimit.

Problem në vete është edhe rasti i Trepçës, që është nën moratorium, e cila ka edhe dhjetëra ndërmarrje të tjera që janë asete thelbësore dhe sociale që nuk kanë të bëjnë asgjë me miniera. Mirëpo, moratoriumi e ka përfshirë edhe atë. Në shikim të parë, ky moratorium mund të konsiderohet edhe si ombrellë, po nga ana tjetër kjo pengon në zhvillimin ekonomik në ato qytete ku ndodhen këto asete të mbajtura me vite nën moratorium, prandaj nga ky elaborim që i është bërë këtij rasti, AKP ka dalë me rekomandime shumë të thjeshta.

Nën një, asetet të cilat nuk kanë të bëjnë me miniera duhet të privatizuar sa më parë që të mos mbahen peng në vendet ku ndodhen këto asete. Identifikimi i kreditorëve të vërtetë, të dihet shuma e borxhit. Mandej, Qeveria të bëhet kreditor ose pronar dhe thuhet se është duke u punuar në këtë qasje për ndërtimin e një strategjie me të cilën është formuar edhe një task-forcë që të merret kryesisht me këto çështje që u cekën më lart.

Përveç tjerash, ka ndryshime pozitive edhe tek çështja e sigurimit të konkurrencës, përkatësisht duke eliminuar të ashtuquajturën kurdisje të ofertave. Ky është ndryshim i madh në mes të AKM-së dhe AKP-së, që më parë ka qenë, ku në një tender janë përzgjedhur tre ofertues, ka ndodhur që është tërhequr i parë, është tërhequr edhe i dyti dhe ka fituar ofertuesi i tretë. Kjo gjë tani është eliminuar, sepse çmimi i parë gjithmonë fiton, do me thanë vlerën e cakton tregu dhe duhet ta ruajmë vlerën.

Mandej, qasja, gatishmëria. Në rastin e zgjidhjes së ndërmarrjeve të Gjakovës është edhe një e dhënë tjetër pozitive, ku dihet që për 7 vjet nuk është marrë askush me këto ndërmarrje. Mandej, listat e punëtorëve, 20%, puna në këtë drejtim edhe me këtë çështje nuk është marrë askush për 7 vjet, pavarësisht gatishmërisë të AKP-së për t'ju qasur këtij problemi. Sipas asaj që thuhet në raport, kanë pritur 9 muaj nga ICO për të emëruar përfaqësuesin e tyre dhe, më në fund, iu kanë thënë se mund të vazhdoni punën edhe pa përfaqësuesin tonë.

Në fund, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet raportin dhe beson se AKP i ka kryer punët e veta mirë. Rekomandon që sa më parë që është e mundur të iniciohen, të bëhen ndryshime në legjislacionin aktual lidhur me aktivitetet e AKP-së, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Këto ndryshime të domosdoshme në

ligjet aktuale kërkohen që të mundësohet funksionimi i duhur i AKP-së dhe të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Kosovë, e cila pa dyshim do ta përshpejtojë procesin e privatizimit, veçanërisht të likuidimit dhe shpërndarjes të 20% për punëtorët, duke lejuar AKP-në të përmbushë mandatin e saj brenda afatit kohor të caktuar, siç thuhet, edhe në këtë raport.

Në fund, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që ta mbështetni raportin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, i cili është mjaftë mirë i detajizuar dhe në mënyrë shumë profesionale i prezantuar.

Bordi i AKP-së në raport paraqet vështirësitë me të cilat ballafaqohet dhe të cilat janë të shumta. Veçanërisht vlen për t'u theksuar mosfunksionalizimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që vërtet e vështirëson punën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

AKP-ja kërkon që urgjentisht të ndryshohet ligji, legjislacioni aktual, në mënyrë që puna e saj të jetë ashtu siç edhe kërkohet sipas statusit, gjegjësisht sipas Pakos së presidentit Ahtisari.

Nga raporti është theksuar se AKM-ja ende funksionon, kështu që AKP-ja ka vështirësi në kryerjen e detyrave për shkak të pengesave dhe dualizmit që paraqiten në mes të AKP-së dhe AKM-së. Vërtet është e paqartë dhe e pakuptueshme që AKM-ja ende funksionon, kur dihet se sipas ligjit AKM-ja është dashur që t'i bartë të gjitha kompetencat tek AKP-ja.

AKP-ja, problematike paraqet edhe situatën për furnizimin me të dhënat kadastrale nga ana e komunave, gjegjësisht njërive komunale që kanë qenë të përfshira në masën e komasacionit të tokave për shkak të keqpërdorimit të dokumenteve kadastrale nga ana e zyrave lokale kadastrale dhe gjykatave lokale.

Në raport theksohet në mënyrë të veçantë zgjidhja e statusit të ndërmarrjeve shoqërore dhe komunale të komunës së Gjakovës dhe të komunës së Drenasit.

Vërejtje tjetër edhe në raport, ku është dhënë nga ana e Bordit apo e kryetarit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, është çështja e mjeteve financiare të cilat mblidhen nga privatizimi, e që AKM-ja nuk ka asnjë informatë se ku gjinden, kështu që kërkohet nga Banka Qendrore e Kosovës dhe AKP-ja të kenë një bashkëpunim, në mënyrë që të mos krijohet huti në opinion mbi gjendjen dhe vlerën e mjeteve të privatizimit.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah Raportin dhe inkurajon AKP-në që të kryej detyrën sipas ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar i vetmi ministër këtu, po unë do t'i përshëndes edhe ata ministra që janë në zyrë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti për Agjencionin Kosovar të Privatizimit është një raport që është hartuar konform udhëzimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik.

Ky raport sjell informata për problemet që e kanë përcjellë këtë agjencion, por për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës janë shqetësuese këto probleme:

Raportit i mungon informata në mënyrë detale për mjetet se ku janë investuar 403.545.000, do të thotë mjete këto të cilat nuk dihet se as ku janë, as ku janë të investuara dhe në çfarë kamate janë të investuara. Atëherë, sa gjysma e buxhetit të Kosovës para të gatshme, që janë shumë të nevojshme për ekonominë e Kosovës, Agjencioni nuk di se ku janë.

Një problem tjetër që raportit i mungon, është analiza kualitative e privatizimit në këtë periudhë raportuese. Për shembull, për Trepçën janë dhënë të dhënat për njësitë e prodhimit, por nuk janë dhënë çmimet që janë në se ka pasur ngritje të mëdha të këtyre metaleve dhe nuk janë dhënë këto çmime, të dimë se Trepça si është duke funksionuar. I kemi parë protestat e fundit të punëtorëve se sa mirë është duke funksionuar Trepça nën udhëheqjen e këtij agjencioni. Prandaj, duhet të ndërmerren masa shumë të shpejta me qëllim që ky gjigant të fillojë punën ashtu siç duhet.

Një problem tjetër, që do a kisha cekur, janë edhe mjetet e harxhuara, 12.715.000 kryesisht agjencionit i ka harxhuar për paga dhe mëditje, çka do të thotë se ndoshta mesatarja e pagës në agjencion është diku mbi 1200 euro, çka do të thotë që është një shumë mjaft e madhe dhe më mirë do të kishte qenë që këto mjete të investohen, që të funksionojë ky agjencion më mirë.

Një problem tjetër që do ta kisha theksuar, është kthimi shumë i ngadalshëm i 20%, ky 20% i cili duhet t'ju takojë punëtorëve dhe kemi raste të shumta që punëtorët janë duke vdekur dhe duke mos e shfrytëzuar këtë 20%...

KRYESUESI: Regjia, ziles për kuorum, përndryshe do ta ndërpres!

...Nuk është problemi vetëm i gjykatës speciale, por është edhe një problem tjetër se tani në fabrikën, Birrarinë e Pejës filloi kthimi 10%, ndërsa 10% tjetër lehet për një afat tjetër. Pse nuk kthehet edhe 10% tjetër dhe të kryhet ai obligim që e kanë ndaj punëtorëve.

Problem tjetër është edhe problemi i privatizimit me spinoff special, ku këtë problem e ka trashëguar nga AKM-ja dhe problemi i fundit është i Llamkosit, ku këtë organizatë e kanë prurë në një situatë që pas ritenderimit të mos konkurrojnë askush që ta blejë organizatën e Llamkosit, do të thotë se këto i ka bërë dikush me qëllime të caktuara po për përfitime të caktuara dhe nuk është bërë një analizë shumë e mirë në këtë raport.

Prandaj, nga kjo konkludojmë se duhet të bëhen ndryshime të mëdha në Ligjin për privatizimin, me qëllim që të shpëtohet aq sa mund të shpëtohet.

Prandaj, Grupi i Aleancës nuk e përkrah këtë raport dhe si konkret do të thotë që duhet të bëhen ndryshime të Ligjit mbi privatizimin, me qëllim që të shpëtohet ajo që mund të shpëtohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i ARK-së e ka shqyrtuar Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit për vitin 2009 dhe mund të thuhet se në këtë raport është paraqitur një pasqyrë e punës së departamenteve brenda këtij Agjencioni Kosovar të Privatizimit, ku njëkohësisht ata përballen edhe me mungesën ligjore për arsye të nxjerrjes së Ligjit mbi AKP-në, i cili gjatë përkthimit nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ka mangësi marramendëse dhe këtu paraqiten problemet. Mirëpo, raporti si raport mund të thuhet se vetëm ka përshkruar gjendjen dhe jo të jepet alternativa çka do të ndodhë me ndërmarrjet të cilat kanë probleme në këtë rast dhe cilat janë rekomandimet të cilat në të ardhmen ky raport i AKP-së mund t'i plotësojë, që në raportin e vitit 2010 të jetë një gjendje më e mirë.

Mund të them se gjatë shqyrtimit të këtij raporti është parë mjaft mirë se si ka përfunduar gjendja e 20% të punëtorëve, që do të thotë akoma janë listat të papërfunduara dhe gjendja e punëtorëve është ajo që është dhe dihet mjaftë mirë se shumë njerëz të cilët kanë lënë vendet e punës nga ky privatizim i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, ata sot edhe kanë vdekur akoma pa e marrë 20%.

Çështja e ndërmarrjeve shoqërore të cilat paraqiten në rastin shumë të freskët në Sharcem në Han të Elezit, ku operatori apo operatori ekonomik, më mirë të themi operatori zviceran ndërrohet me operator grek dhe ndotja e ambientit në këtë lokacion bëhet aq e madhe dhe ky operator ekonomik as nuk paguan taksa për shtetin e Kosovës dhe njëkohësisht përfitimet e tij janë marramendëse, në këtë raport nuk përfshihen aq mirë, gjë që të jep për të kuptuar se diçka është këtu kah fshihet.

Çështje tjetër është çështja e ndërmarrjeve shoqërore në Gjakovë, ku është çështje shumë e nxehtë, çështja e Trepçës, ku definitivisht mund të jem këtu më transparente, është çështja e Memorandumit për arsye të Rregullores 2005/48, e cila pritet të ndërrohet nga Qeveria e Kosovës dhe akoma nuk është ndryshuar. Janë disa të dhëna në ndërmarrjet e privatizuara me spinoff special, ku shihet se politikat kanë qenë jo të qarta për dhënien e këtyre ndërmarrjeve shoqërore me spinoff special dhe forma e privatizimit është bërë në atë metodë që qytetarët e Kosovës nuk kanë përfituar, as shteti i Kosovës nuk ka përfituar dhe tash paraqiten problemet e njëpasnjëshme.

Çështja e Brezovicës gjatë raportimit nga Bordi i AKP-së thuhet se Komisioni Evropian është duke bërë një master - plan për zonën turistike, si do të privatizohet kjo pjesë e Kosovës, dhe AKP-ja është kah pret nga Komisioni Evropian master - planin për zonë turistike. Master - plani për zonë turistike është dashur të bëhet vetë nga Bordi i AKP-së dhe AKP-ja zgjedh brenda Kuvendit të Kosovës, ndërsa çështja e mjeteve të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore gjatë raportimit të bordit të AKP-së brenda Komisionit është thënë se ata nuk e dinë ku janë mjetet e deponuara, kur dihet mjaftë mirë se mjetet e deponuara të ndërmarrjeve shoqërore kanë shkuar nëpërmes BQK në institucione jashtë vendit dhe këtu kërkohet nga qeveria që me një ligj të aprovuar brenda Kuvendit të Kosovës dhe Ligjin për letrat me vlerë që këto të holla, me një plan të mirëfilltë për

zhvillimin ekonomikë të Kosovës, të kthehen në Kosovë. Mirëpo, siç po shihet, nuk janë të interesuar, janë të interesuar për çështje të tjera dhe, definitivisht, raporti si raport me gjithë këto vërejtje, unë nuk mund të them se mund t'i jap dritën e gjelbër për miratim brenda Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti kryesues,

Në fakt, tema e privatizimit apo procesi i privatizimit dhe në këtë raport që po e shqyrtojmë do të duhej të mos kalojë në formën e trajtimit të debateve apo të qasjeve të ndryshme, siç jemi mësuar në shumë raporte tjera, për vetë faktin se kemi të bëjmë me një proces më të rëndësishëm, që është pritur shumë dhe më së shumti kanë pritur qytetarët e Kosovës se do të ndryshojë realiteti në kuptimin e perspektivës apo të mundësive më të mira për një jetë normale.

Ajo çka nuk do të duhej sot të trajtohej kjo temë apo ky raport në formën e raporteve, qysh janë trajtuar të tjerët, të mos trajtohet në aspektin teknik, se kemi të bëjmë me një raport përmbajtësor, gjithëpërfshirës, i përgatitur mirë apo diçka të ngjashme.

Ajo çka është esenciale të theksohet se pas dy viteve e gjysmë thuaj se tash të pavarësisë së vendit, nuk ka rishqyrtim të politikave të privatizimit, vazhdojnë rregulla të njëjta të privatizimit dhe vetvetiu do të lindë një pyetje – a ka shkuar privatizimi në rregull, a ka prodhuar ato rezultate çka kanë qenë të pritura nga qytetarët e Kosovës dhe vetë nga pjesa politike.

Ajo çka mund të themi sot lirisht, se privatizimi deri tash apo procesi i privatizimit quhet një storie apo një tregim i keq që do të merret shembull nga shumë vende, do të merret shembull se si nuk do të duhej të ishte. Në fakt, thjeshtë privatizimi nuk ka qenë apo ky proces në funksion të nxitjes dhe të zhvillimit ekonomik të vendit. Dhe, deri tash, pas privatizimit, me qindra ndërmarrje shoqërore, vetëm në gishta mund t'i numërojmë dhjetëra sosh apo dhjetë sosh të tilla, të cilat janë treguar të suksesshme pas procesit të privatizimit, në një. Tjerat ose kanë falimentuar, ose janë treguar të pasuksesshme.

Ky proces është karakterizuar me shumë defekte. E para, ka pasur pak investitorë, ka pasur shumë vonesa, ka pasur mospërbushje të premtimeve të blerësve, pastaj vonesa në shpërndarjen e 20% të punëtorëve, çmimet kanë qenë të lira. Kur themi çmimet e lira, do të duhej të ishte shumë brengosëse për ne që ka të bëjë me rregullat dhe politikat e këtij procesi të privatizimit. Bordi i këtij Agjencioni, sipas nenit 15 pika (b) të ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, është përgjegjës për miratimin e politikave operacionale dhe nuk mund t'i ikë përgjegjësisë për asnjë moment para këtij Kuvendi organi që i ka nxjerrë.

Ka qenë dhe mbetet kontraproduktive për ekonominë e Kosovës, ku pjesa dërmuese e këtij procesi është kryer me spinoff të rëndomtë, çka nuk ka pasur, çka blerësi në fakt nuk ka pasur kurrfarë obligimesh ndaj punëtorëve, nuk ka pasur kurrfarë obligimesh që të investojë dhe nuk ka pasur kurrfarë obligimesh që ta ruaj distilimin e veprimtarisë së asaj ndërmarrjeje.

Për fat të keq, ky proces i privatizimit i ka gjeneruar ato mjete të cilat nuk janë në funksion të zhvillimit ekonomik sot e asaj dite. Dhe, është e pakuptueshme se krejt ndërmarrjet publike të cilat janë privatizuar në Kosovë e arrijnë një vlerë e cila mund të reflektohet sa gjysma e një kompanie që është privatizua në rajon. Mund ta merrni me mend, krejt ekonomia e Kosovës po vleka sa një ndërmarrje e cila në shtetin fqinj, ndërmarrje e duhanit, është privatizua 700 milionë euro, sipas një procesi, politikat e privatizimit të cilat vetë shteti përkatës i ka bërë. Dhe ne, mbas dy viteve e gjysmë të pavarësisë ende vazhdojmë se kemi rezultate pozitive, ka dhënë këto frute dhe do të pajtohemi me kaq.

Unë mendoj dhe si grup parlamentar jemi të bindur se është momenti i fundit që të ndryshohen këto politika. Është e pakuptimtë, është e pakuptimtë në qoftë se vazhdohet me këtë trend dhe të themi se krejt ekonomia e Kosovës po vlejta gjysmë miliardi. Po ashtu, kemi edhe shembuj tjerë në rajon, kur nuk kanë shkuar me privatizim klasik, të rëndomtë apo special, si po e quajnë tash kjo pjesa tjetër, po ka pasur me privatizim të aksioneve dhe kemi shembuj konkretë, kur kompanitë prestigjioze kanë investuar. Nuk po i përmendi me emra për arsye se i dini të gjithë, mirëpo ajo çka është esenciale, si komision funksional i cili i drejtohet Kuvendit të Kosovës, të miratohet ky raport dhe pikë. Do të ishte shumë e rrugës të miratohet me rekomandimet përcjellëse, është pozitive që Komisioni për Buxhet ka një rekomandim që duhet të ndryshohet, do të marrë një nismë për ndryshimin e Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, mirëpo me kaq nuk mjafton. Politika të cilat i merr, i aprovon dhe i harton ky bord i agjencionit, duhet të jenë përgjegjëse, kompatible me realitetin, realiteti është i hidhur. Procesin e privatizimit në Kosovë mund ta quajmë se është proces i dështuar në kuptimin e pritjeve që kanë pasur qytetarët e Kosovës. Nuk ka gjeneruar punësim, nuk ka gjeneruar mjete të cilat i kanë pritur dhe, përkundrazi, mund të themi se duhet përfundimisht Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë përfundimisht këtë proces për arsye se jemi përball një procesi të privatizimit të gjigantëve ekonomikë, siç është KEK-u, është Posta, kemi të bëjmë me minierat dhe të gjitha këto do të duhej të trajtohen në një kënd shumë më serioz sesa tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka kërkuar deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Hvala i jedinom predstavniku Vlade, koji dolazi iz redova manjinskih zajednica. Ovo je samo dokaz sa koliko pažnje pristupamo analizi oblasti kada je u pitanju Izveštaj o privatizaciji. U nekim parlamentima ovo je top tema oko koje se okupljaju i eksperti, i stručnjaci, u kojoj se reflektuje briga mnogih radnika koji prilikom privatizacije ostanu sa neostvarenim svojim pravima u firmama u kojima su proveli godine ili decenije rada.

Mislim da je izveštaj pokušavao da bude objektivan i detaljan, ali se nama u praksi potkradaju greške gde se, recimo, posebno oblast nadoknade zaposlenima u bivšim javnim preduzećima ili firmama nije dovoljno obrađena. Ja delimično delim mišljenje prethodnog izlagača i drugih mojih kolega i mislim da u ovoj oblasti na neki način, samim tim što ovu temu stavljamo u završnu tačku parlamentarnog zasedanja, obezvređujemo oblast o kojoj razgovaramo.

Ja, u ime parlamentarne grupe kojoj predsedavam, iznosim ovu primedbu kao realnu, argumentujem je time da se ovde radi o sudbini zaposlenih koji su stvarno dali ono što privatizujemo. Ja ne bih želeo da politizujemo ovde, ali je činjenica da ovoj temi prilazimo sa nedovoljno pažnje. Stalno govorimo o nezaposlenosti kao rak rani društva,

ne samo naše države, a kada su u pitanju pokušaji da i na ovaj način pomognemo istima, njima mi evo zasedamo u polu praznoj sali i bez predstavnika vlade.

Mislim, zaista, mi ćemo u načelu podržati ovaj izveštaj sa svim manjkavostima koje navodim, ali bih voleo da se sa malo više pažnje posvetimo ovoj vrlo značajnoj temi u kojoj se obezvređuje ono što je decenijama stvarao. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet, hvala! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kemi të paraqitur. Në emër të Grupit për Integrim, fjalën e ka kërkuar deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa, ponovo na datu reč!

Ponovo imamo pred sobom jako važan izveštaj Agencije za privatizaciju, koji ima po zakonskoj obavezi da da jednom godišnje. Ovo je drugi po redu izveštaj, i kada je u pitanju sam izveštaj, mi smo ga pažljivo pročitali i analizirali i došli smo do zaključka da se izveštaji i Agencija opet bave dosta samim sobom, da se ne bave sa situacijom, da oko privatizacije nemaju konkretne mere i zadatke.

Zašto ovo kažem? Vidimo, prvo, Agencija se dobro bavi sa organizacionom strukturom, gde nam se daje do znanja da se sastoji od borda, od Divizije za prodaju imovine, od Divizije za korporativne uprave i od Izvršne divizije. Sve ove divizije imaju svoje sektore i svoje jedinice, i ja bih se malo više zadržala na Diviziju prodaje imovine, gde u svom sastavu ova divizija ima Odeljenje za prodaju i Odeljenje za likvidaciju.

Znamo da je ova Agencija osnovana na ime regulative UNMIK-a, kasnije regulative Vlade i da je namenski osnovana da bi zaštitila društveni kapital i društveni sektor sa namenom za privatizaciju radi boljeg angažmana i nastupa samih aktera na tržištu. Međutim, šta se ovde dešava? Dešava se, ja moram da kažem, iz analize same Agencije, gde nam daje do znanja kada je u pitanju prodaja, znači da imamo metode, kao što su prodaja običnim spinoffom, prodaja posebnim spinoffom i dekapitulizacija društvenih preduzeća. To su tri načina na koja ova Agencija može da deluje. Međutim, kada je u pitanje razmatranje kako je ova Agencija delovala, mi znamo da je bila preneti prvo Kosovska Agencija za imovinu, sada Kosovska Agencija za privatizaciju i da je praktično nasledila istoimenu agenciju, za mene, samo što se regulativa UNMIK-a i Vlade Kosova menjala.

Moram da kažem da kada imamo pred sobom liste, što je mnogo važno, liste prodatih preduzeća, običnim, posebnim spinoffom, moram da kažem da se obrati pažnja. Agencija je u 2009. godini, konkretno imala izdate 114 liste prodatih preduzeća i utvrđenih radnika sa liste koji koriste 20% po zakonu od prodatih sredstava. Od toga je Agencija podmirila samo 19 liste. 19 liste, mi nismo ni 10% podmirili radnike sa 19 liste. A kada gledamo broj radnika, to je 92 radnika, a nije isplaćeno na hiljade radnika. Šta je to? Ako je Agencija prodala preduzeća po ovim metodama, to su odložena sredstva kao što imamo, kada se bavi o Fondu za privatizaciju, gde su odložena sredstva u Fondu za privatizaciju, poverenička sredstva, i ta sredstva znamo 80% su u namenski u fondu, 20% se izdvajaju na posebnom računu za isplatu radnika.

Ja sam više puta ovde potencirala da se Agencija i Vlada malo više bave sa metodom, da kažem analizom ugovora kako se preduzeća prodaju. Dali, kada je u pitanju država, sada Vlada Kosova, ispunjava uslove preko Agencije, kada su u pitanju radnici za isplatu. Zašto se na vreme ne isplaćuju sredstva i zašto se ta sredstva obrću. Ja ću da

budem mnogo iskrena i da kažem zašto se sa tim sredstvima vrši manipulacija, da ne kažem praktično obično kockanje. Zašto ovo kažem? Evo, imamo listu na stranici, moramo malo da budemo ozbiljni i pažljivi kada slušamo i kada čitamo ove izveštaje. Imamo listu svih poverenika koji su dobili preduzeća na više godina. Ja neću da zamaram parlament sa pojedincima, ali od ukupne liste, stranica 51. znači tamo gde je Kosovska agencija za privatizaciju dala u nadzor preduzeća, imamo datum potpisivanja ugovora, datum isteka ugovora, imamo obaveze investitora za investicije i imamo obaveze koje su ispunjene obaveze koje nisu ispunjene.

Zamislite, od posebnog spinoffa 12.000.000 su obaveze imali investitori, od toga je ispunjeno samo 7 miliona. Ko su ovi investitori, zašto nisu ispunili svoje obaveze? Kada je u pitanje zaposlenje radnika, isto je to polovina. U pitanju je bilo 88.490 zaposlenja radnika, od toga je samo zaposleno 50%, 46.000. Znači, nisu ispunjene obaveze. Da li se vodi računa o ovim ugovorima i ovim investitorima koji koriste društvena sredstva, društvena preduzeća, bogate se na ovom tržištu a osiromaše građane čija je to imovina.

Dalje, ista obaveza kada je u pitanju poseban spinoff od 194. miliona, koje su obveznici koji su dobili preduzeća, investitori dobili, ispunili su ispunjeno, (to je stranica 53.) prijavljeni iznos investicija i ispunjeni iznos je samo 115.miliona, 194. znači za 48%, 50% nisu ispunjeni uslovi. Da li se ova Agencija i ova Vlada bavi sa ugovorima, sa analizom ugovora, pod kojim uslovima su data preduzeća, šta treba ona kao obavezu da imaju, investicije plaćanje u fond i ostalo i dalje zaposlenje i ostalo, to je jedno. Drugo, što moram da kažem, kada je u pitanju sam fond, pošto nemamo puno vremena, kada je u pitanju sam poverenički fond ove Agencije, ja hoću da kažem da dam do znanja da pažljivo pogledamo stranicu, sada, samo malo da nađem stranicu, evo ovako: sredstva, sredstva molim vas, sredstva na početku su bila 528.000.040. To je Poverenički fond Agencije. Sada su sredstva 413, 451 od ukupnog prijema, to je stranica 57. Od ovoga, od ovih sredstava moramo da znamo koji je Poverenički fond od 80% , sredstava od 528, koja su sredstva od 20%, koja su sredstva podeljena i zašto u zaostatku ta sredstva nisu podeljena, ako su izdvojena. Zašto se sredstva građana po 5-6 godine obrću na ime kamate, a ti isti građani čekaju svoja sredstva. Ovo je veliko pitanje i ne može više niko na Kosovu, da kažem, oduzme stečeno pravo radnika koji su u procesu privatizacije, zakonskim putem imaju pravo na 20%. Ta sredstva moraju praktično da se malo više nadgledaju, da imaju reviziju i uopšte ovaj fond. Praktično, sada kada vidimo, 150 i nešto miliona je izdvojeno od Povereničkog fonda, 150 miliona, mi moramo da znamo gde su izdvojena, zašta, gde su, u kojoj banci, namenski, ovo moramo da radimo praktično, jer mi javnim novcem, mi smo poslanici koji ovo pogledamo, prećutimo i odobravamo. Ja moram da kažem svim kolegama ovde da je ćutanje odobravanje. To nisu mala sredstva, 152 miliona su izdvojena, i samo imamo opis na ime transfera, na povereničke račune od likvidacije. Koji računi, koji su to poverenički računi? Poverenički računi su računi koji se čuvaju u banci. U kojoj banci? Molim vas, ova Agencija nam je dala štire izveštaje, nije nam dala poverenike, nije nam dala gde se sredstva čuvaju, nije nam dala gde su ukupna sredstva od 429.000.000, i moramo u ovoj matematičkoj zamci, gde su sredstva bila 500 i nešto miliona, gde je uplet, opet ja moram da kažem, gubljenje sredstava kao kod fonda za Penzijsko i invalidsko osiguranje.

Mi moramo da znamo, ako smo namenski izdvojili ovo za kapitalne investicije, Vlada treba ovde da napravi rebalans budžeta i da nam kaže – ova sredstva su izdvojena namenski za ovo i građani...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Këtu kemi mbaruar me përfaqësues të grupeve dhe kalojmë te deputetët e paraqitur për diskutim.

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet deputetja Suzan Novobrdaliu.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, për këta që janë këtu, se edhe ashtu shpeshherë po mbesim shumë më pak se që është dashur të jemi në sallën e Kuvendit. Sigurisht janë duke punuar diku, por nuk është konflikt interesi.

Unë do të futem drejtpërdrejtë në raport, në raport në faqen 13, ku flitet për Njësinë e kadastrave, edhe po e lexoj vetëm një fjali, që është shumë me rëndësi, thotë: “më shumë paqartësi për shkak të keqpërdorimit të dokumenteve kadastrale nga zyrat lokale kadastrale dhe gjykatat komunale”. Të nderuar, ne kemi shumë raste, posaçërisht në komunën e Prishtinës, ku toka e komunës është zhdukur. Me fjalë tjera, nuk ekziston, ose është privatizuar. Nuk po flasim për 1 milionë, për 2 milionë, po flasim për një vepër që mund të llogaritet me qindra milionë. Në rast se Agjensioni Kosovë i Privatizimit e ka identifikuar se ka manipulime në zyrat lokale kadastrale dhe probleme në gjykatën komunale, unë publikisht po e them se mirë është të bëhet një ftesë jo veç prej Qeverisë me task-forcë, por ndoshta edhe prej Interpolit të këqyrim, se po flasim për shumë para, për shumë të hatashme të mjeteve.

Rasti, për shembull, më i freskët, që kush nuk e di mbi cilën bazë është privatizuar, janë 11 hektarë të të quajturit - Fshati amerikan. Çka më kufizon mua të mos me e marrë edhe unë njëjtë, pse mos të bëhen publik emrat se kush i ka blerë shtëpitë ndoshta me 5-600 mijë euro atje, e shumë e shumë raste në komunë të Prishtinës, ku toka nuk ekziston. Toka në qendër të Prishtinës, po flasim për një ari – 40.000, 50.000 euro. Rastet e fundit, vetëm një rast që më shtyri të mendoj për këtë, ka qenë rasti me Qendrën Klinike Universitare. Është publikuar në “Koha Ditore” dhe në televizione tjera publike se janë avulluar, toka nuk është avulluar, por e ka ndërruar pronarin 6-7 hektarë dhe raporti, këtu po thotë se janë keqpërdorë dokumentet kadastrale dhe zyrat lokale kadastrale dhe gjykatat komunale. Dikush duhet të japë përgjegjësi. Nuk mjafton vetëm të keqpërdoret sentimente emocional e të vazhdohet me keqpërdorim. Sentimenti emocional është i ndarë nga fusha e drejtësisë. Publikisht po bëjë ftesë për t’u futur në investigim të thellë nëpër gjykata komunale, posaçërisht në Gjykatën Komunale të Prishtinës, ku vlera e tokës është shumë, shumë fish më e madhe se nëpër komunat tjera. Njëra prej brengave të mia në këtë raport, po është edhe brengë e të gjithë qytetarëve, është brengë edhe e njerëzve, posaçërisht ishte dashtë me qenë e Ministrisë e Punëve të Brendshme, e cila merret me hulumtim, por ndoshta tash momentalisht janë të zënë, jo qysh t’i zënë, por qysh t’i mbulojnë, sepse me të vërtetë hetuesit po i kanë problem fjalët direkte, thënë nga një hetues, që nën detyrim e them edhe emrin - nuk është problemi për t’i gjetur, problemin e madh e kemi qysh t’i mbulojmë hajnitë.

Po kthehem tash te faqja 25, te Njësia e monitorimit. Kemi Njësinë e monitorimit dhe flasim për dështime me spinoff, po qysh të vijë deri te dështimi, nuk ka pasur arsye, sepse ka ekzistua Njësia e monitorimit. Me fjalë të tjera, në mënyrë të vazhdueshme e ka përcjellë zbatueshmërinë e planit të biznesit që e ka prur kompania që e ka privatizuar ndërmarrjen shoqërore. Nuk ka pasur të drejtë të vijë deri te një dështim i tillë. Edhe këtu i cek disa prej rasteve, në njërin prej rasteve ceket për spinofin special – Llamkosi. Llamkosi është privatizuar dhe tash në dokumentet vjen situata dhe thonë: e zgjidhëm ne një problem se thamë se Llamkosi do të riprivatizohet, do të riprivatizohet, por po e qesim në privatizim me obligime mbi 10 milionë euro dhe normalisht që askush nuk vjen. Edhe një manipulim shumë i thjeshtë aty se, e qesim mbi 10 milionë euro, kurse

asete ka gjithashtu mbi 10 milion euro, por nëse nuk bashkëpunon me mua, nuk ke mundësi t'i nxjerrësh asetet. Me fjalë të tjera, edhe këtu paraqitet nevoja për t'u futur në një investigim shumë të thellë, posaçërisht në kompanitë me spinoff special dhe të përzgjidhen cilat spinoffe të dalin e cilat mos të dalin, se nëse ke mundësi ti, nëse dikush ka mundësi edhe i mbulon, nuk është transparent në proces dhe ofron, thotë – në rast se nuk bashkëpunon me mua, atëherë do të qesim në riprivatizim, në rast se bashkëpunon me mua, atëherë nuk do të qesim në privatizim. Mundësia është shumë e qartë. E përkthyer në gjuhën popullore, kishte për të qenë – ai që paguan, nuk del prej spinoffit, ai që nuk paguan, del në privatizim. E privatizova, të paguhen mjetet që nuk tatimohen, që ndoshta herë, herë kishte për të qenë mirë edhe të tatohen ato, edhe nëse i merr, bile le ta paguajë tatimin.

Gjithashtu, nuk dua ta harroj rastin e tokave. Rasti i tokave, kemi të bëjmë me një trashëgimi prej AKM-së. Nuk është çështje e një viti, dy e tri vite, nuk është e asnjë qeverie, asnjë strukturë udhëheqëse, por një faktor shumë me rëndësi, që drejtor i ndërmarrjeve shoqërore në atë kohë ka qenë ministri Ahmet Shala, që është ministër i Ekonomisë dhe Financave. Me fjalë të tjera, drejtësia mund të vonohet, por nuk kemi nevojë na ta pengojmë që të vijë në vend, sepse manipulimi me toka në komunë, nëpër komuna është jashtëzakonisht i madh, jashtëzakonisht i madh. Flet për një industri që ndoshta vlen me 5-600 milionë euro, ndoshta veç në komunë të Prishtinës 100 a 200 milionë euro. Ata që janë marrë me këtë punë, e dinë. Edhe kjo është që del nga raporti i Agjenciës Kosovare të Privatizimit.

Po dalim tash te njësitë tjera, Njësia e monitorimit, Njësia e Trepçës. Në rregull, por këto sa për ta zvogëluar pak, unë desha, e pashë, janë nënshkruar Memo, nuk është rasti veç me Trepçën, është edhe me ministrinë tjera. Unë, personalisht nuk mund ta kuptoj qysh nënshkruan Memorandum të mirëkuptimit ministria me ministri, e njëjta Qeveri. Për çka? Veç sa për të bërë një banket, një tabelë suedeze, për t'i ndërruar dy-tri gota, të dilet në televizion, nuk ka kuptim, ky është manipulim. Edhe 10 euro në shkofshin për atë banket, edhe 10 euro janë keqpërdorim. Nuk ka mundësi të bëhet memorandum mirëkuptimi një ministri me një ministri tjetër, një ndërmarrje me ministrinë tjetër, janë obligative. Ministria e Energjisë dhe Minierave është obligative të bashkëpunojë me ndërmarrjet të cilat operojnë në fushën e minierave dhe të energjisë. Është obligative, e ka me përshkrim të detyrave të punës. Por, këto janë gjendje qesharake, që herë, herë të lënë për të kuptuar – a thua si mendojnë këta njerëz në të vërtetë në politika ekonomike. A ka mundësi që të trajtohen, të punojnë vetëm nga këndë vështrimi si të duken më mirë. Nuk është rasti veç i Trepçës, është rasti edhe i ministrive tjera. Nuk e kuptoj qysh bëjnë, unë personalisht nuk e kuptoj qysh bën, për shembull, një ministri në të njëjtën qeveri memorandum mirëkuptimi me një qeveri tjetër... E keqe, kjo po na prek nga pak edhe në kulturë organizative të krejt shoqërisë së Kosovës.

Gjithashtu, shpesh është përdorë një slogan, një slogan shumë i përdorshëm edhe vend e pa vend, ka kaluar koha e ekonomisë së planifikuar, ata që kanë qenë me sistemin e kaluar, nuk do t'ju vijë koha, nuk ka qenë, vend e pa vend – jemi për ekonomi të hapur të tregut, një slogan, të them, nja dhjetë fjali. Po këtu, kur të kthehemi, vepra është e ndryshme. Për shembull, në faqen 28, e kemi Bordi i Postës dhe Telekomit të Kosovës, duke parë gjendjen e vështirë, që me të vërtetë është gjendja e vështirë në Trepçe, i dhuron 80 mijë euro mjete monetare. Por, kjo pikërisht është ekonomia e planifikuar. Kush ka pasur të drejtë të vendosë me para publike. Me fjalë të tjera, tjetër çka flitet, tjetër çka veprohet. Nëse është ekonomi e hapur dhe e tregut, mendohet me logjikën

ekonomike, normalisht me vlera demokratike, me vlera që e përshkruajnë ekonominë e hapur dhe të tregut të lirë.

Për të mos e zgjatur, do të kaloj te ndërmarrjet e komercializuara. Edhe kjo mbikëqyret, se unë po dua të dal me një konkluzion standard, me një konkluzion që kishte për të qenë, që buron nga mendja e shëndoshë, që këto raporte të kenë edhe dorën e pushtetit afër. Në rast se ne nuk mundemi vetëm me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të kërkojmë edhe nga institucionet hetuese ndërkombëtare për të qenë afër kur e kemi punën me komercializim, kur e kemi punën me spinoff, sepse mundësia për manipulim është jashtëzakonisht e madhe, është shumë e madhe. Për shembull, po e marrim Sharrcem-in. Publikisht është dalë dhe është thënë dy tri herë që komercializimi do të përfundojë në qershor të vitit 2010. Fjala publike e ka peshën e vet. Në rast se personi publik e thotë, atëherë unë i besoj, sepse ne nuk kemi mundësi t'ua këqyrim dokumentet brenda, kurse këtu raporti, raportohet se përfundon më 24 qershor 2011...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet, fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sa herë që në këtë Kuvend është diskutuar për raportet e AKM-së, edhe tani të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, njëra ndër çështjet kryesore që e kanë karakterizuar çdo debat, ka qenë politika e privatizimit. Rrjedhimisht, besoj se edhe sot shumë e rëndësishme është që të diskutojmë për politikën e dëmshme privatizuese që po i vazhdon ky agjencion, sesa për punën teknike të tij, e cila është e pasqyruar, e përmbledhur në këtë raport, sepse edhe sot dhe gjithnjë do të merremi me këto politika privatizuese pasi që janë politika që nuk i kanë sjellë të mira qytetarit të Kosovës.

Ajo që është shumë e rëndësishme, e që as në këtë raport, sikur edhe në raportet tjera paraprake që i janë paraqitur këtij Kuvendi, nuk është bërë e qartë, janë çështje të cilat na shqetësojnë neve dhe qytetarët e këtij vendi. As sot e kësaj dite ne nuk e dimë se çka po ndodhë me të hyrat nga procesi i privatizimit, ku janë ato, a janë të sigurt dhe, për më tepër, pse nuk po kthehen dhe të investohen në Kosovë për zhvillimin ekonomik të këtij vendi? Madje, edhe pse po vonohet përfundimisht dhe pafundësisht kompensimi i punëtorëve të atyre ndërmarrjeve, apo mos dikush po gjeneron të hyra dhe po i zhvillojnë bizneset e tyre me mjetet e 20% që ju takojnë punëtorëve kosovar. Fatkeqësisht, këto pyetje vazhdojnë të mbesin pa përgjigje, sepse ky vend, me ndihmën e ndërkombëtarëve, bëri përzgjedhjen e politikave të gabuara për privatizimin e pronës shoqërore, ndërsa edhe sot Qeveria jonë po vazhdon po me ato politika, derisa ekonomia e këtij vendi po shkon drejt shkatërrimit të plotë.

Aleanca Kosova e Re gjithmonë ka qenë e zëshme për politikën e keqja privatizuese që po përdorë Kosova, duke ofruar edhe alternativa se si duhet të zhvillohet ky proces jetik për vendin. Edhe sot, ne si deputetë të AKR-së, do të jemi në këtë linjë politike që e ka ndjekur AKR-ja që nga fillimi i privatizimit, sepse vlerësojmë se kjo që po vazhdon, është e dëmshme dhe shkatërruese për të ardhmen e këtij vendi.

AKR-ja është për privatizim të pronës shoqërore, por forma e privatizimit duhet të jetë e atillë që të ndikojë direkt në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, në stimulimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në zbutjen e varfërisë dhe, mbi të gjitha, në rritjen e punësimit. Procesi i privatizimit është pjesë përbërëse e reformave ekonomike që

duhet të implementohen me një kujdes të veçantë. Privatizimi duhet të shënojë menjëherë impakt pozitiv. AKR-ja gjithmonë ka kërkuar një zot shtëpie, në këtë rast pronarin për çdo gjë, tani edhe për pronë private. Mirëpo, transferi i pronës prej asaj shoqërore në atë private duhet të përcillet me një kujdes dhe ekspertizë të madhe. Vlerësoj se kjo duhet të ndodhë, bazuar në rregullin - para se të shitsh, ngritja vlerën dhe mos të trajtohet diçka sikur është e braktisur.

Agjencioni i ri i privatizimit – AKP-ja, nëse do të gjenerojë mirësi për qytetarin e Kosovës dhe për ekonominë e saj, duhet të ndalë dorën e mos të veprojë si AKM-ja e dikurshme, por t'i marrë në konsideratë rekomandimet e lartcekura. Të vlerësohet dhe t'i jepet vlera reale objektit për shitje, të punohet drejtpërsëdrejti me blerësin potencial, sipas asaj që është përshkruar më lartë. Të zgjidhet blerësi që garanton ardhmëri ekonomike për atë ndërmarrje, e jo ai i cili do ta kthejë atë në depo apo edhe tokën bujqësore ta kthejë në djerrinë. T'i ndihmohet atij deri te funksionalizimi i tërësishëm me ekspertizën dhe logjistikën e nevojshme nga AKP-ja. Ky ishte një propozim që AKR-ja e ka bërë më herët dhe e përsëritë vazhdimisht, derisa Qeveria dhe institucionet vendimmarrëse të dëgjojnë derisa nuk e kanë shkatërruar plotësisht të ardhmen e këtij vendi. Askush nuk duhet t'i shoh me xhelozë propozimet tona dhe t'i injorojë ato meqenëse janë tonat. Ne duam t'i shërbejmë zhvillimit, pavarësisht se kush është në pushtet dhe pa frikën se dikush po na e vjedh idenë. Qeveria është përgjegjëse e drejtpërdrejtë e politikave privatizuese në Kosovë, prandaj bëj thirrje që të stopohet privatizimi, për së paku 6 muaj dhe gjatë kësaj periudhe të bëhen edhe ndryshimet, plotësimet e Ligjit të privatizimit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka anëtar i Kryesisë, deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Ju faleminderit!

Unë dua të shpreh shqetësimin tim që ne po debatojmë për një raport dhe protagonist kryesor i raportit nuk është në sallë dhe nuk i jepet mundësia që të japë sqarime lidhur me raportin dhe deputetët nuk kanë mundësi që të bëjnë pyetje të drejtpërdrejta për çështjet konkrete të cilat po ngrihen këtu, një.

E dyta, duhet ta kemi të qartë që Ligjin për privatizimin dhe kompetencat AKP-së ia kemi dhënë ne si deputet këtu dhe mirë që u tha, është mirë që në qoftë se ka të meta në drejtim të privatizimit, të ketë nisma për rishqyrtim të ligjit ose të ketë nisma për amendamentim të ligjit dhe të mos ecim me logjikën vërtet që u kritikua nga deputetët e mëhershëm, ndoshta kur ka reagime për akuza të logjikës moniste në trajtim të çështjeve.

Ne, vërtet, edhe tokat, edhe industrinë e Kosovës, mënyra se si është privatizuar nuk është shumë e mirë, nuk është për t'u lavdëruar as ne, as ata që na e kanë imponuar mënyrën e privatizimit të saj, por njerëzit, ata që i privatizojnë, ata i bëjnë pronë të tyre dhe destinacionin ia japin vetë. Ne duhet të mësohemi me këto çështje. Shqetësuese për mua është Ligji që ia mundëson konkurrimin, ndoshta të pa drejtë dhe të pambështetur në aftësitë ose mundësitë financiare për të investuar gjatë procesit të privatizimit dhe pastaj po mbesin, këto fabrika janë shndërruar në depo, në supermarkete të mëdha, bile edhe në lokale ku bëhen ahengje, dasma për t'i shfrytëzuar ato objekte të cilat kanë qenë dikur ekonomi e vërtetë ose dikush ka pritur që të punësohen punëtorët. Prandaj, nisma për ta ndryshuar ligjin është e mirë, por logjika që duhet ta kontrollojmë pronarin, i cili në bazë të ligjit e blen pronën, është e gabueshme sepse nuk ka asnjë mundësi dhe askund në botë nuk kontrollohet pronari i cili e blen pronën dhe destinacionin e ka atë që e ka.

Çështja tjetër, e parasë së investuar nga privatizimi. Mos të bëhemi që nuk dimë. Ne e dimë si ka filluar privatizimi, e dimë pse janë të deponuara ato para dhe për sa kohë do të jenë të deponuara, sepse ne jemi pajtuar për atë çështje dhe dihet se kush e ka të drejtën e kontestimit dhe të kërkesës së këtyre fondeve gjatë gjithë procesit të ankesave, apo jo. Jam plotësisht i informuar lidhur me veprimet që i bëjnë disa nga gjykatat dhe prokuroritë e rretheve, duke përfshirë këtu edhe njerëzit të cilët punojnë në këto agjencitë komunale të kadastrës. Krim i pashembullt, do ta quaja, është ajo që u ngrit këtu. Tokat, dokumentacioni i tokave është falsifikuar, dokumentacioni i tokave vazhdon të falsifikohet me ndihmën e të ashtuquajturave kadastra që funksionojnë paralel në Kosovë dhe në Serbi, prandaj një fenomen i tillë duhet të ndërpritet dhe asnjë gjykatë mendoj se nuk do të duhej të miratonte asnjë vendim privat, të manipuluar përmes gjykatave dhe përmes prokurorive të Kosovës, përmes dokumentacionit të falsifikuar, të ardhur nga ashtuquajturat zyra kadastrale të qyteteve të veçanta që funksionojnë kush në Nish, kush në Beograd, kush në Krilevë, kush në ndonjë qytet tjetër, sepse nuk janë të sigurta dhe nuk janë të bazuara në argumente.

Ne duhet të bëjmë presion që dokumentacioni kadastral ekzistues, që e ka pasur Serbia, t'ia kthejë Kosovës. Por, përderisa nuk e kemi këtë dokumentacion, mendoj që nuk kanë të drejtë gjykatat që të marrin vendime pasi që të vendoset për privatizimin e pronave, duke përfshirë këtu edhe tokat në Kosovë. Mendoj, ne ose duhet ta ndjekim praktikën që e ndjekin edhe vendet e tjera, do t'i quaja perëndimore, në këtë rasat, sepse andej jemi përcaktuar, që prona është e shenjtë dhe pronari mund të vendos me pronën e vet çfarë të dojë dhe të ndjekim një praktikë e cila është e mbështetur në ligj dhe ta zbatojmë të gjithë ligjin. Në qoftë se duhet ta ndryshojmë ligjin, hajde ta amendamentojmë ligjin e ekzistues, hajde t'ia ndryshojmë kompetencat AKP-së, a AKM-së, apo si janë këto emërtuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

DRITON TALI: Ju faleminderit!

Unë do ta vazhdoja në këtë pikë, se me të vërtetë është interesante. I referohem faqes 13, pra çështjes së pronës. Ka një kohë që tentoj ta ngreh një çështje në Parlament, por nuk i ka ardhur radha, shpresoj se së shpejti t'i vijë, është prona e QKUK-së. Është me të vërtetë turp. Deri në kohën e aparteheidit, derisa nuk ka përfunduar aparthejdi, prona e QKUK-së të mos preket dhe deri atëherë, deri para lufte, prona e QKU-së ka qenë 43 hektarë e 82 ari. Tash, sipas regjistrimit të vitit 2008, del se QKU-ja ka pronë 37 hektarë e 14 ari, pra janë avulluar apo janë shpronësuar 6 hektarë e 68 ari, që në vlerë të parasë së tregut sillet rreth 20 milionë e më tepër euro, dhe kjo ka ndodhur pas luftës.

Mendoj se është turp, mendoj se këtu duhet të aktivizohen të gjithë mekanizmat që ia donë të mirën shtetit të Kosovës. Ne kështu shtet nuk mund të bëhemi. Të ndalet kjo marrëzi.

Tash po kthehem te një pikë, mendoj se të gjithë ne pajtohemi këtu, por edhe më tutje nuk sqarohet pse paratë e privatizimit të Kosovës nuk investohen në Kosovë, duke i pasur gjithë ato projekte. Arsyejimi idiotesk se në Kosovë nuk ka siguri, është për t'u çmendur. Në anën tjetër, ne e kemi njëfarë Agjencioni për promovimin e investimeve, që shko nëpër Evropë, nëpër botë, thotë: Ejani investoni në Kosovë, se në Kosovë është ekonomi e sigurt, ka vend ku të investohet, paratë tona na i qesim jashtë, domethënë

paratë tona ne nuk guxojmë... Unë e di se kush nuk është kah lenë apo kush shet përralla atje, por si është e mundur paratë e tona ne të mos të guxojmë t'i investojmë në Kosovë, e të kërkojmë nga investitorët e huaj – hajdeni investoni në Kosovë. Nuk është vetëm vlera, shuma e privatizimit, por janë rreth 1.4 miliard euro para të kosovarëve që janë jashtë sistemit qarkullues të të ardhurave kombëtare.

Çështjen tjetër që më duhet patjetër ta ngre, është historia apo odiseada e Industrisë së Duhanit në Gjilan, duhani, ndërmarrje e cila është privatizuar me spinoff special dhe nga korriku i vitit 2009, është shkretuar plotësisht. Dhe, këtu vjen ajo që disa herë edhe u cek – Zyra e Monitorimit, Njësia e Monitorimit, më falni. Si është e mundur kjo Njësi e Monitorimit të mos e analizojë gjendjen në ndërmarrjet e privatizuara dhe të lejojë atje një numër të madh të njerëzve që burimin kryesor të ekzistencës së tyre i kanë ato pagat e mjerueshme, e nga ana tjetër mos të marrin paga sipas zotimeve të cilat i ka bërë investuesi dhe jo për një muaj po dy muaj, por për një vjet e sa.

Nëse e marrim dhe e analizojmë faqen 53, nëse e shoh mirë, shihet se Industria e Duhanit, domethënë investuesi, numrin e punëtorëve të cilët e kanë zotuar dhe atyre të cilët janë konfirmuar, nuk e ka mbushur as një të tretën, më pak se 30% të punëtorëve, me të cilët ka qenë i obliguar, sepse atë zotim e ka dhënë, derisa vlerën e investimeve e ka edhe më keq, 19% të investimeve të zotuarat i ka investuar. Unë nuk e kam të qartë këtë njësi monitoruese, pse nuk ka reaguar me kohë, çfarë pune bëjnë tjetër? E ngjashme është edhe te ndërmarrjet tjera problematike. Të gjitha këto ndërmarrësit, të gjithë investuesit kanë ardhur me biznes - plan, vetë e kanë bërë atë biznes - plan, kurrkush nuk ju ka thënë t'i qesin ato afate, ato shuma, vetë i kanë bërë kur kanë konkurruar. Dhe, pse Njësia Monitoruese nuk ka qenë më aktive, unë nuk e kam të qartë sot e asaj dite. Unë e kuptoj që ndërmarrësi mund të jetë, të ketë probleme të ndryshme afariste për një muaj, dy muaj, tre muaj, ama me vite të tëra t'i lësh një numër të madh të njerëzve të cilët burimin e ekzistencës e kanë nga ato ndërmarrje, jo që është gjynah prej zotit, por edhe krejt kundërligjore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet deputeti Heset Cakolli.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër Manaj,

Të nderuar deputetë,

Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencionit Kosovar të Privatizimit për vitin 2009, është me të vërtetë përmbushje e një obligimi ligjor, i përcaktuar në Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Megjithatë, pritjet e mia kanë qenë se ky agjencion, edhe pse është pasardhësi i AKM-së, do të veprojë ndryshe dhe se administrimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe i asketeve do të jetë në të mirë të qytetarëve dhe të zgjidhjes së problemeve ekonomike dhe sociale, sidomos në zbutjen e varfërisë dhe rritjen e punësimit.

Pasqyra që jep ky raport, më tepër avancon problemet sesa që bën zgjidhjen e tyre. Ish-Qeveria në hije e Partisë Demokratike dhe shefi i atëhershëm i saj dhe kryeministri i tanishëm, Hashim Thaçi, pati deklaruar se procesi i privatizimit është i korruptuar, por në momentin që e mori qeverisjen e vendit, me këtë edhe të drejtën e qeverisjes së AKP-së, nuk ka ndryshim tjetër pos ndryshimit të emrit nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, në Agjencionin Kosovar të Privatizimit, e mos të flas që nuk ka asnjë rezultat në luftimi e korrupsionit.

Rezultatet sa i përket vet raportit, janë zhgënjyese dhe unë po i veçoj 5 fakte të rëndësishme:

1. Nuk ka politika atë privatizimit ose, më saktë, ato janë të njëjta me ato të AKM-së;
2. Mungon prezantimi i planit të biznesit dhe i objektivave të qarta të tij. Po i referohem në veçanti, nuk ka asnjë shkronjë për mënyrën e privatizimit të qendrës të skijimit “Brezovica”.
3. Mungon transparenca dhe informimi lidhur me Fondin e privatizimit dhe po flasim për gjysmë miliard euro. Mund të jetë që deputetët e nderuar, siç është zoti Haliti, mund të kenë informatë, por unë kërkoj informatë zyrtare, me qenë se Kuvendi i Kosovës dhe qytetarët e Kosovës asnjëherë nuk janë informuar se ku janë investuar dhe me çfarë interesi janë investuar. Pra, po flasim për 500 milion euro, që nuk janë pjesë e procesit ekonomik aktiv të vendit.
4. Puna është shumë e ngadalshme në sigurimin e të drejtës së punëtorëve për 20%, nganjëherë është edhe parciale, e nganjëherë edhe nuk realizohet, dhe
5. Mungon vlerësimi i strukturës së plotë ligjore për rregullimin e fushës së privatizimit.

Sipas Ligjit, Agjencioni ka autorizime shumë të rëndësishme, si të shitjes, likuidimit të ndërmarrjeve drejt transferimit të tyre, por edhe të aseteve të tyre. Cilat të dhëna qëndrojnë në raport? Në vitin 2009, nga aktivitetet e Agjencionit kemi të shpallura tetë valë të privatizimit, diku të tenderuara 98 ndërmarrje në një shumë të vlerësuar 59 milionë euro. Çka është kryer nga kjo? Vetëm 11 ndërmarrje, 90 ndërmarrje janë përfunduar, të papërfunduara 41 dhe të refuzuara 38, që thotë se shuma e përgjithshme është diku mbi 49 milionë euro. Besoj se kjo nuk mund të konsiderohet sukses. Edhe pse në raport është shkruar se Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka punuar në promovimin dhe mbrojtjen e politikave të AKP-së, është e padefinuar se cilat janë politika.

Po ashtu, një ndër obligimet me rëndësi të Agjencionit, sipas ligjit, është që të përcaktojë politikat për shtimin e vlerës të ndërmarrjes para shitjes, sidomos ato të cilat i merr nën administrimin direkt, në mënyrë që të mund të jenë profitabile dhe të ngrihet vlera e tyre dhe para se të privatizohen të mund të shiten me një çmim më të mirë. A është arritur kjo? Jo. Shembulli i Llamkosit, mbase është shembulli më i mirë, sepse nuk ka pasur asnjë ofertues dhe kjo duhet të jetë shqetësuese.

Raporti gjithashtu përmend, por nuk e sqaron se cili është plani i biznesit për vitin 2009, cilat janë prioritetet që rrjedhin nga ky plan? Sa i përket likuidimit, një vështirësi të cilën e përmend Agjencioni thotë se për likuidimin e një ndërmarrjeje duhen gati tri vjet dhe se nga kjo kohë, 90 muaj janë jashtë kontrollit të AKP-së. Atëherë, pse Agjencioni nuk ka propozuar se si duhet të përshpejtohet ky proces ashtu që procesi i likuidimit të jetë shumë më i shpejtë.

Sa i përket aktiviteteve të ndërmarrjes Trepça, është e dukshme se problem paraqet sidomos pjesa e kompleksit të Trepçës në veri, kurse nga ana tjetër nuk ka raport fare se çfarë ngjanë atje, ndërsa shpenzohen 1 milionë e gjysmë nga Buxheti i Kosovës. Javën e

kaluar, nga ana tjetër, kemi qenë dëshmitarë të marshimit në shenjë të pakënaqësie të minatorëve.

Tjetër, sa i përket një roli tjetër të rëndësishëm, është gjithashtu caktimi i statusit të ndërmarrjeve dhe në këtë aspekt do t'i referohem sidomos statusit të ndërmarrjes së Gjakovës, siç është për shembull "Emin Duraku", ndërmarrjes shoqërore, statusi i së cilës nuk dihet ende.

Po kthehem prapë te fondi i mirëbesimit. Duke marrë parasysh se, sipas të dhënave që na i ka ofruar Agjencioni, thotë se në Bankën Qendrore gjenden mbi 259 milionë euro. Nëse është ashtu, atëherë ku janë 191 milionë euro të tjera ose shuma që është dashur të ndahet 20% për punëtorët, është paraparë të jetë afër 86 milionë euro, në mënyrë të drejtpërdrejtë janë ndarë afër 19 milion euro, do të thotë në përgjithësi 20 milion euro, ku janë 65 milion euro tjera, të cilat nuk janë paguar. Kjo sigurisht që nuk mund të konsiderohet sukses. Çfarë është dashur të përmbajë ky raport, unë rekomandoj këtë:

1. Është dashur të bëjë vlerësimin e post-privatizimit, pra a janë arritur objektivat e privatizimit dhe cilat?
2. Efektet reale të tij,
3. Implikimet financiare,
4. Përfitimet reale për Kosovën nga ky privatizim.

Meqenëse të gjitha këto nuk i ka ky raport, unë nuk e përkrah. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Për replikë, fjalën e ka kërkuar anëtari i Kryesisë, deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Unë nuk kam replikë, por një sqarim kisha, më shumë, edhe me vetveten, edhe me opinionin. Shqetësimi im është që ndërmarrjet që janë shitur dhe vazhdojnë të shiten, nuk kanë arritur që të sjellin zhvillim në Kosovë dhe mendoj se do të duhej që ata që i blejnë, të kenë mundësi që t'i zhvillojnë, ta zhvillojnë ekonominë e Kosovës dhe jo t'i privatizojnë dhe pastaj t'i lënë depo. Ndërsa, sa u përket fondeve, unë mendoj që nuk ka ndryshuar kontoja e këtij fondi të privatizimit nga kontoja që është hapur nga Qeveria paraprake ose qeveritë paraprake, të mëhershme. Prandaj, nuk ka hapur Qeveria aktuale ndonjë konto të re, besoj, dhe unë e kam dëgjuar sa herë edhe në konferenca për shtyp edhe në takime, që ka shprehur shqetësimin kryetari i AKP-së, shefi i AKP-së a si quhet si funksion, i cili ka kërkuar sjelljen e fondeve të privatizimit në Kosovë dhe këtë nuk ka mundur ta arrijë. Ky është një problem i cili nuk i është sqaruar asnjëherë, jo vetëm opinionit, por as neve.

Prandaj, unë nuk mund të përgjigjem për veprimet që i kanë bërë qeveritë paraprake dhe as AKP-ja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Vazhdojmë me diskutimin. Fjalën e ka deputeti Haset Cakolli, le të përgatitet deputeti Emrush Xhamajli. Pauza do të jetë në orën 13:30, sepse kemi shumë të paraqitur.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Bazuar në Ligjin për privatizim, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, si një organ i pavarur publik, përmes Bordit të drejtorëve i dorëzon Kuvendit të Republikës së Kosovës raport vjetor për vitin paraprak. Dhe, ky raport vjetor i punës së Agjencionit, përveç tjerash, duhet të përfshijë gjashtë pikat kryesore të përshkruara në nenin 20, pika 20.2 të Ligjit kosovar të privatizimit.

Ndërsa, ky raport për të cilin po diskutojmë sot, është raporti i dytë me radhë, i pari i plotë vjetor i Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Nga të dhënat e këtij raporti shihet se gjatë vitit 2009, në tetë valë të privatizimit janë tenderuar 85 ndërmarrje shoqërore, nga 98 ndërmarrje të reja, me çmim total të ofertave prej 59.053.353 euro, nga 334 ofertues sa ishin gjithsej.

Po ashtu, gjatë këtij viti janë bërë publike 27 lista përfundimtare dhe 87 lista fillestare të punëtorëve të ndërmarrjeve të shitura, por listat fillestare janë të varura nga shqyrtimi dhe mendimi i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ky raport, i cili është përmbledhur në një numër të vogël faqesh, për mendimin tim ka shumë të dhëna të rëndësishme, të tilla çfarë janë, e që e përshkruajnë tërë procesin e privatizimit. P.sh. të dhënat në tabelën në faqen 66, tregojnë se të hyrat nga spinoffet të pranuar në bankë arrijnë shumën 429.843.971 euro. Pastaj, numri i kontratave të shitjes dhe të nënshkruara është gjithsej 521, si dhe shumë të dhëna tjera të rëndësishme.

Por, në këtë raport, për mendimin tim, është dashur të jepet edhe numri i punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve para privatizimit dhe numri i të punësuarve pas privatizimit, gjë e cila fatkeqësisht është në disproporcion të madh, ndërsa tabela përmban vetëm numrin e punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara me spinoff special, që është gjithsej 6 577 punëtorë. Një pyetje që lind natyrshëm, me qëllimin për ta qartësuar këtë çështje, është se sa ka qenë numri i punëtorëve në këto ndërmarrje para privatizimit, domethënë ndërmarrje të privatizuara me spinoff special.

Përkundër faktit që raporti përmban të dhëna të nevojshme të parapara në ligj, fatkeqësisht gjendja e ekonomisë së vendit pas privatizimit nuk është përmirësuar por, përkundrazi, ka ngecje në zhvillimin ekonomik të vendit.

Te nderuar kolegë deputetë, me këtë rast dëshiroj t'i paraqes disa shqetësime të përgjithshme lidhur me procesin e privatizimit. Edhe me tutje nuk është bërë pagesa e 20% të punëtorëve dhe kjo vonesë ka krijuar pakënaqësi te punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara. Ka punëtorë që ka punuar me dekada në këto ndërmarrje shoqërore dhe pas privatizimit i takojnë vetëm 200-300 euro, por që as këto pak mjete nuk i janë dhënë edhe pas 5 viteve apo ma tepër pas privatizimit, me arsyetimin se Dhoma e Veçantë e Gjykatës nuk i ka vërtetuar listat përfundimtare. Unë konsideroj se kjo çështje nuk do koment. Disa ndërmarrje të privatizuara me spinoff special, pas përmbushjes së obligimeve të parapara me kontratë nuk e zhvillojnë aktivitetin ekonomik. Pastaj, shumë sipërfaqe të tokave bujqësore pas privatizimit nuk punohen, por kanë mbetur djerrinë, si dhe shumë sfida tjera. Por, shtrohet pyetja, a ka Agjencioni Kosovar i Privatizimit ndonjë strategji se si të veprohet me këto kompani të reja të cilat nuk e zhvillojnë më tutje aktivitetin ekonomik?

Unë mendoj se është mirë dhe madje e domosdoshme që me ligj të rregullohet që sipërfaqet e tokave bujqësore që nuk punohen për tri vite rresht, të konfiskohen nga ai pronar dhe të riprivatizohen me qëllim që t'u jepen personave që janë të gatshëm t'i punojnë ato ose, në të kundërtën, të caktohen tatime të larta për to. Ndërsa, të gjithë ata

fermerë që janë të gatshëm t'i punojnë ato toka bujqësore, të kenë subvencione të shumta nga shteti.

Vendimi i zyrtarëve të AKP-së, në bashkëpunim me sindikalistët, që paratë e 20% të privatizimit t'u jepen punëtorëve ende pa përfunduar verifikimi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, konsideroj se është vendim i drejtë dhe i jap mbështetje të plotë.

Në fund, kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të reagojë urgjentisht për kthimin e mjeteve të privatizimit në Bankën Qendrore të Kosovës dhe që, njëkohësisht, Kuvendi i Kosovës të miratojë bazën ligjore për projekte që mund të përdoren këto mjete në mënyrë që vendi ynë të mos marrë kredi për financimin e projekteve të shumta, që ka nevojë vendi ynë, por të shfrytëzohen mjetet nga Fondi i privatizimit, mjetet nga Trusti pensional dhe mjetet tjera. Normalisht, vendit tonë i nevojiten edhe kredi me kamata të volitshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet deputetja Rita Hajzeraj.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit zoti kryesues!

Përsëritet, zëvendëskryeministër!

Do të dëshiroja ta përsëritja edhe pjesën tjetër të Kabinetit, por nuk është këtu.

U përsëritet juve, zotëri kolegë deputetë dhe të pranishëm!

Nga privatizimi është pritur shumë, është pritur me të drejtë, sepse Kosova ka pasur kapacitete prodhuese, ndërmarrje të shumta të cilat edhe pse shumica e tyre janë privatizuar, në fakt nuk është arritur ajo objektivë për të cilën është bërë privatizimi, ajo që u tha edhe nga shumë deputetë të tjerë, është brengosëse se nuk ka gjeneruar vende të punës, nuk ka gjeneruar zhvillim. Për më tepër, edhe ato mjete që janë grumbulluar nga shitja, siç u tha shumë herë këtu, është shqetësim i përbashkët, mendoj i të gjithëve – opozitë e pozitë, që ato mjete janë jashtë edhe duhet të gjendet forma që të kthehem brenda, mjete të nevojshme 413 milionë nuk janë pak për Kosovën.

Unë do të ndalem vetëm në këtë pjesën e raportit ku flet për njësinë “Trepça”. Mua më ka gëzuar fakti se miniera e Trepçës ka filluar ta rritë prodhimin dhe fitimin. Kjo është shpreh në raport në shifra me përqindje, si rritet që janë shënuar në Stan Trg, në Tunelin e Parë, në Artanë, Kishnicë, të gjitha tejkalojnë 20%, 45% edhe kemi ardhur në një pozicion që Qeveria nga investimet që ka bërë për vitin 2009, 4.700.000, këtë vit, sa unë jam i informuar, ka ndarë 1.700.000 euro, nëse nuk jam gabim. Këta tregues flasin se statusi i Trepçës duhet të rishqyrtohet për shkak se me një përkushtim më të madh të Qeverisë dhe të të gjithëve, ajo do t'i sjellë të ardhura buxhetit të Kosovës.

Siç jemi në dijeni, tash është duke u bërë Ligji për miniera dhe minerale dhe në bazë të këtij ligji, i cili me siguri shpejt ka për të na ardhur këtu në Kuvend, për leximin e dytë, parashihet që Trepça të jetë pronë shtetërore, domethënë në menaxhim të Kuvendit dhe të Qeverisë dhe mendoj se kjo do të jetë e mira më e madhe, sepse Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme edhe për nga përbërja, edhe për nga interesimi duket se nuk ka qenë shumë e interesuar që të punohet siç duhet. Tek e fundit, Qeveria është ajo, po mendoj është shteti i Kosovës ai që i ka dhënë mjetet për rimëkëmbjen, për prurjen në këtë situatë të Trepçës dhe urojmë që sa më parë të ndodhë kjo.

Një shqetësim i madh, jo vetëm për mua, por besoj duhet të jetë për të gjithë neve, është trajtimi i punëtorëve dhe i atyre që kanë mbetur pa punë. Në raport, në fakt, përshkruhet

një situatë rozë sa u përket punëtorëve, mirëpo janë disa gjëra që unë jam detyruar të bëj pyetje shtesë rreth raportit. Ta zëmë, konkretisht, në raport jepet numri i të punësuarve në Trepçë – 1339 dhe numri i të mbeturve pa punë – 3926, siç emërtohen në raport – përfitues, ata i kanë të merituar, nuk po përfitojnë diçka të veçantë, nuk raste të natyrës, të them, që kurrë nuk kanë punuar edhe po u jepet nga sociali, por janë njerëz që kanë punuar gjatë dhe ata, në fakt, janë duke marrë ato çka i meritojnë që, në fakt, nuk po i marrkan ato që i meritojnë, më falni, dhe unë u interesova, pyeta se çka përfitojnë këta të papunë, pasi në raport nuk është cekur se çka përfitojnë. Përfitojnë, por nuk është cekur se çka, konkretisht, dhe doli se ata i marrin në fakt nga 50 euro në muaj, nëse jam gabim, të më falni, është aty, është një ndihmë shumë simbolike, ndërsa këta që janë hequr nga lista e përfituesve, nga pensioni i hershëm, aty në raport i keni 353 vetë, këta as nuk kanë punë, as nuk kanë pensione, por në fakt e marrin një ndihmë 30 euro, jo përmes bankës, por me letërnjoftim, janë në listë aty. Edhe pse pas grevës së majit, që është bërë vitin e kaluar, domethënë këtë periudhën e raportuese ka kaluar, siç thuhet, në raport, nuk ka pasur shfaqje publike të pakënaqësisë, përsëri sivjet, siç e dini, më 12 maj, kategoria e të pensionuarve para kohe edhe këta të pa punë dhe pa paga, janë detyruar të dalin në grevë. Ky është një shqetësim i madh, krahas shqetësimit rreth pagesës së 20%, që u tha këtu. Me të vërtetë është një veprim shumë i ngadalshëm i AKP-së në përmbushjen e këtij detyrimi, në pagesën e 20% me kohë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, ndërkaq pas pauzës përgatitet deputeti Bujar Dugolli.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kisha dashur ta përshëndes edhe unë kabinetin, por me qenë se nuk është sot prezent, duke pasur parasysh që kemi një temë jashtëzakonisht të rëndësishme. Si AKP, si AKM, edhe si AKP e dimë që ka funksionuar si agjencion me një rregullore, ndërsa më vonë si AKM, ne si Parlament i Kosovës në vitin 2008, pra numër 03-07, e kemi miratuar më 15 qershor Ligjin për këtë Agjencion, i cili projektligj nuk është komplet, i cili ka lënë jashtëzakonisht hapësira për manipulim në kuadër të privatizimit të ndërmarrjeve publike dhe të ndërmarrjeve tjera.

Ky Agjencion jo shumë i lëvdueshëm e ka sjellë një raport në Kuvendin e Kosovës dhe është hera e dytë që sjell raport dhe është raport më komplet, mirëpo mungojnë dhe ka paqartësi shumë të mëdha, sepse në mesin e tij mungon edhe numri i punëtorëve në kompanitë e privatizuara, që asnjëherë nuk është parë se sa ata punëtorë kanë qëndruar aty, se si ato ndërmarrje janë marrë me të njëjtën veprimtari apo e kanë ndërruar fushëveprimtarinë e tyre. Po ashtu, edhe unë jam dakord që ky projektligj i cili është për AKPM-në, për AKP-në në këtë rast, ka pasur nevojë të jetë më i kompletuar, por në rastin konkret është dashur që sa më herët ky projektligj të ndryshohet, sepse kemi jashtëzakonisht ndërmarrje të mëdha, të cilat veç kanë filluar të privatizohen. Tani e kemi PTK-në dhe KEK-un, që janë dy ndërmarrje publike dhe duke e shikuar realisht, këto dy ndërmarrje publike meritojnë që për secilin ndërmarrje të ketë nga një ligj të veçantë, sepse aty gjenerojnë miliona euro.

Ndërmarrjet apo objektet e privatizuara nuk i kanë shërbyer qëllimit për të cilin janë privatizuar. Ato nuk kanë gjeneruar as mirëqenie, as zhvillim dhe as punësim. Paratë e grumbulluara prej tyre nuk po përdoren për ekonominë e Kosovës, por mbeten të mbyllura në bankat e huaja, duke interpretuar në mënyrë të ngushtë imponimet e dokumenteve ndërkombëtare për Kosovën. Të mos shfrytëzosh burimet ekonomike,

trashëgimi e popullit të Kosovës në dhjetë vjeçarët e fundit, kur kemi indekse të ulëta të investimeve të huaja në vend, pra atë mos shfrytëzosh atë që e ke gati, djersën e brezave të tërë të kosovarëve, është e pafalshme.

Paratë e privatizimeve janë kontributi i brezave më të vjetër për të rinjtë dhe që duhet të jemi përgjegjës për to. Nuk është normale që objektet e privatizuara të mos përdoren fare për shkak të pamundësive financiare të atyre që i përfituan ato. Nuk mund të tolerohet që tokat bujqësore të privatizuara të mbeten djerrinë dhe Kosova të renditet dhe sot në vendet që më së paku e punojnë tokën e tyre. Ne duhet të studiojmë gabimet e kryera deri më tani në këtë proces dhe t'i shmangim ato në privatizimet e ardhshme, edhe pse këto privatizime kanë mbetur me një numër shumë të vogël.

Ky proces duhet të udhëhiqet jo prej Qeverisë, po pikërisht prej Agjencionit, i cili duhet të jetë më i pavarur. Ky proces duhet të udhëhiqet në mënyrë profesionale dhe jo politike. Duhet nxitur forma të reja të privatizimit apo vënien në punë, qoftë edhe me koncesion, qoftë me dhënie në përdorim, qoftë me formën Bot. Nëse nuk veprohet menjëherë, brezat e shkuar nuk do të na e falin, as brezat e ri, për të cilët duhet të punojmë sot që të na e shpërblejnë në të ardhmen dhe të cilën nuk do të jenë mirënjohës ndaj nesh.

Kjo lloj ndërhyrjeje është e vështirë për t'u realizuar, sepse kërkon punë dhe vendosmëri. Nëse ne mendojmë vetëm për qytetarin, për interesin e tij dhe jo për interesa të ngushta të momentit, atëherë ai është drejtimi i vetëm në të cilin duhet të ecim. Ky është qëndrimi unanimit i Grupit tonë parlamentar dhe ne kemi besim tek njerëzit e vullnetit të mirë, nuk kemi pasoja nëse presim 2-3 muaj apo dizajnimin e një rruge të tillë, por do të kishim pasoja të pariparueshme nëse do të vazhdojmë si deri më sot.

Në masën më të madhe të ndërmarrjeve të privatizuara nga ky privatizim i AKP-së menjëherë edhe AKM-së më vonë, asnjëherë nuk është kthyer 20% i punëtorëve, është kthyer në një masë shumë të vogël, por asnjëherë në mënyrën e duhur, siç do duhej të ishte. Ky agjencion nuk e ka dhënë asnjëherë provimin në lidhje me këtë veprimtari. Andaj, ne këtë agjencion e shohim si agjencion të dështuar dhe shpresojmë se në të ardhmen duhet të marrim masa që ky agjencion të riparojë apo të përmirësojë sjelljet e tij në privatizimet e ardhshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në orën 15:00 i kthehem debatit lidhur me pikën në shqyrtim.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Kemi numër të mjaftueshëm për debat, do të thotë 45 deputetë janë. Mund t'ia fillojmë debatit, fjalën e ka Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Nga ajo që tha deri më tash, mund të shprehemi se këtu u diskutuan shumë çështje, që ndoshta nuk kanë për objekt diskutimi vet raportin, i cili është dërguar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, por unë duhet të kujtoj se ky proces i cili ka filluar me nënshkrimin e Rregullores së UNMIK-ut, 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit shumë vite më herët, ata që nuk e dinë, mund të shikojnë në transkripte dhe procesverbale të legjislaturës të parë dhe të shohin se çfarë debati është

bërë në këtë Kuvend rreth kompetencave që ky Agjencion atëherë i pati marrë pa të drejtë dhe pa respektuar të drejtën e deputetëve dhe ja kërkesat e Kuvendit të Kosovës...

KRYETARI: Bujar, të lutem, e ke Raportin e vitit 2009, ndalu në Raportin e vitit 2009. Nëse doni, po kërkoj nga deputetët, nëse doni të bisedojmë, të debatojmë për krejt privatizimin, kërkon, bëjeni një kërkesë me shkrim, por sot në rend dite është Raporti i vitit 2009. Prandaj, i gjithë debati le të jetë në kuadër të raportit.

BUJAR DUGOLLI: Po, zoti kryetar, unë desha ta përmendi një rregullore, një ligj i cili është aprovuar në atë kohë pa pëlqimin e këtij Kuvendi dhe institucionet e Kosovës në vazhdimësi kanë dhënë vërejtje për këtë proces, por shpesh debatet, siç ndodhi edhe sot, debatet më shumë kanë pasur karakter të gjuarjes politike pozitive-opozitive se sa në realitet të nxjerrin diçka të vërtetë në aspektin e përmirësimit të kësaj gjendjeje. Ndodhi më vonë që gjatë vitit 2008 të bëhet ligji, i cili ka dalë si rezultat i pakos së Ahtisarit, ligj i cili lejon themelimin e AKP-së por që, për mendimin, tim edhe me këtë ligj, tash edhe më keq, me votën e Parlamentit të Kosovës nuk iu është dhënë e drejta e merituar këtij Agjencioni, i cili është kompetent për privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore. Pra, atëherë u bë pa pëlqimin e Kuvendit, tash u bë me pëlqimin e Kuvendit dhe të gjendja, për të thënë që nuk ka ecur aspak përpara, por mund të themi që në disa fusha edhe mund të quhet si e degjeneruar.

Çka i mungon këtij raportit? Raportit i mungon lista e ndërmarrjeve të privatizuara gjatë vitit 2009, ku sipas të dhënave që janë paraqitur, janë vetëm 8 valë që janë privatizuar, por nuk dihen, nuk njoftohen deputetët cilat janë ndërmarrjet që janë privatizuar. Konsideroj se është dashur të jetë pjesë e raportit.

Emrat e investitorëve apo të kompanive që i ka blerë këto ndërmarrje, mendoj se nuk ka nevojë të fshihet nga Kuvendi, por duhet të jenë publik ata se kush i ka blerë, qoftë personat fizikë apo juridikë. Informacionet tjera që ka qenë dashur të jenë pjesë e raportit, për rastet e dërguara në Policinë e Kosovës, për kontrollin historik të ndërmarrjeve apo të investitorëve që i kanë blerë ndërmarrjet, nëse thuhet se janë dërguar 100 e sa raste, atëherë duhet të njoftohet Kuvendi se në bazë të kontrollit financiar apo historiku i ndërmarrjeve, çka ka rezultuar, a kanë qenë të gjitha në rregull apo ka pasur vështirësi dhe në çfarë fusha janë bërë vështirësitë.

Nuk kemi asnjë informacion në këtë raport rreth investimeve të huaja gjatë kësaj kohe të procesit të privatizimit, a ka ndodhur që ndonjë investitor i huaj në këto valë të privatizimit të blejë prona në Kosovë dhe ta dimë, thjeshtë, a ka ndodhur diçka e tillë. Mungojnë informatat, po ashtu thuhet se në aspektin e bashkëpunimit rajonal me komunat, ceken komunat e Gjakovës dhe e Gllogovcit për shkak të mosbashkëpunimit dhe keqpërdorimit të dokumenteve kadastrale, por nuk specifikohet për çka, domethënë. Tash u fol edhe për disa komuna tjera, Prishtina e tjerë, por ne nuk e dimë se për çfarë raste po bëhet fjalë dhe sa ka të drejtë Agjencioni apo ka pakënaqësi apo mospërmbushje të legjislacionit ekzistues.

Mungon po ashtu një informacion i duhur për ndërmarrjet e komercializuara, përmbushja e obligimeve, si: qiraja, punësimi e tjera. Nuk kemi po ashtu një informacion detal rreth politikave operuese. Çdo herë janë dhënë rekomandime, edhe në Kuvend në të kaluarën, edhe nga qeveritë më herët rreth ndryshimit apo përmirësimit të politikave operacionale sa i përket privatizimit e tjera dhe nuk kemi asnjë informacion se a ka ndryshuar ndonjë politikë dhe të cilat janë ato politika që janë ndryshuar. Ne do të dëshironim që t'i kishim

këto informacione dhe të ndërrojë praktika e sjelljeve të raporteve që kanë ndodhur në të kaluarën, kur shumë çështje nuk janë hapur për institucionet e Kosovës. Dhe, mendoj që tani, në bazë asaj që deklarohet që ka kompetenca më shumë, atëherë besoj se duhet të jenë këto të prezantuara.

Flitet për vetëm 6 valë të privatizimit, 85 ndërmarrje kryesisht gjatë vitit 2009, domethënë është kaluar viti 2008 pa pasur ndonjë rezultat dhe kjo vonesë i ka pasojat e veta sa i përket kësaj çështjeje. Tek procesi i privatizimit, konsideroj se është e padrejtë të kërkohej më shumë nga ky Agjencion, me këtë kompetencë ligjore që e ka, me një Bord i cili e ka shumicën vendore, por janë tre ndërkombëtarë të cilët çdo vendim mund ta hudojnë në vota dhe mund ta kenë të drejtën e vetos në çfarëdo vendimi të Bordit, dhe kur krahasohet me ish bordin e kaluar, kur ishin 4 vendorë, 4 ndërkombëtarë, kishte raste kur me vota fitonin vendorët dhe tash, në këtë gjendje që e ka Bordi ekzistues, lë për të dëshiruar, sepse nuk mundet asnjë vendim, në rast se njëri nga ndërkombëtarët do ta kundërshtojë, nuk mund të kalojë dhe konsideroj që kjo është e metë shumë e madhe e këtij ligji ekzistues dhe konsideroj që duhet të ndryshohet.

Procesi i likuidimit është një proces shumë kompleks. Edhe nga raporti shihet se në procesin e likuidimit vetëm 20 ndërmarrje i kanë komisionet komplete, sepse dihet që asnjë komision nuk mund të jetë komplet pa u dërguar në secilin rast një përfaqësues ndërkombëtar dhe, në rast se vazhdon me këtë ritëm pa u ndryshuar Ligji për likuidimin, atëherë këtij Agjencioni do t'i duhen të paktën edhe 20 vjet për ta përmbushur këtë obligim ligjor apo për ta përmbushur procesin e likuidimit.

Ligji duhet të ndryshohet për procesin e likuidimit, sepse kemi të bëjmë edhe kategoritë të cilat janë pretendente për çështjet e ndërmarrjeve apo për paratë që dalin nga procesi i privatizimit dhe, në këtë rast, ndryshimet që duhet të pasojnë, duhet të rezultojnë me atë që t'i jepet e drejtë, së pari shtetit, së dyti, t'u jepet e drejtë ish-punëtorëve dhe, së treti, kategorive tjera. Dhe, në rast se nuk përfillen këto, atëherë nga të ardhurat e shitjes së këtyre ndërmarrjeve, nga ai 80%, domethënë nuk do të fitojë asgjë Kosova, po mund të fitojnë pretendentët apo ata të cilët periudha të diskriminimit dhe të okupimit i kanë shkatërruar ndërmarrjet e Kosovës dhe iu kanë krijuar probleme dhe borxhe shumë të mëdha, që edhe me këtë kompensim që mund të ndodhë me atë 80%-shin e shitjes, thjeshtë, do të jetë pak, shumë vështirësi do të ketë Agjencioni në përmbushjen e kësaj detyre.

Vërehet, një sfidë po ashtu e ka Agjencioni të çështja e monitorimit të ndërmarrjeve të privatizuara. Thuhet që vetëm 5 zyrtarë janë për këtë çështje, më falni tek administrimi direkt. Do t'i lutesha Agjencioni që mos të insistojë në administrimin direkt të ndërmarrjeve të cilat nuk kanë probleme, për shembull, është Pallati i Rinisë, Prishtina, ose Fabrika e Amortizatorëve, mos të tentojë në administrim direkt të ndërmarrjeve ku nuk kanë probleme as financiare dhe ku menaxhimi i tyre është në nivel të duhur, mos të tentojë të bëjë një autoritet tek ndërmarrjet, të cilat janë vërtetuar që nuk kanë pasur vështirësi. Statusi i tyre në aspektin juridik është çështje e proceseve tjera dhe nuk e justifikon administrimin direkt që vendoset në këto ndërmarrje.

Tek mbikëqyrja e spinoffeve speciale ka ekzistuar në vazhdimësi një sektor që është marrë me mbikëqyrje. Vërehet që ekziston prapë, por mendoj nga ato 21 ndërmarrje, që është bërë raporti dhe është vërejtur se ndoshta gjysma e atyre ndërmarrjeve nuk e kanë kaluar pozitivisht kontrollin dhe nuk kanë arritur që t'i kryejnë obligimet e investimeve, siç janë paraparë me kushtet e kontratës. Konsideroj që në përjashtim të 4 rasteve, ku

Bordi ka vendosur t'u vë masa gjore, në rastet tjera nuk ka vepruar. Sipas politikave operuese, Bordit i lejohet që të veprojë dhe të aplikoj masa...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe një herë po kërkoj që vërtet diskutuesit të jenë në kuadër të pikës së rendit të ditës për Raportin e vitit 2009 dhe në kuadër të rekomandimeve të dy komisioneve.

Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, të nderuar,

Unë isha ndalur në disa çështje të cilat kanë qenë në diskutim në Komisionin për Transport, se ne kemi pasur mundësi t'i bëjmë pyetje përfaqësuesit të AKP-së dhe disa përgjigje i kemi marrë, disa kanë mbetur të hapura, me lutje që të debatohet këtu në Kuvend. Prandaj, diskutimin ta orientoj në dy-tri pika.

Sa për raport, edhe atëherë kam menduar në komision që duhet të pranohet, mendoj edhe sot që raporti është për ta aprovuar. Nuk është raport i cili jep vetëm pasqyrën tabelare, pa një koment, por është raport i cili i ka edhe vlerësimet pozitive, po gjithashtu edhe konkludimet. Na duhet të shohim se cilat janë ato kërkesa të AKP-së, që të mund të vazhdojë punën më tutje. Sa për metodat e privatizimit, ka qenë prej disa diskutuesve këtu tema e diskutimit, unë mendoj se ajo nuk është çështje e AKP-së, ajo është çështje e legjislacionit, prandaj ata kanë vazhduar punën e AKM-së me atë metodë që e kanë pasur, por kanë bërë mirë që nuk ka vazhduar me metodën spinoff. Këtu në raport i kemi gjashtë ndërmarrje të cilat janë privatizuar me këtë metodë, katër prej tyre i kanë plotësuar të gjitha kushtet nga marrëveshja, të cilat janë zotuar si për investim, ashtu edhe për numrin e punëtorëve, por ato gjashtë tjera kanë dalë problematike.

Është në pyetje çka do të bëjnë më tutje në AKP me këto ndërmarrje, pos Llamkosit, ku pronari është tërhequr, blerësi në të vërtetë është tërhequr, këto pesë janë problematike. Edhe në diskutim ka qenë këtu problem të veprohet më tutje, se rendi është të kthehen aksionet edhe të bëhet edhe një herë ritenderim, po me siguri në situatën tonë, të shoqërisë sonë ku veprojnë edhe do fuqi tjera, shumë është problem të realizojë me sukses AKP-ja privatizimin e tyre.

Problemi tjetër që është, edhe vitin e kaluar e kemi përmendur këtu, por tash duhet të veprojmë konkret, është lidhur me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe gjithnjë kur e përmendim këtë forum, ne po mendojmë se është trashëgimia nga AKM-ja edhe gjithmonë e lidhim me problemin e 20%-shin të mjeteve të ndara për punëtorë, me lista të mira apo me ankesa, por edhe ky problem është zbutur me formimin e Komisionit të AKP-së dhe bashkëpunimin me këtë Dhomë. Por çka është ajo më e rëndësishmja, që mendoj unë që duhet në vëmendjen tonë ta kthejmë, është se kjo Dhomë a i ka edhe do kompetenca tjera. Këtu në raport, në regjistrin e ndërmarrjeve, ku po administrojnë direkt AKP-ja, përmenden pamundësitë derisa nuk vendoset për ankesa të cilat janë orientuar kah Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe pritet veprimi i tyre. Unë mendoj se është mirë ta aprovojmë këtë kërkesë të AKP-së, që të plotësohet legjislacioni edhe të definohet pozita e Dhomës së Posaçme. Gjithashtu, ata veprojnë edhe në bazë të Rregullores të UNMIK-ut, nr. 2005/48, që drejtpërsëdrejti është e lidhur edhe me pozitën e Trepçës.

Nuk jam prej atyre që mendoj se duhet sa më shpejtë të heqet monotoriumi edhe të shkojë në privatizim edhe kjo ndërmarrjeje, por mos t'i bëjmë gabimet sikur me ligjin e mëparshëm ose Rregulloren e UNMIK-ut, që nuk na kanë pyetur, të bëhet për

ndërmarrje publike ligji i veçantë për privatizim, por kur është Trepça në pyetje, në komision AKP-ja e ka përmendur mundësinë për administrim dhe të jetë aksionar Qeveria. Unë nuk po hy në këtë mënyrë të rregullimit çka duhet, por me siguri duhet të shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48, që është edhe kërkesa e AKP-së. Sa për Trepçën, këtu ka mjaft në raport edhe vlerësime. Unë mendoj se vlerësimi i AKP-së për menaxhimin dhe për pozitën momentale është shumë reale, por me siguri nuk është mirë ta vazhdojmë me këtë pozitë, pa menduar se cilat janë ato asete të Trepçës dhe në çfarë mënyre duhet më tutje të veprohet. Prandaj, edhe unë e përkrah kërkesën e AKP-së.

Në fund, në lidhje me tokat bujqësore, ka qenë këtu mjaft në diskutim, ka qenë diskutimi edhe që nuk ekzistojnë, nuk është azhurimi i Kadastrit në rregull, ka shumë pakënaqësi, është përmendur pakënaqësia e njerëzve nga Dukagjini. Mund të ndodhë që nesër lajmërohen edhe të tjerët. Unë mendoj se duhet të harmonizohen ligjet të cilat janë të lidhura me pronë. Na nuk e kemi ende ligjin kur është në pyetje Trepça, për miniera, pastaj Ligjin për privatizim të ndërmarrjeve publike dhe Ligjin gjithashtu në lidhje me pronën private. E përfundoj, nuk e di sa për procedurë çka mund të bëjmë më tutje, ose një sugjerim, se në rekomandim të Komisionit, nuk ekziston. Por, sa për tokat bujqësore, unë mendoj se Kuvendi ynë mund të ndërmarrë masa me kohë, mos po na del problemi i pronës më vonë. Ju faleminderit! Raportin e AKP-së e përkrah.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti. Veç është mirë këta të pozitës mos të diskutojnë më shumë se 5 minuta.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke marrë për bazë planin e biznesit të AKP-së dhe raportin e saj të paraqitur në kontekst të sukseseve, përballë shumë faktorëve siç ishin: gjendja e trashëguar, ndikimi i krizës globale financiare dhe vështirësitë në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë mund të themi që në fillim se vlerësimet e dhënat në raport janë reale.

Tenderimi i 35 ndërmarrjeve shoqërore deri në fund të vitit 2009, në 98 ndërmarrje të reja dhe nënshkrimi i 65 kontratave të shitjes së aseteve me likuidim, të trashëguar nga AKM dhe aseteve përkatëse që u janë ë dorëzuar pronarëve të rinj, flet qartë për një punë serioze. Listat, në raport është e cekur se kanë arritur t'i publikojnë vetëm 27 prej tyre, ndërkaq 37 janë në gjendje fillestare, ndërkaq sipas informacioneve që kemi, dihet se shumë nga këto lista janë në përfundim e sipër, por ato nuk janë përfunduar, sepse në qoftë se ka edhe vetëm një kontestim, lista si e tillë ende nuk shkon në gjendje përfundimtare.

Megjithatë, kjo tregon se ka një lëvizje pozitive në shpërndarjen e 20%. AKP, ka shpërndarë më shumë se 4.5 milionë tek 3065 punëtorë të 19 ndërmarrjeve shoqërore, që ka qar shumë e përgjithshme të shpërndarjeve deri më tani në 20.2 milionë euro. Në përmbledhjen e programit të ... tregohet se totali i të hyrave me spinof të paguara dhe të vendosura në Bord, arrin shumë prej 429.8 milionë euro, që do të thotë është më i madh krahasuar me vitin paraprak që ishte 3.807.6 milionë euro.

Është shumë e rëndësishme arritja e memorandumit të mirëkuptimit në mes të Agjencionit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila ka bërë të mundur kontrollin... e përfituesit të përkohshëm në emër të AKP-së, por gjithsesi sfidë e AKP-së, gjatë vitit 2009 vazhdon të mbetet problemi i identifikimit të pronave, në këtë rast kemi ndërmarrjet në Gjakovë. Prandaj, konsideroj se ndaj Gjakovës duhet të kemi një

qasje pak më të veçantë kur dimë se është ndër qytetet më të plagosura të Kosovës dhe në këtë drejtim, ndoshta duhet të ndërmarrim diçka më shumë.

Sipas raportit, ekzistojnë 120 komisione të likuidimit të trashëguara nga AKM-ja. Ne e dimë se ICO, ka emëruar edhe 20 anëtarë të tjerë të rinj. Në bazë të Ligjit për themelimin e AKM-së, paragrafi 9.2. kompletimi i këtyre komisioneve është paraparë në janar të vitit 2010. Me këtë rast dëshiroj të bëjë pyetje- A janë të kompletuara deri më tani këto komisione të likuidimit?

Ata kanë një mbështetje në konsulentë nga një kompani e huaj, e cila i mbështet edhe me materiale përkatëse. AKP ka trashëguar nga Agjencia paraardhëse AKM, 149 kontrata të mbetura pezull. Pas konsultimit të Departamentit Ligjor të AKP-së, nga fillimi i marsit 2009, deri me tani janë përfunduar 102 kontrata të shitjes dhe 65 të likuidimit. Në rastet kur një ndërmarrje nuk ka procedurë, ka dëmtuar financiarisht dhe kjo reflekton edhe mundësinë e një administrimi direkt, siç është rasti me ndërmarrjen e re të “Llamkos”-it në Vushtrri. Mirëpo, pavarësisht se blerësit të saj i janë marr aksionet, pyetja është: a është gjobitur aksionari, sepse aksionet të cilat ai i ka në dispozicion, për këtë çështje janë më të vogla se realisht, dëmet që i ka shkaktuar prej ndërmarrjes. Prandaj, në të ardhmen roli i Njësisë së Administratës direkt, duhet të merret më intenzivisht me ndërmarrjet e tilla. Në fakt roli i saj ka dhënë rezultate të dukshme në ndërmarrjet- Thertorja eksportuese në Prizren dhe “18 Nëntori në Hoçë. Raporti i jep një vend të dukshëm edhe “Trepçës” ku kemi një punë jashtëzakonisht të mirë të bërë në këtë ndërmarrje, mirëpo pas rënies drastike të çmimeve, gjatë vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009, menaxhmenti i “Trepçës” ka anuluar tenderin për shitjen e koncentratit të zinkut dhe të plumbit. Kjo është bërë për shkak të rënies së çmimeve, është ritenderuar sërish në vitin 2009.

Meqenëse kryetari tha që unë ta shqyrtoj këtë çështje, atëherë shkojmë. Agjencioni ka pasur 5 auditime, për të cilat mund të themi se shumica prej tyre kanë qenë me opinione të kualifikuara. Si çështje shumë e rëndësishme janë ndryshimet në legjislacion, të cilat lidhen me aktivitetin e AKP-së dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, siç është çështja urgjente e domosdoshme për ngritjen e performancës së përgjithshme të AKP-së. Në këtë rast, duhet të themi se Agjencia Kosovare e Privatizimit, si emërtim nuk është i saktë, ai duhet të jetë Agjencia e Privatizimit, por në qoftë se të tjerët duan me çdo kusht ta shtojnë edhe fjalën Kosovë, atëherë duhet të jetë: Agjencia e Privatizimit të Kosovës, kështu është e saktë.

Në fund, më lejoni t’i them disa rekomandime:

1. Intensifikimi i shpërndarjeve të 20%-it,
2. Identifikimi dhe sqarimi i pronave,
3. Kompletimi i Komisionit të Likuidimit,
4. Intensifikimi i veprimtarisë së administrimit direkt,
5. Ndryshimet në legjislacion,
6. Përmirësimi i emërimit të Agjencionit, dhe
7. Vazhdimi i mbështetjes financiare të formave tjera ndihmëse nga Komisioni evropian edhe pas majit të vitit 2010, sepse e dini, Komisioni Evropian bën pagat.

Ju faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe prej teje, por e kalove 5 minuta. Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet Armend Zemaj.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Deputetë të nderuar,

Si zakonisht, në fillim bëjmë vlerësimin teknik të këtyre raporteve, andaj teknikisht ky raport është në rregull dhe kryesisht përshkruan punën njëvjeçare të këtij agjensioni, mirëpo vlerësimet për performancën e këtij agjensioni mungojnë, ngase asnjë raport i auditimit të jashtëm, të paraparë sipas legjislacionit nuk është paraqitur në raport, si dhe raporti i fundit i auditit nga Londra përmes Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, edhe pse është kryer në periudhën gusht 2008, qershor 2009, nuk paraqitet në raport.

Fatkeqësisht edhe ky raport nuk po sjellë risi nga vazhdimi i procesit të privatizimit në Kosovë, deri me tash as nuk po sjell rezultate të cilat kanë qenë të pritura dhe ato nuk janë në favor të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe fatkeqësisht nuk ka shënuar impakte pozitive të qytetarët tanë. Nga raporti identifikohen shumë pengesa në punën e këtij agjensioni, sidomos ato ligjore si rregulloret e UNMIK-ut gjatë likuidimit. Duhet theksuar se AKP-ja, ka trashëguar nga AKM-ja 149 kontrata të mbetura pezull, të cilat pjesërisht ka arritur t'i përfundojë në vitin e kaluar. Pengesë tjetër në procesin e privatizimit, është mosrealizimi i dëshirueshëm i 20%-it për punëtorët. Edhe pse vitin e kaluar janë shpërndarë afër 4.5 milionë euro, shpërndarja e 20%-it për punëtorët duhet të përshpejtohet, duke pasur parasysh varfërinë e tyre dhe humbjen e drejtës së punës në ndërmarrjet e tyre. Mosfunksionimi i Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme, që do të duhej të ishte në shërbim të privatizimit, është edhe rrjedhojë e mungesës së Ligjit për Odën e Veçantë, i cili kishte për të rregulluar shumë çështje.

“Trepça” ende po vazhdon të mbetet nën moratorium, me arsyetimin se “Trepça” ka borxhe që vlerësohen me vlera të ndryshme, e që arrijnë edhe vlerën 100 milionë, që do të thotë nuk është bërë vlerësimi, identifikimi i borxhlinjve të vërtetë dhe vlerës së borxhit, që mund të lë hapësirë për manipulime në dokumentacion. Edhe pse moratoriumi ka për qëllim për ta mbrojtur “Trepçën” nga gjykatat jashtë territorit të Kosovës, ne konsiderojmë se statuskvo fare nuk është zgjidhja afatgjate dhe kjo do të kërkojë kujdes të veçantë të institucioneve tona shtetërore për një betejë juridike se kush do ta administrojë “Trepçën” në të ardhmen.

Në raport qëndron se bordi i një ndërmarrjeje publike që po përgatitet për privatizim, si PTK-ja, po arrin ta ndihmojë “Trepçën” me vlerë prej 80,000 eurove, si dhe me një veturë Mercedes, kurse buxheti i Kosovës për vitin 2009, ka ndarë ndihmë për “Trepçën” mbi 4 milionë e 700 mijë euro. Rritja e prodhimit në këto miniera, ka ndikuar edhe në rritjen e të hyrave vetjake të tyre mbi 7 milionë e gjysmë euro për vitin 2009, gjë që në total arrin një vlerë të konsiderueshme. Nga këto ndihma financiare, nga Qeveria 1 milion e gjysmë janë dedikuar “Trepçës” në Veri. Andaj është e pakuptueshme që prapë në vendin tonë, pas 20 vjetëve po nda ndodhë marshimi i minatorëve nga Mitrovica në Prishtinë, por kësaj radhe me kërkesë për ekzistencë nga institucionet e veta.

Sfidë e madhe për AKP-në, mbetet rishikimi i statusit të ndërmarrjeve të Gjakovës, si ndërmarrja “Emin Duraku”, “Virxhinja” që kanë kaluar nën administrimin direkt të AKP-së, si dhe ndërmarrjet e tjera si Qendra e Rinisë dhe e Sporteve, ndërmarrja e re “Llamkos” si dhe trajtimi i parcelave të tokës që rezultojnë me keqpërdorime të dokumenteve kadastrale nga zyrat lokale. Shembull tipik është, këto ditët e fundit, shumë është duke u biseduar edhe aktuale avullimi i mbi 6 hektarëve të tokës të QKUK-

së, që ka ndodhur në periudhën pas lufte, gjë që do të kërkojë angazhimin e institucioneve relevante për të zbardhur këtë keqpërdorim.

Kemi dilema se është respektuar çështja e sigurimit të konkurrencës gjatë privatizimit të ndërmarrjeve, si për shembull “Vala 40”, që është mbajtur në nëntor 2009, ka përmbajtur 24 ndërmarrje shoqërore, kurse numri total i ofertave ishte 29, që vështirë do t’i plotësonte kushtet për më shumë se një ofertues. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me “Valën 39”. Se sa i dështuar dhe i dhimbshëm ka qenë procesi i privatizimit për vendin tonë, është kur bëjmë bilancin e rezultatit, çka në të vërtetë përfituan qytetarët tonë, vendi ynë nga proces. Spinofi ka qenë dështim për arsye se menaxhmenti i AKM-së e më vonë edhe i AKP-së, do të thosha se nuk ka përfillur kriteret me të cilat janë shitur këto ndërmarrje. Fabrikat falimentuan, punëtorët mbetën në rrugë, pa punë dhe askush nuk dinë për fatin e 459 milionëve të realizuara nga privatizimi. Askush nuk e di, por as kryetari i Bordit të AKP-së, se ku janë këto mjete, ku janë investuar, përveç se vlera e interesit të tyre është shumë e ulët 0,1%. Qeveria e Kosovës do të duhej gjithnjë shpejt ta bëjë punën e vet që edhe paratë e privatizimit të vejnë në funksion dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë, nga se investimi i këtyre parave, do të obligonte ofertën financiare në Kosovë, do ta zbehte presionin e bizneseve me kredi të larta dhe do të ishte një arritje më e lartë e vendit.

Ajo që është mjaft e pakuptueshme, është që tërë ekonomia e Kosovës, do të thotë ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë bërë diku rreth 90% të industrisë së Kosovës, janë shitur vetëm me 450 milionë euro. Me sa di unë, vetëm Kombinati i Duhanit të Nishit në Serbi, është shitur mbi 700 milionë. Tash, merrni me mend një kombinat i duhanit të Nishit ka vlerën gati dyfish më të madhe se krejt ekonomia e Kosovës. Në fund, konsideroj se ky raport është vetëm përshkrim i punës së tij dhe konsideroj se procesi i privatizimit i të mirave ekonomike të popullit të Kosovës, ka qenë jo transparent, jo konkurrues dhe ka pasur raste që është bërë kundër interesave kombëtare, gjë që ka lënë dyshime të mëdha te qytetarët e Kosovës.

Përmbyllja e procesit të mbetur privatizimit, me siguri do të kërkojë transparencë, qartësi, mbi të gjithat vetëdijesim, pjekuri morale dhe shtet-formuese të institucioneve tona shtetërore, që e tëra të kthehet në të mirë të qytetarëve tanë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegët e mi deputetë,

Edhe sot edhe javën e kaluar diskutuam pak a shumë për këtë temë, e cila është me rëndësi për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe mendoj që shumëçka u trajtua në përgjithësi që ka të bëjë edhe me ndërmarrjet publike edhe me procesin e privatizimit.

Mendoj duke analizuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe nga direktivat e saj të paraqitura për vitin 2009, shihet qartë se kjo agjenci, ka arritur objektivat për këtë vit. Por, përveç këtyre sukseseve të arritura, sfida më të mëdha me të cilat duhet të ballafaqohet dhe ballafaqohet gjatë këtij viti, mendoj për vitin 2010, dhe si çështje shqetësuese janë ndërmarrjet e privatizuara me spinof special. Në muajin janar,

patëm rastin e parë kur Bordi i drejtorëve të AKP-së, e ushtroi opsionin e tërheqjes së aksionit ndaj ndërmarrjes së re “LLamkos”, por edhe disa ndërmarrje të cilat janë privatizuar me spinof special, janë larg përmbushjes së zotimeve për investime dhe punësim, andaj ky fakt është shumë shqetësues.

Esenca e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, ka qenë që të vazhdohet veprimtaria e njëjtë dhe të ruhet niveli i punësimit në këto ndërmarrje edhe pas privatizimit, andaj këto elemente kanë ndikim direkt në zhvillimin ekonomik të vendit. Prandaj, në rast të mosrealizimit të zotimeve nga ofertuesit fitues të këtyre ndërmarrjeve, Bordi i drejtorëve të AKP-së, duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme. Siç shihet edhe në raport, sfidë tjetër e këtij institucioni është edhe ndryshimi i Ligjit për themelimin e AKP-së, gjegjësisht harmonizimi i këtij ligji me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për status të presidentit Ahtisari. Këto ndryshime, duhet të bëhen për të mundësuar funksionim më të mirë të AKP-së dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, lidhur me përshpejtimin e procesit të privatizimit, me theks të veçantë likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe procesin e shpërndarjes së 20% për punëtorët e kualifikuar, si element kryesor në realizimin dhe përmbushjen e objektivave brenda afateve ligjore.

Andaj ne si Kuvend, duhet që domosdoshmërisht të ndërmarrim masat e nevojshme lidhur me ndryshimin e këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse kryetari kërkoi nga ne, sidomos të pozitës të jemi shumë të shkurtër, atëherë do të mundohem që të fokusohem vetëm në një nga çështjet. Së pari do ta falënderoj Agjencionin Kosovar të Privatizimit për raportin e shkëlqyer që neve na e ka sjell edhe raportin e kaluar të cilin e kemi debatuar, po ashtu ka përmbajtur shumë detaje dhe në mënyrë shumë koncize e ka përshkruar situatën në përgjithësi brenda agjencionit dhe çështjen e privatizimit.

Po ashtu, edhe ky raport përmban detaje për mënyrën e privatizimit dhe valët e privatizimit, po ashtu edhe njësitë që ekzistojnë brenda agjencionit të privatizimit dhe funksionimin e tyre. Do të ndalesha tek çështja e 20%-it, meqenëse shumë herë u ngritë si debat nga ana e deputetëve, dhe dua të them se, ta marrë një shembull, shifrat, në qoftë se e marrim një shifër që sillet 18 milionë që ka qenë pjesë e shpërndarë e mjeteve në fillim të vitit, pjesa e 20%, domethënë që i është shpërndarë të gjithë punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuar, më datën 31 të këtij viti shuma e tillë ka arritur vlerën 26 milionë dhe kjo pikërisht duke iu falënderuar një reforme apo një ndërhyrjeje që ndryshe quhet edhe shpërndarje e pjesërishtme, të cilën e ka ndarë Agjencioni i Privatizimit në mënyrë që punëtorëve t’u shpërndahet 20 përqindëshi. Dëshmi për këtë janë edhe grevat e pakta të punëtorëve që kohëve të fundit fare ose aspak i kemi parë para Agjencionit të Privatizimit, të cilët konstantë kanë protestuar për shkak të shpërndarjes së 20%.

Çështje tjetër që desha të përmend është edhe një fakt, deri me datën po ashtu 31 të këtij viti janë privatizuar diku 576 ndërmarrje të reja, prej tyre 51 janë privatizuar përmes spinoffit të rregullt, ndërsa 25 prej tyre janë privatizuar me spinoffin special dhe në Fondin e privatizimit deri më tani janë të akumuluar diku mbi 462 milionë euro.

Çështja e cila mendoj është mjaft brengosëse, është puna e Dhomës së Veçantë apo e Odës së Veçantë, e cila siç u përmend edhe shumë herë është një nga pikat më të dobëta apo që më së tepërmi ngec brenda privatizimit dhe dua të përmend që një nga gjykatëset të cilat deri vonë ka qenë aty nga... shqiptare, ajo tani ka dhënë dorëheqje dhe ne çalojmë, nuk e kemi përfaqësuesin gjyqësor brenda Odës së Veçantë. Do të bëjë apel që domethënë sa më shpejt të zgjidhet ky problem si dhe numri i gjykatësve të caktohet, varësisht nga numri i lëndëve apo çështjeve të cilat agjencioni i ka për t'i trajtuar.

Në parim e përkrah raportin dhe votoj “për”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Abdyl Ymeri.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër,

Deputetë të respektuar,

Fillimisht të them se sa i përket privatizimit nëpërmjet metodës spinoof, qoftë edhe spinooff special, Shoqata e Juristëve të Kosovës, bashkë me Lidhjen e Ekonomistëve të Kosovës kanë pas dhënë pikëpamjet e papranueshme dhe ato pikëpamje i ka pas mbështetur një nga ekspertët më të mirë të transformimit të pronës shoqërore, zotëri Djoli Dickson, madje pikërisht ndoshta edhe për këtë supozim i bazuar, ka qenë shkarkuar, sepse dikujt i ka konvencuar privatizimi i këtillë që shihet se është dështim i madh dhe është në disfavorin e ekonomisë së vendit tonë.

Privatizimi deri më sot karakterizohet me këto të veçanta.

Një, ishte int-transparent, ishte abuziv, them ishte se s'ka përfunduar, me kurdisje të çmimeve, çmimet të kurdisura jashtëzakonisht të ulëta, më pastaj uzurpime të konsiderueshme. Një nga kolegët e përmendi Qendrën Klinike Universitare, jam relativisht mirë i familjarizuar me rrethanat e asaj qendre. Aty toka është jashtëzakonisht e shtrenjtë, ndoshta 50.000 euro një ari dhe...

KRYESUESI: Koleg, lidhur me raportin, mundësisht!

RIZA SMAKA: Po, kjo është kjo. Subjektet ekonomike, shoqërore produktive janë privatizuar, edhe si të tilla janë shkretëruar. Ka shumë, me mijëra hektarë tokë buke që janë privatizuar edhe që kanë qenë produktive, kanë qenë, po zëmë, vreshta, kanë qenë tokë produktive, sot janë devastuar krejtësisht. Ose se spinof e ka kuptimin nga anglishtja me tjerrë, e prej saj me tjerrë diçka më të mirë, ndërsa kjo që aplikohet është e kundërta. Për shembull, pikërisht ai aktivitet biznesor që është zhvilluar jo që është kultivuar në një nivel më të lartë, por se është braktisur krejtësisht. Edhe kjo është për vajtim.

Kontratat, zotëri kryesues, dhe kolegë të nderuar, kontrata është ligj, Kontrata është pacta sunt servanda, e obligon këndo. Kontratat nuk përfillen pothuaj se fare, nuk përfillen fare, e po le të kontrollohen atëherë, atëherë AKP-ja le t'i kontrollojë, ka instrumente për t'i kontrolluar ata që i kanë përvetësuar asetet, e nuk i përfillin. Ajo gjithnjë është abuzim i rëndë.

Sa i përket Dhomës së Veçantë, edhe në raport thuhet, kjo është një institucion shumë problematik, thuhet se është në kuadrin e Gjykatës Supreme, nuk është fare, as organizativisht as funksionalisht dhe kjo Dhomë, kjo pothuaj se nuk funksionon ose keq

funksionon. Ka shumë raste kur palët në procedurë me mundimet më të mëdha të tantalit kanë fituar kontestet, mirëpo aktet gjyqësore nuk përmbrohen. Ju lutem është fjala për paranë që pa diskutueshëm u takon dhe është konfirmuar edhe në procedurë gjyqësore, mirëpo aktvendimet e tilla, aktgjykimet nuk përmbrohen. Kjo ndodhë vetëm te ne.

Sa i përket 20%, u fol, domethënë këtu është fjala për privime të drejtave elementare pronësore private. Se privatizimi i derisotëm ishte me të vërtetë problematik për të keq, ja po tregon edhe kjo faktografi, 2.455 ankesa pa parashtresa, ama parashtresat janë padyshim ankesa, do të thotë, numër enorm i rasteve që shprehimisht në mënyrë eksplicite e ka shprehur pakënaqësinë, ama numri më i madh i këtyre ankuesve nuk ka marrë asnjëherë përgjigje. Edhe nuk është fjala për të marrë përgjigje, por duhet të merr akt juridik me vlerë, me arsyetim e me udhëzim juridik. Kjo nuk ndodhë. Do të duhej të stopohej ky proces i këtillë, do të duhej të bëhej një analizë kritike, analitike e privatizimit të derikëtushëm dhe të përcaktoheshin propozime masash. Në bazë të atyre propozimeve të masave do të duhej të bëhej një normim, një amendim, një modifikim i disa normave juridike aplikative që janë problematike dhe të bëhej një modifikim i përshtatshëm, se fundi i fundit, nuk ka normë juridike që nuk është e prekshme, që është e padiskutueshme dhe vetë praktika e ka treguar deri këtu e ka argumentuar se baza apo korniza legjislative është in-adekuate dhe si e tillë kërkon modifikim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Rimëkëmbja e ekonomisë së shkatërruar të Kosovës ishte e lidhur ngushtë me fillimin e procesit të privatizimit në Kosovë, proces ky i cili është vlerësuar edhe nga ekspertët e ekonomisë si një nga detyrat më të rëndësishme dhe prioritare për ngjalljen e kësaj ekonomie. Për këtë ka mbizotëruar mendimi dhe ka qenë një vlerësim i përgjithshëm se nevojitet një kapital serioz për rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, i cili vështirë se do të sigurohet pa privatizimin e ndërmarrjeve ekonomike, shoqërore dhe publike në Kosovë.

Është e kuptueshme se procesi i privatizimit, i udhëhequr në fillim nga AKM-ja, në rrugën e tij ka pasur vështirësi dhe bllokada të shumta, ka pasur tendenca edhe për ta penguar në tërësi procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe atyre publike, pengesa të cilat janë tejkaluar, por ka pasur edhe vlerësime nga më të ndryshme se është dashur të përdoret kjo apo ajo metodë, ky apo ai modalitet i privatizimit.

Në të gjitha këto pengesa dhe probleme ky proces tani po vazhdon të zhvillohet nën udhëheqjen e AKP-së, mirëpo rezultatet e shumëpritura që kanë qenë, do të thosha, pritje shumë më të mëdha dhe cilësuar si hap i një rëndësie të veçantë për nxitjen e zhvillimit ekonomik, këto pritje nuk janë inkurajuese, sepse nga 545 ndërmarrje të privatizuar deri më tani kanë rezultuar të suksesshme një numër shumë i vogël i këtyre ndërmarrjeve, kurse pjesa tjetër e ndërmarrjeve të privatizuar që është më e madhe nuk janë në funksion, sepse pronarët e rinj nuk kanë bërë investime, përkundrazi shumë prej tyre iu është ndërruar edhe destinimi që kishte më parë, të privatizuar në formën e spinofit të rregullt, që do të thotë se nuk ka pasur asnjë obligim për punëtorët që kanë punuar më parë, që do të thotë se kemi zvogëlim të numrit të punëtorëve.

Procesin e privatizimit në periudhat e caktuara e ka përcjell ndërprerja dhe vonesat e shumta, mospërbushja e obligimeve nga pronarët e rinj si dhe vonesa të shumta të shpërndarjes së 20% për punëtorët nga Fondi i privatizimit.

Ndërmarrjet e privatizuar sigurisht se kanë pasur një vlerë më të madhe të aseteve të tyre, por janë shitur me çmime të ulëta, me çka shihet se në Fondin e privatizimit janë akumuluar afër 460 milionë euro, para të cilat nuk shfrytëzohen dhe të cilat po qe se kthehen dhe futen në tregun tonë do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik.

Raporti si i tillë, në tërësinë e tij është përmbajtësor, ka të dhëna që pasqyrojnë punën e agjencionit gjatë një viti. Në pjesën kur shkruhet për auditimin është shumë i përgjithësuar, sepse nuk shkruhet për të gjeturat, cilat janë ato dhe sa rekomandime janë dhënë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e performancës po qe se ato fillojnë të zbatohen në vitin vijues.

Do të përfundoja fjalën time duke kërkuar nga ky agjencion që të përshpejtojë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, pastaj të rishikohet procesi i likuidimit të atyre ndërmarrjeve të cilat ende nuk janë likuiduar, të bëhet përshpejtimi i procedurave për shpërndarjen e 20% të punëtorëve dhe të gjejnë zgjidhjen përfundimtare, nga Qeveria e Kosovës të shqyrtohet mundësia e kthimit të mjeteve të cilat janë në Fondin e privatizimit, të zhblokohen ato sa më shpejt që është e mundur dhe ato mjete të investohen në Kosovë, të cilat do të ndikonin në rritjen ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës.

Të diskutosh dhe të analizosh raportin i cili është objekt shqyrtimi sot këtu është e pamundur e të mos ndërlidhesh edhe me procesin e privatizimit apo më mirë të them edhe me Agjencionin e Privatizimit të Kosovës. Kjo për shumë arsye që kolegët e mi i përmendën pak më përpara, por edhe për disa arsye që vetë do t'i cek.

Si do që të jetë, mendoj se këtij raporti i mungon regjistrimi i ndërmarrjeve që janë privatizuar definitivisht, i ndërmarrjeve që janë në kontest dhe i ndërmarrjeve që presin për t'u privatizuar. Përveç kësaj, këtij raporti i mungon edhe sipërfaqja tokësore bujqësore në tërë territorin e Kosovës, që është akoma pronë shoqërore, sepse për tokën tjetër bujqësore mund të themi se ajo është privatizuar shkel e shko. Pse them shkel e shko? Sepse ka ekzistuar një agro-kombinat i Kosovës, i cili në kuadër të vetin ka pasur shumë kooperativa bujqësore dhe privatizimi është bërë kooperativë për kooperativë, por ka edhe kooperativa bujqësore që Momçillo Trajković, siç është kooperativa bujqësore e Lipjanit e ka shitur tërë pronën bujqësore, tokën bujqësore të kooperativës bujqësore të Lipjanit dhe tani nuk kemi asnjë pëllëmbë toke bujqësore aty, por kemi vetëm zona komerciale – industriale, sikur që po e shihni edhe vetë, në të dy anët për Shkup.

Nga ana tjetër, këtu në raport thuhet 500 ndërmarrje të reja. Nëse di për të interpretuar diçka, ndërmarrje të reja nënkuptohen që të jenë themeluar ndërmarrje të reja nga institucionet apo Qeveria apo komunat e Kosovës, e mandej ato të jenë privatizuar. Përndryshe, 500 ndërmarrje të reja, unë nuk di sa janë themeluar apo krijuar prej përfundimit të luftës e këtej. E di se ka pasur ndaj 437 ndërmarrjeve publike dhe shoqërore masa të dhunshme, e di se ka pasur 210 ndërmarrje kapitale ekonomike të cilat

i ka privatizuar Serbia gjatë periudhës së okupimit dhe nuk dihet se ku janë ato para, por e di se prej atyre një pjesë – 51% kanë shkuar si pronë e Serbisë, 49% u janë ndarë aksionarëve apo më mirë të them punëtorëve që kanë punuar nëpër ato ndërmarrje.

Nga ana tjetër, ne sa i përket tokës bujqësore, nuk kemi dokumentacion origjinal për pronën bujqësore, sepse i tërë dokumentacioni origjinal për të gjitha pronat e paluajtshme është në Kurshumli dhe çdokush që ka ndonjë kontest duhet të marrë një dokumentacion atje i cili tash nuk pranohet edhe si i tillë. Kështu që, toka bujqësore, edhe nëse privatizohet dhe është pronë shoqërore, por privatizohet, asaj i mungon manuali, i mungojnë pikat apo kuotat, i mungojnë përkufizimet me pronat tjera, ndoshta përkufizohet me një pronë private, kështu që mund të lindin shumë lehtë edhe konteste lidhur me këto toka bujqësore. Prandaj, mendoj se patjetër, pavarësisht se kemi disa të dhëna, kemi Agjencionin Kosovar Kadastral, kemi fotokopjet e dokumentacionit, unë lirisht mund të them se pa arsye, pa ndonjë arsye regjimi serb me rastin e tërheqjes nga Kosova, të forcave ushtarake e policore, nuk do ta merrte edhe tërë materialin apo të dhënat kadastrale për pronat e paluajtshme të Kosovës.

Nën 3, për ndërmarrjet që janë privatizuar nuk ka në raport të dhëna nëse ata që i kanë privatizuar ndërmarrjet janë akoma pronarë të atyre ndërmarrjeve të privatizuar, sepse kemi shumë raste kur ato ndërmarrje janë privatizuar po e zëmë nga Nekibe Kelmendi dhe Nekibe Kelmendi brenda natës ia shet tjetërkujt për një çmim dyfishë më të madh dhe kështu brenda natës pasurohet për 100% nga një privatizim i një ndërmarrjeje. Edhe këtë duhet ditur dhe edhe kjo për mua, për mendimin tim, është një kontratë jo e ligjshme – nule, që nuk do të duhej të prodhonte efekt juridik.

Nga ana tjetër, në raport ka të dhëna lidhur me vendosjen e kërkesave për tokë bujqësore, për pronë komerciale dhe për pronë banesore. Mirëpo, lidhur me shumë prona bujqësore, banesore, komerciale e tjera, ka konteste të cilat zhvillohen jo në Dhomën e veçantë, por zhvillohen në gjykatat e rregullta, sepse njëra palë pretendon, që është palë – person fizik, pretendon se ka një të drejtë prone. Mirëpo, kur të mbahen shqyrtimet kryesore ndonëse sipas Ligjit për themelimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, ky agjencion ka mandatin dhe ka kompetencën të përfaqësojë në kontestet në ato gjykata, pra nëpër gjykata akoma po i përfaqëson UNMIK-u. Unë nuk e kuptoj tash a është UNMIK-u akoma përfaqësues dhe menaxhues i ndërmarrjeve apo është Agjencioni Kosovar i Pronës? Prandaj, edhe nuk kemi në raport asnjë të dhënë dhe asnjë informatë se sa konteste janë duke u zhvilluar të kësaj natyre nëpër gjykata, në sa konteste ka përfaqësuar Agjencioni Kosovar i Privatizimit, ani pse me nenin 29, paragrafi 3 të Ligjit mbi themelimin e Agjencionit të Privatizimit përfaqësimin nëpër gjykata e bën pikërisht ky agjencion dhe me dispozitën e fundit të këtij ligji thotë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, që është për themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit dhe Rregullorja 2002/13 që është për jo, vetëm 12, thotë – shfuqizohen. Edhe Agjencia i merr të gjitha detyrimet të cilat i ka pasur përpara UNMIK-u. Nëse i ka pasur përpara UNMIK-u përfaqësimet, atëherë do të duhej logjikisht edhe formalo-juridikisht përfaqësimet t'i ketë kompetencë Agjencioni Kosovar i Pronës.

Çështja tjetër ka të bëjë edhe me.... këtë veç e ceka, dokumentacionin origjinal kadastral. Pa dokumentacion origjinal, sidomos manuali i cili është alfa dhe omega për identifikimin e një prone dhe përkufizimin e saj nuk mund të bëhet asgjë. Mund të ju them se shumë toka bujqësore janë shitur edhe pse kanë qenë shoqërore gjatë viteve të 90-ta, ato prona janë shndërruar në prona private në bazë të anulimeve të kontratave për shitblerjen të vitit 1963 vetëm e vetëm për t'u favorizuar dikush, e dihet se kush dhe ato

toka sot janë të gjitha të shitura dhe janë toka bujqësore dhe Kosova një ditë kurrë të sosën resurset njerëzore nuk do të ketë as tokë bujqësore dhe nuk dihet prej çka do të jetojnë këta njerëz.

Dhe në fund, ndërmarrja “Trepça”. Është e vërtetë se ka një përparim në fushëveprimin e saj, mirëpo ndërmarrja “Trepça” ka edhe njësitë e veta nëpër qytete tjera të Kosovës. Do të ishte shumë mirë që Qeveria e Republikës së Kosovës nga paratë e grumbulluara të privatizimit ta zhvillonte një industri ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, gjysmë minute – një minutë!

NEKIBE KELMENDI: Pra, në te duhet të përpunohej lënda e parë që nxirret nga “Trepça” këtu sepse në këtë mënyrë edhe do të krijohet një mundësi për punësimin e njerëzve të papunësuar të rinj apo të moshës së mesme dhe nga ana tjetër Kosova do të përfitonte shumë më shumë dhe do të forcohej ekonomiksht, sepse si lëndë e parë ajo shitet për një çmim shumë të vogël. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i AKP-së për vitin 2009 paraqitet struktura organizative e AKP-së dhe aktivitetet e Bordit gjatë vitit 2009, drejt arritjes së caqeve për privatizimin e ndërmarrjeve të mbetura me fokus të veçantë të ndërmarrjeve shoqërore për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Koha kur ka filluar procesi i privatizimit nga misioni i administratës ndërkombëtare, Kosova nuk ka qenë e përgatitur në aspektin institucional dhe ligjor dhe as në aspektin politik të fillojë privatizimin, prandaj ka qenë proces i dhembshëm dhe është përcjell me korrupsion dhe padrejtësi të mëdha.

Përmes disa raporteve dhe mjeteve të informimit të sindikalistëve dhe njohësve të ekonomisë thonë se privatizimi në Kosovë ka pasur të meta që nga fillimi, ky proces është karakterizuar me pak investitorë, çmimet e lira, zvogëlim të numrit të punëtorëve, mos përmbushje të premtimeve të blerësve në shpërndarjen e 20% dhe shumë probleme të tjera. Deri më tani janë privatizuar 545 ndërmarrje shoqërore prej të cilave 521 me spinoff të rregullt dhe 24 me spinoff special. Nga këto ndërmarrje në Fondin e privatizimit janë akumuluar 460 milionë euro, këto mjete ende diku mbahen në banka jashtë Kosovës pa përfshirjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

Unë përshëndes punën e Bordit të drejtorëve që përmes këtij raporti paraqet punën njëvjeçare të AKP-së për vitin 2009, që duke pasur parasysh situatën e trashëguar dhe vështirësitë lidhur me Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës AKP-ja ka miratuar transaksione të “Valës 34” deri në transaksionet e “Valës 41” të privatizimit ku ka arritur të tenderojë 85 ndërmarrje shoqërore në 98 ndërmarrje të reja, në total 102 kontrata të spinofëve të rregullta i ka nënshkruar, 65 kontrata të shitjes së aseteve me

likuidim, ka arritur të publikojë 27 lista përfundimtare të punëtorëve dhe 85 lista të reja që ende janë të varura nga Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme për shqyrtim.

AKP-ja edhe përkundër miratimit të planit ambicioz të biznesit për vitin 2010 në këtë raport asnjë fjalë nuk prezanton politikat dhe prioritetet për vazhdimin e procesit të privatizimit në ndërmarrjet shoqërore. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e pasqyrës financiare për vitin 2008 dhe ka lëshuar në korrik të vitit 2009, një raport ku pasqyrat financiare paraqesin pasqyrë të drejtë, por ia ka tërhequr vërejtjen Agjencisë për mungesë të raportimit nga pjesa e veriut të kompleksit “Trepça”. Me asnjë të dhënë nuk paraqitet vlerësimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në këtë raport.

Ajo që vlen për t’u potencuar është se AKP-ja për të realizuar kontrollin e historikut të ofertuesve fitues ka lidhur Memorandumin e mirëkuptimit në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës dhe drejtorit për analizën e krimeve dhe i ka dërguar 110 raste për kontroll policisë. Kjo lë shpresën se do të evitohen deri diku mangësitë që e kanë përcjell këtë proces.

Nën administrimin direkt të AKP-së janë 11 ndërmarrje ku prezantohen edhe arsyet pse janë futur nën administrim. Arsyeja është mospërfitimi i këtyre ndërmarrjeve. Ndërmarrjet e komercializuara janë 9, që 4 prej tyre janë privatizuar në afatin kohor e 5 janë ndërprerë nga komercializimi për arsye se nuk i kanë përmbushur zotimet.

Ndërmarrjet e privatizuar me spinoff special janë 4 dhe siç paraqiten në raport, është Feronikeli, Fabrika e ujit Kllokot, Vreshtaria dhe Veraria në Rahovec, silosi, Birraria e Pejës dhe hoteli Theranda në Prizren dhe Kompania hoteliere “Trofta” në Istog, me spinoff të rregullt.

Bordi i drejtorëve në shkurt të vitit 2009 ka shqyrtuar opsionin e tërheqjes për 4 ndërmarrje me spinoff special. Për 8 ndërmarrje Boardi iu ka dhënë afat të paraqesin planet dhe dinamikën e përmbushjes së zotimeve dhe dëshmi për sigurimin e mjeteve financiare për përmbushjen e këtyre zotimeve, në të kundërtën, tërhiqen aksionet.

Raporti përfshin edhe aktivitetet e përgjithshme të ndërmarrjes “Trepça” e cila përbëhet nga disa asete ku disa prej tyre gjenden në Veri të Kosovës dhe ato nuk janë ende të kontrolluara nga AKP-ja. Pra, raporti përfshin vetëm aktivitetin e “Trepçës” në pjesën jugore.

Minierat e “Trepçës” me njësitë prodhuese, sipas raportit, kanë rritur prodhimin diku për 30%, mandej është bërë rritja e të hyrave, ka kaluar 60%-shin, por edhe investimet kapitale për mirëmbajtjen e këtyre minierave kanë kaluar shumë prej 2,5 milionë.

Privatizimit po i vjen fundi. AKP-ja ka konstatuar se ndërmarrjet më të mëdha u janë shitur njerëzve të papërgjegjshëm. Instituti për Hulumtime, “Riinvest” thotë se duhet shikuar procesi i privatizimit, sepse sipas tij një numër i vogël i ndërmarrjeve të privatizuar janë treguar të suksesshme. AKP-ja fuqishëm beson se e ka kryer punën mirë. Për të qenë më e suksesshme, kërkon rishqyrtimin e legjislacionit të AKP-së dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që të përshpejtohet procesi i privatizimit.

Me këtë rast më habit fakti se AKP-ja, as AKM-ja dhe as Qeveria deri më tani nuk kanë dal me një studim që do të pasqyrojë në mënyrë gjithëpërfshirëse ndërmarrjet e privatizuar, për efektin e tyre në ekonomi, aspektin social, si dhe ndikimin e këtyre

ndërmarrjeve në mesin biznesor. Kuvendi duhet të jetë në nivel të përgjegjësive. Nuk mund të kërkojmë përgjegjësi as nga Qeveria as nga AKP-ja nëse nuk miratojmë Ligin për privatizimin e ndërmarrjeve publike, Ligjin për shoqëritë aksionare, Ligjin për letrat me vlerë, Ligjin për tregun e aksioneve dhe Ligjin për funksionimin e bursës, sepse përmes tyre bëhet përcaktimi real i faktorëve ekonomik.

Si mund të privatizohet toka e Kosovës dhe të caktohet titullari i ri kur Kuvendi ende nuk e ka miratuar Ligjin për pronën, në mënyrë që AKP-ja të jetë në nivel të përgjegjësive për zbatimin e këtyre ligjeve.

Në fund, e përkrah raportin e AKP-së me rekomandimet e Komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Tani po thuaj se të gjitha u thanë dhe t'ju them të drejtën edhe vetë interesimi i deputetëve nuk është aq në nivel për ta zgjatur.

Desha vetëm t'ju përkujtoj se Kushtetuta e Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor të vitit 2008 dhe tek më vonë është themeluar Agjencioni Kosovar i Privatizimit. As dy vjet nuk i ka që nga funksionimi. Shumë nga diskutuesit këtu në fillim të debatit folën për procesin e privatizimit që nga fillimi, për politikat e privatizimit që i ka ndjekur UNMIK-u dhe nuk folën për raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Unë mund të them se ky raport është pa krahasimisht më i mirë dhe është në nivel të duhur, ofron mjaft të dhëna për gjendjen e ndërmarrjeve të privatizuara. Ne nuk kemi pasur rast kurrë të marrim një raport të tillë më herët nga UNMIK-u dhe mund të them se Agjencioni ka bërë përpjekje pothuaj se të pamundura për të krijuar një rregull brenda Agjencionit.

Ju jeni dëshmitarë dhe mirë e dini në çfarë gjendje e ka marrë Bordi aktual punën në Agjencionin të Privatizimit. Si e ka lënë UNMIK-u këtë institucion dhe mund të them se rezultatet janë evidente. Tjetër është legjislacioni në fuqi. Unë mbështes Bordin e drejtorëve të Agjencionit, i cili bën apel që të ndryshohet infrastruktura ligjore në mënyrë që të shtohet efikasiteti i punës së këtij agjencioni, por propozoj që vetë agjencioni të propozojë dispozita të reja ligjore për amendamentimin e ligjit ku i mundëson Agjencionit pavarësi më të madhe në vendimmarrje dhe efikasitet në punë.

Është shqetësuese që ne si Kuvend i Kosovës, por edhe Qeveria në këtë drejtim që mos të bëjë më shumë që 20% i punëtorëve të vijë në xhepat e tyre. Për aq sa jam unë i informuar asnjë individ nuk ka mund pothuaj se të zgjidhë një problem individual me Agjencionin e Privatizimit. Raporti i individit me shtetin në Kosovë duhet të ndryshojë. Individit duhet të arrijë drejtat e veta, ato të cilat i ka të garantuara me Kushtetutë dhe jo të presë sikur qysh ndodh në rastet këtu në Kosovë, pra aktualisht. 20% nuk është edhe problemi më i madh i privatizimit në Kosovë. Mund t'ju them se problemi i privatizimit në Kosovë ka qenë shumë i dhembshëm dhe ka qenë krejtësisht në kundërshtim me të drejtën pozitive ndërkombëtare dhe ka ra ndesh me të drejtat elementare të njeriut. UNMIK-u nuk kishte të drejtë të bëjë transformimin e pronës me asnjë dokument ndërkombëtar. Ishte vetëm një vullnet politik i përkrahur nga klasa e

atëherëshme politike që të fillojë procesi i privatizimit gjëja se UNMIK-u po bën përpjekje për zhvillimin e Kosovës. Pozita politike e Kosovës, Kosova si entitet gjeo-politik, pa status të definuar, nuk guxonte të hynte në procesin e privatizimit dhe u dit qysh në fillim që ky proces do të dështojë. Prosesi i privatizimit në Kosovë ka dështuar. Ka dështuar për shkaqe politike, për shkak të kontestit historik politik, në të cilin Kosova ka kaluar, mirëpo tani me legjislacionin e ri, me ndryshimet e legjislacionit unë mund t'ju them se Agjencioni ka ekspertizë të mjaftueshme që të ndryshojë një çik strategjia e privatizimit në Kosovë dhe të përshpejtohet ky proces.

Për mua me rëndësi është privatizimi, jo edhe sa do të shiten ndërmarrjet tona. Ata të cilët pretendojnë se do të fitojnë para nga shitja, gabojnë. Kjo strategji në Kosovë s'mund të aplikohet. Ne duhet të jemi të lumtur që dikush t'i marrë këto ndërmarrje, t'i menaxhojë dhe të investojë kapital, për arsye se Kosova akoma ka probleme të mëdha me tregjet e huaja, jashtë vendit dhe investimet dy herë edhe në teknologji prodhuese moderne edhe në asetet aktuale të ndërmarrjeve në Kosovë do t'i largojnë investitorët nga Kosova, kurse Kosova nuk mund të dalë nga varfëria kurrë për deri sa nuk e kryen këtë proces dhe nuk fillon që të vijë kapitali në Kosovë. Kosova ka kapitalizmin, pa kapital kurse në të kaluarën për fat të keq kishim socializmin pa politika sociale. Ne duhet të dalim nga ky proces, nga ky rreth vicioz me vendime të guximshme politike duke ofruar kushte për investitorët dhe duke ofruar mundësi që investitorët të bëhen pronarë të ndërmarrjeve tona dhe paratë të cilat i kanë t'i fusin në teknologjinë prodhuese, në mënyrë që të hapim vende të reja të punës. Përndryshe, problemi në procesin e privatizimit do të ekzistojë edhe një kohë në Kosovë. Ju e dini as Maqedonia, as Shqipëria, as shtetet tjera në rajon, të cilat nuk kanë pasur konflikte të natyrës çfarë kemi pasur ne nuk e kanë përfunduar procesin e privatizimit, por privatizimi megjithatë në Kosovë ka filluar...

KRYESUESI: Lidhur me raportin, mundësisht!

GANI BUÇINCA: ... Unë e mbështes... Unë e di në përgjithësi se shqiptarët janë hakmarrës dhe donë të hakmerren dhe nuk më pengon kjo se edhe unë jam shqiptar. Unë e mbështes raportin dhe e përgëzoj Agjencionin për punën e bërë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Kah fundi, singerisht, nuk ishe në pikën e rendit të ditës, pavarësisht qysh e kualifikon ti ndërhyrjen time. Dhe vazhdojmë me deputetin e radhës, Gani Geci, le të përgatitet deputeti Ramadan Avdiu.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kur flasim për privatizimin, unë që në fillim dua të them se të gjithë ne jemi për privatizimin, askush nuk është kundër. Dhe në dorë kemi një raport të Agjencionit Kosovar të Privatizimit që në fakt është një raport mjaft i mirë, me ngjyra evropiane.

Të nderuar deputetë,

Unë këtu dëgjova edhe parafolësit e mi dhe unë do të ndërlidhem qysh në fillim se paratë e privatizimit nuk janë në Kosovë. Tanë po e dimë që nuk janë në Kosovë. Nëse afaristët kosovarë marrin kredi, me fajde në njëfarë forme se kreditë me 15% nuk janë kredi, janë fajde, ndërsa ne ato para i kemi me 0.10% në bankat evropiane apo edhe nuk dimë ku i kemi për shkak se në këtë raport nuk shkruhet ku janë paratë e privatizimit, në cilën bankë. Gjithashtu parafolësit e mi thanë se është bërë edhe falsifikim i dokumenteve të kadastrës dhe dokumentet e kadastrës qenkan diku në Nish. Sipas asaj se qenkan diku në Nish është bërë falsifikim të dokumenteve....

Unë po dua t' i nxjerr disa dokumente të kadastrës që kanë të bëjnë me qendrën, me QKUK apo Qendrën Klinike spitalore në Prishtinë. Ju lutem, të nderuar deputetë, unë kam një dokument të vitit 1958 dhe në këtë dokumentin e vitit 1958 thotë se QKUK në vitin 1958 i ka pasur 43 hektarë e 82 ari. Po e kam edhe një dokument të vitit pak ma këndeje, të vitit 1980. Edhe ai dokumenti i vitit 1980 thotë të njëjtën gjë, që QKUK i ka pasur 43 hektarë e 82 ari, bile këtu shkruan 82 ara, pak shqip, pak serbisht. Gjithashtu unë e kam edhe një dokument tjetër të fletës poseduese, dokument zyrtar. Ky e ka datën e re 2004 dhe në këtë dokumentin e datës 2004 parcela 28.05/1 i ka 63 ari në një vend pikë 73 metra dhe 39 hektarë e 75 ari e 58 metra. Kjo është e kohës së UNMIK-ut me datën 26.4.2004. Po e kam edhe një dokument tjetër i vitit 2008. Më 11.11.2008, parcela e njëjtë, ngastra e njëjtë 28.05/1 i ka, atë shtëpinë aty nuk kanë mund me ia hëngër se ajo 63 ari e 63, është shpi, që shkruan, s'kanë mund me ia hëngër, po në vendin ku janë 39 ari e 75 metra janë 37 ari e 13 metra. Dhe prapë numri është i njëjtë. Numri 28.05/1 dhe prapë numri 28.05/1. Këtu 39.75 ndërsa këtu 37.13. Do të thotë 1 hektarë e 99 ari janë humbur në Qendrën Klinike të Kosovës, në Qendrën Universitare.

Ju lutem, unë nuk kam qare për pa i thirrur prokurorët. Qysh e ka emrin ai prokurori vendës Ismet Kabashi, po unë dyshoj që ky s'guxon me i ra andej kah QKUK, por po e thërras prokurorin Ismet Kabashin se tani mos me thirrur Ismet Kabashin më thonë po i thërret evropianët, po kur tutet Ismeti, i thërras ata. Po e thërras Ismet Kabashin: zotëri Ismet hajde shko heto ngastrën 28.05/1. E di që ti s'guxon. Nuk dua për ta thirrur këtë prokurorin e Finlandës a kah është ky, se tani më thonë, ky ish- komshi me Rusi e ju fill thoni marr informata prej Rusie. Po dua ta thërras një prokuror amerikan. A ka ndonjë prokuror amerikan se ai prokurori amerikan nuk e ka komshi Rusinë as Beogradin dhe tani s'keni çka të thoni.

KRYESUESI: Lidhur me raportin!

GANI GECI: E thërras një prokuror që të vijë dhe t'i hetojë ngastrat edhe të privatizimit dhe ngastrat e Kosovës. Ju lutem, ne, këtë tokë nuk mundemi me rritë. Kaq sa ka tokë Kosova, ato kilometra s'mundemi me i rritë, po në bazë të kësaj që po shoh unë dhe unë disa herë kam gabuar dhe sinqerisht ju kërkoj falje për ato gabime që i kam bërë se kam thënë – jeni majtistë. Sinqerisht, ju kërkoj falje. Mundeni të jeni ju majtistë vetëm për shkak se keni fotografinë e Enver Hoxhës përmbas , se ju jeni asi që krejt pasurinë e Kosovës po u mundofshi me shti në xhepa. Kështu që majtistëve duhet me ua heq këtë epitet sepse....

KRYESUESI: Gani, përmbaju rendit të ditës, Gani, të lutem!

GANI GECI: ... Ju lutem, unë në rend të ditës jam, për pasurinë e Kosovës po flas. Dhe, sinqerisht për atë që kam thënë majtistë, po ju kërkoj falje sinqerisht, sepse unë kam pas menduar se kam pas ndejtur në burg me Ramën, ju duhet me nda pasurinë... Mirëpo, juve, për sa i përket pasurisë, jo që ishit majtistë po krejt parat e Kosovës me mund po i shtini në xhep tuajin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu, le të përgatitet deputetja Salë Berisha- Shala.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet është fundi i debatit dhe thuaj se e gjithë materia është shterur, mirëpo më intrigoj diskutimi i fundit, diskutimi paraprak dhe unë nuk di çka ka Agjencioni Kosovar i Privatizimit me QKUK-n ose me parcelat e QKUK-s, me ato letra, zoti Geci duhet të shkoni në komunë të Prishtinës për të parë ku ka luajtur puna, ku s'po përputhen parcelat.

Sa i përket raportit, konsideroj se brenda suazave ligjore që i ka Agjencioni Kosovar i Privatizimit para nesh ka pru një raport shumë real dhe shumë profesional dhe mbi bazën e këtij raporti ne mund të konstatojmë edhe rritjen e performancës së Agjencionit Kosovar të Privatizimit.

Unë nuk do t'i përsëris ato çka thanë kolegët deputetë, por vetëm dua të inkurajoj Agjencionin Kosovar të Privatizimit që të vazhdojë dhe ta dinamizojë çështjen e shpërndarjes së 20%, por njëkohësisht do të dëshiroja që ta inkurajojë kryetarin, drejtorin e Bordit të Agjencionit, zotin Hasanaj i cili ka filluar dhe po insiston që Fondin e mirëbesimit ta kthejë në Kosovë dhe ta shfrytëzojë për zhvillim të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputetja... Gani Geci e merr fjalën për replikë.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues! Unë as atij nuk ia përmenda emrin po as ai mua s'ma përmendi emrin, por iu referua. Ne themi: “moj e mira nëpër tallë – në kallabllak njihet budalla”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me deputeten Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

KRYESUESI: Më fal deputete! Një minutë replikë – kundër replikë deputetit Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Unë asnjëherë nuk kam dashur që ta abuzoj mikrofonin e Parlamentit dhe ta stigmatizoj ose ta kualifikoj dikë. Por, kualifikimet të cilin e bën, le ta marrë për vete, sepse, vërtet i tillë është.

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, jo, s'ka të drejtë më. Vazhdojmë me deputeten Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë tani po flas si deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe e mora me qëllim fjalën që t'i përkujtoj... Një koleg i imi e përmendi kur është themeluar me ligj AKP-ja. Unë do të kursehem që të mos i përmend ato data, po do të thirrrem në nenet që e rregullojnë veprimtarinë e këtij agjencioni dhe që përshkruhen në këtë raport.

Bazuar në nenin 20, pika 20. të paragrafit 2 të Ligjit, Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe do të bëjë publik një raport vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë: nën a) pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë, b) veçmas nga llogaritë e Agjencisë pasqyrat financiare të llogarive dhe aseteve të cilat mbahen nga Agjencia në mirëbesim; nën c) listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrim direkt të Agjencisë në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, nën d) listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara

gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull; nën e) listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9 dhe nën f) listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit. Dhe të gjitha këto obligime ligjore të këtij agjencioni janë të përfshira në këtë raport.

Dhe ne këtu mund të flasim, poshtë e përpjetë edhe të kërkojmë nga ky agjencion në këtë raport që të përfshihen edhe çështje tjera që nuk janë në obligimin ligjor të këtij agjencioni, si për shembull ne mund të flasim këtu pse Feronikeli është ndotës i ambientit apo pse nuk i paguan tantiema buxhetit të Kosovës? Ashtu siç u tha, pse nuk flitet në raport për fillimin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, që nuk janë në mandatin ligjor të këtij agjencioni, po është Ligji për ndërmarrjet publike? Pra, pse flitet në raport për sukseset e “Trepçës”, ndërsa kemi protesta të minatorëve dhe duhet të thuhet dhe t’u jepet përgjigja se jo të minatorëve, por të ish- minatorëve të cilët Qeveria e kaluar dhunshëm i ka çuar në pension në vitin 2005 e shumë e shumë çështje të tjera të cilat u ngritën që për hir të opinionit duhet të jenë të sqaruara, apo u kërkua këtu pse nuk janë të detajizuara përfituesit gjatë privatizimit, domethënë pronarët që e kanë privatizuar? Pra, dihet se privatizimi ka ndodhur me spinof special dhe spinof të rregullt, ato ndërmarrje që janë privatizuar me spinoff të rregullt nuk janë më në mandatin e AKP-së që t’i kontrollojë se a po përcillet apo shitet prona apo jo, ndërsa në mandatin e AKP-së janë monitorimi i ndërmarrjeve të privatizuar me spinoff special e kështu me radhë.

Një tjetër gjë pozitive që më ra në sy, përfaqësuesi i LDD-së tha pse Komisioni funksional në fjalë, nuk jep rekomandime, por na bie një rekomandim vetëm ta mbështesim, pa ndonjë arsye dhe ka shumë të drejtë ai përfaqësues i këtij subjekti politik, sepse kjo mendoj është dobësi e udhëheqjes së Komisionit, për shkak se i bien raportet në formë të tilla dhe këtë e përmend me qëllim, ngase për mua është shumë e çuditshme dhe këtu e shoh një paraqitje kontraverze të këtyre udhëheqësve dhe anëtarëve të këtij komisioni. Pra, ky raport është shqyrtuar në komision, më 27 prill dhe thuhet në procesverbal se është përkrahur njëzëri, ndërsa këtu dalin me qëndrime tjera, sa i përket seancës e kështu me radhë. Por, kisha pasur dëshirë që deputetët t’i lexojnë mirë ligjet dhe të analizojnë mirë se me çfarë kompetence ligjore bëhen edhe raportet e agjencioneve të ndryshme apo dikastereve tjera të Qeverisë, që të mos manipulojnë opinionin i cili na përcjell në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputete Shala! Më lejoni, meqë nuk kam bashkëkryesues këtu, që në cilësinë e deputetit t’i them dy-tri fjalë për pikën, si diskutues i fundit deri sa të presim mos po bëhet kuorumi për të votuar, nëse jo, atëherë duhet shtyrë votimin.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Përkrah atë pjesë të diskutimeve që ishin të fokusuara në Raportin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit për faktin se ne javën e shkuar kishim një debat i cili pothuaj fund e krye ishte lidhur me privatizimin, pra temë e kishte privatizimin ani pse ishte gjendja në ndërmarrjet publike në Kosovë. Po fokusi i atij debati ka qenë privatizimi, prandaj sot shumë herë kemi rrëshqitur nga diskursi, përkatësisht nga pika dhe ajo që rezulton nga ky raport, i cili mendoj që është i kompletuar konform ligjit ekzistues, por që nuk përmbush shumëçka që ngritët në opinion dhe mbi të gjitha nuk përmbush atë se a është procesi i privatizimit në funksion të misionit dhe qëllimit që i kanë vu institucionet e Kosovës përkatësisht që pret opinionin kosovar. Ai mision është rivitalizimi i ekonomisë.

Dhe, pikërisht këtu, mund të pajtohem me pjesën e diskutuesve që një çmim i ulët i privatizimit të ndërmarrjeve publike nuk është i dëmshëm nëse është në funksion të rivitalizimit të ndërmarrjeve, përkatësisht të përmbushjes së detyrimeve të spinofit, qoftë i rregullt, qoftë special, me një fjalë në funksion të gjenerimit të vendeve të reja të punës. Madje, edhe pjesa e mjeteve që janë grumbulluar nga privatizimi që u tha është modeste krahasuar me vendet e rajonit, po të ishte në funksion të asistimit të privatizuesve për të riaktivizuar resurset që i kanë privatizuar prapë do ta justifikonte çmimin e ulët.

Asnjëherë nuk është menduar që 500 milionë euro nga privatizimi, të cilat sot jepen në bankat ndërkombëtare në njëfarë mënyre për të afarizuar prej atyre pareve, megjithatë konsideroj që ato është dashur që të bëhen pjesë e një aseti të një banke investive në Kosovë, që do të mund të stimulonte privatizuesit të cilët, një pjesë e tyre asnjëherë s'kanë mund t'i përmbushin kushtet dhe tash janë në konflikt me detyrimet që i kanë pasur, përkatësisht ndiqen nga gjykatat, sikundër e dimë.

Kjo ndoshta është ajo pjesa që na detyron urgjentisht sikundër ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka dhënë rekomandimin e dytë të cilin do të duhej ta hidhnim në votim bashkë me rekomandimin për aprovim të këtij raporti që t'i hyjmë ndryshimit të Ligjit mbi... Unë do të thosha se ligji do të duhej edhe të riemërtohej, të jetë ligj për rregullimin e fushës së privatizimit dhe jo të një autoriteti që merret me privatizimin qysh është Agjencioni Kosovar. Ndoshta, Kosova ka nevojë për ligj që rregullon privatizimin dhe pastaj aty e gjen në një farë mënyre veten në mënyrën e funksionimit edhe Agjencionin kosovar.

Kjo ishte ajo që desha ta them. Ju faleminderit për vëmendjen!

Deputetja Nekibe Kelmendi, ka kërkuar fjalën për vetëm një korrigjim të fjalimit të saj, të një lapsusi të vogël.

NEKIBE KELMENDI: Sa për transkript. E kam përdorur – kur të sosën resurset njerëzore, kam menduar në resurse natyrore. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA: Raporti vjetor i AKP-së për vitin 2009 është një raport gjithëpërfshirës dhe i pasur me të dhëna. Por, nga ky raport kuptohet se disa probleme që na kanë përcjellë prej fillimit të procesit të privatizimit në Kosovë, ato kanë qenë prezente edhe gjatë vitit 2009.

Njëri prej këtyre problemeve është mos shpërndarja e 20% - shit punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara. Nga raporti kuptohet se deri në vitin 2009 shuma e përgjithshme e mjeteve të shpërndara këtyre punëtorëve ka arritur në 20,2 milion €, që do të thotë, prej shumës rreth 86 milionë € që janë të dedikuara në emër të të drejtave të punëtorëve, punëtorëve u janë paguar 20.2 milionë €. Po ashtu, në raport është paraqitur tabela me numrin e punëtorëve që kanë përfituar nga shpërndarja e 20% - shit te secila ndërmarrje shoqërore, por shihet se ka ngecje të madhe në kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara.

Spinoff-i special është problem tjetër shqetësues, ku mos përmbushja e obligimeve për investime të ndërmarrjet të privatizuara me këtë metodë paraqesin pikën më të dobët. Nga të dhënat e raportit kuptohet se, nga 21 ndërmarrje shoqërore të privatizuar me spinoff special, në 14 ndërmarrje të privatizuara nuk janë përmbushur obligimet ose zotimet për

investime nga ana e pronarëve të rinj. Në mesin e këtyre ndërmarrjeve janë: Llamkosi, ku prej 15 milionë € investime të zotuar, investime të raportuara janë vetëm 1,6 milionë €, Hoteli Grand, ku prej 20,2 milionë € investime të zotuar, janë raportuar 1,2 milionë €, IMK Fabrika e Gypave, ku prej 13,2 milionë € investime të zotuar, janë raportuar 5,2 milionë €, Xim Strezovci, ku pronari i ri është zotuar për 14,3 milionë € investime, kurse janë raportuar vetëm 546.457 € e kështu me radhë. Këto shifra flasin për shuma të mëdha të mjeteve të zotuar, por shumë pak të raportuara. Në kuadër të ndërmarrjeve të privatizuara me spinoff special vërehet edhe mos përmbushja e obligimeve të pronarëve të rinj edhe nga aspekti i numrit të punëtorëve të zotuar, si në ndërmarrjen Industria e Duhanit Gjilan, ku prej 12.147 punëtorëve të zotuar, janë raportuar 6.623 punëtorë, Hotel Iliria, ku janë zotuar për punësimin e 7.905 punëtorëve, kurse janë raportuar për 3.955, në NBI Suhareka zotimi ka qenë për 5.503 punëtorë, kurse janë raportuar 3.267 punëtorë. Në kuadër të ndërmarrjeve të privatizuara me këtë model vërehet edhe një numër i atyre që kanë tejkaluar numrin e të punësuarve, si, Kosova Tex për 129 punëtorë Veraria Rahoveci për 1.068 punëtorë, FAN për 159 punëtorë, Hotel Grand për 597 punëtorë etj. Ndaj ndërmarrjeve të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet e zotuar, qoftë në shumën e investimeve, qoftë në numrin e punëtorëve, mendoj se AKP-ja ka qenë shumë tolerante, nuk e ka ndërpre kontratën, duke i pritur që t'i përmbushin obligimet e tyre. Dhe, në fund, dua të theksoj se një shqetësim të madh paraqesin mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimit. Deri vonë qytetarët e Kosovës kanë qenë të shqetësuar që këto mjete gjenden jashtë Kosovës dhe nuk shërbejnë për nevojat e ekonomisë së Kosovës, tani kemi një shqetësim më të madh, ngase nga zyrtarët e AKP-së mësojmë se as ata vetë nuk dinë ku gjinden mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimit.

KRYESUESI: Faleminderit! E kemi përmyllur debatin. Në sallë kemi 59 deputetë. Lus regjinë që edhe një herë me zile t'i ftoj deputetët! Po, veç nuk ju kam përmendur...Regjia, ziles të lutem! Mund ta marrësh fjalën për diskutim...!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

KRYESUESI: Unë deklarova se diskutuesi i fundit i paraqitur këtu isha unë dhe nuk besoj se është mirë që të zgjatemi prapë, ndërkaq nuk e përmenda askënd që të më replikojë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Të nderuar kolegë, që votimin e raportit duhet ta shtyjme për seancën e datës 27, sepse nuk kemi kuorum për të votuar. Ndërkaq, kalojmë në pikën e radhës. Për të diskutuar kemi kuorum, por për të votuar as pikën e radhës nëse në ndërkohë nuk na shtohet numri.

Pika e njëmbëdhjetë e seancës është:

11. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore

Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për barazi gjinore dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Ismet Beqiri apo raportuesin e këtij komisioni për arsyetimin e raportit me rekomandime. Në emër të Komisionit fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Në të vërtetë ky ka qenë një mocion të cilin unë e kam ngritur më datën 4 mars së bashku, me 10 deputetë të tjerë që programi për barazi gjinore të sillet për debat në Kuvendin e Kosovës, meqenëse kohë më parë është hartuar nga Qeveria e Kosovës. Atëherë, do t'i them disa fjalë në lidhje me programin si ngritëse e mocionit dhe në emrin e Partisë Demokratike të Kosovës.

Programi i Kosovës për barazi gjinore synon ngritjen e një programi kombëtar dhe vendosjen e synimeve dhe objektivave nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës çka është edhe objektiv i tretë i objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit që ky Kuvend e ka miratuar kohë më parë.

Objektivi i tretë i Deklaratës së mijëvjeçarit ka të bëjë pikërisht me nxitjen e barazisë gjinore. Në këtë kuadër edhe vendet e Ballkanit perëndimor, përfshirë edhe Kosovën, kanë shpallur synimet e tyre për të arritur këtë objektivë. Duket e qartë se të gjitha këto vende po bëjnë përpjekje për të arritur këtë synim.

Përfshirja dhe implementimi i çështjeve gjinore në politikat, programet dhe iniciativat për zhvillimin e vendit duhet të jetë një imperativ edhe për Kosovën si një shtet i ri para të cilit shtrohen shumë sfida, ato të zhvillimit ekonomik, social, si dhe ato të integritit në familjen evropiane.

Ne edhe pse si shtet i ri kemi bërë përparime në programet e Qeverisë për barazi gjinore e sidomos në fushën legjislative, siç janë Ligji për barazi gjinore, i cili tashmë ekziston plani kombëtar për arritjen e barazisë gjinore, Ligji kundër diskriminimit, Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e njeriut, Plan i veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe së fundi Ligji kundër dhunës në familje, që është edhe në fazën finale. Po ashtu mbetet edhe shumë për t'u bërë në fushën e arsimit, punësimit, ekonomisë, shëndetësisë dhe sigurisë. Ky fakt prek 50% të popullatës dhe bën që gjysma e popullatës të mos përfitojë nga përparimi i arritur nëpërmjet përpjekjeve të tjera për reforma politike, shoqërore dhe ekonomike. I gjithë programi është fokusuar në 6 fusha, në arsimim dhe në arsimimin apo rritjen e qasjes së grave në arsim më cilësor si çështje themelore për zhvillimin e një shoqërie, të dhënat...tregojnë se në fillim të shkollimit numri i vajzave është më i lartë se i djemve, por me kalimin e viteve numri i vajzave bie, apo shumë vajza e braktisin mësimin. Llogaritet që shkalla e analfabetizmit në Kosovë të jetë deri në 16% te femrat mbi moshën 15 vjeçare, derisa shifrat e tilla për djemtë të moshës së njëjtë arrijnë deri në 10%. Në këtë kategori nuk llogariten analfabetët funksionalë që janë një numër i tyre që nuk dinë as të votojnë apo plotësojnë ndonjë aplikacion.

Po ashtu integrimi i grave në ekonomi është një nga pikat apo fushat e këtij programi sepse shkalla e lartë e papunësisë sjell edhe varfëri të lartë. Llogaritet se vetëm 2% të kredive në Kosovë i është dhënë grave dhe 2% e bizneseve u takojnë grave. Me këtë program tentohet të bëhet rritja e numrit të grave afariste nëpërmjet dhënies së mundësive për më shumë qasje në kapital dhe kredi. Punësimi dhe përkujdesja sociale është pika e tretë për kategori të prekura nga problemet sociale. Në Kosovë llogaritet në shkallën e lartë të papunësisë, shkalla e papunësisë te gratë llogaritet të jetë deri në 68%. Mbështetja

e familjeve të varfra, ku kryefamiljare janë gratë dhe po ashtu është një nga objektivat e këtij programi. Llogaritet se 4% janë më të varfra familjet ku gratë janë kryefamiljare.

Përkujdesja shëndetësore, përmirësimi i shëndetit të grave duke iu përgjigjur nevojave shëndetësore të tyre, megjithëse sot qasja në institucione shëndetësore është më e lehtësuar, edhe më tutje mbetet sfidë trajtimi i mirëfilltë në institucione shëndetësore.

Brengë tjetër në shoqërinë tonë që ndërlihet drejtpërdrejt me aspektin e shëndetësisë dhe me gjininë femërore në përgjithësi është shkalla e lartë e grave të cilat vuajnë nga kanceri i gjirit dhe i mitrës dhe vështirësitë me të cilat gratë ballafaqohen gjatë kurimit të sëmundjeve të tilla. Për këtë arsye dhe me qëllim të zbutjes sadopak të situatës së rëndë shëndetësore në si grup punues brenda Komisionit kemi dalë me rekomandimit që monografia, ultrazëri i gjirit dhe pap-testi në të gjitha institucionet publike shëndetësore të bëhet falas, në mënyrë që sado pak tua mundësojmë dhe lehtësojmë grave që për kontrollet e tilla të mos paguhet.

Ky debat gjithashtu koincidon edhe me një ditë tjetër të rëndësishme. Ditë më parë nën organizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe në partneritet me Shoqatën e Obstetërve dhe Gjinekologëve si pjesë e iniciativës Evropian në Prishtinë, është mbajtur konferenca treditore mbi shëndetin e gruas. Kjo njëherësh është edhe objektiv i katërt dhe i pestë i zhvillimit të mijëvjeçari që drejtpërdrejt lidhet me shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

Po ashtu miratimi i këtij programi është edhe një mbështetje në fillimin e projektit të monografisë ku një grup mjekësh të profileve të ndryshme, radiologë, kirurgë, patologë e të tjerë nga Kosova dhe nga Ohajo e Amerikës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Telemjekësinë, Qendrën Klinike Universitare, Institutin e Shëndetit Publik dhe Ambasadën Amerikane nga 29 gushti i këtij viti deri më 11 shtator do të organizojnë një projekt për monografinë dhe i cili do të përfshijë tri komponentë: donacionin e pajisjeve për monografi dhe trajnim, kirurgjinë e gjirit, edukimin e popullatës në terren në formë të ndryshme për rrezikun dhe mundësitë e trajtimit të sëmundjeve të tilla. Në këtë fazë projekti do të përfshijë vetëm dy qytete Prishtinën dhe Pejën për të vazhduar më pastaj me qytetet tjera. Gjithashtu pikë e programit janë edhe gratë në vendimmarrje dhe mund të themi se numri i grave pjesëmarrëse në institucionet vendimmarrëse në Kosovë, duke mos e llogaritur Parlamentin lë edhe shumë për të dëshiruar. Llogaritet se 15% e të punësuarve në administratën publike janë gra, në institucionet në nivelin qendror 20%, ndërsa në nivelin lokal vetëm 8%.

Gjithashtu në këtë program unë kam insistuar që të futet edhe çështja e sigurisë si çështje shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme për ne si shoqëri dhe shtet në ndërtim. Siguria si term është mjaft i gjerë, por këtu do të fokusohesh në disa segmente të sigurisë, siç është dhuna në familje, trafikimi i qenieve njerëzore, detyrimi në prostitucion, aborti selektiv, dhuna nëpër shkolla. Ne fatmirësisht e kemi në përfundim Ligjin kundër dhunës në familje që edhe më tepër do ta plotësojë infrastrukturën ligjore. Sot në botë llogaritet se vdesin më tepër gra si pasojë e dhunës në familje sesa në aksidentet e trafikut. Shifrat e dhunës në familje janë po ashtu brengosëse, por më brengosëse është mos raportimi i tyre në institucione dhe në organet gjegjëse, gjë që e potencon edhe raportin e progresit.

Sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore është interesante të thuhet se që nga paslufta kjo dukuri ka pasur një rritje dhe përderisa të trafikuarat kanë qenë shtetase të huaja është për keqardhje se viteve të fundit numri i grave të trafikuar nga Kosova ka pësuar një rritje, për dallim nga ato që janë shtetase të huaja. Kosova sipas raportit të Departamentit

të Shtetit Amerikan renditet në kategorinë e dytë për trafikim të qenieve njerëzore si një vend i origjinës, vend transit dhe vend i destinuar për të trafikuarat. Ne kemi planin e veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore të hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme që është njëherësh udhëheqëse e Grupit ndërministror ku po ashtu janë të përfshira edhe një numër i organizatave joqeveritare, strehimoreve me qëllim të ofrimit të ndihmës të viktimave të trafikimit. Po ashtu do t'i inkurajoja edhe gratë që më numër më të madh të marrin pjesë dhe të inkuadrohen në institucionet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me sigurinë, siç janë Policia, Forca e Sigurisë, apo Agjencioni i Inteligjencës, sepse pjesëmarrja e tyre në këto institucione lë mjaft për të dëshiruar.

Politika gjinore dhe zbatimi i tyre në praktikë është përvojë e re për Kosovën dhe është një nga standardet që nga ne kërkohet të plotësohet me qëllim të anëtarësimit në strukturat euroatlantike. Përkushtimi për integrimin e këtyre politikave do të rezultojë me krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Misioni i këtij programi është nxitja e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë, institucionet qeveritare, jo qeveritare, shoqëria civile, individë partnerë ndërkombëtarë dhe donatorë që do të kontribuojë në mënyrë të koordinuar në arritjen e barazisë gjinore në Kosovë nëpërmjet implementimit të politikave dhe programeve të paraqitura në këtë dokument. Roli i mekanizmave institucional përfshin monitorimin sistematik të gjendjes së grave dhe burrave me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të politikave, programeve dhe masave të planifikuara për arritjen e barazisë. Në planin e veprimit për partneritet evropian në pika....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, regjia!

MIMOZA AHMETAJ: Në planin e veprimit për partneritet evropian në pikën 39 kërkohet nga Qeveria e Kosovës të miratojë programin e Qeverisë për promovimin e të drejtave të gruas në Kosovë dhe po ashtu në Raportin e progresit të këtij viti në pikat 43 dhe 44 bëhet vërejtje për emërimin e zyrtarëve gjinorë në të gjitha ministrinë dhe komitetet për barazi gjinore e po ashtu bëhet vërejtje edhe për nivelin e lartë të dhunës në familje dhe për mos raportimin.

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah raportin dhe ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Kalojmë te grupet parlamentare, sipas radhës, Grupi Parlamentar i PDK-së mendoj që deputetja foli edhe në emër të Grupit Parlamentar.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Sinqerisht ne patëm për ta ngritur një mocion, për të kërkuar që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, duke marrë parasysh numrin e paktë të deputetëve dhe seriozitetin të cilin mund ta sjell ky debat, prandaj ne mund ta përkrahim këtë program për barazi gjinore bashkë edhe me rekomandimet, por edhe një herë sugjeroj që të shtyhet për seancën e ardhshme dhe ky debat me këtë temë kaq të rëndësishme për barazi gjinore...

KRYESUESI: Zoti Zemaj, inicuesja nuk e kërkoi një gjë të tillë, prandaj vazhdoni...

ARMEND ZEMAJ: Iniciues është Komisioni për Barazi Gjinore dhe për të Drejtat e Njeriut.

KRYESUESI: Në emër të Komisionit, po më duket.

ARMEND ZEMAJ: Mirë, ne nuk e kemi parë. Në bazë të dokumentacionit nuk e kemi parë dhe më vjen keq nëse jemi keqkuptuar. Është në emër të Komisionit. Atëherë, ne e përkrahim këtë program me gjithë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj... Më falni, sepse jemi ende te grupet parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Mbase nevoja për ta pasur Kosova një program për barazi gjinore më së miri mund të mbështetemi në përvojën e shoqërive të zhvilluara të cilat e dinë se të drejtat e femrës janë një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, por edhe të gjithëmbarshtëm.

Studimet në Kosovë kanë vërtetuar se ekziston barazia gjinore, por çka është me e rëndësishme në situatën e tanishme kur ekziston një varfëri e theksuar dhe papunësi e madhe, kjo gjendje më së shumti godit kryesisht gratë, prandaj edhe në një mënyrë ky program duhet të jetë një instrument realisht edhe për luftimin e varfërisë si dhe nxitjen e punësimit dhe zvogëlimin e papunësisë të gratë. Me fjalë të tjera fakti se synojmë të jemi pjesë e familjes evropiane, gjithashtu shtron nevojën që dimensionin gjinor të integrohet në politikat publike dhe në programet e Qeverisë, gjegjësisht në të gjithë sektorët e saj.

Edhe pse programi përfshin një periudhë prej vitit 2008 deri në vitin 2013, kurse tani jemi në vitin 2010, unë po filloj menjëherë me korrigjimin ose me nevojën e korrigjimit të vitit, propozoj që programi të jetë nga viti 2010 deri në vitin 2015, pasi që kanë kaluar dy vjet.

Politikat aktuale për barazinë gjinore, por edhe ligjet të cilat janë në fuqi nuk janë treguar shumë efikase në aspektin e arritjes së barazisë gjinore, edhe pse Kushtetuta e Kosovës i mbron dhe avancojnë parimet e barazisë, por edhe ligjet në fuqi si Ligji për barazinë gjinore, kundër diskriminimit, pastaj për mbrojtjen nga dhuna në familje, kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kodi i familjes dhe rregullat tjera janë ligje shumë të mira, por në praktikë nuk zbatohen plotësisht.

Prandaj, hartimi i këtij programi si instrument kryesor i politikave të cilat dalin nga Ligji për barazi gjinore dhe plotësimi i Planit për integritet evropian është kërkesë edhe për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane. Programi është një dokument strategjik i cili përpaket të ofrojë një vizion për arritjen e barazisë gjinore, cakton objektivat, masat, aktorët kryesorë për avancimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat, sidomos në atë sociale dhe ekonomike. Janë përfshirë edhe aktorët kryesorë – institucionet qendrore dhe ato lokale, por edhe ato jashtë Qeverisë si donatorë – shoqëria civile, OJQ-ët dhe mediat.

Janë përcaktuar kryesisht tetë objektiva strategjike dhe unë po i përmend këto: Një, është promovimi i barazisë gjinore; dy, është rritja e mundësive të femrave për arsimin cilësor; përmirësimi i shëndetit të tyre; fuqizimi ekonomik; përmirësimi i gjendjes sociale;

reduktimi i papunësisë dhe nxitja e punësimit; përmirësimi i imazhit në media, kulturë dhe sport dhe rritja e pjesëmarrjes së femrës në vendimmarrje.

Për nevojën e ekzistimit të një programi të tillë në Kosovë, flasin edhe të dhënat të cilat janë shumë shqetësuese dhe po filloj nga papunësia dhe varfëria e lartë në Kosovë, e cila kryesisht godet femrat dhe sidomos nëpër fshatra posaçërisht në qoftë se ato janë kryefamiljare dhe kjo rrjedhimisht ndikon menjëherë edhe në mirëqenien e fëmijëve dhe mirëqenien e gjithë familjes.

Analfabetizmi të femrat është shumë më i lartë se sa të meshkujt, gjegjësisht tek të rinjtë dhe kjo është e shprehur sidomos në shkollat e mesme.

Shëndeti është më i dobët te nënat dhe vdekja e foshnjave është gjithashtu më e lartë, që është një tregues që tregon për pasojën e shëndetit të dobët dhe të jetesës në varfëri.

Të drejtat ekonomike janë më të vogla të gratë. Të dhënat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të vitit 2004 flasin se nga 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme 98% të tyre pronarë janë meshkujt, kurse vetëm 2% janë femrat.

Shkalla e papunësisë është më e lartë të gratë – 68.9%, ndërsa të meshkujt 36.9%.

Në vendimmarrje si në familje dhe shoqëri, gratë kanë më pak të drejta, do të thotë në familje për çështjet të cilat janë më të rëndësishme për familje, gratë nuk janë pjesë e vendimmarrjes, kurse në shoqëri pjesëmarrja e grave në postet udhëheqëse në administratën publike është 1 me 10 në favor të meshkujve.

Dhuna në familje është prezent, trafikimi i femrave është rritur gjatë viteve. Pabarazia vërehet gjithashtu edhe në media.

Në përgjithësi pra programi ofron analiza të gjendjes gjinore, identifikon problemet dhe jep masat për përmirësimin e tyre dhe gjithashtu përbën planin e veprimit. Është në përgjithësi një plan aktiv dinamik. Megjithatë, ka mangësi dhe duhet plotësuar dhe rekomandimet e mia, gjegjësisht të Grupit Parlamentar të Aleancës janë këto.

E para, siç e thashë, duhet ndryshuar afati kohor, domethënë, është program afatmesëm. Vitet duhet të ndryshohen nga 2008 në 2010 dhe nga 2013 në 2015. Të gjitha aktivitetet të cilat janë të përfshira në planin e veprimit për këto dy vjet gjithashtu duhet të ndryshojnë.

2. Duhet të përfshihet Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, sepse monitorimi i përfshirjes gjinore në komuna me ligj i takon kësaj ministrie.

3. Edhe pse rolin qendror për barazinë gjinore dhe promovimin e saj e ka Agjencia për Barazi Gjinore, ky agjencion ka mungesë të fuqisë politike dhe të kapaciteteve teknike që të ndikojë në politikat sektoriale, prandaj është e nevojshme që kjo të fuqizohet.

Një çështje me rëndësi dhe shpresoj se kryeministri do ta dëgjojë këtë, është se për një kohë shumë të gjatë kemi ushtrues detyre të agjencioneve, gjegjësisht që dy vjet nuk është caktuar shefi i Agjencionit, por për dy vjet kemi ushtrues detyre dhe kjo në një mënyrë pengon funksionimin e mirëfilltë të Agjencionit e gjithashtu edhe funksionalizimin e mirëfilltë të tij.

4. Duhet të rivendosen zyrtarët e barazisë gjinore nëpër komuna sipas Ligjit për barazi gjinore në pozitat e politikave aktive, në mënyrë që të përmirësohet sistemi i monitorimit.
5. Disa masa dhe mekanizma të monitorimit janë të përgjithësuar dhe nuk janë aktivitete të matshme. Nuk është e qartë se kush e siguron buxhetin. Propozimi i Grupit Parlamentar është që secili sektor brenda buxhetit të vet të sigurojë buxhetin edhe për aktivitetet e caktuara në planin e veprimit. Kjo ishte 5.
6. Vështirë mund të realizohet plani nëse komponentë e barazisë gjinore nuk është pjesë e strategjisë së zhvillimit të Kosovës të cilën strategji deri më sot Qeveria e Kosovës nuk e ka sjell, që vë në dyshim edhe suksesin e këtij programi.
7. Duhet të ngritën kapacitetet për raportim dhe monitorim.
8. Duhet të krijohet një sistem i të dhënave, ashtu që në bazë të këtyre të dhënave të mund të krijohen dhe të zhvillohen politikat e barazisë gjinore dhe sipas nevojës ato të ndryshohen.
9. Të bëhet raportimi i rregullt, së paku një herë në vit, në Kuvend për progresin e arritur në zbatimin e këtij programi.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Barazia gjinore është një komponentë e rëndësishme e demokracisë dhe element esencial për integrimin evropian të vendit. Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij dokumenti strategjik për zhvillimin e Kosovës, por edhe nëse merren parasysh dhe inkorporohen rekomandimet e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ne në parim e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së e ka fjalën deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, e ka analizuar këtë program për barazi gjinore bashkë me rekomandimet. Programi është një dokument strategjik i cili është hartuar në vitin 2008, ndërsa në Kuvend sillet në vitin 2010, do të thotë, 2 vjet më vonë dhe atë sillet me iniciativë – me mocionin, sikur që u tha më herët, nga zonja Mimoza dhe për shkak të inicimit të miratimit të Programit për barazi gjinore, e falënderoj të njëjtën.

Këtë program ne do ta përkrahim. I njëjti është mirë i përgatitur, pasqyron gjendjen reale të femrës në shoqërinë kosovare dhe shpresojmë se do të implementohet.

Në kapitullin e parë të këtij programi kemi analizën dhe pabarazinë gjinore në Kosovë ku kemi vështirimin e përgjithshëm për barazinë gjinore dhe varfërinë, shkakë që prodhojnë këtë varfëri dhe diskriminim gjinor. Flitet për dominimin e normave patriarkale, vështirësitë në zbatimin e ligjit që vonojnë barazinë gjinore, nivelin e ulët arsimor të grave që është shkak për t'i lënë ato në varfëri, kequshqyerja dhe qasja e vogël në shërbimet shëndetësore që kushtëzojnë shëndet të dobët të nënave. Gratë kanë më pak të drejta ekonomike, gratë nuk janë forcë aktive në tregun e punës, gratë shpërblehen më pak dhe kanë vështirësi në ruajtjen e vendit të punës. Pra, gratë kanë një nivel më të lartë

papunësie, kanë më pak të drejta në vendimmarrje, pabarazi në kulturë dhe në media. Do të thotë, siç shihni, me qëllim i përmenda këta tituj, sepse kur përmendet gruaja në shoqërinë kosovare gjithmonë flitet për më pak të drejta, nivel më të lartë të papunësisë. Do të thotë çka është negative, gjithmonë adresohet, do të thotë për të drejta po flas, çka s'i jepet, krejt janë më pak ose më lart sa i përket papunësisë.

Te kapitulli i dytë, programi i parasheh mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore, ku përfshihen mekanizmat në nivelin qendror, në nivelin lokal, kuadri ligjor dhe i cili është deri diku edhe problem, sepse u tha më herët se po ka probleme te eksploatimi i ligjeve, prandaj duhet edhe ato t'i monitorojmë sa janë duke u zbatuar.

Kapitulli i tretë. Kemi misionin, vizionin dhe objektivat dhe planin e veprimit, ku parashihen veprimet që duhet të ndërmerren për vitet 2008, 2010, 2012, 2013. Meqë programi na ka ardhur qysh në vitin 2010, tani, atëherë këto veprime të 2008 nuk di çka është ndërmarrë dhe si janë ndërmarrë ato veprime?

Rekomandimet të cilat janë dhënë në kuadër të pikës për shëndetësi, në Programin për barazi gjinore, ku thotë përfshirja e papa-testit, të monografisë dhe ultrazërit të gjirit falas në të gjitha institucionet shëndetësore publike, çka plotësisht e përkrahim. Në program të përfshihet çështja e sigurisë. Në bazë të Ligjit për barazi gjinore si mekanizëm kryesor i përmirësimit dhe të ngritjes së barazisë gjinore në nivel lokal të themelohet Zyra për barazi gjinore. Komitetet komunale për barazi gjinore duhet të jenë të veçanta të funksionalizohen dhe të veprojnë si të pavarura.

Grupi parlamentar i AKR-së e përkrah këtë program dhe rekomandimet e dhëna. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së fjalën e ka deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje të posaçme Programin e Kosovës për barazi gjinore si një dokument shumë të rëndësishëm pasi që çështjet gjinore janë parë si një dimension i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë. Gjithashtu, përfshirja dhe implementimi i çështjeve gjinore në politikat, programet dhe iniciativat për zhvillimin e vendit si shtet i ri, para të cilit shtrohen shumë sfida, ato të zhvillimit ekonomik e social si dhe ato të integritetit në familjen evropiane ku ligji për barazi gjinore na detyron për hartimin e këtij programi.

Mirëpo, unë do të ndalem në disa çështje sidomos te mekanizmat e nivelit lokal për arritjen e barazisë gjinore, ku e dimë se deri më tani është shkelur Ligji për barazi gjinore edhe përkundër faktit se është miratuar nga viti 2004.

Në bazë të këtij ligji për barazi gjinore decidivisht në nivele lokale si mekanizëm kryesor për përmirësimin dhe ngritjen e barazisë gjinore duhet të krijohen zyrat për barazinë gjinore. E thanë edhe koleget e mia, mirëpo këtu kanë qenë disa propozime që vërtet duhet t'i kemi parasysh dhe besoj e kërkoj edhe përkrahjen tuaj kolegë të nderuar deputetë. Fatkeqësisht për arsye të ndryshme kjo gjë fare nuk është implementuar, por përkundrazi çështjet gjinore janë degraduar dhe tani po "funksionojnë" në kuadër të njëjësive për të drejtat e njeriut. Madje, zyrtarët për barazi gjinore janë konvertuar në

koordinatorë të njësive për të drejtat e njeriut dhe detyrën e tyre primare si zyrtarë të barazisë gjinore tek-tuk e kryejnë sa për të thënë.

Çështjen tjetër në të cilën duhet të ndalem, janë komitetet komunale për barazi gjinore që nuk funksionojnë fare si të mëvetësishme. Ato ose nuk ekzistojnë fare ose janë të përngjitura në bisht të komiteteve tjera, zakonisht të komiteteve për kulturë, rini, sport dhe çështje gjinore.

Si të tilla, mekanizmat në fjalë nuk mund ta bëjnë integrimin e perspektivës gjinore në politikat zhvillimore komunale, qoftë në aspektin formal institucional, qoftë në aspektin e konsolidimit me komponentin e shoqërisë civile.

Ne jemi ndalur edhe te objektivat. Si objektive numër një, te pika 1.1.3. mendojmë se ndërmarrja e iniciativave për aksione afirmative, sepse fare pak iniciativa janë ndërtuar në këtë drejtim.

Si rekomandim kryesor propozoj objektiven numër 2, që të gjenden mënyra inovative për inkurajimin e femrave për të aplikuar për studime të larta, studime pasuniversitare dhe sidomos inkurajimin për të aplikuar në pozita vendimmarrëse nëpër organet më të larta të universiteteve publike dhe private ku e dimë se asnjë akademike femër nuk është. Këtë gjë duhet ta bëjmë me anë të veprimeve konkrete, nëpërmjet organizimit të vizitave në nivelet lokale.

Krejt këto çështje që po i them mendoj që të inkorporohen në programin e Kosovës për barazi gjinore, jo vetëm si pjesëmarrës aktiv nëpër tryeza e debate, por edhe si kërkues profesional për llogaridhënie në rast të mos përfshirjes së përqindjeve të barazisë gjinore të kërkuara me ligj, por gjithashtu edhe organizimi i takimeve përmbajtjesore me udhëheqësit e partive politike në mënyrë që të ndryshohet praktika e ofrimit të posteve grave vetëm në vigjilje të zgjedhjeve apo të përmbushjes së planeve ditore.

Te objektivi strategjik numër 3. Me rastin e miratimit të draftit të ligjit për shëndetësinë, provizionet në lidhje me shëndetin riprodhues të femrave, të kenë karakter obligativ si për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore, por edhe uljen e tarifave për kontrollet e detyrueshme si e cekën edhe kolegët e mia papa-testin, monografia, e tjera.

Te objektivi numër 4. fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave, cilat janë mundësitë konkrete dhe cilat janë aktivitetet konkrete që burri dhe gruaja të kenë qasje të barabartë në pronë, kapital dhe kredi. Gjithashtu të bëhet analizë për presionet e mundshme familjare dhe shoqërore për ta lënë punën ose fare për të mos punësuar gra, kështu që a ka shërbim të tillë që jep informacione se sa gra kanë qasje ose ndonjë të drejtë të pronës familjare? Çfarë bashkëpunimi bëhet me sektorët e thjeshtë të shërbimeve, për shembull kompanitë e sigurimeve të veturave, se sa është përqindja e pronës mbi automjetet e kështu me radhë? Si ndikojnë këta faktorë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit, a ka mekanizma të cilët monitorojnë procesin e punësimit të grave dhe burrave në sektorin privat?

Dhe te objektivi strategjik numër 7, mendoj që përmirësimi i imazhit të grave në media, të bëhet – kulturë dhe sport.

A është bërë analizë konkrete apo emisione për t'i parandaluar pengesat kulturore që veç ekzistojnë të pjesëmarrjes së grave ta zëmë në procesin e votimit dhe në politikë. A bëhet

analizë? Unë nuk e kam vërejtur në këtë program, domethënë se mund të bëhet analizë e stereotipeve të përfaqësimit të pjesëmarrjes së gruas në jetën politike dhe publike. Çfarë aksionesh afirmative janë ndërmarrë për emisionet e nivelit të lartë të temave ekonomike, politike, të ambientit të sigurisë e tjerë që udhëhiqen nga femrat analiste?

Edhe këtë dua ta theksoj, duhet të merren parasysh që pikëpamjet e grave lidere të inkorporohen në të gjitha fazat e ndonjë aktiviteti, të zhvillohen dhe të publikohen materiale në formë të fakteve për jetë për popullatën e gjerë, për shembull pjesëmarrja e grave në zgjedhje. Në rast të krijimit të komisioneve formale dhe jo formale të mos aprovohen në rast se gruaja nuk është pjesëmarrëse.

Andaj, për fund, zonja dhe zotërinj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet në parim Programin e Kosovës për barazi gjinore me të gjitha rekomandimet shtesë të dala nga Komisioni funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Në emër të Grupit "7+" nuk është paraqitur askush....Jo, tash u paraqit në fakt.
Deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Grupi "7+" i dëgjoi nga zonjat referatet, përkatësisht diskutimet, ato kishin bërë referatet aq të mira, jo vetëm Mimoza, por edhe të tjerat, ashtu që edhe Grupi "7+" e mbështet këtë projekt ose këtë ligj që sa më shpejt të kalojë, pra gratë, le të kënaqen, aman, se i duam gratë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit SLS, nuk ka të lajmëruar.
Në emër të Grupit për Integritet, fjalën e ka deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH: Hvala lepa na datu reč!

Imamo jako važan predlog izveštaja za ravnopravnost polova, kada je u pitanju sudbina i mesto žene u kosovskom društvu.

Ja moram da kažem, da me izvine sve kolege i kolegice, po prisustvu danas ovde u Skupštini vidi se koliko je, kakvu ulogu ima žena na Kosovu.

Ako dobro razmotrimo ovaj izveštaj, to je jedan od domaćih zadataka koji je nama dala Evropska komisija radi integrisanja Kosova u evropsko društvo. To je poboljšanje uloge žene i njeno veće prisustvo u svim društvenim sferama. Da li je to sfera zdravstva, prosvete, kulture, ekonomije i normalno medije. Ove sve sfere su jako vitalne. Žena treba da vodi glavnu ulogu kada je podeljenost između muškaraca i žena u okviru poslova i poslodavaca, a isto tako moram da navedem da ovde imamo izveštaj Svetske banke da na Kosovu ima negde oko 2.070.000 stanovnika i od toga 1.010.000 su žene a 1.060.000 muškarci. Kada iz analize gledamo, vidimo da su žene pristupačne ili prisutne u svim sferama, negde od 10 do 20% u korist muškaraca. Znači svaka sfera je većinom zastupljena muškim polom, što znači da prvi cilj koji žena treba da ima i koji u stvari ima kao majka, sestra i u društvu, osnova društva za poboljšanje siromaštva u društvu. Jako je vidno da žena kao osoba malo više pristupačnije, ozbiljnije prilazi svakom problemu zato što je ona glava porodice i onda se malo obzirnije i namenski ponaša prema svakom problemu koji joj se da u prilici da reši.

Ja dajem do znanja, mi svi poslanici znamo da imamo dobru zakonsku strukturu, da su ovde usvojeni od svih nas zakoni kao što je Nacrt zakona o polnoj ravnopravnosti, Nacrt

zakona protiv diskriminacije, Nacrt zakona o zaštiti porodice, međutim nešto što nedostaje u Nacrtu zakona o polnoj ravnopravnosti, što mi kao poslanici nismo mogli da uvidimo, to što hoću danas da dam kao preporuku jeste da mora da postoji amandman radi izbora poverenika za zaštitu ravnopravnosti. Mi po ovom zakonu nemamo znači poverenika za zaštitu ravnopravnosti. Znači, nemamo ministra. Moramo da imamo poverenika za zaštitu ravnopravnosti da bi se strukturalno organizovali od centralnog do lokalnog nivoa, ne preko Agencije za ravnopravnost polova, ne preko običnih kancelarija, nego da to struktura bude linijska od centralnog do lokalnog nivoa. Samo preko našeg poverenika mi možemo da zaštitimo našu ravnopravnost. Zašto ovo kažem? Zato što nema dosta koordinacije organizacije službene na Kosovu, nemamo dovoljno statistiku, nemamo prateće elemente pri kojima ćemo ove mere, načelne mere koje su date u ovom programu da možemo da analiziramo i da pratimo. A kada budemo imali svog poverenika, taj poverenik je namenski postavljen zakonski da bi prikupljao sve ove podatke, da analizira sadašnju i buduću situaciju sa domaćim zadacima koji su pred nama. Da bi se poboljšala situacija žene i uloga žene u društvu, znači moramo da imamo svog poverenika, što sada, što je žalosno, nemamo. Moramo mi kao žene da se podignemo i da tražimo amandmanom da se u Nacrtu zakona o ravnopravnosti izglasa poverenik i da se utvrdi način kako da se taj poverenik izglasa od strane Parlamenta i političkih subjekata koji su na vladi koncenzusom, normalno, svih političkih subjekata tako što ćemo imati službu i generalnog odgovornog čoveka za ravnopravnost polova.

Jedno što hoću da kažem, što je jako važno, moramo da se bavimo više statistikom, moramo pred sobom da postavimo domaći zadatak na svoje mesto, šta hoćemo da postignemo u sferi medicine, ekonomije, obrazovanja, zdravstva, kulture, u medijima i kako da prezentujemo ulogu žene i kako da poboljšamo ove loše procenete koje imamo za sada na Kosovu. Moramo da poboljšamo i kada je u pitanju zaštita žene s time što ćemo u civilnom društvu ili u specijalnoj službi kao što je policija, Ministarstvo za unutrašnje poslove i ostalo gde će biti prisustvo žena, gde se moramo izboriti preko svog poverenika za konsenzus za procenat koji će biti najmanji procenat prisutnosti naših predstavnica u ovim službama.

Ja znam da smo dosta umorni ali ipak mislim da preporukom da se mi žene izborimo za jednog poverenika koji će se izboriti u platformi u evropskom društvu, u regiji gde ćemo imati metodu i način kako da pospješimo ulogu žene na Kosovu. Toliko od naše grupe za sada. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Hvala!

Deputetja e radhës e paraqitur për diskutim është Sanie Aliaj dhe dy kolegë deputetë të cilët i kisha lutur që të jenë të shkurtër dhe të aprovojnë atë që po thonë gratë.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në fillim para se të bëj vlerësimin tim për Programin e Qeverisë për barazi gjinore, duhet t'ju drejtohem zoti kryesues se nuk e keni respektuar Rregulloren e Kuvendit, me vetë faktin se nuk keni kërkuar nga Komisioni funksional të dalë para Kuvendit të prezantojë rekomandimet që duhet të jenë pjesë integrale e këtij programi, por edhe për një arsye tjetër që rekomandimet e propozuara nga Komisioni funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione duhet të jetë edhe pjesë e transkriptit.

Gruaja është pjesë e natyrshme e njerëzimit, andaj fuqizimi i saj dhe barazimi me gjininë tjetër përbëjnë përpjekje normale për një jetë më të mirë për Kosovën shtet demokratik ku mbretëron rendi dhe ligji.

Ligji për barazinë gjinore është një nga iniciativat kryesore ligjvënëse që tregon për vullnetin politik, që insiston në përmirësimin e pozitës së grave dhe arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, duke ofruar krijimin e mundësive më të mira për gratë që marrin pjesë në politikë dhe në vendimmarrje. Mirëpo, ende nuk ka përfaqësim të mjaftueshëm që i plotëson kërkesat e Ligjit për barazi gjinore, i cili rregullon pjesëmarrjen e grave në institucionet me 40%.

Me këtë rast do të potencojë në mënyrë të veçantë për vetë gratë që sot nuk kanë durimin të dëgjojnë se sfida për deputetet e Kuvendit, e në veçanti për gratë deputete, është harmonizimi i Ligjit për zgjedhjet dhe Ligjit për partitë politike me Ligjin për barazinë gjinore.

Për ta implementuar Ligjin për barazinë gjinore, në veçanti nenet 3 dhe 4 të këtij ligji, Agjencioni për Barazi Gjinore ka hartuar strategjinë për barazi gjinore 2006-2015, për rritjen e numrit të femrave në institucione dhe është aprovuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2006, si pjesë integrale e strategjisë dhe planit zhvillimor të Kosovës.

Programi i Kosovës për barazi gjinore është dokument strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i hartuar nga Këshilli drejtues i Programit për Barazi Gjinore dhe është miratuar më 19 mars 2008 ku përcaktohet qëllimi, objektivat dhe mekanizmat kryesorë që janë përgjegjës për zbatimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës. Pra, ky program vjen në miratim dy vjet pas hartimit nga Agjencioni për Barazi Gjinore.

Programi për barazi gjinore është i fokusuar në 6 fusha: integrimin e grave në ekonomi; integrimin e grave në tregun e punës dhe përkujdesjes sociale për kategoritë e prekura nga problemet sociale; gratë në procesin e vendimmarrjes; përkujdesja shëndetësore dhe qasja e femrave dhe meshkujve në shërbimet shëndetësore; arsimimi i grave; përfaqësimi dhe kontributi i tyre në kulturë dhe media.

Që ky program të jetë edhe më komplet dhe më i zbatueshëm propozoj që të futet edhe objektivi për siguri dhe gjinia. Koncepti i sigurisë është shumë dimensional, por kjo ndihmon ngritjen dhe monitorimin e politikave të sigurisë në raport me gjininë. Njëherësh ky objektivi është edhe në harmoni me aktet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, e në veçanti të mbrojtjes së grave dhe fëmijëve, në sigurinë e komunitetit, dhunën në familje, trafikimin e qenieve njerëzore, krimin e organizuar, e tjera.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore ka për qëllim të nxisë dialogun e brendshëm për integrimin e barazisë gjinore në Kosovë, që do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe meshkujve në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit, duke i vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në shërbim të shoqërisë. Ky program do t'i shërbejë Qeverisë së Republikës së Kosovës në drejtim të adresimit të çështjeve të barazisë gjinore, aftësimit të kapaciteteve për vendimmarrje gjithëpërfshirëse, shpërndarjen racionale dhe të drejtë të burimeve njerëzore, materiale, financiare, hartimin e planit të veprimit për zbatimin e strategjisë për barazi gjinore.

Programi ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin 3 kapituj, ku janë të renditura shkaqet që prodhojnë varfëri dhe diskriminim gjinor. Pjesa e dytë janë mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore.

Në Kosovë janë krijuar një varg mekanizmesh institucional dhe instrumente ligjore që synojnë avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare. Mekanizmat në nivelin qendror janë: Agjencioni për Barazi Gjinore, Zyra për qeverisje të mirë, institucioni i Ombduspersonit – Njësia për barazi gjinore, zyrtarët për barazi gjinore në ministri dhe Këshilli ndërministror për barazi gjinore, kurse mekanizmat në nivelin lokal janë Zyra për barazi gjinore, që pak para se të vijë në procedim ky program, janë inkorporuar në kuadër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, gjë që me këtë rast do të kërkoja që në kuadër të programit të hyjë kërkesa për rikthimin e funksionalizmit të këtyre zyrave.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, të mbajmë edhe pak qetësinë!

SANIJE ALIAJ: Roli i mekanizmave institucional të grave dhe meshkujve bëhet me qëllim të vlerësimit të efikasitetit të politikave, programeve dhe masave të planifikuara në arritjen e barazisë gjinore.

Në kapitullin III të Programit janë të renditura misioni, vizioni dhe objektivat për arritjen e barazisë gjinore. Misioni i programit është të nxisë aktorët e ndryshëm të shoqërisë, institucionet, shoqërinë civile, individë, partnerë ndërkombëtarë dhe donatorët që të kontribuojnë në mënyrë të koordinuar në arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, përmes implementimit të politikave dhe programeve të parashikuar me këtë dokument.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar një varg ligjesh të cilat garantojnë barazinë gjinore, në mesin e të cilave është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Kosovës, Kodi i familjes dhe ai i pari që ka qenë iniciativë është Ligji për barazi gjinore.

Ky program përbën 8 objektiva strategjike të parapara siç janë: përhapja e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore; mbrojtja e të drejtave dhe fuqizimi i gruas, ndër të tjera, fuqizimi ekonomik i grave dhe pjesëmarrja e barabartë e dy gjinive në vendimmarrje në çështjet e rëndësishme të shoqërisë.

Bordi jo formal i grave deputete, kohë më parë iu drejtua Komisionit për hartimin e Rregullores së Kuvendit të Kosovës, me një amendament që garanton barazinë gjinore në institucionet e Kosovës, por për çudi në Rregulloren e Kuvendit, ky amendament, jo që nuk u respektua, por së paku nuk ishin lodhur për ta renditur si amendament të propozuar nga një mekanizëm që është formuar në kuadër të Kuvendit.

Me këtë rast, do të bëj një krahasim se Kuvendi i Kosovës miraton ligje, por edhe vetë nuk i zbaton. Këtë do ta ilustroja me faktin se në Kryesinë e Kuvendit nuk është asnjë grua. Vetëm dy femra udhëheqin komisionet parlamentare. Asnjë grua nuk është shefe e grupit parlamentar e si të kërkojmë nga Qeveria ta rritë përqindjen, që për momentin në nivelin qendror varion diku mbi 14% e në nivelin lokal 36.9%.

Programi për barazinë gjinore ndahet në dy pjesë. Pjesa e dytë përfshin planin e veprimit dhe dinamikën që duhet të ndërmarrin institucionet bartëse dhe partnere për realizimin e objektivave strategjike të Programit për barazi gjinore.

Duke përcaktuar veprimet që duhet ndërmarrë, kohën e realizimit, burimet buxhetore, treguesit e monitorimit....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete për kontributin! Vazhdojmë me diskutuesin e parafundit, deputetin Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë do të flas shkurt, sepse i thanë të gjitha zonjat dhe zonjushat, vetëm dy rekomandime.

Objektivi strategjik 5, citoj: përmirësimi i treguesve të punës me gratë dhe vajzat, duhet specifikuar më shumë detaje që nxisin zhvillimet e qëndrueshme të punësimit të gratë si dhe stimulimin e faktorëve që ndikojnë në ruajtjen e gjendjes aktuale, pra atë të punësimit. Për shembull, duke inkurajuar kompanitë e mëdha, si dhe institucionet shtetërore që në kuadër të tyre të hapen qendrat e kujdesit ditor të fëmijëve, të njohura si Keys Dey Center, ky është një model amerikan, pra është fjala për gratë me foshnje prej 6 muaj e tutje. Kjo do t'u krijonte më shumë mundësi nënave që pas pushimit të lehonisë të jenë më pranë fëmijës së tyre, gjë që në masë të madhe do t'u mundësonte grave të riktheheshin në tregun e punës.

Dhe rishikimi i buxhetit është një rekomandim i dytë. Pika 8.4 që i referohet, citoj: nxitjes së grave për pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje përmes organizimit të debateve, konferencave, fshatrave, trajnimeve, tribunave e takimeve e tjera. Pika 8.4.1. ku ka buxhet vetëm 6.000 euro, mendojmë se është krejtësisht i pamjaftueshëm dhe duhet të rritet. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Dhe deputeti i fundit i paraqitur për këtë pikë, është zoti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Mos u bëni merak se nuk e kam ndërmend të diskutoj, vetëm të jap një vërejtje lidhur me shifrat që janë dhënë këtu në program, sepse kryesisht janë cituar institucionet ndërkombëtare dhe janë cituar ato të dhëna që janë para vitit 2008. Shumëçka në këtë drejtim ka ndryshuar, andaj ju lusim që të rishikohen edhe një herë këto dhe t'i fusin këto që janë reale.

Dhe një selam në fund, pata për zëvendëskryeministrin, por ai shkoi. Ndoshta merreni ju atje si kryesues dhe si Kryesi e Kuvendit, që të siguroni që deputetët, këta ministrat të marrin pjesë në këto debate për shkak se po diskutohet për çështje të rëndësishme dhe unë besoj, po të kishin qenë këtu, së paku 3 ministra, do të kishin reaguar në shifrat që janë dhënë këtu në këtë material. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Po, jemi në fund fare! Reagim, ndaj kujt? Një minutë, deputetes Aliaj!

SANIJE ALIAJ: Të nderuar deputetë,

Unë jam interesuar nga Ministria për Shërbime Publike të marr informacionin lidhur me përqindjen e përfaqësimit të femrës në institucionet qendrore dhe lokale. Është reale se nga viti 2008, 10% e diçka, në vitin 2009 është rritur në 14% dhe 36.9% e prezanton realitetin e përfaqësimit të femrës në nivelet lokale në institucionet komunale. Kjo është

realitet. Në qoftë se edhe Ministria e Shërbimeve Publike nuk e prezanton realitetin, nuk di ku e kërkojmë tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e ka kërkuar edhe Ibrahim Makolli, për një sqarim.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues!
Pasi që filloi me sqarime, po dua edhe unë të jap një sqarim për hir të objektivitetit, sepse ky mbetet dokument.

Shikoni kolegë se sa joserioze është Agjencia për Barazi Gjinore, kur e përpilon këtë raport, thirret në shënimet... Ne po flasim për këtë që ne kemi këtu, që po e miratojmë. Thirret në shënimin e organizatave, shënimet e vitit 2002. Ne jemi në vitin 2010. Është joserioze që një agjencion që thirret për promovim të barazisë gjinore e të shërbehet me shënime të huaja, ndërkaq do të duhej vetë t'i ketë këto shënime. Shënimet janë kryesisht të vitit 2002 dhe unë besoj shumë që gjendja prej vitit 2002 në vitin 2010 ka ndryshuar së paku për shifra. Prandaj, do të ishte mirë që këtë raport ta rishikojmë edhe një herë Agjencia për Barazi Gjinore këtë strategji në mënyrë që seriozisht të nxjerrim dokument i cili mbetet për të ardhmen, dhe jo kësisoj çfarë e kanë bërë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Meqë debati lidhur me këtë pikë është shteruar, duhet t'ju njoftoj se në sallë kemi 50 deputetë dhe nuk kemi numrin e mjaftuar për të proceduar me votimin e këtij programi e as edhe të pikës së propozuar nga deputeti Ramë Buja për korrigjimin e Rregullores së Punës të Kuvendit, kështu që të gjitha votimet për dy pikat e fundit dhe këtë, mbeten për seancën e radhës. Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve